



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për  
“Dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse,  
nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit  
të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”**

### **RAPORT AUDITIMI**

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**MINISTRIA E FINANCAVE**

**“Auditim i Përputhshmërisë”**

**“ Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve  
matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit  
dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që  
i jepet shoqërisë”**

**Tiranë, korrik 2024**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i rezultateve të auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	5
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>6</b>
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	8
7.	Metodat e auditimit	8
8.	Dokumentimi i auditimit	8
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>9</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	9
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	9
2.1	Auditim mbi procedurën ligjore të ndjekur për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit deri në lidhjen e kontratës koncesionare.	9
2.2	Auditim mbi masat e marra nga MZHETTS dhe MFE për marrjen në konsideratë të mendimeve të dhëna nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe/ose zbatimin e rekomandimeve/vendimeve të lëna nga palë të treta, të cilat kanë kryer hetim, vlerësim ligjor, auditim etj., mbi procedurën e dhënies me koncesion, përmbajtjen e kontratës koncesionare etj.	62
2.3	Auditim mbi masat e marra nga MFE, për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, lidhur me kryerjen e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe për ankesa të përcjella nga vetë koncesionari në drejtim MFE, sa i përket zbatimit të kontratës koncesionare.	<b>68</b>
2.4	Auditim mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.	90
<b>IV.</b>	<b>KONKLuzioni I PËRGJITHSHËM</b>	<b>168</b>
<b>V.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>168</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.**

Grupi i auditimit shqyrtoi procesin e kryer nga MZHETTS dhe MFE, e ndarë në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për procedurën e dhënies me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë “N. C.” sh.p.k.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij**

Auditimi i procedurës së dhënies me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë “N. C.” sh.p.k., ka rëndësi pasi ka efekte në besueshmërinë e konsumatorëve për sasitë e karburantit që furnizohen si dhe në shmangien e detyrimeve tatimore nga subjektet furnizuese.

### **c. Qëllimi dhe objektivat e auditimit**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 09.12.2016, deri 31.12.2022. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Auditim mbi procedurën ligjore të ndjekur për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit deri në lidhjen e kontratës koncesionare.

-Auditim mbi masat e marra nga MZHETTS dhe MFE për marrjen në konsideratë të mendimeve të dhëna nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe/ose zbatimin e rekomandimeve/vendimeve të lëna nga palë të treta, të cilat kanë kryer hetim, vlerësim ligjor, auditim etj., mbi procedurën e dhënies me koncesion, përmbajtjen e kontratës koncesionare etj.

-Auditim mbi masat e marra nga MFE, për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, lidhur me kryerjen e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe për ankesa të përcjella nga vetë koncesionari në drejtim MFE, sa i përket zbatimit të kontratës koncesionare.

-Auditim mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe ka dhënë 17 rekomandime.

### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje të veçantë çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore të procedurës për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit, lidhjen e kontratës

koncesionare, masat e marra nga MFE për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.

-Shkelje e kuadrit rregullator të fushës (koncesioneve) për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, pasi është bërë nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, i cili nuk përfshin dhënien me koncesion një nga fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës.

-Projekt-vendimi dhe relacioni shoqëruar i tij, përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim nga ish Ministri përgjegjës për ekonominë, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të koncesioneve, të organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave, kryesisht në përmbajtjen e projekt-akteve që propozohen për miratim.

-Mendimet e dhëna nga Ministritë e Linjës, kryesisht mendimet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, nuk është në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës.

-Ministria duhet të ishte shprehur kundër dhënies me koncesion, pasi e ka për detyrë (VKM për përgjegjësinë shtetërore) që të vlerësojë nëse një projekt-akt është në përputhje me politikën e qeverisë.

-Kontrata koncesionare në përmbajtjen e saj nuk reflekton plotësisht kërkesat e përcaktuara në DST, detyrim ligjor ky për tu zbatuar nga Autoriteti Kontraktues.

-Nga verifikimi i kryer në sistemin e ngritur nga N. I., konstatohet se nuk ofrohet mundësia për të aksesuar raportet e monitorimit periodike të aktivitetit të koncesionarit;

Në procesin e vënies në dispozicion të dokumenteve përkatës nga subjekti, u verifikuan vështirësi të ardhura nga shkrimet dhe bashkime të ministrisë, duke u reflektuar në zgjatjen e kohës e auditimit.

Auditimi u krye për periudhën 09.12.2016, deri 31.12.2022, bazuar të dhënave të marra në subjekt, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, duke identifikuar fushat e auditimit.

#### **h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

-Strukturat drejtuese në Ministri të marrin masa që në procedurat e dhënies me koncesion, analiza ekonomike dhe financiare si pjesë e studimit të fizibilitetit, të kryhet me përgjegjshmëri e profesionalizëm duke shprehur një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe çdo të ardhur që pritet të krijohet, në të gjithë kohëzgjatjen e projektit.

-Strukturat drejtuese në Ministri duhet të marrin masa për miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare "N. I." SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos. Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, çdo shërbim tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare N. I. SHPK, të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës. Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme.

-Strukturat drejtuese në Ministri të marrin masa që aktiviteti i koncesionarit të kryhet në normalitet si dhe institucionet që janë pjesë e zbatimit të kundërvajtjeve administrative të bashkëpunojnë me përgjegjshmëri e të kryejnë detyrat funksionale për të parandaluar krijimin e evazionit fiskal.

## **I.1. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM I AUDITIMIT**

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Financave “*Për Dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë*”, për periudhën 09.12.2016 deri më datë 31.12.2022, lidhur me përputhshmërinë, rezultuan mangësi kryesisht në procedurën e dhënies me koncesion dhe zbatimin e kontratës koncesionare, si shkelje e kuadrit rregullator të fushës (koncesioneve) për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, pasi është bërë nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, i cili nuk e përfshin dhënien me koncesion në një nga fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës. Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi, ku janë investuar 63,975,994 lekë. U konstatuan mangësi në hartimin e kontratës së koncesionit duke mos pasqyruar kushtet e DST. Gjithashtu u konstatuan mangësi në zbatimin e kontratës nga koncesionari si dhe nga institucionet që mbështesin parregullsitë e konstatuara.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 257/1, datë 03.05.2023, i ndryshuar, “Mbi auditimin e përputhshmërisë në Ministrinë e Financave” (me ndryshime), miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04.05.2023 deri në 19.01.2024 ushtroi auditim “Mbi përputhshmërisë” “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”, për periudhën nga 09.12.2016 – 31.12.2022, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. Sh. (përgjegjës grupi),
2. K. H., anëtar.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:** Ky auditim ka për qëllim kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, të procedurës për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit, lidhjen e kontratës koncesionare, masat e marra nga MFE për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.

Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Kontrulli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) auditoi procesin e kryer nga MZHETTS dhe MFE, në procedurën e dhënies me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë “N. C.” sh.p.k. Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje të veçantë çështjet që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore të procedurës për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit, lidhjen e kontratës koncesionare, masat e marra nga MFE për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.

Në procesin e vënies në dispozicion të dokumenteve përkatës nga subjekti, u verifikuan vështirësi të ardhura nga shkrirje dhe bashkime të ministrisë, duke u reflektuar në zgjatjen e kohës e auditimit.

Auditimi u krye për periudhën 09.12.2016, deri 31.12.2022, bazuar të dhënave të marra në subjekt, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, duke identifikuar fushat e auditimit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 257/1, datë 03.05.2023 “Mbi auditimin e Përputhshmërisë”.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Drejtimi i MZHETTS dhe MFE dhe ministritë e tjera të përfshira në proces. Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e procedurave përkatëse në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e procesit të dhënies, lidhjes së kontratës dhe monitorimit të koncesionit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efiçent të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligjin nr. 125/2013, ‘Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat’, i ndryshuar;

Ligji nr. 162/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”;

Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar;

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;

Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjinr.9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

VKM nr. 365, datë 20.6.2018 “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”;

VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;

VKM Nr.150, datë 22.03.2007 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”, i ndryshuar;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar;

Akte të tjera nën ligjore: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzim i përbashkët METE dhe MF nr.2, datë 08.2.2013 “Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”;

Udhëzim nr. 3492, datë 30.4.2015 "Për koordinimin ndër-institucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzim nr. 35, datë 12.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të standardeve mbi raportimin dhe monitorimin e ecurisë financiare dhe jo-financiare të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat nga autoritetet kontraktuese”;

Urdhër i Ministrisë së METE nr.195, datë 09.03.2009 “Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara”;

Rregullore e brendshme etj.

#### **6. Standardet e Auditimit:**

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;

-INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”.

#### **7. Metodatat e auditimit:**

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

#### **8. Dokumentimi i auditimit:**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet



e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar për Projekt Raportin u përgatit Raporti i Auditimit.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Procedura e dhënies me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, filluar më datë 09.12.2016, me “Propozim i Pa kërkuar”, nga subjekti A. N. C. Sh.P.K., drejtuar MZHETTS ku pretendohet se aktiviteti që kryhet aktualisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, nuk bazohet në teknologji të përparuar, në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës dhe kjo shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer.

Procedura e kryer për dhënien me koncesion, lidhja dhe monitorimi i kontratës.

#### **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

#### **2.1. Auditim mbi procedurën ligjore të ndjekur për shqyrtimin e projektit të propozuar, vlerësimin tekniko-ekonomik, zhvillimin e procedurës, vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit deri në lidhjen e kontratës koncesionare.**

Nga auditimi u konstatua që:

Në zbatim të pikës 1 u audituan çështjet e mëposhtme:

-Kuadri rregullator i fushës, si dhe kuadri rregullator që rregullon çështje të veçanta në këtë procedurë, në fuqi sipas periudhave, në të cilat janë ndërmarrë veprimet nga Autoriteti Kontraktor dhe palët e përfshira në procedurë.

-Forma dhe përmbajtja e propozimit të pa kërkuar dhe dokumentacionit bashkëlidhur, për marrjen me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, paraqitur nga subjekti N. C. Sh.P.K pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

-Ngritja e komisionit për dhënien me koncesion, vlerësimi tekniko-ekonomik i propozimit të subjektit N. C., për të dalë në përfundimin se varianti i dhënies me koncesion të shërbimit publik të verifikimit metrologjik të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, është më i favorshëm, në krahasim me variantin tjetër, pra vazhdimin e ofrimit të tij nga institucioni publik, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

## **I.Përshkrimi i situatës, kronologjia e procedurës së dhënies me koncesion deri në lidhjen e kontratës koncesionare.**

Sipas dokumentacionit rezulton se, për kronologji, dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ka filluar me:

-Me shkresën nr. 98 prot., datë 09.12.2016 “Propozim i Pa kërkuar”, ku subjekti A. N. C. Sh.P.K ka bërë propozimin e pa kërkuar për marrjen me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (GLN), drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes (shkresë e protokolluar pranë MZHETTS me nr. 9666 datë 09.12.2016). Në këtë kërkesë, pasqyrohet informacioni: “Aktiviteti që kryhet aktualisht nga DPM, nuk bazohet në teknologji të përparuar, në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës dhe kjo shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer. Bashkëlidhur shkresës, studimi i fizibilitetit paraqitur nga subjekti.

-Me Urdhrin nr. 10236 datë 30.12.2016, “Për ngritjen e Komisionit për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, të Ministrit të MZHETTS, zj. M. E., është ngritur komisioni i dhënies me koncesion i përbërë nga: G. K., Sekretar i Përgjithshëm i MZHETTS, E. Sh., Inspektor pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, S. H., Drejtor i Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, A. P. dhe G. V., Specialist pranë Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve. Në zbatim të urdhrit të mësipërm, komisioni ngarkohet për kryerjen e detyrave: Hartimi dhe studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik/privat, përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik/privat dhe hartimin e dokumentacionin e tenderit; shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar; formulimin e propozimit të përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së koncesionit/PPP, si dhe një shpjegim të tyre; si dhe kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit/PPP në përputhje me rregulloret në fuqi.

1.Me shkresën nr. 4529 prot, datë 05.05.2017 me lëndë “Dërgohet për mendim një projekt vendim” nënshkruar nga Ministri i MZHETTS zj. M. E., është dërguar për mendim projektvendimi “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, z. P. V., Ministrit të Ministrisë së Financave z. A. A., Ministrit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë z. D. Gj. dhe Ministrit të Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin zj. E. V. F.. Bashkëlidhur shkresës, është relacioni shpjegues, pasqyruar disa prej paragrafëve, si më poshtë vijon: *“I. Qëllimi i Projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen:*

*-Hartimi i këtij projektvendimi është iniciativë ligjore e MZHETTS. Ky projektvendim ka për qëllim të vendosë zhvillimin e projektit të paraqitur pranë MZHETTS si propozim i pa kërkuar, në fushën e metrologjisë.*

*-Nëpërmjet këtij projekti do të rritet ndjeshëm eficientia e veprimtarisë kontrolluese në pajisjet matëse dhe shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe do të eliminohet abuzimi me sasinë në distributorët e karburanteve në vend, duke siguruar përfitime të drejtpërdrejta ekonomike tek konsumatorët.*

*-Aktiviteti që kryejnë institucionet shtetërore (DPM dhe ISHMT) nuk bazohet në teknologji të përparuar në përpunimin e të dhënave dhe monitorimin e punës, çka shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer.*

*-Gjithashtu fakti që këto dy drejtori janë në varësi të të njëjtit institucion krijon problem në pavarësinë efektive dhe kontrollin e punës.*

*III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas*

e ndërkombëtar.

-Ky projektvendim është hartuar duke u mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, nenin 15, të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar.

VIII. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

-Ky projektvendim nuk ka efekte buxhetore."

-Në vijim të shkresës së mësipërme, Ministrinë përkatëse kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me projektvendimin, pasqyruar kronologjikisht si më poshtë vijon:

2.Me shkresën nr.4529/1 prot., datë 16.05.2017, pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin zj. E. V. F., ku është shprehur:

- Të paraqiten kostot e kryerjes së një shërbimi të tillë nga ana e drejtorive përgjegjëse, duke analizuar edhe pse këto kosto shihen si të papërbalueshme për kryerjen e një kontrolli efektiv.
- Cilat janë kostot e pajisjes së institucioneve shtetërore me teknologji të përparuar, që do të mundësonte kryerjen e përpunimit të të dhënave dhe monitorimit të punës.
- Të jepet një pasqyrë e vlerës së investimit që do kryejë shoqëria N. C., duke pasqyruar edhe tarifën e përfaqësuar për shërbimin që do ofrojë.
- Të justifikohet dhënia e një koncesioni të tillë për 20 vjet në bazë edhe të kthimit nga investimi që do përfitojë shoqëria në fjalë.
- Në pritje të një përgjigje nga ana e Ministrisë së Financave për dhënien e koncesionit, bazuar në vendimin nr.146, datë 22.02.2017<sup>1</sup>, nga ana e MZHETTS të qartësohet kuadri legjislativ për DPM, ku të përcaktohen qartësisht kompetencat në mënyrë që të evitohen përplasjet me ISHMT.

2.1.MZHETTS me shkresën nr.4529/6 prot., datë 28.06.2017, i ka kthyer përgjigje Ministrinë të Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin zj. E. V. F., ku është shprehur:

▪ Subjekti që ka identifikuar mundësinë e kryerjes së shërbimit në fjalë dhe ka paraqitur propozimin e pa kërkuar, ka paraqitur edhe një studim fizibiliteti, i cili detajon si më poshtë:

-Kostot e nevojshme për kryerjen e shërbimit të propozuar, si dhe investimin që duhet të kryhet nga subjekti koncesionar. Studimi përmban një përshkrim të hollësishëm në sasi dhe cilësi të pajisjeve laboratorike që do të sigurohen nga subjekti koncesionar. Shoqëria propozuese garanton se të gjithë laboratorët që do të përdorë do të jenë të markuar me vulën CE, për të garantuar një cilësi sa më të lartë të shërbimit.

-Analizë të kostove operacionale të institucionit që e kryen këtë shërbim, si dhe një analizë të përfitimeve ekonomike për buxhetin e shtetit dhe më gjerë që vijnë nga dhënia me koncesion.

-Analizë e hollësishme të përfitimit kryesor që synohet me dhënien e këtij koncesioni, që është ultima ratio përfitimi i konsumatorëve të produkteve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, për të minimizuar abuzimet në sasi të shiten në shpërndarës. Ky përmirësim do të ndikojë jo vetëm në financat e konsumatorit, por rrjedhimisht dhe në të ardhurat që do të hyjnë në buxhetin e shtetit.

-Gjithashtu, studimi shoqërohet nga një analizë e kuadrit ligjor, ku ndahen qartë kompetencat që mund t'i kalohen koncesionarit pa krijuar mbivendosje me detyrat që kryhen nga ISHMT.

2.2. Me shkresën nr.4529/7 prot., datë 03.07.2017, pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin zj. E. V. F., ku është shprehur:

▪ Në përgjigje të shkresës tuaj nr.4529/6 prot., datë 28.06.2017, ju bëjmë me dije se shprehemi dakord me argumentimin e dhënë nga institucioni juaj.

3.Me shkresën nr.4529/2 prot., datë 16.05.2017, pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Drejtësisë z. P. V., ku është shprehur:

---

<sup>1</sup> VKM për disa ndryshime në VKM nr.575, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat".

▪ **Në relacion nuk gjejmë argumente për sa i përket përfutimeve dhe interesave që ka shteti për dhënien me koncesion të shërbimit në fjalë.** Mungesa e përpunimit të të dhënave apo monitorimit të punës nga ana e institucioneve shtetërore DPM dhe ISHMT, siç argumentohet në relacion, nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për të justifikuar ndërmarrjen e kësaj nisme. Për më tepër bëhet fjalë për një sektor që është i ndryshëm nga ato çfarë janë përcaktuar në nenin 4 të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, për të cilin nevojitet një analizë më e kujdesshme dhe gjithë përfshirëse.

▪ Në relacion nuk rezulton të jetë bërë një studim në lidhje me efektivitetin dhe përmirësimin e cilësisë së këtyre shërbimeve, nëse jepen me koncesion sipas kritereve të përcaktuara në nenin 12 dhe 13 të VKM nr.575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar. Paraqitja e një studimi të plotë fizibiliteti, tregon në vetvete qëllimin e projektaktit, objektivat që synohen ta arrihen, argumentimin e propozimit të projekt aktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projekti, nëse projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përbalueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërinë, efeciencës, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe kostos së këtij projekti në buxhetin e shtetit. Elemente që mungojnë në relacionin shpjegues të nismës së përcjellë.

▪ **Gjithashtu neni 10 i VKM nr. 575, datë 10.7.2013 parashikon se çdo operator ekonomik ose grup operatorësh ekonomik, mund të paraqesë një propozim të pa kërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP dhe autoriteti kontraktues i analizon propozimet e tilla me kusht që: a) propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve që parashikohen në nenin 4 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat.** Pra autoriteti kontraktues ka detyrimin që të marrë në shqyrtim vetëm ato propozime që kanë lidhje me një projekt në njërin prej sektorëve që përcaktohen në nenin 4 të Ligjit nr.125/2013 dhe jo nëse këto propozime vijnë për sektorë të ndryshëm nga ato që përcaktohen në ligj. Pika 2 e nenit 4 të Ligjit nr.125/2013, i referohet vetëm rasteve kur këto propozime vijnë nga ministritë e linjës, autoritete të njëjësive të qeverisjes vendore apo organeve qendrore politikës së koncesioneve/partneriteteve publike private, nëpërmjet identifikimit të nevojave dhe mangësive që mund të kenë, **dhe jo rasteve të propozimeve të pa kërkuara.** Ndaj propozimi konkret në këtë rast nuk gjen mbështetje ligjore dhe paraqet paqartësi si sa i takon procedurës së ndjekur, ashtu dhe impaktit që mund të sjellë dhe nevojës reale të tij.

▪ **Teknikisht:** Në vijim të argumenteve të parashtruar më sipër, vlerësojmë se nuk mund të shprehemi lidhur me përmbajtjen e dispozitave konkrete të projektaktit.

▪ **Përfundimisht:** Nga shqyrtimi në tërësi i projektaktit, si dhe duke marrë në konsideratë gjetjet e mësipërme, **propozojmë rivlerësimin e nismës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për koncesionet/partneritetin publik privat.**

**3.1.**Me shkresën nr.3019 prot., datë 19.05.2022 (pra 3 ditë më pas nga mendimi i parë), pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Drejtësisë z. P. V., ku është shprehur:

▪ Në vijim të komunikimeve lidhur me praktikën tuaj me nr.4529, datë 05.05.2017, nëpërmjet së cilës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është kërkuar mendimi mbi projektvendimin, Ministria e Drejtësisë shprehet se:

▪ **Në parim:** Vlerësim për nisjen e procedurave për dhënien me koncesion të një shërbim, është para së gjithash nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor që mbulon fushën e veprimtarisë ku përfshihet objekti i kontratës së koncesionet/PPP.

▪ **Teknikisht: Projektakti është hartuar në përputhje me rregullat e teknikës legislative.**

▪ **Përfundimisht: Për sa më sipër, propozojmë kalimin e nismës për shqyrtimin dhe vlerësimin në Këshillin e Ministrave.**

**4.**Me shkresën nr.4529/3 prot., datë 22.05.2017, pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Financave z. A. A., ku është shprehur:

▪ Sipas relacionit shoqëruar të projektvendimit në rubrikën e vlerësimit të të ardhurave dhe

shpenzimeve buxhetore theksohet se koncesioni nuk do të përcjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit. Nga përmbajtja e këtij relacioni argumentohet se realizimin i këtij projekti pritet të ketë përfitime të rëndësishme të cilat konsistojnë në sigurimin e pavarësisë teknike, në kryerjen e kontrollit me standard dhe integritet dhe eliminimin e abuzimeve në sasi duke mundësuar përfitime ekonomike për konsumatorin dhe ekonominë në përgjithësi.

**Nga ana tjetër**, rezulton se në këtë relacion **nuk është argumentuar se cili do të ishte impakti në buxhet në lidhje me të ardhurat që realizon Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nga ofrimi i shërbimit të verifikimit të instrumenteve matëse, nëse do të bëhej kalimi i këtij shërbimi nga shteti tek privati.**

▪ Për sa më sipër në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, MZHETTS, si institucioni që ka në fushën e përgjegjësi veprimtarinë për menaxhimin e sistemit kombëtar të metrologjisë në RSH, **duhet të marrë paraprakisht miratimin nga Këshilli i Ministrave për dhënien me koncesion/PPP të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Nëse më pas, me VKM përcaktohet se kjo veprimtari mund të jepet me koncesion/PPP, duhet të procedohet me kërkimin për dhënien e bonusit në mbështetje të ligjit.**

5.Me shkresën nr.4529/5 prot., datë 25.05.2017, pranë MZHETTS, ka kthyer përgjigje Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në mungesë dhe me porosi Zv. Ministri z. I. B., ku është shprehur:

▪ *Ministria e Energjisë dhe Industrisë shprehet në parim dakord për miratimin e tij.*

6.Me shkresën nr. 4529/8 datë 17.08.2017, me lëndë “Dërgohet për shqyrtim dhe miratim një projektvendim”, Ministri i MZHETTS, zj. M. E., i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, z. E. A.. Bashkëlidhur shkresës, është relacioni shpjegues, pasqyruar disa prej paragrafëve, si më poshtë vijon:

### **I. Qëllimi i Projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen**

-Hartimi i këtij projektvendimi është iniciativë ligjore e MZHETTS. Ky projektvendim ka për qëllim të vendosë zhvillimin e projektit të paraqitur pranë MZHETTS si propozim i pakërkuar, në fushën e metrologjisë.

-Nëpërmjet këtij projekti do të rritet ndjeshëm eficienca e veprimtarisë kontrolluese në pajisjet matëse dhe shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe do të elinohet abuzimi me sasinë në distributorët e karburanteve në vend, duke siguruar përfitime të drejtpërdrejta ekonomike tek konsumatorët.

-Aktiviteti që kryejnë institucionet shtetërore (DPM dhe ISHMT) nuk bazohet në teknologji të përparuar në përpunimin e të dhënave dhe monitorimin e punës, ç’ka shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer.

-Gjithashtu fakti që këto dy drejtori janë në varësi të të njëjtit institucion krijon problem në pavarësinë efektive dhe kontrollin e punës.

### **III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar**

-Ky projektvendim është hartuar duke u mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 1251/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, nenit 15, të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar.

### **VII. Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit**

Projektvendimi është hartuar nga MZHETTS dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

*Ministria e Drejtësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin janë shprehur në parim dakord.*

*Lidhur me sugjerimet e Ministrisë së Financave sqarojmë se projektvendimi është hartuar në bazë të pikës 2 të nenit 4 të Ligjit, 125/2013, si dhe pikës 15 të VKM nr.575, datë 10.07.2013.*

### **VIII. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore**

*-Ky projektvendim nuk ka efekte buxhetore.*

Nga data 17.08.2017 deri më datë 20.06.2018, në dosjen e procedurës së dhënë me koncesion vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk administrohet asnjë dokumentacion mbi ecurinë e procedurës/korrespondencë që lidhet me procedurën përkatëse.

-Me VKM nr.365, datë 20.06.2018, miratohet dhënia me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit (10% të pikëve) në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë N. C..

-Me Urdhrin nr. 195 datë 12.07.2018, “Për ngritjen e Komisionit për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, të Ministrit të MFE, z. A. A., është ngritur komisioni i dhënies me koncesion i përbërë nga: E. M., Kryetar i komisionit, Përgjegjës Sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve në MFE, E. O., Anëtar, Specialist pranë Drejtorisë së Koncesioneve në MFE, A. U., Anëtar, Specialist pranë Drejtorisë Juridike në MFE, A. P. dhe G. V., Anëtar, Specialist pranë Agjencisë së Trajtimin të Koncesioneve. Në zbatim të urdhrin të mësipërm, komisioni ngarkohet për kryerjen e detyrave: Hartimi dhe studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik/privat, përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik/privat dhe hartimin e dokumentacionin e tenderit; shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar; formulimin e propozimit të përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së koncesionit/PPP, si dhe një shpjegim të tyre; si dhe kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit/PPP në përputhje me rregulloret në fuqi.

-Me procesverbalin nr.1, datë 13.07.2018, komisioni i dhënies me koncesion ka vendosur t’i drejtohet shoqërisë N. C., për paraqitjen e propozimit të përgatitur, si subjekti që ka paraqitur propozimin e pa kërkuar dhe ka marrë bonusin.

-Me shkresën nr.13462/1 prot., datë 13.07.2018, Sekretari i Përgjithshëm pranë MFE, zj. G. P., i është drejtuar shoqërisë N. C., ku i kërkohet përcjellja e propozimit të përgatitur nga shoqëria, në përputhje me VKM-në nr. 365, datë 20.06.2018.

-Me shkresën nr. 13462/2 datë 23.07.2018 shoqëria N. C. dërgon në MFE-së studimin e fizibilitetit të projektit.

-Me procesverbalin nr.2, datë 24.07.2018, komisioni i dhënies me koncesion ka vendosur përgatitjen e studimit të fizibilitetit.

-Me procesverbalin nr.3, datë 31.07.2018, komisioni i dhënies me koncesion ka zhvilluar diskutime me çështje që përfshihen në studimin e fizibilitetit, me qëllim përmirësimin e projektit.

-Me procesverbalin nr.4, datë 06.08.2018, komisioni i dhënies me koncesion ka vendosur shqyrtimin e studimit të fizibilitetit.

-Me procesverbalin nr.5, datë 08.08.2018, komisioni i dhënies është mbledhur për trajtimin përfundimtar të studimit të fizibilitetit, si dhe përgatitjen e raportit përmbledhës informues.

-Në vijim në dosje administrohet studimi i fizibilitetit, me mbishkrimin “Gusht 2018”.

**Arsyetimi i vendimit të dhënies me koncesion, pika 5, analiza e flukseve monetare, pika 5.2,**

## **komisioni parashtron:**

*-Duke qenë se të ardhurat nga kontrolli ligjor mbulojnë plotësisht kostot, aktiviteti i DPM konsiderohet në pamje të parë me fitim (të ardhurat në DPM nuk janë subjekt i tatim fitimit, si dhe DPM nuk llogaritet amortizim kontabël). Sidoqoftë të ardhurat nga ky shërbim nuk kalojnë në buxhetin e shtetit, pra kanë një efekt zero (Faqe 90 paragrafi i fundit i studimit të fizibilitetit nga komisioni).*

*-Referuar studimit të fizibilitetit të projektit, **dhënia me koncesion nuk do të sjellë impakt negativ në buxhetin e shtetit pasi tarifa që mblihet aktualisht, mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.***

-Në vazhdim, pika 5.3 Konkluzionet e komisionit: Nga analiza krahasuese e projektit për koncesion në studimin e fizibilitetit me projektin e ofruar tashmë nga DPM, **dhënia me koncesion ka një leverdishmëri të dukshme ekonomike dhe financiare për buxhetin e shtetit, i cili në situatën aktuale del i dëmtuar për shkak se nga tarifat e këtij shërbimi nuk ka asnjë kontribut në buxhet**, madje problematika të këtij shërbimi dëmtojnë buxhetin e shtetit për shkak të evazionit që lidhet me abuzimet me sasinë e karburantit që shitet etj.

-Më datë 10.08.2018 komisioni përkatës i dërgon Ministrin të MFE raportin përmbledhës në lidhje me projektin e koncesionit, ku parashtrohet si më poshtë vijon:

“Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë kryen verifikimin e instrumenteve matëse, përfshirë këtu distributorët e karburantit, ndërkohë që Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka funksionin e inspektimit. Aktiviteti që kryhet nga institucionet shtetërore nuk bazohet në një teknologji të përparuar në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës, e cila shkakton mungesë efikasiteti në operacione si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer. Kjo teknologji ka nevojë të përmirësohet me qëllim realizimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm sipas standardeve me të mira ndërkombëtare”.

-Memo e datës 22.08.2018 e Drejtorisë së Koncesioneve, ish Drejtor i Drejtorisë, zj. A. K., drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik, Drejtor i Drejtorisë zj. M. Dh., për mendim studimin e fizibilitetit për projektin.

-Proces-verbal nr. 6 datë 24.08.2018 nga Komisioni i ngritur me Urdhër 195 datë 12.07.2018, bën me dije se ka përfunduar hartimin e Dokumenteve të Tenderit, në përputhje me VKM nr.575 datë 10.07.2013, që gjenden bashkëlidhur.

-Raport përmbledhës datë 24.08.2018 nga Komisioni, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm zj. G. P., ku përveç të tjera (të përmendura edhe në raportin e datës 11.08.2018), bëhet me dije se pas miratimit të studimit të Fizibilitetit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, komisioni ka vijuar punën me hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së hapur.

-Memo e datës 27.08.2018 e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik, kthim përgjigje drejtuar Drejtorisë së Koncesioneve. Në përgjigje, kjo Drejtori shprehet pa komente përsa kohë ky projekt nuk shoqërohet me kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

-Memo datë 03.09.2018 e Sekretarit të Përgjithshëm zj. G. P. drejtuar Ministrin të Financave dhe Ekonomisë z. A. A., në lidhje me vlerësimin e projektit për dhënien me koncesion të “Shërbimit të kontrollit ligjor nëpërmjet verifikimit të instrumenteve të shpërndarjes së karburantit” ku kërkohet miratimi për vijimin e procedurave nga Komisioni i Dhënies së Koncesionit në lidhje me këtë projekt. Strukturat përkatëse në Ministrinë e Financave janë shprehur parimisht dakord me vazhdimin e procedurave.

-Më datë 21.08.2019, nënshkruhet Kontrata Koncesionare nr. 15326 prot datë 21.08.2019 ndërmjet MFE, koncesionarit “N. C.” dhe shoqërisë koncesionare SPV “N. I.”.

## **Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohen veprime dhe mosveprime, si më poshtë vijon:**

**1.** Në shkresën nr. 98 prot., datë 09.12.2016, nëpërmjet të cilës është paraqitur propozimi i pa kërkuar, administrohet bashkëlidhur studimi i fizibilitetit, me mbishkrimin viti 2017, pra nuk përputhet me datën në të cilën është paraqitur në MZHETTS, propozimi i pa kërkuar.

Veç sa më sipër, në dosjen përkatëse, administrohet edhe dokumenti me mbishkrimin “arsyetimi i vendimit të dhënies me koncesion”, ku nuk dokumentohet se kush e ka hartuar, pasi është një dokument pa nënshkrimin e punonjësit/punonjësve, vulën e institucionit, nuk ka datë ku të pasqyrohet koha kur është hartuar, nuk ka numrin e protokollit, nuk administrohet procesverbali i komisionit të dhënies me koncesion ku të shprehet për hartimin e këtij dokumenti, nuk administrohet raporti përmbledhës ku t’i drejtohet titullarit të AK, si dhe miratimi i tij.

-Pra sa më sipër, në kushtet kur dokumentacioni i mësipërm nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 13 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi vërtetësinë dhe përmbajtjen e dokumentacionit të mësipërm.

**2.** Veprime në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, pasi është bërë nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, i cili nuk përfshin dhënien me koncesion një nga sektorët e përcaktuar në ligjin e koncesioneve. Konkretisht:

-Pranë MZHETTS është dorëzuar propozim i pa kërkuar për nisjen e procedurës së dhënies me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të intrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Propozimi i pa kërkuar është bërë për fushat që nuk parashikohen në dhënien me koncesion. Propozimet e pa kërkuara pranohen dhe shqyrtohen nga Autoriteti Kontraktor për ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, por në këtë rast nuk propozohet për këto fusha.

Pavarësisht sa më sipër, MZHETTS ka vazhduar procedurën, duke ngritur komisionin e dhënies me koncesion, kryerjen e disa detyrave, çka do të thotë që propozimi i pa kërkuar është pranuar marrë në shqyrtim nga MZHETTS.

Gjithashtu edhe nga informacionet që pasqyrohen në shkresat “kthim-përgjigje” të MZHETTS, konkretisht shkresa drejtuar Ministrisë të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, rezulton se MZHETTS shprehet për studimin që ka kryer subjekti mbi bazën e të cilit ka propozuar edhe projektvendimin për dhënien me koncesion. Gjithashtu edhe pika 2 e projektvendimit të propozuar, ku është përcaktuar dhënia e bonusit me 10% të pikëve për shoqërinë N. C.. Bonusi propozohet nga Autoriteti Kontraktor në Këshillin e Ministrave dhe jepet për rezultatin tekniko-financiar të arritur. Pra qartë kuptohet se duhet të shqyrtosh propozimin, që të propozosh dhënien e bonusit. Edhe në relacionin që shoqëron projektvendimin e propozuar, Kreu I, pasqyrohet informacioni “Ky projektvendim ka për qëllim të vendosë **zhvillimin e projektit të paraqitur pranë MZHETTS si propozim i pa kërkuar**, në fushën e metrologjisë”.

Faktet e mësipërme, tregojnë se propozimi i pa kërkuar është pranuar dhe marrë në shqyrtim. Pra MZHETTS nuk e ka identifikuar vetë projektin, duke ngritur një grup pune, nëpërmjet të cilit të identifikohen nevojat dhe mangësitë që mund të ketë shërbimi që ofrohet nga DPM, duke vijuar me kryerjen e një vlerësimi financiar, teknik dhe ligjor, ku kuadri rregullator i koncesioneve parashikon edhe marrjen e ekspertëve të fushës, që më pas t’i drejtohej Këshillit të Ministrave për të propozuar dhënien me koncesion të fushës përkatëse, fillimisht dhe pas miratimit të pranonte dhe shqyrtonte propozime të pa kërkuara/t’i drejtohej operatorëve ekonomik të ndryshëm, për përgatitjen e propozimeve, duke vijuar me veprimet e tjera deri në lidhjen e kontratës koncesionare. Konstatimi i mësipërm mbështetet në përcaktimet ligjore të bëra në:

-Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar me Ligjin nr. 88/2014 dhe Ligjin Nr.77/2015, në fuqi për periudhën kur janë kryer veprimet e MZHETTS, konkretisht:



Neni 3, pika 10: “Objekti i koncesionit” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruara në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj.

Neni 4, pika 1: Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme:

- a) transport (sistemin e hekurudhave, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimin, transportin publik);
- b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;
- c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;
- ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;
- d) telekomunikacion;
- dh) shkencë dhe arsim;
- e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;
- ë) kulturë dhe sport;
- f) shëndetësi;
- g) shërbime sociale;
- gj) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;
- h) rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- i) parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;
- j) strehim;
- k) godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;
- l) shpërndarje e gazit natyror;
- ll) rehabilitim dhe zhvillim urban dhe sub-urban;
- m) ndriçimi publik në territorin e njësisve administrative vendore;
- n) bujqësi.

Neni 4, pika 2: Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës apo propozime që këto i marrin nga autoritete të njësisve të qeverisjes vendore apo të organeve qendrore të politikës së koncesioneve/partneriteteve publike private, vendos për koncesionet/partneritetet publike private që zbatohen në sektorë të tjerë.

Duke vijuar me nenin 17, pika 1: Autoriteti kontraktues **identifikon** dhe shqyrton projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat brenda sferës së kompetencave të tij – Në këtë rast MZHETTS nuk ka bërë vetë identifikim të projektit.

Neni 17, pika 2: Autoriteti kontraktues informohet dhe mund të marrë në shqyrtim projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat të identifikuar apo të propozuara nga:

- a) Kryeministria – Nuk ka propozim nga Kryeministria;
- b) autoritetet e tjera kontraktuese të së njëjtës hierarki administrative, organet e qeverisjes qendrore apo vendore – Nuk ka propozim nga autoritete të tjera;
- c) institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit – Nuk ka propozim nga këto institucione;
- ç) institucionet dhe organizatat shkencore vendase dhe ndërkombëtare – Nuk ka propozim nga këto institucione;
- d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pa kërkuara – Ka një propozim të pa kërkuar, por në zbatim të pikës 7 të nenit 25 të Ligjit të mësipërm, është miratuar VKM nr.575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, ku në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 13 rregullohet procedura për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjes dhe trajtimit të propozimeve të pa kërkuara, konkretisht:

Çdo operator ekonomik ose grup operatorësh ekonomikë, referuar më poshtë si propozuesi, mund të paraqesë një propozim të pa kërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP dhe autoriteti

kontraktues i analizon propozimet e tilla, me kusht që: a) propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve që parashikohen në nenin 4 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat – Propozimi i pa kërkuar nuk lidhet me asnjë nga fushat e përcaktuara në nenin 4. Në kushtet e mësipërme, MZHETTS duhet të kishte refuzuar propozimin e pa kërkuar.

Gjithashtu në nenin 3, pika 2 në VKM nr.575, datë 10.7.2013, përcaktohet:

3. Bazuar në dispozitat e nenit 17 të ligjit, **pikënisja e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit/PPP mund të jetë:**

a) procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori – Nuk ka një proces të tillë, për më tepër që në këtë periudhë ka qenë në fuqi Strategjia Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut (SNMKMT) 2015-2020<sup>2</sup>, e përgatitur nga vetë MZHETTS. Në planin e veprimit të strategjisë nuk parashikohet në asnjë rast dhënia e këtij shërbimi ndaj privatit, përkundrazi parashikohet fuqizimi i DPM në ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës në tërësi, pjesë e të cilit janë edhe instrumentet matës të naftës dhe gazit të lëngshëm.

b) analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit – Nuk ka një raport për analizën e gjendjes infrastrukturore, identifikimin e mungesave dhe/ose nevojave të investimit. Për më tepër që nuk ka asnjë raport auditimi të vetë MZHETTS që të ketë identifikuar mangësitë e kryerjes së këtij shërbimi nga DPM.

c) projekttime të nxitura nga prioritetet e politikave – Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015-2020 është një dokument politik i qeverisë, cilësuar në krye të herës në përmbajtje të strategjisë, siç e kemi theksuar edhe më sipër nuk parashikon dhënien e këtij shërbimi privatit.

Bazuar në përcaktimet e bëra në nenin 3 të pikës 4, përcaktohet se Autoriteti Kontraktor ngre komisionin e koncesionit, por për të bërë raportin përmbledhës, i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë e të përshtatshmërisë së **idesë së projektit** dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit – Pra nëpërmjet këtij raporti analizohet situata, mangësitë, nevojat, për të ardhur tek përcaktimi i bërë në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 3 në VKM nr.575, datë 10.07.2013.

**3.**Projekt-vendimi dhe relacioni shoqërues i tij, përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim nga ish Ministri përgjegjës për ekonominë zj. M. E., është në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator të koncesioneve, të organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave, kryesisht në përmbajtjen e projekt-akteve që propozohen për miratim, fushën e përgjegjësisë shtetërore të MZHETTS; Veç sa më sipër relacioni shoqërues përmban të dhëna të rreme, sa i përket mungesës së efekteve në buxhet të këtij projekt vendimi.

Konkretisht, në:

-Ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; Neni 24, pika 1: Propozuesit e projekt akteve jua dërgojnë për mendim ministrive dhe institucioneve të tjera të interesuara projektaktin dhe një relacion shpjegues për objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e tij – Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se projektakti nuk i është dërguar për mendim Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, institucion i interesuar.

Neni 25, pika 1: Propozimet e projektakteve, që paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, duhet të përmbajnë projektaktin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive ose të institucioneve të interesuara, dokumentacionin që shoqëron projektaktin, në varësi të kërkesave të ligjit ose të përmbajtjes së tij, si dhe përmbledhjen që do të përfshihet në komunikatën për mediat – Në relacion nuk janë pasqyruar plotësisht mendimet dhe vërejtjet e ministrive. Konkretisht nuk pasqyrohet i plotë mendimi i dhënë nga Ministria e Financave, si dhe mendimi i parë i dhënë nga Ministria e Drejtësisë.

Nenin 25, pika 2: Relacionet duhet të përmbajnë:

<sup>2</sup> Miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015. [https://kmk-financa-gov-al.translate.google.com/miratimi-i-strategjise-se-mbrojtjes-se-konsumatoreve-dhe-mbikeqyrjes-se-tregut-2020/?\\_x\\_tr\\_sch=http&\\_x\\_tr\\_sl=sq&\\_x\\_tr\\_tl=en&\\_x\\_tr\\_hl=en&\\_x\\_tr\\_pto=sc](https://kmk-financa-gov-al.translate.google.com/miratimi-i-strategjise-se-mbrojtjes-se-konsumatoreve-dhe-mbikeqyrjes-se-tregut-2020/?_x_tr_sch=http&_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en&_x_tr_pto=sc)

a) objektivat që synohen të arrihen, lidhjen ose jo me programin politik të Këshillit të Ministrave – Objektivat e pasqyruara në relacion nuk janë konkrete dhe të matshme. Thuhet se do të rritet ndjeshëm eficientia e veprimtarisë kontrolluese në pajisjet matëse dhe shpërndarëse të karburantit, por pa përcaktuar se çfarë indikatorësh janë përdorur për të vlerësuar eficientinë ekzistuese, si dhe treguesit konkret se sa do të rritet eficientia. Thuhet për eliminim në abuzimet në sasi, por nuk jepen të dhëna konkrete se sa është abuzimi në sasi dhe vlera monetare përkatëse. Thuhet se do të mundësojë përfitime ekonomike për konsumatorin final dhe ekonominë në përgjithësi, por nuk jepen të dhëna konkrete cilësore dhe sasiore, pra cilat do të jenë përfitimet ekonomike dhe sa do të jenë ato në terma të matshëm. Për më tepër që bien në kundërshtim me objektivat e përcaktuar në SNMKMT 2015-2020.

b) argumentin që objektivat e projektaktit nuk mund të arrihen me instrumentet ekzistuese ligjore – Në relacion nuk pasqyrohet një argument i tillë.

ç) përputhshmërinë me Kushtetutën dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Në rastin e projektligjeve, të akteve normative me fuqinë e ligjit dhe të akteve normative edhe shkallën e përputhshmërisë së projektaktit me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë – Nuk pasqyrohet përputhshmëria e këtij projektvendimi me legjislacionin e fushës, atë të metrologjisë. Nuk sigurohet përputhshmëria e propozimit të bonusit me 10% të pikëve, pasi sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “j” të pikës 4 të nenit 3 në VKM nr. nr.575, datë 10.7.2013, propozimi për dhënien e pikëve bonus jepet në raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit, por në fakt nuk ka një raport të tillë. Pra edhe propozimi i bonusit në projektvendim nuk është bërë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, në këtë rast të VKM së mësipërme.

d) shpjegimin për marrjen ose jo parasysish të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrive ose të institucioneve të tjera të interesuara – Nuk jepet shpjegim i plotë për mendimin e dhënë nga Ministria e Financave, e cila kërkon edhe analizën financiare, pra efektin në të ardhurat e buxhetit të shtetit, nëse ky shërbim kalon nga shteti tek privati. MZHETTS në relacion ka dhënë shpjegim vetëm për vërejtjen e Ministrit të Financave mbi përputhshmërinë ligjore të procedurës së ndjekur, por jo edhe për analizën financiare.

3. Për projektaktet me karakter financiar-ekonomik, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare, që rrjedhin nga zbatimi i tyre – Ky projektakt ndër të tjera, shoqërohet me efekte buxhetore, konkretisht në të ardhurat e buxhetit të shtetit<sup>3</sup>. Ndërkohë në relacionin shoqërues të projektaktit, thuhet se nuk ka efekte në buxhet. Për më tepër që edhe Ministri i Financave e ka kërkuar analizën e efekteve financiare.

-Në vijim të sa më sipër, për të mbështetur konstatimin, parashtrojmë gjithashtu se DPM nga shërbimi i verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm, vetëm në vitin 2016, ka realizuar 76,193,123 lekë (pa TVSH) nga 128,641,427 lekë (pa TVSH) që ka realizuar metrologjia ligjore në total për këtë vit.

-Në vijim të paragrafit të mësipërm dhe në zbatim të VKM nr.571, datë 29.08.2012 “Për lejimin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga DPM gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etalonëve kombëtare të matjeve”, DPM nga të ardhurat vjetore të realizuara ka të drejtën e përdorimit të vlerës prej 10,000,000 lekë dhe pjesa tjetër kalon në buxhetin e shtetit. Pra edhe sikur DPM të ofronte vetëm shërbimin e verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit, minimalisht në buxhetin e shtetit derdhen 66,193,123 lekë (76,193,123 lekë - 10,000,000 lekë), vlerë e cila përbën efektin në buxhetin e shtetit. Pra në këtë rast konstatohet se ky projektvendim ka efekte buxhetore. Ky fakt evidentohet edhe nga akt-rakordimi i të ardhurave vjetore 2016, mbajtur ndërmjet DPM dhe Degës së Thesarit, pasqyruar si më poshtë:

<sup>3</sup> Pika 1 në nenin 3 dhe neni 5 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

RAKORDIMI I TE ARDHURAVE

Periudha JANAR - DHJETOR 2018

Gr.	TITUL	KAP	Dis.	Lok.	Institucio ni	Artikulli	Pershkrimi	Totali i arketuar	Pjesa e Institucionit	Rritje te autorizuar	Per tu derdhur ne buxhet	Mbeten per tu trashëguar
711	7110	71101	3535	0	1004109	7110199	Te ardhura nga sherbimi	138,641,427.48	0.00	10,000,000.00	128,641,427.48	0.00
466	4664	46641	3535	0	1004109	4664100	Derdh.gabim viti vazhdim	27,028,549.00	0.00	27,028,549.00	0.00	0.00
711	7115	71154	3535	0	1004109	7115499	Gjoha	3,052,785.73	0.00	0.00	3,052,785.73	0.00
711	7115	71156	3535	0	1004109	7115600	Deitore	323,466.80	0.00	0.00	323,466.80	0.00
710	7109	71096	3535	0	1004109	7109600	Qera	19,949.40	0.00	0.00	19,949.40	0.00
<b>TOTALI</b>								<b>169,066,178.41</b>	<b>0.00</b>	<b>37,028,549.00</b>	<b>132,037,629.41</b>	<b>0.00</b>

PERFAQESUESI I DPM-ee

Petrit RAMA

PERFAQESUESI I THESARIT

Petraq SHANTO

PERGJEGJESE E SEKTORIT TE TE ARDHURAVE

Shqipe ÇERA

Sa më sipër evidentohet qartë se të ardhurat nga shërbimet që ofron DPM, pjesë e të cilave është edhe ai i verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit, kalojnë në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu nga MZHETTS duhet të ishte pasqyruar analiza, e të ardhurave të realizuara nga DPM me të ardhurat që do të realizohen nga tarifa koncesionare me tatim fitimin, duke evidentuar efektin në buxhet të projektvendimit, nëpërmjet të cilit shërbimi do të kalojë nga shteti tek privati. Nëse do t'i referoheshim studimit të fizibilitetit të dorëzuar nga shoqëria N. C., më datë 23.07.2018, me shkresën nr.13462/2 prot., dhe më konkretisht vitit 2019, si vit i plotë aktiviteti në përllogaritjet e kryera nga subjekti, kemi 2,331,370 lekë të ardhura nga tarifa e koncesionit + 1,121,155 tatim mbi fitimin = 3,452,525 lekë të ardhura për buxhetin e shtetit. (Sqarojmë se TVSH është e ardhur që realizohet në të dy rastet, pra si nga DPM dhe nga subjekti privat. Për më tepër që të ardhurat nga TVSH që do të arkëtohen nga private nuk kanë prirje të ndryshojnë me të ardhurat nga TVSH që arkëtohen nga DPM, pasi privati do e kryejë punën e tij mbi bazën e të dhënave për stacionet e karburantit që do të vendosen në dispozicion nga DPM. Pra do të kemi të njëjtin nr. verifikimesh të instrumenteve. Gjithashtu për përfitimin në drejtime të tjera fiskale, pra ulja e evazionit fiskal, nuk është bërë përllogaritje se sa do të jetë në terma të matshëm) Nëse do t'i referoheshim faktit të të ardhurave në buxhetin e shtetit nga tarifa koncesionare dhe tatimi mbi fitimin (duke marrë vitin 2021, si një vit i plotë i aktivitetit të koncesionarit, për ta vendosur në kushte të barabarta), rezulton se në buxhetin e shtetit janë arkëtuar 2,405,255 lekë tarifa koncesionare + 919,437 tatim mbi fitimin = 3,324,692 lekë, janë të ardhurat në buxhetin e shtetit nga dhënia me koncesion.

Pra sa më sipër në rastin e parë (fazën studimore) efekti negativ në reduktimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit është 62,740,597 lekë, ndërsa në rastin e dytë (faza e zbatimit të kontratës), efekti negativ në reduktimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit është 62,868,431 lekë.

-VKM Nr.584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar;

Kreu II, pika 4: Ministrat e ushtrojnë këtë të drejtë (propozimin e projektakteve) në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore – Projektakti nuk është në përputhje me përgjegjësitë që burojnë nga Strategjia Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut.

Kreu III, pika 12: Përpara fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike në bashkërendim me strukturën juridike, bëjnë vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit ku përfshihen, ndërmjet të tjerave, shpjegime lidhur me:

- a) qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen;
- b) përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore;
- c) pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi;
- ç) parashikimet dhe masat, që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit;
- d) shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme.

-Në dosjen e procedurës nuk rezulton të ketë një vlerësim paraprak të nismës për propozimin e projektaktit.

Kreu III, pika 14: Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues ose specialistë të drejtorive, sektorëve ose enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit – Konstatohet se nuk janë organizuar këshillime gjatë hartimit të projektaktit, minimalisht me DPM, si strukturë e fushës përkatëse në MZHETTS.

Kreu III, pika 16: Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë relacionin shpjegues të projektaktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar përpara se t'i dërgohen për shqyrtim ministrit – Konstatohet se nuk është kryer raporti i vlerësimit të të ardhurave.

Kreu V, pika 30: Projektakti ripunohet duke marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara. Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë dhe sipas rastit ministrat e treguar në pikat 22/1 deri 27 të kësaj rregulloreje, shihen me përparësi gjatë ripunimit të projektaktit – Konstatohet se projektakti edhe pas sugjerimeve të bëra nga Ministri i Financave, nuk është ripunuar.

Kreu VI, pika 45: Propozimet e projekteve shoqërohen me:

- a) projektaktin e bashkërenduar me ministritë përkatëse;
- b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mos-reflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministritë e interesuara;
- c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara me përjashtim të rasteve kur, për shkak të mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 28, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin. Në çdo rast mendimi i Ministrit të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin – Konstatohet se nuk jepet shpjegim i plotë për mendimin e dhënë nga Ministria e Financave, e cila kërkon edhe analizën financiare, pra efektin në të ardhurat e buxhetit të shtetit, nëse ky shërbim kalon nga shteti tek privati. MZHETTS në relacion ka dhënë shpjegim vetëm për vërejtjen e Ministrit të Financave mbi përputhshmërinë ligjore të procedurës së ndjekur, por jo edhe për analizën financiare. Konstatohet se nuk janë bashkëlidhur mendimet e ministrive.

-VKM Nr.835, datë 18.09.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të MZHETTS”, i ndryshuar;

Kreu II: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri.

Kreu III, pika 1: Hartimi dhe zbatimi i strategjive e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik, për të gjitha institucionet qendrore në vend.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së SNMKMT 2015-2020, konkretisht informacionit që lidhet me infrastrukturën e cilësisë dhe veçanërisht me metrologjinë, pjesë përbërëse e infrastrukturës së

cilësisë, konstatohet se nga MZHETTS nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në VKM Nr.835, datë 18.09.2013.

Për sqarim të konstatimit të mësipërm, pasqyrojmë disa prej informacioneve dhe objektivave të SNMKMT 2015-2020, si më poshtë vijon:

### **Kapitulli 1.2**

-Infrastruktura e Cilësisë (standardizim, metrologji, akreditim, testim-certifikim, vlerësim konformiteti) përbën themelin e reformave në tregun brendshëm, të cilat krijojnë premiset për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, **mbrojtjen e interesave ekonomike** të konsumatorit dhe të sektorit privat, në lidhje me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në Shqipëri.

#### **Kapitulli 1.2.3 Metrologjia**

-**Asnjë ekonomi tregu** nuk mund të funksionojë pa një sistem kombëtar metrologjie, që të jetë në gjendje të realizojë matje të harmonizuara të njohura ndërkombëtarit, në përputhje me sistemin ndërkombëtar të njësive të matjeve "SI".

-Në ekonominë e zhvilluara dhe në shtete të veçanta, përfshi ato që janë vende në zhvillim ose të gatshëm për të hyrë në tregun ndërkombëtar, matjet përbëjnë rreth 3-6 për qind të GDP. Sistemi i metrologjisë është një prej komponentëve kyç të infrastrukturës së çdo shteti.

-**Ngritja dhe forcimi** i infrastrukturës metrologjike për të përmbushur nevojat e vendit tonë, si dhe integrimi në infrastrukturën metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare janë parë me përparësi nga Qeveria Shqiptare dhe donatorët e huaj.

-**Metrologjia Ligjore** është një aktivitet i rëndësishëm dhe tradicional i funksionimit të shtetit, që ka qëllim **mbrojtjen e interesave ekonomike** të konsumatorëve nga matjet e pasakta në transaksionet tregtare dhe zyrtare, në fushat e sigurisë, shëndetit, ambientit, etj nëpërmjet kontrollit metrologjik ligjor të instrumenteve matës.

## **2.Kapitulli II: Vizioni, Politikat dhe qëllimet e Politikave**

### **2.2 Qëllimet e politikave**

**Në fushën e metrologjisë** do të vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e legjislacionit në fushën e metrologjisë duke e harmonizuar atë me dokumentet dhe praktikën e mira evropiane, për zgjerimin e shërbimeve metrologjike të kërkuara nga industria dhe biznesi dhe arritjen e njohjes ndërkombëtare të dokumenteve të lëshuara nga DPM, për rritjen e efikasitetit në kontrollin e produkteve të para paketuara. Vëmendje të veçantë do të kushtohet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë si dhe **rritjes së efektivitetit të metrologjisë ligjore** nëpërmjet përmirësimeve ligjore, **përmirësimit të sistemit të menaxhimit të aktivitetëve** të sektorëve të shërbimit në Tiranë, Korçë, Lezhë dhe Fier si dhe përfshirjes së sektorit privat në kryerjen e shërbimeve metrologjike në fusha të caktuara.

## **3 Kapitulli III: Objektivat e Politikës dhe Produktet Madhore**

### **3.1 Objektivat afat shkurtër deri në fund të 2015**

17. Njohja ndërkombëtare e shërbimeve të DPM-së në fushën e forcës dhe presionit dhe vazhdimin e përgatitjes për zgjerimin në **pesë fushat e tjera**.

i) Akreditim i 7 laboratorëve (masë, forcë, presion, **volum**, elektrik, temperaturë, gjatësi), zgjerim i objektit të akreditimit në fushën e masës, forcës.

18. Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar.

Produktet:

i) Etalone të ri-kalibruara në një institucion homolog të EURAMET të 7 Laboratorëve në fushën e elektrikut, temperaturë-lagështisë, forcës, presionit, **volum-rrjedhjes**, masës dhe matjeve dimensionale, që përbëjnë 42 instrumente matës, si edhe 3 sete masash kampion, si rezistenca elektrike, gramarë dhe blloqe fundor.

19. Forcimi i mbrojtjes së konsumatorit.

a) **Përmirësimi të menaxhimit të sistemit të metrologjisë ligjore dhe rritjes së numrit të verifikimeve** dhe inspektimeve të instrumenteve matës ligjore me 2 %.

Produktet:

i) Kryerja e 84,000 verifikimeve të instrumenteve matës në përdorim për vitin 2014-2015

3.2 Objektivat afat gjata (2016-2020)

22. Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve nga matjet e pasakta nëpërmjet rritjes me 2 % për çdo vit të numrit të verifikimeve dhe inspektimeve të instrumenteve matës në treg dhe në përdorim;

Produkte madhore do të jenë:

i) **Akreditimi** i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA me EA në fushën e kalibrimeve.

ii) Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga EURAMET dhe në dy laboratorët e **volumeve** dhe termometrisë, gjithsej 2 laboratorë.

iii) **Deklarimi** në database të BIPM-së të 3 fushave (**volumeve**, termometrisë dhe gjatësisë).

iv) Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve, gjatësisë dhe presionit, **si dhe DML-së dhe DIM me instrumente dhe auto-laboratorë verifikimi.**

**4.** Veç sa më sipër, konstatohet se propozimi për dhënien me koncesion të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe miratimi i tij, ka ndikuar negativisht në eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Konkretisht për kryerjen e këtij shërbimi, janë investuar 63,975,994 lekë në blerjen e 9 autolaboratorëve + pajisjet e nevojshme (seri enësh standarde volumore çeliku inoks) + 555,204 lekë mirëmbajtje, gjithsej 64,531,198 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa eficiencë.

#### Investimet për blerjen e auto laboratorëve

	Emërtimi	Viti i Blerjes	Vlera	Shpenzime mirëmbajtje
1.	Autolaboratori. naftë targë TR 3026 S	2009	7,555,353	100,944
2.	Autolab. naftë targë TR 4167 R	2008	6,100,000	46,092
3.	Autolab. naftë targë TR 3024 S	2009	7,555,353	46,080
4.	Autolab. naftë targë TR 3025 S	2009	7,555,353	144,996
5.	Autolab. naftë targë AA 076 DR	2012	9,898,815	52,416
6.	Autolab. naftë targë AA872 HD	2014	7,500,000	46,680
7.	Autolab. naftë targë AA 651 HJ	2014	7,500,000	35,916
8.	Autolab. gazi targë AA 973 DP	2012	7,911,120	47,280
9.	Autolab. gazi targë AA 874 HD	2014	2,400,000	34,800
	<b>Totali investimit</b>		<b>63,975,994</b>	<b>555,204</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Konstatimi i mësipërm, mbështetet në përcaktimet ligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Neni 4, shkronja “ç”: Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë: përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve publike;

-Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

Neni 3, pika 1: Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore.

Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar:

Neni 8, pika 1: Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të



një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efijencë.

**6.** Mendimet e dhëna nga Ministrinë e Linjës, kryesisht mendimet e Ministrisë së Drejtësisë (ish Ministër P. V.) Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin (ish Ministër E. V. F.) bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore në kuadrin rregullator të fushës, konkretisht në VKM që përcakton fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive të mësipërme. Theksojmë veprimin në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës nga ish Ministri i Drejtësisë z. P. V., i cili në harkun kohor prej 4 ditësh, në kushte të njëjta dhe pa ndryshuar asnjë faktor, analizë, apo ndryshim ligjor, ka dhënë dy mendime të ndryshme, ku si fillim është shprehur kundër dhënies me koncesion dhe më pas ka shprehur dakortësinë.

-Gjithashtu ish Ministri E. V. F. duhet të ishte shprehur kundër dhënies me koncesion, pasi e ka detyrë (VKM për përgjegjësinë shtetërore) që të vlerësojë nëse një projekt-akt është në përputhje me politikat e qeverisë. Në këtë rast ky projekt-akt bie në kundërshtim me politikat e qeverisë, pasi në strategjinë për mbrojtjen e konsumatorit 2015-2020 (dokument politik i qeverisë, cilësuar në krye të herës në përmbajtje të strategjisë) miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015, në planin e veprimit nuk është përcaktuar si objektivi dhënia e shërbimit të verifikimit metrologjik të pistoletave të karburanteve nëpërmjet koncesionit/formë tjetër ligjore.

Konstatimet e mësipërme mbështeten në:

-Ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; Neni 24, pika 2: Në çdo rast projektaktet, përveç atyre me karakter individual, i dërgohen për mendim Ministrisë së Drejtësisë, **i cili shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së tyre.**

-Ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”; Neni 5, pika 2: Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6, pika 3: Jep mendim të specializuar për projektet e akteve ligjore dhe të akteve nënligjore normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore, si dhe për realizimin e reformimit të legjislationit në përgjithësi.

-VKM Nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar;

Kreu IV, pikat 22 dhe 22/1: Të gjitha projektaktet pa përjashtim i dërgohen për mendim Ministrisë së Drejtësisë, i cili duhet të shprehet lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe për terminologjinë juridike të projektaktit duke parashtruar, kur është rasti, edhe formulimet përkatëse.

Të gjitha projektaktet i dërgohen për mendim ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me Parlamentin, i cili jep mendimin e tij bazuar në programin politik të Këshillit të Ministrave, angazhimet e marra nga Kryeministri përpara Kuvendit, si dhe objektivat e punës të secilës ministri.

Kreu V, pika 29: Mendimet e ministrave dhe institucioneve të interesuara përmbajnë vërejtje, komente ose sugjerime për çështje teknike të formës dhe përmbajtjes së projektaktit, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe dokumentacionit tjetër shoqërues duke u përqendruar, si rregull, në dhënien e mendimit të specializuar sipas fushave përkatëse të veprimtarisë që kanë në kompetencë.

-VKM Nr. 834, datë 18.9.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për marrëdhëniet me parlamentin”, i ndryshuar;



Kreu II, pika 2: Përgatit dokumente apo mendime vlerësuese për projektaktet e propozuara për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

Kreu IV, pika 1: Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për realizimin e fushës së përgjegjësive sipas pikës 2 të ndarjes II të këtij vendimi, ka këto kompetenca:

1. Jep mendime për përputhshmërinë e projektaktit me:

a) **Kushtetutën**<sup>4</sup>, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

b) **programin politik të Këshillit të Ministrave**<sup>5</sup>;

c) kërkesat apo opinionet e dokumenteve politike dhe të raporteve të institucioneve të BE-së, në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Kreu IV, pika 5: Kujdeset për garantimin nga ministritë përgjegjëse të një **procesi konsultimi me grupet e interesit**, shoqërinë civile për çdo nismë, ligjore apo nënligjore.

**6.**Duke i'u referuar të gjitha parashtrimeve të bëra më sipër, në këtë situatë ngarkohet me përgjegjësi edhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, z. E. A., i cili e ka detyrë funksionale kthimin e projekt akteve të propozuara nga ministritë e linjës, të cilat bien në kundërshtim me ligjin.

Konstatimi i mësipërm mbështetet në:

-Ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; Neni 9, pika 1, shkronja “c”: Kthen, në bazë të argumenteve ligjore, projektaktet e paraqitura për shqyrtim, kur ato bien në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjin;

Neni 24, pika 3: Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, jua kthen për plotësim ministrave propozues projektaktet, kur ato nuk përmbushin kriteret dhe kushtet e paraqitjes së tyre, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e Këshillit të Ministrave, në bazë e për zbatim të tij.

-VKM Nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar;

Kreu V, pika 34: Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kur vëren se projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron nuk përmbush kriteret e pikës 47, shkronjat "a" dhe "b" të kreut VI të kësaj rregulloreje, vendos kthimin e motivuar të projektaktit ministrit propozues.

Kreu VI, pika 47: Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos kthimin e projektaktit ministrit propozues, vetëm kur:

a) mungon njëri nga dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të këtij kreu të rregullores;

b) nuk është respektuar forma dhe përmbajtja e parashikuar në këtë rregullore për përgatitjen dhe hartimin e projektakteve, relacionit shpjegues dhe dokumenteve sipas pikave 19, 20 dhe vijuese të kësaj rregulloreje;

c) projektakti nuk është në pajtim me Kushtetutën, vjen në kundërshtim ose nuk është në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislationin e brendshëm;

ç) mangësitë e projektaktit, veçanërisht atyre me përmbajtje voluminoze, nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë shumë të dukshme dhe të pranishme gjatë gjithë përmbajtjes së tij.

**Mbi komisionin e dhënies me koncesion ngritur me urdhrin nr.195, datë 12.07.2018, hartimin e studimit të fizibilitetit dhe arsyetimin e vendimit të dhënies me koncesion:**

<sup>4</sup> Neni 6 i Kushtetutës “Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse (Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ku parashikohet procedura që duhet të ndiqet për paraqitjen e projektakteve në Këshillin e Ministrave), përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

<sup>5</sup> Programi politik 2013-2017 miratuar me VKM nr.45, datë 15.09.2013 të Kuvendit të RSH, Kapitulli “Ekonomia”, nën kapitujt “Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregjeve”, “Partneriteti publik-privat” dhe “Mbrojtja e konsumatorit” si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015-2020 (Kjo Strategji është në përputhje me Programin Evropian të mbrojtjes së konsumatorëve 2014 – 2020 dhe Programin e Qeverisë 2013-2017. Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut, është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo është në linjë me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA)

**7.** Komisioni i dhënies me koncesion ngritur me Urdhrin nr. 195 datë 12.07.2018, nuk përmban specialist të fushës, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.<sup>6</sup>

**8.** Në mungesë të kompetencës ligjore komisioni i dhënies me koncesion ka vendosur që t’i drejtohet subjektit N. C. për paraqitjen e propozimit të përgatitur prej tij, ndërkohë komisioni duhet të shqyrtonte propozimin e përgatitur nga ky subjekt që tashmë ishte dorëzuar pranë AK dhe jo të kërkonte dorëzimin sërish, pasi në këtë rast jemi përball procedurës së dhënies me koncesion, e cila ka ardhur si rrjedhojë e propozimit të pa kërkuar, për të cilën është dhënë edhe bonusi 10% të pikëve. Mënyra se si ka vepruar komisioni, është në kundërshtim me procedurën, pasi në këtë rast komisioni ka kërkuar paraqitjen e propozimit. Konkretisht në pikën 15 të nenit 3 të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht:

*“Propozim i pa kërkuar” është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese”.*

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V..*

**9.** Studimi i fizibilitetit përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion, përmban të dhëna të rreme, të pa-përditësuara, si dhe jo të referuara në burime zyrtare, me qëllim pasqyrimin e informacionit të saktë, të zbatueshëm dhe të përshtatshëm për kontekstin e analizës.

-Konkretisht vetë komisioni, për ta bërë fizibël projektin e koncesionit, i ka shtuar si të ardhura vjetore koncesionarit edhe të ardhurat nga TVSH dhe tatim fitimin që do të sigurohen nga ofrimi i shërbimit nga koncesionari, si dhe është sjellë situata në kushte jo të barabarta me krahasuesin e sektorit publik, pra ofrimin e shërbimit nga DPM, ku kësaj të fundit nuk i kanë njohur aspak të ardhura për buxhetin e shtetit, përkundrazi i kanë shtuar si kosto/shpenzim TVSH që nuk ka mbledhur DPM dhe tatimin fitimin<sup>7</sup>. Theksojmë se në asnjë rast në përmbajtje të studimit të fizibilitetit, nuk referohet burimi për vlerën e TVSH së pambledhur nga DPM dhe tatim fitimit. Konkretisht në studimin e fizibilitetit TVSH pasqyrohet si kosto për buxhetin e shtetit në rastin kur shërbimi ofrohet nga DPM (paralelisht nga komisioni i njihet si ardhur, në rastin e dhënies me koncesion), ilustruar me vitin 2018, e cila është përlllogaritur në vlerën 192,234,635 lekë, ndërkohë që referuar bilancit të DPM, viti 2018, pasqyra e pozicionit financiar, llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, e cila pasqyron detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme, paraqitet në vlerën 14,741,334 lekë/7.6% e vlerës së pasqyruar nga komisioni, ku theksojmë se 1,879,900 lekë janë detyrimet si rrjedhojë e shërbimeve që ofron DPM. Pra në asnjë rast detyrimet e njohura që ka DPM ndaj buxhetit të shtetit nuk janë në vlerën 192,234,635 lekë.

Për më tepër që sipas përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr.575, datë 10.7.2013, komisioni i studimit të fizibilitetit, nuk duhet të përfshijë në përlllogaritjet e tij si kosto për DPM, TVSH e pambledhur apo tatim fitimin t’i njohë si të ardhura koncesionarit TVSH dhe tatim fitimin e pambledhur nga DPM.

Konkretisht në nenin 8, pika 4, shkronja “a”, përcaktohet se: Krahasuesi i Sektorit Publik (KSP) është llogaritja e vlerës aktuale neto të kostove totale neto të projektit, në qoftë se kjo do të arrihet në bazë të një metode të prokurimit tradicional. Krahasuesi i Sektorit Publik përbëhet nga flukset e mjeteve monetare që lidhen me: a) krahasuesin bazë të sektorit publik, i cili paraqet shpenzimet totale të parashikuara në paragrafët 3-6 të nenit 7 të këtyre rregullave, minus vlerën e të ardhurave që mund të mbliidhen siç është parashikuar në paragrafin 7 të nenit 7;

<sup>6</sup> Nga verifikimi në qendrën e botimeve zyrtare nuk rezulton që të ketë delegim të kompetencave për procedurat e dhënies me koncesion.

<sup>7</sup> DPM nuk është subjekt i tatim fitimit (Neni 18 në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar) dhe në këto kushte nuk duhet të njihet si shpenzim tatim fitimi në rastin kur shërbimi ofrohet nga DPM.

Për të vijuar me përcaktimet ligjore të bëra në paragrafët 3-6 dhe 7 të nenit 7 “Analiza ekonomike dhe financiare”:

-Kostot e drejtpërdrejta të investimeve lidhen në mënyrë specifike me ndërtimin e objekteve të reja dhe mund të përmbajnë, por nuk kufizohen në shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, teknike dhe të menaxhimit të projektit, kostot e projektimit, kostot e tokës apo të blerjes së një asemi të ri, kostot e përgatitjes së truallit, kostot e ndërtimeve dhe të vënies në funksionim, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera – Pra në asnjë rast nuk parashikohet përllogaritja si shpenzim të “evazionit fiskal” të supozuar nga komisioni i dhënies me koncesion.

-Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes përfshijnë kostot e mbajtjes së aseteve gjatë ciklit të plotë të projektit në gjendjen e kërkuar për të dhënë rezultatet e specifikuar dhe mund të përfshijnë kostot e lëndëve të para, mjetet dhe pajisjet, si dhe kostot e personelit të shoqëruara me mirëmbajtjen - Pra në asnjë rast nuk parashikohet përllogaritja si shpenzim të “evazionit fiskal” të supozuar nga komisioni i dhënies me koncesion.

-Kostot e drejtpërdrejta operative lidhen me funksionimin e përditshëm të objektit dhe përfshijnë kostot e plotë të personelit (ku futen pagat, përfitimet e punonjësve, detyrimet për kontributet e pensioneve, kontributet e sigurimeve, trajnimin dhe zhvillimin, pushimet vjetore, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të pritshme shtesë), kostot e shërbimeve, lëndët e para dhe materialet e konsumit, kostot e drejtpërdrejta të menaxhimit, si dhe shpenzimet e sigurimit - Pra në asnjë rast nuk parashikohet përllogaritja si shpenzim të “evazionit fiskal” të supozuar nga komisioni i dhënies me koncesion.

-Kostot indirekte të projektit janë një pjesë e kostos së administrimit të objektit dhe përfshijnë kostot e kohës dhe të punës së drejtuesve të lartë, personelit, kontabilitetit, faturimit, shërbimeve ligjore, qirasë, komunikimet dhe burime të tjera institucionale të shfrytëzuara nga projekti - Pra në asnjë rast nuk parashikohet përllogaritja si shpenzim të “evazionit fiskal” të supozuar nga komisioni i dhënies me koncesion.

-Të ardhurat e projektit përfitohen nga:

a) përdoruesit fundorë që paguajnë për shërbimin apo për një pjesë të tij; dhe/ose

b) përdorimi i aseteve të institucionit.

Pra në asnjë rast nuk parashikohet përllogaritja si e ardhur TVSH dhe tatim fitimi i pambledhur nga DPM, por përllogaritet si e ardhur vetëm tarifa e shërbimit, që në këtë rast është tarifa për verifikim për pistoletë në 6 muaj.

-Gjithashtu komisioni shprehet se tarifa e shërbimit të verifikimit nuk kalon në buxhetin e shtetit, por në buxhetin e DPM-së, pra dhënia me koncesion nuk do të sjellë impakt negativ në buxhetin e shtetit. Në vazhdim, pika 5.3 Konkluzionet e komisionit: Nga analiza krahasuese e projektit për konçension në studimin e fizibilitetit me projektin e ofruar tashmë nga DPM, dhënia me konçension ka një leverdishmëri të dukshme ekonomike dhe financiare për buxhetin e shtetit, i cili në situatën aktuale del i dëmtuar për shkak se nga tarifat e këtij shërbimi nuk ka asnjë kontribut në buxhet, madje problematika të këtij shërbimi dëmtojnë buxhetin e shtetit për shkak të evazionit që lidhet me abuzimet me sasinë e karburantit që shitet etj. – Siç e kemi theksuar më sipër, në konstatimin për projektvendimin e propozuar për dhënien me koncesion, i njëjti arsyetim vlen edhe për studimin e fizibilitetit të hartuar nga komisioni i dhënies me koncesion në muajin Gusht të vitit 2018. Në vijim të sa më sipër, për të mbështetur konstatimin, e ritheksojmë se DPM nga shërbimi i verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm, vetëm në vitin 2016, ka realizuar 76,193,123 lekë (pa TVSH) nga 128,641,427 lekë (pa TVSH) që ka realizuar metrologjia ligjore në total për këtë vit.

-Në vijim të paragrafit të mësipërm dhe në zbatim të VKM nr.571, datë 29.08.2012 “Për lejimin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga DPM gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etalonëve kombëtare të matjeve”, DPM nga të ardhurat vjetore të realizuara ka të drejtën e përdorimit të vlerës prej 10,000,000 lekë

dhe pjesa tjetër kalon në buxhetin e shtetit. Pra në këtë rast konstatohet se dhënia me koncesion ka efekte buxhetore dhe konkretisht në reduktimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Ky fakt evidentohet edhe nga akt-rakordimi i të ardhurave vjetore 2017, mbajtur ndërmjet DPM dhe Degës së Thesarit, pasqyruar si më poshtë:

INSTITUCIONI DREJTORIA E PERGJITHSHME E METROLOGJIS  
KODI I INSTITUCIONIT 1004109

AKT-RAKORDIMI  
I të ardhurave per periudhen JANAR-DHJETOR 2017

Nr	Kodi i Institucio nit	Llogaria ekonomike	Emertimi i llogarise	Te ardhurat mujore	Te ardhurat progresive	Pjesa e Institucio nit	Rritje e autorizuar	Derdhur ne buxhet	Mbeten per tu trashëguar
1	1004109	4664100	Derdh.gabim viti vazhdim	0.00	23,355,237.00	0.00	23,355,237.00	0.00	0.00
2	1004109	7110199	Te ardhura nga sherbimi	381,981.00	123,095,891.38	0.00	10,000,000.00	113,095,891.38	0.00
3	1004109	7115499	Gjoha	0.00	8,493,178.00	0.00	0.00	8,493,178.00	0.00
4	1004109	7115600	Deftore	0.00	106,473.00	0.00	0.00	106,473.00	0.00
5	1004109	7109600	Qera	0.00	19,949.00	0.00	0.00	19,949.00	0.00
6									
7									
8									
##									
##									
##									
##									
			TOTALI	381,981.00	155,070,728.38	0.00	33,355,237.00	121,715,491.38	

Specialisti i te ardhurave  
Qëndrime Bregu  
Nepunesi zbatues per Institucionit  
Lije Allmuc

Specialisti i te ardhurave  
Petraq Shanto  
Pergjegjese e Sektorit te te Ardhurave  
Shqipe Cera

Sa më sipër evidentohet qartë se të ardhurat nga shërbimet që ofron DPM, pjesë e të cilave është edhe ai i verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit, kalojnë në buxhetin e shtetit.

### Duke vijuar me mangësitë në përditësimin e informacionit të pasqyruar në studimin e fizibilitetit, konkretisht:

**Situata e tregut, pika 2.2.1** - Të dhëna për ndarjen e tregut sipas subjekteve dhe të ardhurave, që i referohen vitit 2015, ndërkohë që studimi i fizibilitetit është përgatitur në muajin Gusht të vitit 2018.

**Problematika e sistemit aktual, pika 2.3** – Mbi problemet në pavarësinë e ISHMT dhe DPM, të cilat janë pjesë e një institucioni dhe në këto kushte krijon problem në pavarësinë efektive dhe kontrollin e punës, ndërkohë në SNMKMT 2015-2020, në kapitullin 1.1.2 Siguria e produkteve jo-ushqimore, përgjigja për problematikën lidhur me sigurinë e produkteve jo-ushqimore është (pasqyruar shprehimisht): “Mbikëqyrja e tregut prej rrjetit të strukturave përgjegjëse/Inspektorateve në varësi të ministrive përkatëse të linjës për fushat e veta të veprimtarisë, duke krijuar një pengesë të fuqishme ndaj tregtarëve që përpiqen t’i shmangen rregullave duke nxitur kështu përmirësimin e funksionimit të tregut, sjelljes së operatoreve ekonomike dhe rritjes së konkurrencës së lirë e të ndershme” – Pra vetë AK e ka parashikuar në strategji mbikëqyrjen e tregut nga strukturat në varësi të ministrive përkatëse të linjës për fushat e veta të veprimtarisë.

Duke vijuar, në studimin e fizibilitetit identifikohen mangësi për punën e DPM, mbi materiale të publikuara në median e shkruar që i përkasin vitit 2013.

**Problematikat kryesore dhe hapësirat për zhvillim të skemës aktuale, pika 2.7** – Komisioni shprehet se institucionet mund të hasin në vështirësi në financimin dhe realizimin e kalibrimit në kohë të pajisjeve, trajnimin e metrologëve, akreditimin e laboratorëve, etj, ndërkohë që referuar SNMKMT 2015-2020, janë planifikuar kostot e shërbimeve të mësipërme dhe burimet e financimit, pasqyruar për metrologjinë si më poshtë vijon:

Tabela 1: Kostimi i zbatimit të strategjisë sipas objektivave afat shkurtër deri në fund të 2015 (000 lekë)

Çështje të mbuluara nga strategjia	Kosto totale	Buxhet	Hendek Financiar (mbështetje nga donatorët apo financimeve të huaja)
Metrologjia	529,000	429,000	100,000

Burimi: SNMKMT 2015-2020

Tabela 2: Kostimi i zbatimit të strategjisë sipas objektivave afat gjatë 2016-2020 (000 lekë)

Çështje të mbuluara nga strategjia	Kosto totale	Buxhet	Hendek Financiar (mbështetje nga donatorët apo financimeve të huaja)
Metrologjia	1,500,000	1,250,000	250,000

Burimi: SNMKMT 2015-2020

**Projekti Teknik, lista e standardeve teknike dhe teknologjia e përdorur, pika 3.1.5** – Vlera e investimit është 474,000 euro, pra jo në lek. Nuk jepet informacion mbi kursin e këmbimit të përdorur. Nëse i referohemi kursit të këmbimit nga data 24.07.2018 deri më datë 08.08.2018, kursi mesatar i këmbimit është 1 euro - 125 lekë, që do të thotë se vlera e investimit është 59,250,000 lekë dhe jo 64,890,600 lekë, sa është vendosur vlera e investimit.

**Analiza ekonomike dhe financiare, numri i stacioneve, pika 4.1.1** – Numri i karburanteve i referohet vitit 2015, ndërkohë që studimi i fizibilitetit është përgatitur në muajin Gusht të vitit 2018, ndërkohë që kjo e dhënë mund të sigurohet nga DPM, duke bërë një vlerësim real të numrit të stacioneve të karburantit, numrit të pistoletave, si dhe përlllogaritjen e të ardhurave.

Gjithashtu studimi i fizibilitetit nuk:

- Shprehet për harmonizimin e projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorial strategjikë;
- Pasqyron mënyrën e përlllogaritjes së tarifës së koncesionit;
- Pasqyron mënyrën e përlllogaritjes së tarifës për verifikimin jashtë radhe, e cila sipas studimit të fizibilitetit është 20% më shumë se tarifa e verifikimit periodik, pra 6,000 lekë + (20% \* 6,000 lekë);
- Për më tepër komisioni shprehet për evazion fiskal, por në asnjë rast nuk e shoqëron me shifra të matshme evazionin, si dhe burimin e tyre.

-Në procesverbalet e mbledhjes së komisionit, konkretisht në procesverbalin nr.3, datë 31.07.2018; nr.4, datë 06.08.2018 dhe nr.5, datë 08.08.2018, nuk pasqyrohet plotësisht puna e kryer nga komisioni, pasi në procesverbalin nr.3, komisioni shprehet se ka zhvilluar diskutime me çështje që përfshihen në studimin e fizibilitetit, me qëllim përmirësimin e projektit, por nuk pasqyrohet asnjë çështje/përmirësim të sugjeruara nga komisioni, si dhe nuk pasqyrohet nëse këto përmirësim i janë kërkuar subjektit apo jo. Po kështu edhe në procesverbalin nr.4, ku komisioni shprehet se ka vendosur shqyrtimin e studimit të fizibilitetit, por nuk pasqyrohet asnjë informacion se çfarë ka rezultuar nga shqyrtimi, si dhe në procesverbalin nr. 5, komisioni shprehet se është mbledhur për përgatitjen e raportit përmbledhës informues, por nuk ka bashkëlidhur procesverbalit raport përmbledhës, apo në procesverbal të pasqyrohet informacioni që do të përfshihet në raportin përmbledhës.

-Veç sa më sipër, edhe përlllogaritja e të ardhurave vjetore nga shërbimi i verifikimit (tarifë verifikimi \* nr. verifikimesh në një vit) nuk është plotësisht reale, pasi tarifa është marrë e plotë 6,000 lekë (mbi të cilën në çdo vit aplikohet 2% inflacion) dhe jo tarifa që aplikohet në varësi të numrit të pistoletave të karburantit (deri në 6 pistoleta në karburant, tarifa është 6,000 lekë për pistoletë; nga 7 deri në 12 pistoleta në karburant, tarifa është 5,900 lekë). Theksojmë se në studimin e fizibilitetit të komisionit të dhënies me koncesion/subjektit N. C., pasqyrohet informacioni, se numri mesatar i distributorëve në stacion karburanti është:

Viti 2018-7 distributor/stacion

Viti 2019-7 distributor/stacion

Viti 2020-8 distributor/stacion

Viti 2021-8 distributor/stacion

Nëse marrim të ardhurat që do të krijohen në vitin 2020, duke pasur në konsideratë vlerën e tarifës së përcaktuar në pikën 7.1, pasqyra 3/1 Udhëzimin e përbashkët ndërmjet ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) dhe Ministrisë së Financave (MF), nr.2, datë 08.2.2013 “Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, i ndryshuar, si dhe numrin e distributorëve, atëherë të ardhurat nga shërbimi i verifikimit për vitin 2020 janë:

6900 distributorë \* 2 verifikime në vit = 13,800 verifikime periodike në vit

13,800 verifikime \* (5,900 lekë/distributor \* 2% inflacion) = 13,800 \* 6,018 lekë/distributor = 83,048,400 lekë + 5,216,400 lekë të ardhura nga verifikimi jashtë radhe = 88,264,800 lekë/1,407,600 lekë më pak, në krahasim me të ardhurat e përlogaritura në studimin e fizibilitetit, të cilat janë në vlerën 89,672,400 lekë.

Për vitin 2021 janë:

6820 distributorë \* verifikime në vit = 13,640 verifikime periodike në vit

13,640 verifikime \* (6,018 lekë/distributor \* 2% inflacion) = 13,640 \* 6,138.36 lekë/distributor = 83,727,230 lekë + 5,259,038 lekë të ardhura nga verifikimi jashtë radhe = 88,986,268 lekë/1,419,106 lekë më pak, në krahasim me të ardhurat e përlogaritura në studimin e fizibilitetit, të cilat janë në vlerën 90,405,374 lekë.

Mangësitë në përlogaritjen e të ardhurave ndikojnë automatikisht edhe në flukset monetare neto, të cilat çojnë në uljen e vlerës për para NPV dhe normën e brendshme të kthimit nga investimi, ilustruar si më poshtë vijon:

Tabela nr.3

	Viti 2019	Diferenca
Të ardhurat pa TVSH, në lekë	87,662,824	
- Tarifa koncesionare (0.5%)	438,314	
Shpenzimet operative	72,686,124	
Fitimi Operativ	14,538,386	
Zhvlerësim/amortizim	10,232,648	
Fitimi para interesit	4,305,738	
Interesi i kredisë	2,195,412	
Fitimi para taksave	2,110,326	
Tatim mbi fitimin (15%)	316,549	
Fitimi neto	1,793,777	

#### Fluksi monetar i skontuar

Fitimi neto	1,793,777	
+ Amortizim	10,232,648	
-Ndryshimi në kapitalin qarkullues	4,611,744	
-Ndryshimi në detyrimin e TVSH	763,402	
Fluksi i lirë i parasë	17,401,571	
Faktori i skontimit	0.91	
Fluksi monetar i skontuar	15,835,430	4,202,062 lekë më pak

Tabela nr.4

	Viti 2020	Diferenca
Të ardhurat pa TVSH, në lekë	88,264,800	
- Tarifa koncesionare (0.5%)	(444,324)	
Shpenzimet operative	(72,292,101)	
Fitimi Operativ	15,528,375	
Zhvlerësim/amortizim	(8,634,562)	
Fitimi para interesit	6,896,813	
Interesi i kredisë	(1,591,263)	
Fitimi para taksave	5,305,550	
Tatim mbi fitimin (15%)	(795,832)	
Fitimi neto	4,510,167	

#### Fluksi monetar i skontuar

Fitimi neto	4,510,167	
+ Amortizim	8,634,562	
-Ndryshimi në kapitalin qarkullues	(50,995)	

-Ndryshimi në detyrimin e TVSH	(28,529)	
Fluksi i lirë i parasë	13,065,205	
Faktori i skontimit	0.81	
Fluksi monetar i skontuar	10,582,816	927,495 lekë më pak

Tabela nr.5

	Viti 2021	Diferenca
Të ardhurat pa TVSH, në lekë	88,986,268	
- Tarifa koncesionare (0.5%)	444,931	
Shpenzimet operative	74,203,252	
Fitimi Operativ	14,338,085	
Zhvlerësim/amortizim	7,233,022	
Fitimi para interesit	7,105,063	
Interesi i kredisë	948,778	
Fitimi para taksave	6,156,285	
Tatim mbi fitimin (15%)	923,443	
Fitimi neto	5,232,842	

#### Fluksi monetar i skontuar

Fitimi neto	5,232,842	
+ Amortizim	7,233,022	
-Ndryshimi në kapitalin qarkullues	159,568	
-Ndryshimi në detyrimin e TVSH	2,276	
Fluksi i lirë i parasë	12,627,708	
Faktori i skontimit	0.71	
Fluksi monetar i skontuar	8,965,673	915,103 lekë më pak

Tabela nr.6

	Viti 2022	Diferenca
Të ardhurat pa TVSH, në lekë	89,566,490	
- Tarifa koncesionare (0.5%)	447,832	
Shpenzimet operative	76,111,723	
Fitimi Operativ	13,006,935	
Zhvlerësim/amortizim	6,007,262	
Fitimi para interesit	6,999,673	
Interesi i kredisë	265,522	
Fitimi para taksave	6,734,151	
Tatim mbi fitimin (15%)	1,010,123	
Fitimi neto	5,724,028	

#### Fluksi monetar i skontuar

Fitimi neto	5,724,028	
+ Amortizim	6,007,262	
-Ndryshimi në kapitalin qarkullues	159,286	
-Ndryshimi në detyrimin e TVSH	618	
Fluksi i lirë i parasë	11,891,194	
Faktori i skontimit	0.63	
Fluksi monetar i skontuar	7,491,452	792,743 lekë më pak

Tabela nr.7

	Viti 2023	Diferenca
Të ardhurat pa TVSH, në lekë	90,136,095	
- Tarifa koncesionare (0.5%)	450,680	
Shpenzimet operative	78,118,907	
Fitimi Operativ	11,566,508	
Zhvlerësim/amortizim	4,940,105	
Fitimi para interesit	6,626,403	
Interesi i kredisë	0	
Fitimi para taksave	6,626,403	
Tatim mbi fitimin (15%)	993,960	
Fitimi neto	5,632,442	

#### Fluksi monetar i skontuar

Fitimi neto	5,632,442	
+ Amortizim	4,940,105	
-Ndryshimi në kapitalin qarkullues	167,506	
-Ndryshimi në detyrimin e TVSH	-558	
Fluksi i lirë i parasë	10,739,495	
Faktori i skontimit	0.56	
Fluksi monetar i skontuar	6,014,117	676,000 lekë më pak

Pra nëse do të përllorarisnim NPV dhe IRR deri në 6 vite aktivitet (pas vitit 2023 aktivitet do të rinovohen 100% dhe kështu me radhë çdo 6 vjet deri në vitin 2038) sipas të dhënave të studimit të fizibilitetit do të kishim:

<b>Vlera aktuale neto (NPV)</b>					
Vitet	Flukset Neto	Norma e skontimit per 6 vjet	NPV 000/Lekë	Kur NPV është pozitive, investimi është fizibël	Faktori i skontimit për vitet 2018-2024
Investimi fillestar	-64,890	4.6%	6,124		
2018	7,684				0.98
2019	21,961				0.91
2020	14,255				0.81
2021	13,827				0.71
2022	13,100				0.63
2023	11,956				0.56
					4.6
<b>Kthimi i brendshëm nga investimi (IRR)</b>					
Vitet	Flukset Neto				
Investimi fillestar	-64,890				
2018	7,684				
2019	21,961				
2020	14,255				
2021	13,827				
2022	13,100				
2023	11,956				
<b>IRR</b>	<b>7%</b>		IRR 7% > Norma e kontimit 4.6% Pra investimi është fizibël dhe mund të vendoset për kryerjen e investimit		

Por nëse do të përllorarisnim NPV dhe IRR deri në 6 vite aktivitet me të dhënat sipas përlloraritjeve në tabelat nr.3-7, do të kishim:

Vitet	Flukset Neto	Norma e skontimit per 6 vjet	NPV 000/Lekë	Kur NPV është negative, investimi nuk është fizibël	Faktori i skontimit për vitet 2018-2024
Investimi fillestar	-64,890	4.6%	(1,981)		
2018	7,684				0.98
2019	17,401				0.91
2020	13,065				0.81
2021	12,627				0.71
2022	11,891				0.63
2023	10,737				0.56
					4.6
<b>Kthimi i brendshëm nga investimi (IRR)</b>					
Vitet	Flukset Neto				
Investimi fillestar	-64,890				
2018	7,684				
2019	17,401				
2020	13,065				
2021	12,627				
2022	11,891				
2023	10,737				
<b>IRR</b>	<b>4%</b>	IRR 4% < Norma e kontimit 4.6% Pra investimi nuk është fizibël dhe nuk mund të vendoset për kryerjen e investimit			

Pra referuar të dhënave të mësipërme, kemi të tjerë tregues, të cilët ndikojnë në vendimmarrjen e AK për dhënien me koncesion.

**10.**Në arsyetimin e vendimit të dhënies me koncesion, bazuar në krahasuesin e sektorit publik (Llogaritja e vlerës aktuale neto NPV) komisioni përkatës nëpërmjet raportit përmbledhës duhet të kishte propozuar refuzimin e propozimit dhe heqjen dorë nga zbatimi i tij.

-Nga analiza financiare e kryer nga grupi i auditimit, përlloraritja e NPV dhe IRR (norma e kthimit të investimit) bazuar në të dhënat e studimit të fizibilitetit të koncesionarit dhe të dhënave faktike nga DPM, rezulton se ofrimi i shërbimit nga sektori publik në krahasim me privatit, është më fizibël nga ana financiare, pasi norma e NPV dhe IRR janë më të larta në krahasim me normat e privatit.

Në 2 skenarët e përlloraritjes së NPV dhe IRR, në rastin kur shërbimi vazhdon nga DPM, kemi pasur në konsideratë, si më poshtë vijon:

Shërbimi fillon më datë 01.01.2018 dhe përfundon më datë 31.12.2037;



Drejtoria e Metrologjisë Ligjore kryen vetëm shërbimin e verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit;

Verifikimi periodik – 2 herë në vit;

Numri i verifikimeve periodike për vitin 2018 dhe 2019 është marrë nga DPM, duke i'u referuar faktit të kryer;

Numri i verifikimeve jashtë radhe është marrë nga studimi i fizibilitetit;

Në skenarin e parë tarifa e verifikimit periodik dhe jashtë radhe ngelet e pandryshuar, pra 6,000 lekë.

Në skenarin e dytë, e kemi indeksuar me normën e inflacionit 2%, duke filluar nga viti 2020.

Numri total i punonjësve, 13, konkretisht Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së, Drejtori i Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore, 9 metrolog dhe 2 punonjës administrate.

Pagat për vitin 2018 dhe 2019 janë marrë nga të dhënat faktike të DPM dhe më pas për vitet në vijim janë indeksuar me normën e inflacionit 2% (siç ka vepruar subjekti në studimin e fizibilitetit).

Karburanti është përlllogaritur me çmimin mesatar 170 lekë/litër dhe është indeksuar çdo vit me normën e inflacionit 2%.

Janë përfshirë 10,000,000 lekë (pjesa takuese e DPM nga të ardhurat e realizuara nga shërbimi i verifikimit<sup>8</sup>) shpenzime operative të tjera për çdo vit, për kalibrim, sigurimin e pajisjeve, krahasime ndërlaboratorike, etj.

Shpenzimet kapitale përfshijnë investimin e nevojshëm për 9 autolaborator, 9 sisteme portabël, 1 flowmetër, termometër dhe pajisje zyre, si dhe zëvendësimin/rinovimin e auto laboratorëve, pajisjeve portabël, pajisjeve të tjera teknike të nevojshme në procesin e verifikimit si dhe pajisjet e zyrës, ku është parashikuar që çdo 6 vjet të rinovohen 100%.

Gjithashtu nga viti 2019 e në vijim parashikohen shpenzime kapitale për mirëmbajtjen e aktiveve, nga DPM, në masën 3% të vlerës së investimit total. Vlera e mirëmbajtjes është indeksuar çdo vit me normën e inflacionit 2%.

Norma e skontimit është marrë 15.3%, sa është vendosur në studimin e fizibilitetit.

Në skenarin e parë vlera e NPV është 249,477 mijë lekë/231,398 mijë lekë më tepër nga vlera e subjektit N. C., si dhe IRR është 25% ose 2.2% më e madhe se vlera e subjektit N. C..

Në skenarin e dytë, vlera e NPV është 299,605 mijë lekë/277,526 mijë lekë më tepër nga vlera e subjektit N. C., si dhe IRR është 28% ose 5.2% më e madhe se vlera e subjektit N. C..

Nga krahasimi, analiza dhe vlerësimi me dy metodat sasiore si më lart, rezultojnë:

a) Treguesi i vlerës në kohë të pasës të investimit të sektorit publik rezultoi se është më i lartë.

b) Norma e kthimit të brendshëm (IRR) e investimit nga krahasuesi i sektorit publik është i më lartë;

Sa më sipër, duke ju referuar kriterëve ligjore, nëse krahasimi mes alternativës së krahasuesit të sektorit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e parë (pra vazhdimi i ofrimit të shërbimit nga DPM) ofron vlerën më të mirë të pasës dhe në këto kushte autoriteti kontraktues nuk mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP.

**11.** Studimi i fizibilitetit dorëzuar nga subjekti N. C. përmban të dhëna të pasakta në përlllogaritjen e të ardhurave vjetore. Konkretisht në vitin 2019 sipas studimit të fizibilitetit të dorëzuar nga subjekti, të ardhurat vjetore janë parashikuar për tu realizuar në vlerën 93,264,824 lekë, nga të cilat 88,074,000 lekë prej verifikimeve periodike dhe 5,180,824 lekë prej verifikimeve jashtë radhe. Nga përlllogaritjet e kryera, duke pasur në konsideratë numrin e distributorëve në vitin 2019, tarifën e përcaktuar në studimin e fizibilitetit, rezultojnë:

-13,980 verifikime periodike në vit \* 6,000 lekë/verifikim = 83,880,000 lekë të ardhura nga verifikimet periodike.

-720 verifikime jashtë radhe në vit \* 7,200 lekë/verifikim = 5,184,000 lekë të ardhura nga verifikimet jashtë radhe.

<sup>8</sup> VKM nr.571, datë 29.08.2012 “Për lejimin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga DPM gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etalonëve kombëtare të matjeve”.

-Gjithsej 89,064,000 lekë të ardhurat për vitin 2019 / 4,200,824 lekë më pak.

Kjo mangësi në përlllogaritje duhet të ishte evidentuar nga komisioni i dhënies me koncesion dhe duhet ti ishte kthyer subjektit N. C. për saktësim të të ardhurave për vitin 2019.

**12.**Raporti përmbledhës i përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion është bërë pas hartimit të studimit të fizibilitetit, ndërkohë që ky dokument hartohet përpara përgatitjes së studimit të fizibilitetit. Nëpërmjet këtij raporti AK vendos:

të kthejë për plotësim propozimin e pa kërkuar.

të pranojë propozimin dhe të vazhdojë hartimin e studimit të fizibilitetit.

të refuzojë propozimin dhe të heqë dorë nga zbatimi i projektit.

**12.1.** Në raportin përmbledhës drejtuar titullarit të AK, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V..*

**13.**Në mendimin e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, nëpërmjet MEMO-s nr. s'ka datë 27.08.2018, nuk pasqyrohet mendimi i drejtorisë së mësipërme për impaktin që mund të ketë dhënia me koncesion në drejtim të deficitit buxhetor dhe detyrimeve kontigjente eventuale. Sipas nenit 12 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “Deficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat”. Në këtë rast nëpërmjet dhënies me koncesion do të reduktohen të ardhurat e buxhetit të shtetit, çka bën të nevojshme dhënien e mendimit për impaktin që mund të ketë reduktimi i të ardhurave. Gjithashtu referuar përcaktimit të bërë në pikën 22 të nenit 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shprehimisht: “Detyrim kontingjent” është detyrimi që mund t’i lindë njësisë së qeverisjes së përgjithshme në raport me të tretë, në të ardhmen, si rezultat i risqeve të mundshme, të lidhura me ngjarje apo nisma, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të viteve të mëparshme. Në këtë rast duke marrë në konsideratë risqet e identifikuar në studimin e fizibilitetit, konkretisht riskun e inflacionit, që i është transferuar autoritetit kontraktor për të ndërmarrë veprimet e nevojshme. Një rritje e normës së inflacionit, mund të sjellë rritjen e shpenzimeve të subjektit koncesionar dhe për pasojë në flukset monetare hyrëse dhe në normën IRR. Veç sa më sipër në analizën që kryen Ministria e Financave me qëllim miratimin e projektit:

a) përcakton ndikimet e menjëhershme dhe të mundshme fiskale për qëllimet e vlerësimit të përbalueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe për qëllime të buxhetimit të detyrimeve dhe angazhimeve të tilla, kur është e përshtatshme;

c) përcakton qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, në lidhje me projeksionet afatgjata (fluksin e parasë) dhe parashikimet (makroekonomike) të kapacitetit buxhetor dhe aftësinë për të përkrahur shërbimin e mbështetjes financiare dhe angazhimet e tjera kontraktuale të parashikuara nga projekti;

ç) analizon risqet, kryesisht ato që merren përsipër plotësisht ose pjesërisht nga autoriteti kontraktues, për qëllimin e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së tyre dhe të kostove, si dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave për trajtim jashtë bilancit, nëse është e përshtatshme.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit dhe Borxhit Publik, znj. M. Dh..*

**14.**Nuk administrohet miratimi i projektit për dhënien me koncesion, nga titullari i AK. Konkretisht në MEMO-n, nr. s'ka, datë 03.09.2018, përgatitur nga ish Sekretari i Përgjithshëm, zj. G. P., drejtuar Ministrin të Financave dhe Ekonomisë, z. A. A., ku kërkohet miratimi i projektit për vazhdimin e procedurave, pra shpalljen e njoftimit të kontratës në APP, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:  
Nenin 9, pikat 2 dhe 6 të nenit 18, pikën 3, shkronjën “b” në pikën 5 të nenit 19, pikën 3 të nenit 29, në Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;  
Pikën 3, 4 dhe 7 të nenit 8, pikën 1 dhe shkronjat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 12, pikat 1 dhe 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 17, shkronjat “a”, “c” dhe “ç” në pikën 1 të nenit 20 në VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar; Pikën 2 në Kreun IV në VKM nr.503, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Skenari nr.1, tarifa e shërbimit mbetet e pandryshuar (000 lekë)

Situata aktuale - DPM																					
		Dhjetor 2018	Dhj. 2019	Dhj. 2020	Dhj. 2021	Dhj. 2022	Dhj. 2023	Dhj. 2024	Dhj. 2025	Dhj. 2026	Dhj. 2027	Dhj. 2028	Dhj. 2029	Dhj. 2030	Dhj. 2031	Dhj. 2032	Dhj. 2033	Dhj. 2034	Dhj. 2035	Dhj. 2036	Dhj. 2037
<b>Te ardhurat</b>		80,790	79,944	80,448	87,012	85,998	84,864	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784	83,784
Shpenzime operative																					
Paga		11,347	11,957	12,196	12,440	12,689	12,942	13,201	13,465	13,73	14,009	14,289	14,575	14,867	15,164	15,467	15,777	16,092	16,414	16,742	17,077
Karburant		42	44	45	46	46	47	48	49	50	51	52	53	55	56	57	58	59	60	61	63
Pjesa takuese e DPM nga të ardhurat e realizuara, e cila përdoret për shpenzime të ndryshme, si marketing, kalibrim, etj		10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
<b>Total Shpenzime</b>		21,389	22,001	22,241	22,486	22,736	22,990	23,250	23,515	23,785	24,061	24,342	24,629	24,922	25,220	25,525	25,835	26,152	26,475	26,804	27,141
<b>Fitimi / (Humbja) totale</b>		59,400	57,942	58,206	64,525	63,261	61,873	60,533	60,268	59,998	59,722	59,441	59,154	58,861	58,563	58,258	57,948	57,631	57,308	56,979	56,642
Shpenzimet kapitale		(73,497)	-	(1,874)	(1,911)	(1,949)	(74,967)		(2,249)	(2,294)	(2,339)	(2,386)	(2,434)	(76,466)		(2,339)	(2,386)	(2,434)	(2,483)	(77,996)	
<b>Flukset e lira monetare</b>		(14,097)	57,942	56,332	62,614	61,312	(13,094)	60,533	58,019	57,704	57,382	57,054	56,719	(17,605)	58,563	55,918	55,561	55,197	54,825	(21,017)	56,642
Kosto e kapitalit për projektin	15.3%																				
Periudha		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Faktori i skontimit	1	0.87	0.75	0.65	0.57	0.49	0.43	0.37	0.32	0.28	0.24	0.21	0.18	0.16	0.14	0.12	0.10	0.09	0.08	0.07	0.06
<b>Flukset monetare te skontuara</b>	0	(12,226)	43,582	36,747	35,423	30,083	(5,572)	22,339	18,570	16,017	13,814	11,912	10,270	(2,764)	7,976	6,605	5,691	4,904	4,224	(1,404)	3,282
<b>NPV e projektit</b>		<b>249,477</b>																			
<b>IRR</b>		<b>25%</b>																			

Skenari nr.2, tarifa e shërbimit e indeksuar me inflacion (000 lekë)

Situata aktuale - DPM																					
		Dhjetor 2018	Dhj. 2019	Dhj. 2020	Dhj. 2021	Dhj. 2022	Dhj. 2023	Dhj. 2024	Dhj. 2025	Dhj. 2026	Dhj. 2027	Dhj. 2028	Dhj. 2029	Dhj. 2030	Dhj. 2031	Dhj. 2032	Dhj. 2033	Dhj. 2034	Dhj. 2035	Dhj. 2036	Dhj. 2037
<b>Te ardhurat</b>		79,998	80,508	88,716	89,358	89,861	90,352	92,077	93,836	95,631	97,461	99,328	101,233	103,176	105,157	107,178	109,240	111,342	113,487	115,675	117,906
Shpenzime operative																					
Paga		11,347	11,957	12,196	12,440	12,689	12,942	13,201	13,465	13,735	14,009	14,289	14,575	14,867	15,164	15,467	15,777	16,092	16,414	16,742	17,077
Karburant		42	44	45	46	46	47	48	49	50	51	52	53	55	56	57	58	59	60	61	63
Pjesa takuese e DPM nga të ardhurat e realizuara, e cila përdoret për shpenzime të		10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000

ndryshme, si marketing, kalibrim, etj																					
<b>Total Shpenzime</b>		21,389	22,001	22,241	22,486	22,736	22,990	23,250	23,515	23,785	24,061	24,342	24,629	24,922	25,220	25,525	25,835	26,152	26,475	26,804	27,141
<b>Fitimi / (Humbja) totale</b>		58,608	58,506	66,474	66,872	67,125	67,361	68,826	70,321	71,845	73,400	74,986	76,603	78,253	79,936	81,653	83,404	85,190	87,012	88,870	90,765
Shpenzimet kapitale		(73,497)	-	(1,874)	(1,911)	(1,949)	(74,967)		(2,249)	(2,294)	(2,339)	(2,386)	(2,434)	(76,466)		(2,339)	(2,386)	(2,434)	(2,483)	(77,996)	
<b>Flukset e lira monetare</b>		(14,889)	58,506	64,600	64,960	65,175	(7,606)	68,826	68,072	69,551	71,060	72,599	74,169	1,786	79,936	79,313	81,017	82,756	84,529	10,874	90,765
Kosto e kapitalit për projektin	15.3%																				
Periudha		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Faktori i skontimit	1	0.87	0.75	0.65	0.57	0.49	0.43	0.37	0.32	0.28	0.24	0.21	0.18	0.16	0.14	0.12	0.10	0.09	0.08	0.07	0.06
<b>Flukset monetare te skontuara</b>	0	(12,913)	44,006	42,140	36,750	31,978	(3,236)	25,400	21,787	19,306	17,107	15,157	13,430	280	10,887	9,368	8,299	7,352	6,513	726	5,260
<b>NPV e projektit</b>	<b>299,605</b>																				
<b>IRR</b>	<b>28%</b>																				

**1. “Tenderi me objekt: “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”</b>		
<b>1. Urdhër për fillimin e procedurës:</b> Nr.195, datë 12.07.2018	<b>2. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit:</b> Urdhër Nr.195, datë 12.07.2018 E. M. E. O. A. U. A. P. G. V.	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave:</b> Urdhër Nr.195, Datë 12.07.2018, i ndryshuar S. P. A. A. A. U. A. P. G. V.
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur”		
<b>5. Vlera e parashikuar e investimit (pa TVSH)</b> 64,890,600 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSH):</b> “N. C.” Sh.P.K – 70,000,000 lekë	
<b>7. Data e hapjes së tenderit:</b> 18.10.2018	<b>8. Burimi Financimit:</b> Investim tërësisht me fondet e subjektit N. C.	<b>9. Operatorët Ekonomikë</b> a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
<b>10. Ankimime</b> Ankesë e e paraqitur nga OE “P. T.” në dt.01.10.2018.	<b>11. Përgjigje ankesës nga AK</b> Ankesat në procedurat konkurruese shqyrtohen nga KPP	<b>12. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Vendimi nr. 77/2019 prot., datë 07.02.2019 Refuzimin e ankesës dhe lejimin e AK për vazhdimin e procedurës.
<b>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> nr. 15326 prot datë 21.08.2019	<b>14. Vlera e kontratës (me TVSH)</b> 84,000,000 lekë	<b>15. Afati i kontratës</b> 20 vite

**Nga auditimi i dokumentacionit mbi respektimin e kuadrit rregullator për krijimin e dosjes së procedurës konkurruese, dorëzimin e ofertave, hapjen dhe vlerësimin e ofertave, u konstatua se:**

-Procedura e tenderimit (krijimi i dosjes së procedurës konkurruese, dorëzimi i ofertave, vlerësimi i ofertave, mbyllja e fazës së vlerësimit të ofertave, hapja e ofertave dhe arkivimi i procedurës) nuk është kryer e gjitha me mjetet e komunikimit elektronik.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të sistemit të prokurimeve “E-prokurim”, në seksionin e Autoritetit Kontraktues, konstatohet se nuk administrohet asnjë dokumentacion mbi procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Për arritjen në konstatimin e mësipërm, u krye verifikimi në dritaren “Kërko” me fjalë kyçe, si “kontroll”, “verifikim”, si dhe me nr. e referencës së procedurës së prokurimit “REF-85913-09-17-2018”, si dhe në disa prej moduleve, si “Hetim” “Arkiva” “Kërkesa” “Regjistri i parashikimit për vitin 2018” “Regjistri i realizimit për vitin 2018 dhe 2019”, ku rezultoi se vetëm në regjistrin e parashikimit të vitit 2018, është publikuar zhvillimi i procedurës, me të dhënat e përgjithshme, pra AK, fondi, statusi<sup>9</sup>.

Referuar njoftimit të kontratës dhe DST, është vendosur se dorëzimi i ofertës do të kryhet me mjete elektronike.

**Mosveprimi i mësipërm ka cenuar qëllimin dhe parimet e përzgjedhjes, pasi nëpërmjet mosveprimit nuk është siguruar transparenca në zhvillimin e procedurës përkatëse.**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:

-Nenin 9 dhe pikën 2 të nenit 22 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar.

-Shkronjën “dh” në pikën 2 të nenit 1, shkronjën “b” në nenin 2, pikat 1, 2, 3 dhe 4 në nenin 22 në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-Pikën 1 në VKM nr.130, datë 12.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat”.

- Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm të APP, Nr. 13, datë 28/05/2015 “Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë”, ku përcaktohet se si krijohet dosja e procedurës

<sup>9</sup> Bashkëlidhur akt-konstatimit janë fotot (print-screen) nga sistemi e-prokurime.

konkurruese, dorëzimi i ofertave, vlerësimi i ofertave, mbyllja e fazës së vlerësimit të ofertave, hapja e ofertave dhe arkivimi i procedurës.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V., për fazën e krijimit të dosjes së procedurës konkurruese dhe ngarkimin e ofertave.

Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U., për fazën e vlerësimit të ofertave, të cilët në kushtet e mësipërme, pra në mungesë të dosjes së krijuar në sistem, e cila do të shërbente për shkarkimin e dokumenteve të OE dhe më pas shqyrtimin dhe vlerësimin shkresor të tyre, nuk duhet të kishin pranuar kryerjen e vlerësimit të ofertës.

-Gjithashtu për mangësitë e mësipërme, mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 1 dhe 3 të nenit 22 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, personat përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë, duhet të kishin siguruar nëse vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, pra sigurimin e transparencës deri në përfundim të procedurës, kjo si gjatë fazave të krijimit të dosjes së procedurës konkurruese si dhe gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

### **Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr.6, datë 24.08.2018, nga komisioni i dhënies me koncesion.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit/kriteret e vlerësimit nuk janë në përputhje me pikën 2 të nenit 31 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht në pikën 2 të nenit 31, përcaktohet se:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit **nuk do të jetë më pak se 50 pikë** – Në këtë rast pesha e kriterit të çmimit të kontratës (që përfaqëson vlerën e investimit) është vlerësuar me 10 pikë. Në pikën 2 të nenit 22 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, përcaktohet se: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj”, duke vijuar me përcaktimin në pikën 2 të nenit 23, ku parashikohet se komisioni vendos koeficientët për secilin kriter, por pa specifikuar vlerën përkatëse të tyre, çka krijon detyrimin për komisionin e dhënies me koncesion, që t’i referohet përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**Pika 2.2/a** - AK kërkon që për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të pasqyrave financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitura në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet – Kërkesa nuk është në përputhje me përcaktimin e bërë në shkronjën “a” të pikës 4 në nenin 28 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në shkronjën “a” të pikës 4 përcaktohet se për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse. Pra kërkohen kopje të certifikuara dhe të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe jo vetëm të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse.

**Pika 2.3.1** – AK për aftësinë teknike dhe profesionale kërkon: Eksperiencë në ekzekutimin e suksesshëm të punëve të ngjashme të një shërbimi në fushën e inspektimit dhe matjes brenda 3 viteve të fundit – Në procesverbalin e hartimit të kritereve të veçanta të kualikimit, kapacitetet teknike, nuk pasqyrohet argumenti teknik se si ndikon në përmbushjen e aftësive teknike dhe profesionale, eksperiencë 3 vjeçare në fushën e inspektimit dhe matjeve, si dhe përse një periudhë tjetër kohore nuk është e mjaftueshme. Është e panevojshme eksperiencë në fushën e inspektimit, pasi në këtë rast do të kryhet shërbimi i verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm, që është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike. Pra instrumenti do të

nënshtrohet matjes për të verifikuar saktësinë e tij. Në këto kushte është e mjaftueshme eksperiencia në fushën e matjes, si dhe kërkesa për eksperiencë në fushën e inspektimit, në gjykimin e grupit të auditimit mund të kufizojë konkurrencën.

**Pika 2.3.1.b** - Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë; dhe/ose
2. Fatura tatimore për çdo shërbim

Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 28 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në pikën 3 përcaktohet se: “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore të shitjes**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”. Pra vendosja e kërkesës, që veç faturave tatimore të dorëzohen edhe kontratat, është e panevojshme, krijon kosto në kohë për OE, si dhe mund të vështirësojë pjesëmarrjen e tij, pasi një OE nuk e ka detyrim ruajtjen e kontratave, por vetëm të faturave tatimore deri në një periudhë 5 vjeçare.

**Pika 2.3.2.1** – AK ka kërkuar certifikatë akreditimi ISO/IEC 17020:2012 “Kritere të përgjithshme për funksionimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektime” (në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) - Në procesverbalin e hartimit të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, **nuk pasqyrohet argumenti teknik** se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së mësipërme vetëm në fushën e inspektimit nëpërmjet verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe jo edhe në një fushë tjetër pra energji elektrike, uji i pijshëm, mjekësi etj.

-Kërkesa e mësipërme **nuk është në përputhje** me përcaktimin e bërë në nenin 30 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku veç Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, duhet të përcaktohet edhe pranueshmëria e certifikatave të lëshuara nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Sjellim në vëmendje** këtu edhe rekomandimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, nr.3330 prot., datë 20.03.2018 për APP dhe nr.145 prot., datë 16.03.2018 për DPA, për mënyrën se si duhet të veprojnë AK në vendosjen e kërkesave për certifikimin.

-Gjithashtu vendosja e kriterit në formën e mësipërme, pra specifikimi se certifikata duhet të jetë vetëm në fushën e inspektimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, **kufizon konkurrencën**, pasi kufizon pjesëmarrjen e OE që kanë certifikatën e mësipërme në fushat e tjera të inspektimit nëpërmjet verifikimit të instrumenteve matës të energjisë, ujit, cisternave rrugore, terminaleve të shpërndarjes me shumicë të karburantit.

-Për më tepër që kjo kërkesë **bie në kundërshtim me pikën 2.3.1**, kapacitetet teknike, në DST, ku kërkohet eksperiencë në punë të ngjashme në fushën e inspektimit dhe matjeve. Një OE mund të vërtetojë plotësimin e këtij kriteri, duke dorëzuar punë të ngjashme në fushën e inspektimit dhe matjeve, por jo specifikisht në shpërndarësit e karburantit dhe gazit të lëngshëm, por në një fushë tjetër, pra plotësohet një nga kërkesat e kapacitetit teknik, çka nënkupton se OE ka edhe certifikatën ISO 17020, e cila është lëshuar për fushën në të cilën OE kryen aktivitet, por nuk mund të marrë pjesë pasi nuk e ka në fushën e inspektimit nëpërmjet verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Veç sa më sipër, për të përforcuar konstatimin, se një kërkesë e tillë kufizon konkurrencën, citojmë informacion referuar Raportit të Auditimit të Performancës, faqe nr.,54, kryer nga KLSH<sup>10</sup> pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së, ku rezulton se në Shqipëri janë aktualisht 15 kompani private të certifikuara me certifikatë ISO 17020 si trupa verifikuese. Nga këto, 3 janë subjekte/laboratorë privatë për verifikim të matësve të energjisë elektrike, 4 për verifikimin e matësve të ujit të

<sup>10</sup> Miratuar me Vendimin nr.234, datë 30.12.2021 të Kryetarit të KLSH-së.



pijshëm, 4 për verifikim të cisternave rrugore; 2 për shërbim riparimi dhe testimi të përkohshëm të distributorëve të karburantit, si dhe 2 për peshoret automobilistike.

**Pika 2.3.2.2** – AK ka kërkuar certifikatë akreditimi ISO 9001:2008 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” - Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, **nuk pasqyrohet argumenti teknik** se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së mësipërme. Gjithashtu ky standard është shfuqizuar me ISO 9001:2015<sup>11</sup>, pra certifikatat e akreditimit ISO 9001:2008 nuk kanë vlefshmëri ligjore.

**Pika 2.3.2.3** – AK ka kërkuar certifikatë akreditimi OHSAS 18001:2007 “Shëndeti dhe sigurimi në punë” - Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, **nuk pasqyrohet argumenti teknik** se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së mësipërme. Gjithashtu ky standard është shfuqizuar me ISO 45001:2018<sup>12</sup>, pra certifikatat e akreditimit OHSAS 18001:2007 nuk kanë vlefshmëri ligjore.

**Pika 2.3.2.4** – AK ka kërkuar certifikatë akreditimi ISO 14001:2015 “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” - Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, **nuk pasqyrohet argumenti teknik** se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së mësipërme. Sqarojmë se ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. Në rastin në fjalë projekti i është nënshtruar vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe sipas këtij raporti, projekti nuk rezulton të ketë ndikim në mjedis, por edhe sikur të ketë, subjekti ka detyrim ligjor që të respektojë masat parandaluese dhe rehabilituese të përcaktuara në VNM për mbrojtjen e mjedisit.

-Në përmbajtjen e DST, specifikimet teknike, pika 2.2, lidhur me sistemet e informacionit që do të ofrohen nga OE gjatë zbatimit të projektit, konstatohet se nuk janë në përputhje të plotë me propozimin e bërë në studimin e fizibilitetit. Konkretisht në studimin e fizibilitetit propozohet që të ndërtohet baza e të dhënave, duke qenë e aftë të këmbejë, ndër veprojë dhe të verifikojë të dhënat me bazat e tjera shtetërore të të dhënave. Pra krijimin e një baze të dhënash me numrin e karburanteve, emrin tregtar, vendndodhjen, selinë kryesore dhe degët, etj, si dhe përditësimin e këtij informacioni. Ndërtimi i bazës së të dhënave nuk është përcaktuar në DST. -Gjithashtu në DST nuk jepet informacion mbi numrin e distributorëve që janë në Shqipëri, me qëllim dhënien e ndihmës ndaj OE për përgatitjen e analizës financiare.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 22 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 24 në VKM nr.575 datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar; Pikën 3, shkronjën “a” të pikës 4 në nenin 28, nenin 30, pikën 2 të nenit 31, pikën 2 të nenit 61 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V..*

### **Ankesa**

Në lidhje me kriteret e vendosura në procedurën e mësipërme me shkresën nr.17621 prot., datë 01.10.2018, pranë MFE administrohet ankesa nga OE P. T. SA. Ankesa i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me paraqitjen e ankesës, nga KPP (organi i vetëm që shqyrton ankesat për procedurat konkurruese) është marrë vendimi nr.1539/1 prot., datë 01.10.2018, protokolluar në MFE me shkresën nr.17871, datë 04.10.2018.

<sup>11</sup> <https://www.iso.org/standard/46486.html>

<sup>12</sup> <https://www.nqa.com/nl-nl/certification/standards/ohsas-18001>

KPP ka vendosur të pranojë dhe shqyrtojë ankesën, pezullimin e procedurës, si dhe MFE të dërgojë pranë KPP, informacionin e hollësishëm për procedurën dhe dokumentacionin e mbajtur.

Në mënyrë të përmbledhur ankesa është bërë për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në mënyrë të paargumentuar nga AK dhe mospublikimin e studimit të fizibilitetit në sistemin e prokurimit, konkretisht:

- Për kriteret ekonomike, pika 2.2, shtojca 8, mbi paraqitjen e pasqyrave financiare dhe togfjalëshin “aktivitet pozitiv të qëndrueshëm”.
- Për kriteret teknike, ku është kërkuar që për dokumentimin e eksperiencave të mëparshme me sektorin privat të pranohen faturat tatimore shitje, si dhe përcaktimin e vlerës së faturave tatimore.
- Mbi paqartësinë për formën e paraqitjes së dokumenteve të ofertuesve të huaj, konkretisht për gjuhën e dokumenteve.
- Mbi mungesën e paraqitjes së studimit të fizibilitetit në sistemin e prokurimeve.
- Mbi mënyrën e trajtimit të propozimit për marrjen me koncesion, i cili nuk duhet të trajtohet si propozim i pa kërkuar dhe rrjedhimisht ndaj subjektit nuk duhet të jepet bonus.
- Mbi paqartësitë dhe mungesën e informacionit të nevojshëm në shtojcën 12 dhe shtojcën 16, të cilat pengojnë OE në përgatitjen e ofertës ekonomike dhe teknike.
- Me urdhrin nr.256, datë 05.10.2018 të titullarit të AK, është vendosur pezullimi i procedurës, dhe ngarkohet komisioni i dhënies me koncesion të përgatitë dhe të dërgojë materialet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar.
- Me shkresën nr.445 prot., datë 11.01.2019 pranë MFE është administruar fletë-thirja nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë. Bashkëlidhur fletë-thirrjes, kërkesë padia e bërë nga subjekti N. C. Sh.P.K, me palë të paditur KPP dhe objekt “Nxjerrjen e vendimit në lidhje me ankimin e bërë nga subjekti P. T. SA”.
- Me shkresën nr.2262 prot., datë 11.02.2019 pranë MFE është administruar vendimi i KPP nr.77/2019 prot., datë 07.02.2019.
- KPP ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga subjekti P. T. SA, si dhe të lejojë AK vazhdimin e mëtejshëm të procedurës konkurruese.
- Me shkresën nr.4911 prot., datë 25.03.2019 pranë MFE është administruar kërkesë padia e bërë nga subjekti P. T. SA, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë të paditur KPP dhe MFE, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të KPP, detyrimin e KPP për të ndryshuar kriteret në DST, si dhe detyrimin e AK që të mos vijojë me procedurën e prokurimit”.
- Gjithashtu në dosje administrohet shkresa nr.4911/3 prot., datë 10.06.2019, bashkëlidhur vendimi nr. 2058 regjistër themeltar, datë 10.04.2019 “Për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë” i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me palë paditës “P. T. SA”, në të cilin është vendosur refuzimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e zbatimit të vendimit të KPP nr.77/2019 datë 07.02.2019.
- Me vendimin nr.1790 prot., datë 27.05.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, Gjyqtare znj. N. H., ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë, shfuqizimin e vendimit të KPP dhe detyrimin e MFE për ndryshimin e kriterëve të DST.
- Shkresa nr. 4911/7 prot., datë 18.06.2019, ku dërgohet kërkesa ankimore me objekt “Kundërshtim i Vendimit nr.1790 (80-2019-1832) datë 27.05.2019” të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
- Në dosje nuk administrohet nëse ka vendim nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, për shqyrtimin e ankesës së mësipërme.
- Shkresa nr.4911/8 prot., datë 01.07.2019, ku administrohet ankimi i bërë nga KPP për ndryshimin e vendimit nr. 1790 prot., datë 27.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
- Shkresa nr.4911/9 prot., datë 01.07.2019, ku administrohet ankimi i bërë nga Avokati i Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, për vendimin nr. 1790 prot., datë 27.05.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

-Me urdhrin nr.204, datë 03.06.2019 të ish Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është bërë heqja e pezullimit të procedurës konkurruese, jo në përputhje me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 2 të nenit 64/2 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi urdhri për heqjen e pezullimit dhe vazhdimin e zbatimit të vendimit të KPP, është bërë pas 3 muaj e 23 ditëve dhe jo brenda 10 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të KPP. Në rastin e mësipërm urdhri për heqjen e pezullimit dhe vazhdimin e procedurës duhet të ishte bërë brenda datës 22.02.2019.

### **Vlerësimi i ofertave.**

Në këtë tender kanë marrë pjesë 1 OE përkatësisht OE N. C. Sh.P.K me ofertën ekonomike në vlerën 70,000,000 lekë, vlera e investimit që do të kryejë subjekti.

-Me urdhrin nr.205, datë 03.06.2019 të ish Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, znj. A. D., është bërë ndryshimi i komisionit të dhënies me koncesion, përkatësisht:

Z.E. M. zëvendësohet me Znj. S. P. dhe Znj. E. O., zëvendësohet me Znj. A. A..

-Nga komisioni i dhënies me koncesion me përbërje, S. P., Kryetar, A. U., A. A., A. P. dhe G. V., Anëtar, është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 03.06.2019 për hapjen e ofertave.

-Nga komisioni i dhënies me koncesion është mbajtur procesverbali nr.s’ka, datë 07.06.2019 për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni ka vendosur të shpallë fitues OE N. C. Sh.P.K me pikët maksimale të konkurrimit, pra 100 pikë.

-Me shkresën nr.10441/1 prot., datë 14.06.2019, AK ka njoftuar OE N. C. Sh.P.K, për klasifikimin e ofertës dhe se do të presë afatin e rishikimit administrativ, në rast të ankesave dhe më pas do të vijojë me njoftimin e shpalljes së fituesit në faqen zyrtare të APP.

-Gjithashtu raporti i vlerësimit nr.12609 prot., datë 01.07.2019 drejtuar titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. A. K..

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të administruar në dosje, përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:**

-Komisioni i dhënies me koncesion nuk ka në përbërje të tij ekspert të fushës, në kundërshtim me përcaktimet e bëra pikën 2 të nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar.

-Në procesverbalin e mbajtur për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe në raportin përmbledhës, nuk pasqyrohet asnjë informacion mbi dorëzimin/jo të dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kriterëve teknike, shtojca 10, konkretisht:

#### **KT1: Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit– 35 pikë**

Ofertuesi do të paraqesë zgjidhjen teknike për pajisjet dhe mjetet që do të përdorë për kryerjen e shërbimit – Nuk pasqyrohet informacion.

Ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij një plan të detajuar në lidhje me kapacitetin logjistik të shoqërisë duke vënë në përdorim të gjitha burimet dhe aftësitë që zotëron - Nuk pasqyrohet informacion.

Gjithashtu duhet të paraqitet dhe një përshkrim i programit kompjuterik (software) që do të përdoret për të kryer dhe monitoruar në kohe reale shërbimin - Nuk pasqyrohet informacion.

Ofertuesi do të paraqesë një plan të përgjithshëm mbi disponueshmërinë e pajisjeve, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e të gjitha pajisjeve, mjeteve dhe programeve kompjuterike gjatë periudhës së Koncesionit - Nuk pasqyrohet informacion.

#### **KT2: Plani i Zbatimit të Projektit dhe Ri-investimit– 20 pikë**

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan pune për fillimin e kryerjes së Shërbimit - Nuk pasqyrohet informacion.

#### **KT3: Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve – 15 pikë**

Ofertuesi duhet të paraqesë një plan për burimet njerëzore që do të përdorë në projekt - Nuk pasqyrohet informacion.

#### **KT4: Procedurat e Menaxhimit të Cilësisë - 10 pikë**

Ofertuesi duhet të paraqesë një dokument që do të paraqet një përmbledhje të procedurave të menaxhimit të cilësisë që do të zbatohet për kryerjen e shërbimit - Nuk pasqyrohet informacion.

Pra sa më sipër nuk vërtetohet dorëzimi i dokumentacionit brenda afatit 18.10.2019 (data e fundit për dorëzimin e ofertave) nga OE N. C. Sh.P.K.

*Për këtë mban përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

-Raporti i vlerësimit nuk përmban informacionin sipas përcaktimit të bërë nën 68 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Theksojmë se në këtë raport, pasqyrohet informacioni se në këtë procedurë nuk ka pasur asnjë ankesë.

*Për këtë mban përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

-Në dosjen e procedurës nuk administrohet deklarata e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit nga anëtari i komisionit të dhënies me koncesion, znj. A. P., pra nuk vërtetohet nënshkrimi i kësaj deklarate, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 64 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këto kushte nga Kryetari i komisionit të dhënies me koncesion, duhet të ishin marrë masat për administrimin e deklaratës së mësipërme.

*Për këtë mban përgjegjësi znj. S. P..*

-Raporti i vlerësimit i është drejtuar për miratim z. A. K., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MFE, në rolin e titullarit kontraktor, ndërkohë në këtë periudhë, titullar i AK ka qenë ish Ministri i MFE, znj. A. D..

Z. A. K. i janë deleguar kompetencat e titullarit të AK, me urdhrin nr.1, datë 06.01.2020, të ish Ministrisë të MFE, znj. A. D.. Theksojmë se edhe në urdhrin e mësipërm ish Sekretarit të Përgjithshëm i janë deleguar kompetencat e titullarit të AK, vetëm për procedurat e prokurimit me fondet buxhetore të MFE.

-Pra në këto kushte miratimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm z. A. K., është në tejkalim të kompetencës ligjore dhe si i tillë mbështetur në nenin 109 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në RSH”, konsiderohet i paligjshëm.

-Sa më sipër, komisioni i dhënies me koncesion nuk duhet të kishte vazhduar procedurën, pra konceptimin e formularit të njoftimit të fituesit për miratim, me qëllim botimin e tij në faqen zyrtare të APP, deri në miratimin e raportit përmbledhës nga titullari i AK-së.

*Për këtë mban përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U., si dhe ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE, z. A. K..*

-OE shpallur fitues nuk plotëson shkronjën “a” të pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në DST. Konkretisht në shkronjën “a” të pikës 2.2 kërkohet: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të Pasqyrave Financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet – Nga verifikimi i pasqyrave financiare, në vitin 2016 subjekti N. C. shpk ka dalë me humbje. Nëse do të referohemi edhe shpjegimit të AK drejtuar KPP me shkresën nr.17871/2 prot., datë 09.10.2018, rezulton se qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qenë shprehimisht: Sipas këtij parashikimi (pra aktivitet pozitiv të qëndrueshëm) ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do të kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave financiare.

Gjithashtu edhe KPP në trajtimin e ankesës së subjektit P. T. SA, shprehet se dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite, është një parakusht që tregon rrezikun potencial të mos-përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike. OE “N. C.” Sh.P.K nuk duhet të

ishte kualifikuar për fazën e vlerësimit të kriterëve teknike. Sa më sipër është në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit.

*Për këtë mbajnë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U.*

**Shënim:** Grupi i auditimit, për kontratën e koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019, publikuar edhe online nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, ka hasur vështirësi jo vetëm për marrjen dhe shqyrtimin e dokumenteve, kjo kryesisht për shkak të keqadministrimit të praktikës nga të gjitha strukturat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, si dhe nëse janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet shkresore të prodhuara nga institucionet apo dorëzuara nga shoqëri përfituese, si dhe në mungesë të dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës, grupi i auditimit nuk ka mundur të realizoj zbatimin e kontratës, duke ndikuar në rezultatin e auditimit, si dhe në dhënien e opinioneve të kufizuara lidhur me përputhshmërinë e zbatimit të saj nga përfituesi si dhe monitorimin e saj nga strukturat përgjegjëse.

Për sa më sipër konstatohet:

-Procedura e dhënies me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, nga MZHETS, është në kundërshtim me kuadrin rregullator të koncesioneve.

-Forma e zgjedhur është nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, të subjektit A. N. C. Sh.P.K, me argumentin se: *“Aktiviteti që kryhet aktualisht nga DPM, nuk bazohet në teknologji të përparuar, në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës dhe kjo shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer.* Objekti i kërkuar në propozim nuk përfshihet në fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës.

-Projekt-vendimi dhe relacioni shoqërues i tij, përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim, është në kundërshtim me kërkesat e kuadrin rregullator të koncesioneve, kryesisht në përmbajtjen e projekt-akteve që propozohen për miratim.

-Relacioni shoqërues përmban të dhëna jo të sakta, sa i përket mungesës së efekteve në buxhet të këtij projekt vendimi, pasi DPM nga shërbimi i verifikimit të pistoletave të karburantit realizon 76,193,121 lekë, të cilat kalojnë për llogari të buxhetit të shtetit dhe me dhënien me koncesion këto të ardhura janë të munguara për Buxhetin e Shtetit.

-Mendimet e dhëna nga Ministritë e Linjës, kryesisht mendimet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, bien në kundërshtim me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës, konkretisht në VKM që përcakton fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive të mësipërme.

-MZHETS duhet të ishte shprehur kundër dhënies me koncesion, pasi e ka detyrë (VKM për përgjegjësinë shtetërore) që të vlerësojë nëse një projekt-akt është në përputhje me politikat e qeverisë. Në këtë rast ky projekt-akt bie në kundërshtim me politikat e qeverisë, pasi në strategjinë për mbrojtjen e konsumatorit 2015-2020 (dokument politik i qeverisë, cilësuar në krye të herës në përmbajtje të strategjisë) miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015, në planin e veprimit nuk është përcaktuar si objektiv dhënia e shërbimit të verifikimit metrologjik të pistoletave të karburanteve nëpërmjet koncesionit/formë tjetër ligjore. Në procedurën e ndjekur nuk është marrë mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nuk është marrë mendimi i Ministrisë së Mjedisit, ku sipas raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, megjithëse në vlera të ulëta, projekti mund të ketë ndikim në mjedis.

Sa më sipër është në mos përputhje me Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar me Ligjin nr. 88/2014 dhe Ligjin Nr.77/2015, në fuqi për periudhën kur janë kryer veprimet e MZHETS, konkretisht: Neni 3, pika 10: “Objekti i koncesionit” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruara në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj. Neni 4, pika 1.

Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Konkretisht për

kryerjen e këtij shërbimi, janë investuar 63,975,994 lekë në blerjen e 9 autolaboratorëve si dhe pajisjet e nevojshme.

Vlera 63,975,994 lekë përbën efekt ekonomik negativ për Buxhetin e Shtetit.

-Studimi i fizibilitetit dorëzuar nga koncesionari përmban të dhëna të pasakta në përlogaritjen e të ardhurave vjetore, të cilat automatikisht ndikojnë në vlerën e NPV (vlera aktuale neto) tregues i cili shërben për marrjen e vendimit për kryerjen e investimit ose/jo.

Studimi i fizibilitetit përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion, përmban të dhëna jo të sakta, si dhe të pakonfirmuara nga burime zyrtare. Komisioni, për ta bërë fizibel projektin e koncesionit, i ka shtuar si të ardhura vjetore koncesionarit edhe të ardhurat nga TVSH që do të sigurohen nga ofrimi i shërbimit nga koncesionari, si dhe është sjellë situata në kushte jo të barabarta me krahasuesin e sektorit publik, pra ofrimin e shërbimit nga DPM, ku kësaj të fundit nuk i kanë njohur aspak të ardhura për buxhetin e shtetit, përkundrazi i kanë shtuar si kosto TVSH që nuk ka mbledhur DPM, ndërkohë që DPM nuk është institucioni përgjegjës për mbledhjen e TVSH.

Komisioni i dhënies me koncesion nuk përmban specialist të fushës, detyrim ligjor.

Nga analiza financiare e kryer nga grupi i auditimit, përlogaritja e NPV dhe IRR (norma e kthimit të investimit) bazuar në të dhënat e studimit të fizibilitetit të koncesionarit dhe të dhënave faktike nga DPM, rezulton se ofrimi i shërbimit nga sektori publik në krahasim me privatin, është më fizibel nga ana financiare, pasi norma e NPV dhe IRR janë më të larta në krahasim me normat e privatit. Vetëm ky rezultat për komisionin e dhënies me koncesion përbën shkak për marrjen e vendimit për refuzimin e dhënies me koncesion të shërbimit të verifikimit metrologjik.

Sa më sipër është në mos përputhje me Vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, neni 7,8.

Mos paraqitja e saktë dhe e besueshme e studimit të fizibilitetit, sjell vendim marrje jo të duhur nga AK.

- Raporti përmbledhës i përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion është bërë pas hartimit të studimit të fizibilitetit, ndërkohë që ky dokument hartohet përpara përgatitjes së studimit të fizibilitetit. Ky raport është i rëndësishëm për vendim marrjen e AK për vazhdimësinë e projektit.

Në raportin përmbledhës drejtuar titullarit të AK, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK.

Në mendimin e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, nëpërmjet MEMO-s nr. s’ka datë 27.08.2018, nuk pasqyrohet mendimi i drejtorisë së mësipërme për impaktin që mund të ketë dhënia me koncesion në drejtim të deficitit buxhetor dhe detyrimeve kontigjente eventuale.

Nuk administrohet miratimi i projektit për dhënien me koncesion, nga titullari i AK. Konkretisht në MEMO-n, nr. s’ka, datë 03.09.2018, përgatitur nga ish Sekretari i Përgjithshëm, zj. G. P., drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, z. A. A., ku kërkohet miratimi i projektit për vazhdimin e procedurave, pra shpalljen e njoftimit të kontratës në APP, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK.

Sa më sipër është në mos përputhje me nenin 12 i Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “Deficiti buxhetor, në një vit buxhetor, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat”. Në këtë rast nëpërmjet dhënies me koncesion do të reduktohen të ardhurat e buxhetit të shtetit, çka bënë të nevojshme dhënien e mendimit për impaktin që mund të ketë reduktimi i të ardhurave. Gjithashtu referuar përcaktimit të bërë

në pikën 22 të nenit 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shprehimisht: “Detyrim kontingjent” është detyrimi që mund t’i lindë njësisë së qeverisjes së përgjithshme në raport me të tretë, në të ardhmen, si rezultat i risqeve të mundshme, të lidhura me ngjarje apo nisma, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të viteve të mëparshme. Në këtë rast duke marrë në konsideratë risqet e identifikuar në studimin e fizibilitetit, konkretisht riskun e inflacionit, që i është transferuar autoritetit kontraktor për të ndërmarrë veprimet e nevojshme. Një rritje e normës së inflacionit, mund të sjellë rritjen e shpenzimeve të subjektit koncesionar dhe për pasojë në flukset monetare hyrëse dhe në normën IRR. Veç sa më sipër në analizën që kryen Ministria e Financave me qëllim miratimin e projektit:

a) përcakton ndikimet e menjëhershme dhe të mundshme fiskale për qëllimet e vlerësimit të përbalueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe për qëllime të buxhetimit të detyrimeve dhe angazhimeve të tilla, kur është e përshtatshme;

c) përcakton qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, në lidhje me projeksionet afatgjata (fluksin e parasë) dhe parashikimet (makroekonomike) të kapacitetit buxhetor dhe aftësinë për të përkrahur shërbimin e mbështetjes financiare dhe angazhimet e tjera kontraktuale të parashikuara nga projekti;

ç) analizon risqet, kryesisht ato që merren përsipër plotësisht ose pjesërisht nga autoriteti kontraktues, për qëllimin e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së tyre dhe të kostove, si dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave për trajtim jashtë bilancit, nëse është e përshtatshme.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:

Nenin 9, pikat 2 dhe 6 të nenit 18, pikën 3, shkronjën “b” në pikën 5 të nenit 19, pikën 3 të nenit 29, në Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar; Pikën 3, 4 dhe 7 të nenit 8, pikën 1 dhe shkronjat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 12, pikat 1 dhe 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 17, shkronjat “a”, “c” dhe “ç” në pikën 1 të nenit 20 në VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar; Pikën 2 në Kreun IV në VKM nr.503, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V., si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit dhe Borxhit Publik, znj. M. Dh..*

Në pikën 4.2 të dokumenteve të tenderit, AK në kriteret e përzgjedhjes së fituesit, ka përcaktuar me 80 pikë kriteret teknike dhe me 10 pikë ofertën ekonomike për investimin fillestar si dhe 10 pikë tarifën koncesionare. Në procesverbalin nr. 6, datë 24.08.2018 komisioni nuk ka argumentuar arsyet e dhënies së pjesës më të madhe të pikëve kriterëve teknike.

-Në lidhje me aktivitetin ekonomik pozitiv, AK nuk i ka kërkuar të certifikuar pasqyrat financiare.

-AK nuk ka argumentuar kërkesën për eksperiencë brenda 3 viteve të fundit në fushën e inspektimit dhe matjes, kur shërbimi që kërkohet verifikimi i instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm duke konfirmuar nëpërmjet nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike. Pra instrumenti do të nënshtrohet matjes për të verifikuar saktësinë e tij. Në këto kushte është e mjaftueshme eksperiencia në fushën e matjes, si dhe kërkesa për eksperiencë në fushën e inspektimit, në gjykimin e grupit të auditimit mund të kufizojë konkurrencën.

-Kërkesa nga OE për dokumentimin e përvojave të mëparshme duke kërkuar kontratën dhe faturat tatimore krijon vështirësi në pjesëmarrjen në procedurë.

Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, nuk pasqyrohet argumenti teknik se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së akreditimit ISO/IEC 17020:2012 “Kritere të përgjithshme për funksionimin e

tipave të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektime” (në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarëseve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit), vetëm në fushën e inspektimit nëpërmjet verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe jo edhe në një fushë tjetër pra energji elektrike, uji i pijshëm, mjekësi etj. Vendosja e këtij kriteri kufizon konkurrencën.

-Në përmbajtjen e DST, specififikimet teknike, pika 2.2, lidhur me sistemet e informacionit që do të ofrohen nga OE gjatë zbatimit të projektit, konstatohet se nuk janë në përputhje të plotë me propozimin e bërë në studimin e fizibilitetit. Konkretisht në studimin e fizibilitetit propozohet që të ndërtohet baza e të dhënave, duke qenë e aftë të këmbëjë, ndërveprojë dhe të verifikojë të dhënat me bazat e tjera shtetërore të të dhënave. Pra krijimin e një baze të dhënash me numrin e karburanteve, emrin tregtar, vendndodhjen, selinë kryesore dhe degët, etj, si dhe përditësimin e këtij informacioni. Ndërtimi i bazës së të dhënave nuk është përcaktuar në DST.

-Gjithashtu në DST nuk jepet informacion mbi numrin e distributorëve që janë në Shqipëri, me qëllim dhënien e ndihmës ndaj OE për përgatitjen e analizës financiare.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 22 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 24 në VKM nr.575 datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar; Pikën 3, shkronjën "a" të pikës 4 në nenin 28, nenin 30, pikën 2 të nenit 31, pikën 2 të nenit 61 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

*Për sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje si vijon: E. M., E. O., A. U., A. P. dhe G. V..*

Në këtë tender ka marrë pjesë një Operator Ekonomik, përkatësisht OE N. C. Sh.P.K me ofertën ekonomike në vlerën 70,000,000 lekë, vlera e investimit që do të kryejë subjekti.

-Komisioni i dhënies me koncesion nuk ka në përbërje të tij ekspert të fushës, në kundërshtim me përcaktimet e bëra pikën 2 të nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar.

-Në procesverbalin e mbajtur për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe në raportin përmbledhës, nuk pasqyrohet asnjë informacion mbi dorëzimin/jo të dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kriterëve teknike, shtojca 10, një plan te detajuar ne lidhje me kapacitetin logjistik te shoqërisë dhe një plan te përgjithshëm mbi disponueshmërinë e pajisjeve, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e të gjitha pajisjeve, mjeteve dhe programeve kompjuterike gjatë periudhës së Koncesionit.

-Raporti i vlerësimit nuk përmban informacionin sipas përcaktimit të bërë nenin 68 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Sa më sipër është në mos përputhshmëri me pikën 2 e nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, dhe nenin 68 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Mos evidentimi i informacioneve përkatëse rrit riskun vendim marrjeve që sjellin në keqmenaxhim të aseteve publike.

*Për këtë mban përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U.*

-Komisioni i dhënies me koncesion, i ka drejtuar raportin e vlerësimit për miratim z. A. K., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MFE, në rolin e titullarit kontraktor, ndërkohë në këtë periudhë, titullar i AK ka qenë Ministri i MFE.

Z. A. K. i janë deleguar kompetencat e titullarit të AK, me urdhrin nr.1, datë 06.01.2020, të ish Ministrit të MFE. Theksojmë se edhe në urdhrin e mësipërm ish Sekretarit të Përgjithshëm i



janë deleguar kompetencat e titullarit të AK, vetëm për procedurat e prokurimit me fondet buxhetore të MFE.

-Pra në këto kushte miratimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm z. A. K., është në tejkalim të kompetencës ligjore dhe si i tillë mbështetur në nenin 109 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në RSH”, konsiderohet i paligjshëm.

-Sa më sipër, komisioni i dhënies me koncesion nuk duhet të kishte vazhduar procedurën, pra konceptimin e formularit të njoftimit të fituesit për miratim, me qëllim botimin e tij në faqen zyrtare të APP, deri në miratimin e raportit përmbledhës nga titullari i AK-së.

Sa më sipër është në mos përputhje me nenin 109 i Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në RSH”.

-OE shpallur fitues nuk plotëson shkronjën “a” të pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në DST. Konkretisht në shkronjën “a” të pikës 2.2 kërkohet: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të Pasqyrave Financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet – Nga verifikimi i pasqyrave financiare, në vitin 2016 subjekti N. C. shpk ka dalë me humbje. Nëse do ti referohemi edhe shpjegimit të AK drejtuar KPP me shkresën nr.17871/2 prot., datë 09.10.2018, rezulton se qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qenë shprehimisht: Sipas këtij parashikimi (pra aktivitet pozitiv të qëndrueshëm) ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do të kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave financiare.

Gjithashtu edhe KPP në trajtimin e ankesës së subjektit P. T. SA, shprehet se dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite, është një parakusht që tregon rrezikun potencial të mos-përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike.

Mos pasja e aktivitetit pozitiv ekonomik rrit riskun e mos përmbushjes së detyrimeve të kontratës publike.

Sa më sipër është në mos përputhje me shkronjën “a” e pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit.

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me email datë 27.06.2024 nga z. A. U., i cili shprehet se i qëndron observacioneve të bëra me shkresë nr. 19754/8, datë 29.01.2024, “Komente mbi gjetjet e evidentuara në Akt-Konstatimin nr. 1”, nga znj. A. P. me email datë 21.06.2024, ku shprehet se i qëndron observacioneve të bëra për akt konstatimet, z. G. V. me emailin e datës 19.06.2024 ku shprehet se i qëndron komenteve të bëra për akt konstatimet dhe emailin e znj. I. Z. datë 18.06.2024, bashkëlidhur observacionet e znj. P. C., znj. S. P., znj. S. D., z. A. L., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në vijim të Akt Konstatimit nr. 1, datë 19.01.2024 "Mbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të programit të auditimit të përputhshmërisë nr. 25711 prot., datë 03.05.2023 të ndryshuar", mbi projektin për "Dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm", dhënë shoqërisë "N. C." sh.p.k. për periudhën, nga data e fillimit të projektit deri më 31.12.2022, paraqiten argumentet si më poshtë vijon: 1. Në evidentimin e bërë nga grupi i auditimit, në faqen 5 të aktit të konstatimit, ku përcaktohet se: "Nga data 17.08.2017 deri më datë 20.06.2018. në dosjen e procedurës së dhënies me koncesion vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, nuk administrohet asnjë dokumentacion mbi ecurinë e procedurës korrespondencës që lidhet me procedurën përkatëse.", sjellim në vëmendje se, në datën 17.08.2017, projektvendimi për "Dhënien me koncesion të shërbimit të*

*kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë", është dërguar për shqyrtim dhe miratim nga Ministri i MZHETTS tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave. Ky projektvendim është miratuar me VKM nr. 365, datë 20.06.2018. Pra gjatë kësaj periudhe, procedura as nuk ishte miratuar e as nuk kishte nisur. Praktika i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe nuk mund të ketë korrespondenca në MFE.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Ju sqarojmë se paragrafi që ju observoni, është përshkruar dhe jo konstatim, si dhe për më tepër nuk ngarkoheni ju me përgjegjësi. Gjithsesi, jemi shprehur në atë mënyrë, pasi në pjesën hyrëse të VKM nr.365, datë 20.08.2018, në krahasim me Projekt VKM e propozuar, ka një ndryshim në togfjalëshin: Me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë që propozimi i Projekt VKM, është bërë nga ish Ministri i MZHETTS. Për këtë arsye grupi i auditimit ka kërkuar nëse ka pasur një propozim të ri të projekt aktit, mbi të cilin Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë vendimin, apo vendimi i Këshillit të Ministrave është bazuar mbi Projekt Aktin e propozuar nga ish Ministri i MZHETTS. Pra nëse do t'i referoheshim pjesës hyrëse të VKM nr.365, datë 20.08.2018 (pra me propozim të Ministrit të MFE), në krahasim me veprimin faktik (Pra propozimi është bërë nga ish Ministri i MZHETTS), atëherë kuptohet qartë se ka pasur një ngjarje të ndryshme nga ngjarja e mëparshme, e cila ka sjellë ndryshimin e togë-fjalëshit në VKM nr.365, datë 20.08.2018 dhe kjo ngjarje, ligjërisht duhet të dokumentohet.

Përveç sa më sipër, në zbatim të kuadrit rregullator (të cilin e kemi cituar në akt-konstatim dhe projekt raport) që rregullon procedurën e paraqitjes për shqyrtim në Këshillin e Ministrave të projekt akteve dhe dokumentacionit shoqëruar të tyre, duhet të kishte korrespondencë shkresore, pasi propozimi i projekt aktit nga ish Ministri i MZHETTS, ka disa mangësi (të cilat i kemi pasqyruar në vijimësi të raportit përfundimtar) dhe në këto kushte nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, projekt akti duhet të ishte kthyer për plotësim të mangësive.

*2. Në lidhje pikën 7 të faqes 18, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se: 'Komisioni i dhënies me koncesion ngritur me urdhrin nr. 195, datë 12.07.2018. nuk përmban specialist të fushës. në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 18 në ligjin nr. 12120 13.... ', sjellim në vëmendje se në nenin 18 të ligjit të sipërpërmendur, është parashikuar: "1. Për shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues, në koordinim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve/ Partneriteteve Publike Private, krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik/privat. 2. Anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion jurist, ekonomist, profesion teknik dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit/partneritetit publik privat. 3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit/publik/privat është tek, por jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se 2 janë nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)." Në lidhje me këtë konstatim, kujtojmë se numri i anëtarëve ka qenë 5 (pesë), tre prej të cilëve nga autoriteti kontraktues dhe dy nga ATRAKO. Por, ky komision nuk ka asnjë tagër ligjor që të veprojë përpara datës së miratimit të aktit nga titullari i institucionit, në të cilin përcaktohen përbërja e komisionit dhe detyrat që i ngarkohen. Ky komision është ngritur me urdhër të titullarit të AK, i cili ka përcaktuar përbërjen dhe detyrat. Anëtarët e komisionit, pasi njihen me urdhrin, fillojnë me zbatimin e tij.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Si fillim, paragrafi që ju observoni, nuk ju ngarkon me përgjegjësi. Grupi i auditimit nuk është shprehur për numrin e pjesëtarëve në komision, por për përbërjen e tij. Nisur nga objekti i koncesionit, në përbërje të tij dhe në zbatim të kuadrit rregullator (të cilin e kemi cituar në konstatimin përkatës) duhet të kishte specialist të fushës, kryesisht inxhinier në degët mekanike, elektrike, elektronike etj, të cilët kanë të drejtën të ushtrojnë funksionin e metrologut të autorizuar. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

3. Në lidhje pikën 8 të faqes 18, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se: ' Mënyra se si ka vepruar komisioni, është në kundërshtim me procedurën, pasi në këtë rast komisioni ka kërkuar paraqitjen e propozimit. Konkretisht në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 125/2013 ..., përcaktohet shprehimisht se "Propozimi i pa kërkuar " është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese " ; sqarojmë se mënyra se si ka vepruar komisioni nuk është në kundërshtim me procedurën, pasi propozimi i pa kërkuar ishte paraqitur dhe miratuar përpara ngritjes së këtij komisioni dhe ky dokument është kërkuar për tu administruar. Pra, nuk është kërkuar të paraqitet një propozim i ri i pa kërkuar nga një subjekt, por vetëm të mundësohet ky propozim. Për këtë arsye, Komisioni i dhënies së koncesionit, i është drejtuar subjektit "N. C." sh.p.k., me anë të shkresës nr. prot. 1346211, datë 13.07.2018, për të kërkuar përcjelljen pranë MFE, në cilësinë e autoritetit kontraktues, të propozimit të përgatitur, në përputhje me VKM nr.365, datë 20.02.2018, e cila kishte përcaktuar si AK një institucion tjetër nga MZHETTS.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport. Studimi i fizibilitetit ka qenë bashkëlidhur shkresës nr. 9666 datë 09.12.2016. Pra në këtë rast mund t'i drejtoheshit zyrës së protokollit pranë MFE. Për më tepër që e keni cituar edhe në relacionin dërguar ish Sekretarit të Përgjithshëm znj. G. P., ku jeni shprehur se është krijuar nevoja e administrimit të studimit të fizibilitetit me të dhëna të përditësuara. Veç sa më sipër, për të ardhur në argumentin që paraqisni në observacion (pra jo një studim fizibiliteti të ri), ju duhet ta kishit refuzuar studimin e fizibilitetit të paraqitur nga N. C. në vijim të kërkesës tuaj, studim i cili kishte mbishkrimin "Gusht 2018" dhe analiza ekonomiko-financiare i referohet vitit 2018 si vit i parë në ushtrimin e aktivitetit, ndërkohë që duhet të fillonte nga viti 2017, ashtu siç fillonte studimi i fizibilitetit mbi të cilin është marrë edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.365, datë 20.08.2018. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

4. Në lidhje me analizën e bërë nga grupi i auditimit në pikën 9 të Akt Konstatimit, në faqet 18-21, sqarojmë se, projekti për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm është miratuar për tu dhënë me koncesion nëpërmjet VKM nr. 365, datë 20.6.2013. Gjithashtu, nëpërmjet VKM është miratuar afati i kohëzgjatjes së kontratës dhe bonusi prej 10 % të pikëve shoqërisë "N. C." sh.p.k.

Në faqen 1 të studimit të fizibilitetit është parashikuar shumë qartë burimi i të dhënave të përdorura nga Komisioni, të cilat janë referuar nga institucionet shtetërore vendase dhe të huaja, raporte të ndryshme të organizatave të huaja, Banka Botërore dhe burime të tjera të cilat janë konsideruar me rëndësi për përgatitjen e studimit.

Është e rëndësishme të theksojmë se, referuar nenit 25 të ligjit 125/2013, Komisioni nuk ka ndryshuar të dhëna, por ka referuar tek të dhënat e paraqitura nga propozimi i pa kërkuar në përputhje me referencën ligjore të sipërpërmendur. Përsa i përket të ardhurave nga TVSH dhe tatim fitimit shprehem se nuk ka të bëjë me TVSH dhe tatim fitimit e DPM (pasi DPM nuk është objekt i këtyre detyrimeve fiskale), por me taksat dhe tatimet që nuk janë mbledhur nga operatorët që kanë detyrimin të kenë pajisjet e tyre ligjërish të kontrolluara dhe verifikuara për shkak të mangësive në kryerjen e shërbimit nga DPM, të parashtruara në studimin e fizibilitetit, të cilat nëse shërbimi do të ofrohej siç duhej, do të ishin mbledhur nga subjektet dhe do të derdheshin në buxhetin e shtetit.

Për të vijuar më tej analiza e arsytimit të vendimit të koncesionit nuk ishte e mundur të bëhej me metodën e Krahasuesit Publik Privat, pasi shërbimi i DPM nuk mund të jepej me prokurim, pasi kjo metodë nuk është parashikuar në ligjin për Metrologjinë. Për këtë arsye është përdorur krahasimi midis ofrimit të shërbimit nga DPM dhe ofrimi nga një subjekt privat me koncesion,

*parashikuar në nenin 8 të VKM nr. 575/2013, të ndryshuar, për të arritur qëllimin e analizës së arsyetimit të vendimit të koncesionit.*

*Për sa i përket konstatimit mbi faktin se, Komisioni e ka pozicionuar TVSH-në si kosto në rastin kur shërbimi jepet nga DPM dhe si e ardhur për buxhetin në rastin kur jepet me koncesion, mendojmë se është tërësisht e logjikshme dhe e saktë pasi TVSH e munguar do të llogaritet si mangësi dhe me ndikim negativ kur krahasohen metodat. Gjithashtu është e drejtë të konsiderohet si e ardhur shtesë në rastin kur jepet me koncesion, TVSH që aktualisht nuk ishte e mundur të mbledhej, sepse në fund me metodën që kemi zgjedhur ka rezultuar se kjo vlerë do të ri mbledhet vetëm nëse jepet me koncesion dhe fakti i gjithë këtyre viteve tregon që nuk është mbledhur. Pra në mënyrë të përmbledhur, nuk bëhet fjalë për detyrimet e pa mbledhura të "Operacioneve me Shtetin (detyrime)" pasi kjo vlerë është vetëm për ato pika të cilat DPM ka arritur të kryejë shërbimin, por nuk ka mbledhur të ardhurat. Po për ato pika të cilat DPM nuk ka shkuar ndonjëherë apo ka shkuar vetëm një herë në disa vjet. Vlera për të cilën referohet Komisioni rreth 192 mln lekë i përket të ardhurave të cilat kanë munguar ndër vite në buxhetin e shtetit dhe do të vazhdonin të mungonin nëse do të vazhdohej me të njëjtën situatë.*

*Pra nuk qëndron konstatimi se Komisioni ka llogaritur gabim TVSH dhe tatim fitimin, por i ka llogaritur ato si efekte negative ose pozitive për njërën metodë dhe për tjetër për të treguar vlerën më të mirë për para të këtij projekti. Për të vazhduar me tej me parashikimin e neneve 3-6 dhe 7 të VKM nr. 575/2013, të ndryshuar, theksojmë se këto referenca ligjore janë për përgatitjen e modelit financiar të rastiit të propozimit të pa kërkuar. Në këtë rast vlen të përmendet që elementi kryesor i cili e bën vlerësimin për të përzgjedhur metodën e dhënies së këtij shërbimi, e cila arrin vlerën më të mirë për para është risku. Në mënyrën me të cilën ju keni kryer llogaritjet, keni lënë pa përfshirë risqet të cilat në këtë rast përballohen tërësisht nga koncesionari dhe sigurisht që vijnë me një kosto për të, që në rastin se do të jepej me metodën prokurim, do të përballohej i gjithi nga shteti.*

*Për sa i përket përmbajtjes së kostove, të cilat janë cituar nga ju, nga VKM nr. 575/20 13, të ndryshuar, po e përsërisim se kostot përlllogariten për projektin e koncesionit dhe komisioni referuar propozimit të pa kërkuar i ka bërë njësoj siç parashikon VKM nr. 575/2013, e ndryshuar, në faqen 56 e në vijim të studimit në seksionin Analiza Ekonomike dhe Financiare. Pra vlerën e TVSH dhe tatim fitimin e kemi llogaritur si efekt negativ që ndodh në buxhet vetëm për të bërë arsyetimin e vendimit dhe jo kur llogarisim ecurinë e projektit koncesionar, siç parashikon edhe VKM nr. 575/20 13, e ndryshuar në nenet 3-6 dhe 7.*

*Për sa i përket analizës së bërë në lidhje me buxhetin e DPM dhe vlerës së arkëtuar nga ky institucion në vitin 2016, sqarojmë se kjo vlerë që ju referoni është vlera që mbledhet aktualisht, por nuk pasqyron vlerën që duhet të mbledhej realisht nga institucioni. Përsa i përket pjesës së të ardhurave që kalon në buxhetin e shtetit vlen të theksohet edhe shuma totale që merr DPM në vit për të përballuar të gjitha shpenzimet vjetore. Këto shuma sigurisht që dalin nga buxheti i shtetit sepse DPM është institucion buxhetor dhe të gjitha shpenzimet dhe përballimi i risqeve të paparashikuara në lidhje me këtë projekt do të mbuloreshin nga buxheti i shtetit. Pra për të bërë këtë analizë duhet parë i gjithë buxheti i DPM ndër vite dhe jo vetëm pjesa e të ardhurave që arkëtohen apo 10 mln lekë shpezime që mban DPM nga këto të ardhura. Këtë gjë e ka konfirmuar edhe analiza e bërë nga strukturat përkatëse të buxhetit në MFE të cilët kane dhënë miratimin e tyre për këtë projekt.*

*Pra fillimisht projekti në vetvete del i qëndrueshëm nga ana teknike financiare dhe më pas bëhet krahasim në lidhje me metodën e zbatimit të këtij projekti duke bërë krahasuesin i cili ka për qëllim të përcaktojë elementet negative dhe pozitive që vijnë si pasojë e zbatimit të projektit në secilën nga mënyrat, prokurim apo koncesion.*

*Në pikën 2 të nenit 13 të VKM nr. 575, datë 1 0.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", e cila është riformuluar sipas VKM nr. 31 3, datë 27.4.20 16 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, Këshillit të Ministrave...", përcaktohet se "Komisioni i koncesionit/PPP mund të përdorë të gjitha ose një pjesë të informacionit të propozimit të pa kërkuar për të hartuar studimin e fizibilitetit.". Në kushtet kur propozimi i pa kërkuar është hartuar nga një nga*

*shoqëritë e auditimit më të mëdha në botë si Deloitte, është trajtuar dhe miratuar me VKM, nuk mund të konsiderohet e gabuar marrja e të dhënave të këtij propozimi për hartimin e studimit të fizibilitetit nga Komisioni i dhënies së koncesionit.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport. Si fillim jemi të qartë se DPM nuk është subjekt i tatim-fitimit, pasi këtë e përcakton ligji i fushës, pra për tatimin mbi të ardhurat, ku përcaktohen subjektet dhe objekti. Sa i përket TVSH, theksojmë se DPM është subjekt i TVSH, pasi vlera e faturës tatimore që lëshon DPM për ofrimin e shërbimit, përbëhet nga çmimi i shërbimit dhe TVSH.

Ju mund të referoni edhe më shumë burime informacioni, por për të vlerësuar evazionin fiskal në këtë sektor ka një institucion publik dhe që është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Ju shprehemi se i referohemi taksave dhe tatimeve që nuk janë mbledhur si rrjedhojë e detyrimit që kanë subjektet që t'i kenë pajisjet e tyre ligjërisht të kontrolluara për shkak të mangësive në shërbimin e ofruar nga DPM. Për këtë sqarojmë se DPM nuk është institucion që ka detyrimin ligjor arkëtimin taksave dhe tatimeve, por as nuk vepron si agjent për llogari të të tretëve në mbledhjen e taksave dhe tatimeve.

Gjithashtu theksojmë se DPM nuk e ka detyrim që të dali në terren dhe të kryejë kontrole se cili prej subjekteve ka instrumente matës dhe cili prej tyre nuk i ka verifikuar ato (këtu flasim për verifikimin fillestar). Pra hapet një subjekt i ri i cili, tregton karburant. Në këtë rast, nga duhet ta dijmë DPM se është hapur një subjekt i ri, në rast se ky subjekt nuk ka aplikuar pranë DPM për kryerjen e verifikimit fillestar, apo institucione të tjera si DPT, QKB nuk i përcjellin DPM informacion se është hapur një subjekt me aktivitet tregtim karburanti. Edhe sikur DPM ta kishte këtë informacion, përsëri nuk e detyron dot subjektin në mënyrë direkte, por do t'i drejtohej ISHMT dhe DPT, që ndaj subjektit të merreshin masa administrative deri në kallëzim penal. Madje edhe vetë koncesionari gjatë ushtrimit të aktivitetit, ka subjekte të cilat nuk i ka verifikuar (të cilat janë për faj të tij, ashtu si edhe jo për faj të tij, konstatime të cilat i kemi trajtuar në akt-konstatimin nr.3).

Ndryshe është verifikimi pasardhës, i cili kryhet në premisat e DPM, pra DPM planifikon kryerjen e verifikimit tek këto subjekte dhe gjatë vitit zbaton këtë plan, por ju në analizën tuaj, për të përligjur edhe argumentin që pasqyroni në observacion, në asnjë rast nuk keni cituar se (për ilustrim shifrat dhe periudha) në 100 subjekte, të cilat në muajin Korrik të vitit 2023, duhet të kryejë verifikimi metrologjik dhe në muajin Korrik të vitit 2023, DPM nuk është paraqitur pranë këtyre subjekteve për të kryer verifikimin. Pra arsyetimi juaj është subjektiv dhe jo objektiv dhe i matshëm.

Grupi i auditimit në asnjë rast nuk është shprehur se është në kundërshtim me ligjin përdorimi i të dhënave të studimit të fizibilitetit të subjektit. Për më tepër që edhe në raportimet vjetore të DPM pranë MFE, në asnjë rast nuk janë evidentuar mangësi nga strukturat përgjegjëse, për ilustrim Sekretari i Përgjithshëm i MFE, t'i drejtohej DPM se në një vit ushtrimor, si rrjedhojë e moskryerjes së punës në nivelin e kërkuar, ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara.

Shprehemi për risqet që ka marrë përsipër subjekti, por asnjë prej risqeve nuk është i monetarizuar, minimalisht risqet financiare, të cilat të materializoheshin në kosto për buxhetin e shtetit.

Ju në studimin tuaj, në asnjë rast nuk keni bërë një analizë të mesatarizuar kosto/njësi, pra sa i kushton mesatarisht (numri i metrologëve që verifikon një pistoletë, paga ditore e tyre, për sa orë kryejnë verifikimin e një pistolette dhe paga për orë për verifikim, shpenzimi i karburantit, kosto e mirëmbajtjes së automjetit, kosto administrative të tjera) buxhetit të shtetit shërbimi i verifikimit për një instrument matës dhe sa të ardhura realizon nga verifikimi i një instrumenti, për të vlerësuar nëse të gjitha të ardhurat e DPM shpenzohen nga DPM për kryerjen e funksionit të saj.

Grupi i auditimit nuk shprehet aspak për kompaninë që ka përgatitur studimin e fizibilitetit, pasi nuk është objekt i punës audituese, por shprehet për mangësitë në analizë, të cilat duhet të ishin evidentuar nga ju.

Observacioni nuk merret në konsideratë.

5. Në lidhje me pikën 9 të faqes 18, ku grupi i auditimit shprehet se "Studimi i fizibilitetit përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion përmban të dhëna të rreme, të pa përditësuar, si dhe jo të referuara në burime zyrtare, me qëllim pasqyrimin e informacionit të saktë, të zbatueshëm dhe të përshtatshëm për kontekstin e analizës "; sqarojmë se të dhënat janë trajtuar në secilin rast dhe janë pasqyruar në studimin e fizibilitetit të përgatitur nga Komisioni i dhënies së koncesionit për aq sa është e mundur të bëhet ky verifikim.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport. Në përllogaritjen e të ardhurave, të cilat i'a keni njohur koncesionarit, nuk keni respektuar kuadrin rregullator (të cilin e kemi cituar specifikisht gjatë trajtimit në akt-konstatim), si dhe përveç kësaj, nga shqyrtimi i dokumentacionit, ku pasqyrohet metoda dhe burimi, për përllogaritjen e TVSH, e cila nuk është mbledhur nga DPM dhe që është njohur si e ardhur për koncesionarin, ju i jeni referuar një shkrimi në Gazetën "Panorama", i bërë në vitin 2013.

6. Në lidhje me paragrafin e fundit të faqes 19, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se: "Gjithashtu komisioni shprehet se tarifa e shërbimit të verifikimit nuk kalon në buxhetin e shtetit, por në buxhetin e DPM-së"; sqarojmë se, shërbimi që kalon nga një institucion shtetëror tek një subjekt privat, transferon tek ky i fundit së bashku me kostot edhe risqet, të cilat nuk do të jenë më barrë për buxhetin për sa kohë ky shërbim do të ofrohet nga një subjekt privat, i cili për më tepër do të derdhë edhe të ardhura në formën e tarifës koncesionare në buxhet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Theksojmë se për të evidentuar dhe vlerësuar evazionin fiskal në këtë sektor, mund t'i drejtoheshit DPT.

7. Në lidhje me përkufizimin e hartuar nga grupi i auditimit, në faqen 21, ku thuhet se: "Për më tepër komisioni shprehet për evazion fiskal, por në asnjë rast nuk e shoqëron me shifra të matshme evazionin, si dhe burimin e tyre ", sqarojmë se evazoni, si fenomen, nuk mund të matet dhe nxirret si konkluzion me vlera fikse. Përderisa ka shërbime verifikimi dhe inspektimi të instrumenteve matëse, nëpërmjet instrumenteve të shpërndarjes së karburanteve, do të thotë që nga ana e subjekteve private kanë rezultuar ndërhyrje në pajisje, por kjo nuk mund të jetë e matshme, pasi nuk janë të dhëna që ofrohen nga këto subjekte. Për më tepër, sjellim në vëmendje se, Komisioni i dhënies së koncesionit, në studimin e fizibilitetit ka evidentuar: Në kontrollin e fundit të Drejtorisë së Metrologjisë, rreth 12% e pajisjeve të furnizimit me karburant rezultuan jashtë afateve ligjore.

Gjithashtu të dhënat për këtë projekt janë mbledhur edhe nga burimet e konsulentit i cili ka i ka cituar mënyrën e si ka gjetur të dhënat dhe si i ka përpunuar ato. Kjo gjë është vërtetuar nga të ardhurat e arkëtuara nga ky shërbim nga shoqëria koncesionare të cilat janë rreth 20% më të larta se ato të arkëtuara nga DPM, pra rreth 8% më shumë se ato të konsideruara si evazion gjatë përgatitjes së studimit. Duke qenë se Komisioni e ka argumentuar evazionin fiskal, ky konstatim nuk qëndron dhe kërkoj më të hiqet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Theksojmë se për përllogaritjet e kryera i jemi referuar të dhënave sasiore (numri i karburanteve, numri i pistoletave për karburant, ecuria e tyre përgjatë viteve, verifikimet fillestare, periodike dhe ato jashtë rradhe) të pasqyruara në studimin e fizibilitetit, si dhe duke u bazuar në tarifën e miratuar. Lidhur me analizën e kryer për 6 vite, ashtu siç e kemi theksuar në akt-konstatim është për të ilustruar, se si ndikon në treguesit financiar (NPV dhe IRR) përllogaritja e gabuar e të ardhurave. Pra, grupi i auditimit nuk është shprehur se bazuar në analizën e kryer për një periudhë prej 6-vitesh, komisioni duhet të kishte marrë vendimin për refuzimin e dhënies me koncesion, por kemi pasqyruar të dhënat se si ndikon përllogaritja e gabuar e të ardhurave, duke bërë vetëm për 6

vite. Norma e skontimit është bërë bazuar në koston e kapitalit 15.3% (të vlerësuar nga vetë subjekti) e shpërndarë në 6 vite aktivitet.

8. *Ne lidhje me piken e fundit te konstatuar nga grupi auditimit ne faqen 21 ku shpreheni se. Përlllogaritja e te ardhurave vjetore nga shërbimi i verifikimit nuk është plotësisht reale ... si dhe llogaritjet e bëra ne lidhje me vitin 2020 dhe 2021 janë tërësisht te pabazuara nga ana juaj dhe janë tërësisht hipotetike. Me poshtë po ju parashtrajmë mënyrën e detajuar te llogaritjes së të ardhurave të cilat bazohen në të ardhurat nga kontrollet periodike, kontrollet jashtë radhe, rritja normale për shkak të rritjes ekonomike dhe ulja e numrit të pikave të karburantit për shkak të kontrolleve. Burimi i të ardhurave të kompanisë janë tarifatat nga kontrollet e distributorëve të karburantit dhe gazit (GLN), të cilat aktualisht kryhen 2 herë në vit dhe verifikimet jashtë radhe pas riparimeve të distributorëve. Duke qenë se aktiviteti i kompanisë është supozuar të fillojë në Tetor të vitit 2018, të ardhurat e gjeneruara për gjithë vitin 2018 përfshijnë kryerjen e Shërbimeve të kontrollit vetëm një herë për gjysmën e subjekteve, si dhe verifikim jashtë radhe të 25% të distributorëve të riparuar. Si rrjedhojë, rritja e të ardhurave në vitin 2019, krahasuar me 2018, është mjaft e ndjeshme pasi përfshin aktivitetin e një viti të plotë.*

*Gjatë periudhës 2019-2024 të ardhurat kanë pësuar një rritje mesatare vjetore të lehtë, rreth 0.3% në vit, kjo pasi edhe pse tarifa ka filluar të indeksohet me normën e pritshme të inflacionit nga viti 2019 e në vazhdim, numri i distributorëve të karburantit ka një tendencë në rënie. Nga viti 2024 e në vijim kompania pritet të ketë një aktivitet konstant, pasi tarifatat e inspektimeve pritet të rriten me nivelin e inflacionit, duke ndikuar drejtpërdrejtë mbi nivelin e të ardhurave. Gjatë periudhës 2024-2038 pritet që Kompania të kryejë 13,280 kontrolle (+684 verifikime jashtë radhe) në vit. Përsa i përket ndikimit në llogaritjen e NPV dhe IRR shprehemi se përlllogaritja e bërë në studimin e fizibilitetit shprehemi se është tërësisht e pabazuar në legjislacionin për koncesione pasi kjo analizë referuar nenit 7 pika 2 të VKM nr 575/ 20 13, kryhet për te gjithë kohëzgjatjen e koncesionit dhe jo për një periudhe 6 vjeçare sic keni vepruar ju. Megjithatë për të analizuar më saktë situatën shprehemi se pavarësisht rezultatit të elementeve të analizës financiare të sipërpërmendur (NPV dhe IRR) vendim mbi realizueshmërinë e projektit nuk merret duke vendosur DPM dhe partnerin privat në të njëjtën situatë përsa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve që do të kryhen. Gjithashtu nuk keni llogaritur asnjë nga risqet që do të marrë përsipër partneri privat gjatë zbatimit të kësaj kontrate sic është parashikuar ne nenin 7 pika 11 e VKM nr 575/20 13. Pra asnjëherë nuk mund të jetë e njëjtë mundësia dhe aftësia për te siguruar fondet për investimin kapital nga DPM dhe nga koncesionari pasi ky i fundit se pari do te investojë rreth 40% me kapitalet e veta dhe se dyti mund të sigurojë fonde nga huatë bankare shumë më shpejt dhe më lehtë se institucionet shtetërore dhe së treti nuk mund të llogariten në mënyrë të njëjtë kostot e institucionit publik me kostot e privatit. Gjithashtu është e paqartë se si është llogaritur nga ana juaj norma e skontimit prej 4.6% për 6 vite. Pra për këtë konstatim kërkojmë të referoheni tek parashikimet e bëra në studimin e fizibilitetit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit duke marrë në konsideratë të gjithë elementet që ndikojnë në llogaritjen e rezultatit financiar pasi këto projekte nuk mund të analizohen sikur jemi përpara një situatë "riskfree". Pra analiza e kryer nga ana juaj nuk i ka parashikuar të gjithë elementet e të ardhurave dhe për rrjedhojë keni rezultuar në diference të ardhurash me ato të studimit të fizibilitetit i cili mbi të gjitha nuk është detyrues për asnjë por pasqyron situatën ne një periudhe te caktuar kohore duke supozuar një skenar i cili është më i zakonshmi. Më pas shoqërohet me elementin e garës i cili i jep të drejtën operatoreve private të sjellin ofertat e tyre sipas situatës së tyre specifike.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimit të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, përcaktohet qartë se në procesverbale pasqyrohet puna e komisionit, ndërkohë ju në procesverbale, nuk shpreheni konkretisht për punën e kryer.

9. Në lidhje me procesverbalet e hartuara nga Komisioni i dhënies së koncesionit, ku në paragrafin e fundit të faqes 21, grupi i auditimit ka përcaktuar se: ...nuk pasqyrohet plotësisht puna e kryer nga komisioni... ", sjellim në vëmendje pikën 6 të nenit 18 të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetit publik privat", të ndryshuar, ku parashikohet "6. Komisioni i dhënies së koncesionit /partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. ". Të gjitha procesverbalet reflektojnë punën e komisionit dhe janë nënshkruar nga anëtarët pjesëmarrës në çdo mbledhje. Komisioni ka vepruar në zbatim të kësaj dispozite dhe procesverbalet janë hartuar duke u bazuar në procedurën e zhvilluar nga anëtarët. Procesverbali përbën një akt pjesë të procedurave administrative, përmbajtja e të cilit nuk ka cenuar zhvillimin e procedurës së dhënies së koncesionit. Meqenëse, dispozita e sipërcituar nuk parashikon formatin e procesverbaleve, nuk mund të gjykohet në mënyrë të njëanshme përmbajtja e procesverbalit. Gjithashtu, sjellim në vëmendje pikën 2 të nenit 12 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, të ndryshuar, ku është parashikuar se "Gjatë periudhës së përgatitjes së raportit përmbledhës, autoriteti Kontraktues mund të kërkojë informacione shtesë nga propozuesi "Komisioni i dhënies së koncesionit ka evidentuar punën e tij gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit dhe në procesverbalin nr. 5, datë 08.08.2018 ka cilësuar trajtimin përfundimtar të studimit të fizibilitetit tashmë të hartuar dhe përgatitjen e raportit përmbledhës informues.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Më hollësisht pasqyrohet edhe në nenin 8 të VKM nr. Nr. 575, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar.

10. Në lidhje me pikën 10, faqe 24, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se: Në arsyetimin e vendimit të dhënies me koncesion. bazuar në krahasuesin e sektorit publik, komisioni përkatës nëpërmjet raportit përmbledhës duhet të kishte propozuar refuzimin e propozimit dhe heqjen dorë nga zbatimi i tij", sqarojmë se propozimi i pa kërkuar është trajtuar dhe miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet të cilit, shoqërisë propozuese i është dhënë bonusi prej 10 për qind të pikëve (referuar nenit 15 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, të ndryshuar me VKM nr. 313, datë 27.4.2016). VKM në mënyrë të qartë përcakton se shërbimi do të jepet me koncesion, projekti do të zgjasë 20 vjet dhe MFE do të jetë autoritet kontraktues. Për sa i përket Krahasuesit të sektorit publik, referuar nenit 8 pika 1 të VKM nr. 575/2013, të ndryshuar, shprehemi se kjo analizë nuk ka për qëllim miratimin apo refuzimin e projektit, por përcaktimin nëse forma koncesion/ppp duket si modeli më i përshtatshëm për zbatimin e projektit. Prandaj kjo analizë kryhet në fund dhe pas gjithë analizave të tjera të përcaktuara në këtë VKM të cilat vërtetojnë që projekti në vetvete është i qëndrueshëm dhe ka leverdishmëri.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të mësipërm merret në konsideratë në lidhje me përgjegjësinë e anëtarëve të komisionit.

11. Në lidhje me pikën 12, në faqen 26, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se "Raporti përmbledhës i përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion është bërë pas hartimit të studimit të fizibiliteti, ndërkohë që ky dokument hartohet përpara përgatitjes së studimit të fizibilitetit. ... ", sqarojmë se raporti për të cilin referohet grupi i auditimit është raporti përmbledhës i studimit të fizibilitetit, i parashikuar në pikën 4 të nenit 3 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, e cila është riformuluar me VKM nr. 313, datë 27.4.2016, në këtë mënyrë: 4. Komisioni i koncesionit/PPP përgatit një raport përmbledhës i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë e të përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit. Ai duhet të përmbajë të paktën: a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit. kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut; b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave; ..; propozimin për dhënien e pikëve bonus në bazë të rezultateve teknike dhe financiare për propozimet e pa kërkuara. 5. Autoriteti kontraktues, bazuar në raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, me vendim përcakton: a)



shtyrjen ose refuzimin e plotë të zbatimit të projektit. Bazuar për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit dhe alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit për mungesën e fizibilitetit përshtatshëmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm; b) vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit; c) kthimin për plotësim të propozimit të pa kërkuar, për shkak se nuk është paraqitur sipas formave të kërkuara në nenin 10 të këtyre rregullave. Në këtë rast, propozuesi ka afat 30 ditë nga data e kthimit të propozimit për ta plotësuar atë. ". Sqarojmë se raporti përmbledhës informues, siç specifikohet në procesverbalin nr. 5, datë 08.08.2018 të Komisionit të dhënies së koncesionit, është një raport që ka treguar mbi zhvillimin e procedurës nga viti 2016, kur propozimi i pa kërkuar u paraqit pranë MZHETTS, miratimin e VKM për dhënien me koncesion të këtij shërbimi dhe dhënien e bonusit të shoqërisë propozuese, situatën aktuale dhe rezultatet e projektit (Raporti i sipërcituar gjendet bashkëlidhur observacionit).

Bashkëlidhur raportit që ju referoni, i cili i është drejtuar titullarit të AK, është përcjellë studimi i fizibilitetit të projektit, duke theksuar se duhet të vlerësohet nga strukturat përkatëse në MFE, referuar ligjit nr. 125/2013, të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 9, pikës 1 të nenit 17, nenit 18 e 19 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, të ndryshuar, ku parashikohet që projektet të vlerësohen dhe miratohen nga ministria përgjegjëse për financat. Pra faza në të cilën gjendej puna e Komisionit të dhënies së koncesionit, nuk ishte përgatitja e raportit përmbledhës "paraprak" për të vlerësuar një propozim të pa kërkuar, pasi kjo fazë ishte ezauruar tek MZHETTS dhe pasi është miratuar nga titullari i institucionit, është dërguar në Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e VKM, për vijueshmërinë e projektit. Duke qenë se Komisioni i dhënies së koncesionit, të ngritur nga MFE, nuk ka qenë në fazën e parashikuar në nenin 3 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, të ndryshuar me VKM nr. 313, datë 27.4.2016, mbi "Identifikimin e projekteve të mundshme", ky komision në zbatim të nenit 9 të VKM nr. 575/2013, të ndryshuar, ka përgatitur dokumentin i cili përmbledh rezultatet e studimit të fizibilitetit dhe më tej paraqitet për miratim në MFE.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Më hollësisht se cilët janë elementët që duhet të përmbajë një dokument i brendshëm, pasqyrohen në nenin 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

12. Në lidhje me pikën 12.1, në faqen 26, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se "Në raportin përmbledhës drejtuar titullarit të AK. mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK", sjellim në vëmendjen tuaj se, memo me nr. 13462, datë 10.08.2018, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, me lëndë "Raport përmbledhës në lidhje me projektin "Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (GLN)", (e cila gjendet bashkëlidhur observacionit) mban shënimin e Titullarit, i cili i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm që praktika të vijojë sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, për shqyrtim nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Koncesioneve. Për sa i përket vulës së institucionit, ajo nuk është përdorur në asnjë nga korrespondencat brenda MFE dhe raporti është përcjellë me memo, pra nuk ka qenë një shkrues që të mbajë vulën e institucionit. Vula e institucionit përdoret për dokumente të firmosura nga Titullari i AK ose i deleguari i tij. Në këtë rast, dokumenti përbën një raport, që ka funksion vetëm brenda institucionit dhe nuk shërben si formë komunikimi midis institucioneve të tjera. Për sa më sipër, ky konstatim nuk qëndron dhe kërkojmë të hiqet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Grupi i auditimit për konstatimin përkatës, i është referuar përcaktimeve ligjore të bëra për çdo hap të procedurës në Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm të APP, Nr. 13, datë 28/05/2015 "Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i

ofertave nga operatorët ekonomikë”, ku përcaktohet se si krijohet dosja e procedurës konkurruese, dorëzimi i ofertave, vlerësimi i ofertave, mbyllja e fazës së vlerësimit të ofertave, hapja e ofertave dhe arkivimi i procedurës, si dhe verifikimit në sistemin e prokurimeve.

13. Në lidhje me pikën 14, në faqen 27, ku grupi i auditimit ka përcaktuar se "Nuk administrohet miratimi i projektit për dhënien me koncesion nga titullari i AK. Konkretisht në memo nr. s'ka, datë 03.09.2018... ku kërkohet miratimi i projektit për vazhdimin e procedurave, pra shpalljen e njoftimit të kontratës në APP, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK", sqarojmë se, memo e sipërcituar i përket hapit ligjor të miratimit të projektit nga MFE, referuar ligjit nr. 125/2013 të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 9, pikës 1 të nenit 17, nenit 18 e 19 të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, të ndryshuar, ku parashikohet që projektet të vlerësohen dhe miratohen nga ministria përgjegjëse për financat. Në rastin e këtij projekti, MFE është njëkohësisht autoritet kontraktues dhe ministria përgjegjëse për financat, që shqyrton projektin nëpërmjet strukturave të saj. Miratimi i titullarit sipas shënimit mbi dokument mban nënshkrimin e tij. Për sa i përket vulës, rikujtojmë se korrespondencat janë brenda të njëjtit institucionin dhe jo në formën e shkresave që mund të dërgohen një institucioni tjetër, për këtë arsye nuk mban vulë. Për sa më sipër, ky konstatim nuk qëndron dhe kërkohet të hiqet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në akt-konstatim dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Grupi i auditimit për konstatimet e bëra i është referuar fillimisht ligjit të posaçëm, pra atij për koncesionet dhe për detyrime të cilat nuk përcaktohen në këtë ligj, i është referuar ligjit të prokurimeve (ashtu siç është përcaktuar në ligjin e koncesioneve, pra kur në këtë ligj nuk përcaktohet mënyra e veprimit, referimi duhet bërë në ligjin e prokurimit).

14 . Në lidhje me hartimin e kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr. 6, datë 24.08.2018 nga Komisioni i dhënies së koncesionit, në faqet 31-33, shprehemi se hartimi i Dokumenteve të Tenderit është bërë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 125/2013 të ndryshuar. Në pikën 7 të nenit 24 të këtij ligjit, parashikohet se: "Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat.". Pra nuk mund të konsiderohet moszbatim i ligjit të prokurimit publik, për aq kohë sa ka dispozita të zbatueshme në ligjin për koncesionet/partneritetin publik privat. Kjo është referenca ligjore ku mund të bazohemi, pasi ky projekt kategorizohet si koncesion i shërbimeve publike dhe jo partneritet publik privat sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 125/2013, të ndryshuar. Në nenin 26, pika 2, të VKM nr. 575/2013, të ndryshuar, është përcaktuar forma, mënyra dhe përmbajtja e Njoftimit të Kontratës, i cili ka në përbërje edhe kriteret e vlerësimit dhe të kualifikimit dhe për rrjedhojë nuk ka qenë e detyrueshme përgatitja e argumenteve për vendosjen e kriterëve teknike sipas legjisllacionit të prokurimit publik.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

15. Në lidhje me konstatimet e bëra nga grupi i auditimit, për kriteret e vendosura nga Komisioni i dhënies së koncesionit, sqarojmë se, në mungesë të përvojës me projekte të ngjashme, Komisioni është përparësuar të vendosë kriteret e cilat janë gjykuar mbështetur edhe në parimet e ligjit të prokurimeve publike herë pas here. Kujtojmë se, kriteret janë publikuar në sistemin elektronik dhe kanë qenë publike për një periudhë 30 ditore, në të cilin subjektet e interesuara mund të ankoreshin dhe të kërkonin ndryshimin e dokumenteve të tenderit, referuar pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr.125/2013, ku parashikohet se: "Palët e interesuara për procedurën konkurruese kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin ose korrigjimin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese. Kjo kërkesë duhet depozituar brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës. Në rast se dokumentet e procedurës

konkurruese ndryshohen ose korrigojohen, afati i fundit për dorëzimin e ofertave mund të shtyhet, në përputhje me rrethanat, por jo më shumë se 10 ditë."

Shoqëria e interesuar "P. T." sh.a ka paraqitur ankim përpara KPP dhe pas shqyrtimit të ankimit, institucioni më i lartë i shqyrtimit të ankimeve për procedurat konkurruese, pra KPP me vendimin nr. 77/2019, datë 07.02.2019 ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik "P. T." sh.a dhe lejimin e AK për të vijuar me hapat e mëtejshme të procedurës. Për më tepër, mund të referoheni tek korrespondenca e dërguar nga MFE si AK për KPP mbi argumentet e kritereve të vendosura, në kohën kur është bërë ankesa. Për sa më sipër, ky konstatim nuk qëndron dhe kërkojmë të hiqet.

Në lidhje me paragrafin e parë të faqes 35, ku është evidentuar se, pezullimi i procedurës ka zgjatur 3 muaj e 23 ditë, sjellim në vëmendjen tuaj ankimin e paraqitur nga subjekti i interesuar "P. T." sh.a përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vendimin nr. 1790 (80-20 1 9-1 832), datë 27.05.20 1 9, të kësaj gjykate, në faqen e dytë është shkruar: "Me vendim të datës 11.04.2019 gjykata, pasi mori në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë, vendosi refuzimin e kësaj kërkesë, si të pabazuar në prova dhe në ligj". Në kushtet kur, KPP vendosi mospranimin e ankesës dhe lejimin e vijimit të procedurave dhe gjykata nuk pranoi kërkesën për sigurimin e padisë me objekt "Pezullimi i zbatimit të vendimit të KPP nr. 77/2019, duke mos e lejuar AK të vijojë me hapat e mëtejshme", nuk përbën asnjë shkelje në zhvillimin e procedurës, koha që është vlerësuar e nevojshme për të vijuar me hapat e mëtejshëm.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimit të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

16. Në lidhje me pikën "vlerësimi i ofertave", në faqen 35-36, ku grupi i auditimit shprehet se: "Në procesverbalin e mbajtur për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe në raportin përmbledhës nuk pasqyrohet asnjë informacion mbi dorëzimin/jo të dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kritereve teknike, konkretisht: ...", si dhe "Për sa më sipër nuk vërtetohet dorëzimi i dokumentacionit brenda afatit 18.10.2019 (data e fundit për dorëzimin e ofertave) nga OE N. C. shpk. Gjithashtu lidhur me pikën që raporti i vlerësimit nuk përmban informacionin sipas përcaktimit të bërë në nenin 68 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, sqarojmë se, afati për dorëzimin e dokumenteve lidhur me këtë procedurë është data 18.10.2018 dhe jo 18.10.2019, siç citohet në akt konstatim. Procedura "Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm", është një procedurë e zhvilluar tërësisht me mjete elektronike, ku i gjithë procesi që nga krijimi i dosjes, dorëzimi i ofertave, hapja e ofertave është realizuar nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Vetëm faza e vlerësimit të ofertuesve dhe njoftimet janë kryer në formë shkresore pasi udhëzimi i APP nr. 13 shprehet se për koncesionet/ppp veprimet në sistem bëhen deri në fazën e dorëzimit të ofertave dhe më pas vazhdohet në formë shkresore. Gjithashtu, edhe dokumentacioni i shqyrtuar për vlerësimin e ofertës është dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti brenda afatit të përcaktuar në format elektronik në procedurën e prokurimit me mjete elektronike. Duke qenë se lidhur me këtë procedurë ka pasur një periudhë pezullimi dhe ndryshim të anëtarëve të komisionit, hapja e procedurës në sistemin elektronik është bërë më datë 03.06.2019, që dokumentohet edhe me anë të Procesverbalit të hapjes së ofertave të mbajtur nga Komisioni i dhënies së koncesionit. Po këtë datë mban edhe i gjithë dokumentacioni elektronik i shqyrtuar nga Komisioni për vlerësimin e ofertave, dokumentacioni i shkarkuar nga faqja zyrtare e Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili gjendet në formatin screenshot në vijim.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimit të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

17. Në lidhje me konstatimin e bërë në faqen 36, ku grupi i auditimit shprehet se: "Raporti i vlerësimit nuk përmban informacionin sipas përcaktimit të bërë në nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.."; sjellim në vëmendje nenin 68 të VKM nr. 914/2014, ku parashikohet se: "...Raporti përmbledhës duhet të përmbajë të paktën referencën e procedurës, përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesin e renditur të parin, informacion nëse ka patur ankesa dhe vendim marrja në lidhje me to."

Raporti i vlerësimit nr.12609 datë 01.07.2019, edhe pse nuk është detyrim të përgatitet sipas përcaktimeve të legjislacionit për Prokurimin Publik, është përgatitur nga Komisioni i dhënies së koncesionit dhe përmban informacion në përputhje me nenin 68 të VKM nr. 914/2014, pasi ai përmban përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve që është dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, përmban informacion mbi ofertuesit pjesëmarrës që në këtë rast është një i vetëm dhe vlerën e ofertës së tij, përmban informacion mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit, vlerësimin me pikë të këtyre kriterëve dhe klasifikimin e ofertuesit si të parin, si dhe informacion lidhur ankesat që në këtë rast nuk ka patur.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

18. Në lidhje me konstatimin po në faqen 36, ku grupi i auditimit shprehet se : "në dosjen e procedurës nuk administrohet deklarata e ekzistencës ose jo të konfliktit të interesit nga anëtari i komisionit të dhënies së koncesionit znj. A. P. "sqarojmë se, përpara hapjes së ofertave, draft deklarata për konfliktin e interesit i është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit, të cilën e kanë nënshkruar dhe dorëzuar në dosjen e procedurës. Pavarësisht se konstatohet se deklarata e konfliktit të interesit nga znj. A. P. mungon, sjellim në vëmendje se kjo anëtare ka qenë pjesë e grupit të punës, pra Komisionit të dhënies së koncesionit, që në urdhrin nr. 195, datë 12.07.2018, në fazën e hartimit të studimit të fizibilitetit nga Komisioni. Duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtën procedurë Koncesioni/PPP, pra është i njëjti subjekt, Znj. A. P. nuk është në kushtet e konfliktit të interesit.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

19. Në lidhje me konstatimin po në faqen 36, ku grupi i auditimit shprehet se "Raporti i vlerësimit i është drejtuar për miratim z. A. K., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MFE, në rolin e titullarit kontraktor, ndërkohë në këtë periudhë, titullar i AK ka qenë ish Ministri i MFE, znj. A. D....në këto kushte miratimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm z. A. K., është në tejkalim të kompetencës ligjore dhe si i tillë mbështetur në nenin 109 në Ligjin nr.447/2015 "Kodi i procedurave administrative në RSH", konsiderohet i paligjshëm. Sa më sipër, komisioni i dhënies me koncesion nuk duhet të kishte vazhduar procedurën, pra konceptimin e formularit të njoftimit të fituesit për miratim, me qëllim botimin e tij në faqen zyrtare të APP, deri në miratimin e raportit/përmbledhës nga titullari i AK-së.", sqarojmë se, me mbylljen e procedurës së vlerësimit të ofertave, Komisioni i dhënies së koncesionit ka vijuar punën me përgatitjen e raportit përmbledhës dhe hartimin e formularit të njoftimit të fituesit, të cilat si çdo informacion tjetër në lidhje me procedurën komisioni ja ka përcjellë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë me anë të memos së datës 25.06.2019. Ky dokumentacion pasi është shqyrtuar nga ana e Ministrisë, konsiderohet i miratuar, duke qenë se në datën 01.07.2019 Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka nënshkruar Formularin e Njoftimit të Fituesit, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Po në këtë datë është bërë edhe miratimi i Raportit përmbledhës, i cili përmban informacion që ka për qëllim dokumentimin e hapave të ndjekura nga Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe klasifikimin e operatorëve. Për sa kohë ministri

përgjegjës për Financat në cilësinë e titullarit të AK, ka dhënë miratimin "nënshkruar njoftimin e fituesit" prezumon se ka dhënë automatikisht edhe miratimin e raportit përmbledhës për të cilin ju referoheni. Nënshkrimi i këtij raporti nga Z. K. është bere ne cilësinë e nëpunësit me të lartë civil te institucionit te MFE (referuar dhe Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit për Nëpunësit Civil). Dokumenti, i cili konfirmon shpalljen e fituesit dhe dërgohet për publikim, është Formulari i Njoftimit të Fituesit i cili në këtë rast është nënshkruar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

20. Në lidhje me konstatimin e bërë në paragrafin e fundit, ku grupi i auditimit shprehet se "OE shpallur fitues nuk plotëson shkronjën "a" të pikës 2. 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", në DST. Konkretisht në shkronjën "a" të pikës 2.2 kërkohet: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të Pasqyrave Financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet - Nga verifikimi i pasqyrave financiare, në vitin 2016 subjekti N. C. shpk ka dalë me humbje. Nëse do të referohemi edhe shpjegimit të AK drejtuar KPP me shkresën nr.1787 1/2 prot., datë 09.10.2018, rezulton se qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qenë shprehimisht: Sipas këtij parashikimi (pra aktivitet pozitiv të qëndrueshëm) ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do të kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave financiare.", sqarojmë se, për vlerësimin e këtij kriteri Komisioni i dhënies së koncesionit ka marrë në konsideratë edhe pasqyrat financiare të dorëzuara nga shoqëria "N. C." sh.p.k, në ofertën e tyre konkurruese për periudhën nga 01.01.2018 deri në 30.09.2018. Nga analizimi i bilanceve të shoqërisë evidentohet se viti 2016 është mbyllur me një rezultat financiar me humbje, por në këtë rast duhet të kemi parasysh se humbja nuk vjen si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave apo të mungesës së aktivitetit por si pasojë e "Kërkesave të Arkëtueshme" të cilat konsiderohen si të ardhura të bazuara në marrëveshje midis palëve që do të paguhen në një periudhë të mëvonshme dhe jo sa herë ato krijohen. Kjo shumë është rreth 9 mln lekë dhe është e përafërt me humbjen e parashikuar në bilanc e cila është rreth 11 mln lekë. Në këtë këndvështrim mendojmë se vlera negative e vitit të parë në fitimin e kompanisë është e përkohshme dhe nuk pasqyron realisht qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Gjithashtu për të vijuar me arsyetimin, Komisioni ka gjykuar se fitimi i shoqërisë deri në 30.09.2018 është pozitiv në vlerën 17,792,963 lekë, gjë që konfirmon ecurinë pozitive dhe qëndrueshmërinë e aktivitetit të këtij subjekti. Pra kuptimi i termave ecuri pozitive e qëndrueshme dhe vlerë pozitive në pasqyrat financiare nënkupton rritjen e të ardhurave dhe për rrjedhojë edhe fitimit të kompanisë për çdo periudhë pasardhëse. Ky analizim i situatës financiare është shkaku për të mos skualifikuar kompaninë e cila ka marrë pjesë në garë. Për sa më sipër, ky konstatim nuk qëndron dhe kërkohet të hiqet.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 19754/8, datë 29.01.2024, "Komente mbi gjetjet e evidentuara në Akt-Konstatimin nr. 1" nga znj. M. Dh., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Observacion lidhur me pikën 13 të akt konstatimit, në të cilën ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit për zbatimin e përcaktimeve të përgjegjësive të Ministrisë së Financave të përcaktuara në nenin 20 i VKM nr.575/2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/PPP", i ndryshuar shprehemi se: Drejtorja e

Përgjithshme e Buxhetit në rastin e shqyrtimit të projekteve koncesionare/PPP shprehet për përballueshmërinë e kostove që shoqërojnë këto projekte në buxhetin e shtetit. Në këtë kontekst, përgjegjësitë e tjera të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me shqyrtimin e projekteve koncesionare/PPP nuk mund t'i alokohen Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Projekti në fjalë nuk kërkon mbështetje buxhetore, pasi lidhet me një shërbim kostoja e të cilit përballohet nga tarifat e përdoruesve. Lidhur me shpjegimet e bëra në Aktverifikim mbi mundësinë e të ardhurave në buxhet dhe detyrimet kontingjente ju sqarojmë se: Në studimin e fizibilitetit të projektit koncesionar është paraqitur, si pjesë e analizës dhe krahasuesi i sektorit publik (KSP), si një element, i cili analizon përfitueshmërinë e projektit në aspektin krahasues të ofrimit të shërbimit nga sektori publik dhe ai me partneritet publik privat. Sipas kësaj analize ofrimi i këtij shërbimi rezulton me përfitueshmëri më të lartë po të ofrohej nga partneri privat, sesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Mbi këtë bazë, është gjykuar që ky projekt, jo vetëm që nuk ka kosto të drejtpërdrejta buxhetore, por në të kundërt, ka efekte pozitive në buxhet dhe më gjerë, të shpjeguara gjerësisht dhe në studimin e fizibilitetit në fjalë. Gjithashtu, mundësia e të ardhurave nuk mund të gjykohej e veçuar, pasi këto të ardhura lidhen me një shërbim, i cili ka kosto që materializohen me kostot buxhetore që Drejtoria e Metrologjisë i nevojiteshin për të kryer këtë shërbim. Pra në rast të kontraktimit me PPP të këtij shërbimi, kostot buxhetore dhe burimet njerëzore të nevojshme për kryerjen e shërbimit nga ana e Drejtorisë së Metrologjisë zerohen ose drejtohen në ofrimin e shërbimeve të tjera që ofrohen nga kjo Drejtoria. Rrjedhimisht, nuk mund të flitet për ndikime në të ardhura dhe për më shumë në deficitin buxhetor. Lidhur me përgjegjësitë e Ministrisë së Financave, për sa i përket vlerësimit të detyrimeve kontingjente që burojnë në rast materializimi të risqeve fiskale kryesisht ato që në kontratë parashikohet të përballohen nga Autoriteti Kontraktor, ritheksojmë faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit ka si detyrë vlerësimin mbi përfshirjen në planifikimin buxhetor afatmesëm të implikimeve financiare për ato kontrata që kërkojnë mbështetje buxhetore dhe jo trajtimin e risqeve fiskale. Për më tepër, që në vlerësimin tonë, risku i cituar i inflacionit nuk mund të lidhet me buxhetin e shtetit, pasi materializimi i këtij risku mund të ndikojë në nivelin e tarifës së vendosur për këtë shërbim.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Për observacionin e mësipërm i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport dhe nuk kemi asnjë argument më tepër. Grupi i auditimit për konstatimet e bëra i është referuar kuadrit rregullator të fushës, dokumentacionit financiar (akt-rakordimet e DPM me Degën e Thesarit, mendimit të vetë ish Ministrit të MFE, z. A. A., si dhe kuadrit rregullator, pra ligjit të koncesioneve, se çfarë duhet të përfshijë mendimi, si dhe ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor). Theksojmë se për buxhetin e shtetit do të shtohet kostoja për mbajtjen në punë dhe pagesën e metrologëve të DPM, të cilët deri në dhënien me koncesion të shërbimit, justifikonin punën e tyre nëpërmjet kryerjes së këtij shërbimi, ndërkohë që me dhënien me koncesion të tij, puna e metrologëve pothuajse përgjysmohet, pra kryhen më pak shërbime, ndërkohë që paga e tyre ngelet e njëjtë/vjenë në rritje. Observacioni nuk merret në konsideratë.

**II.2.2. Auditim mbi masat e marra nga MZHETTS dhe MFE për marrjen në konsideratë të mendimeve të dhëna nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe/ose zbatimin e rekomandimeve/vendimeve të lëna nga palë të treta, të cilat kanë kryer hetim, vlerësim ligjor, auditim etj., mbi procedurën e dhënies me koncesion, përmbajtjen e kontratës koncesionare etj.**

#### **Nga auditimi konstatohet që:**

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, pika 2, u auditua zbatimi rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e kryer në MFE, të cilat lidhen me përmbajtjen e kontratës koncesionare, si dhe rekomandime që kanë dhënë palë të treta për përmbajtjen e kontratës koncesionare.

Theksojmë se për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer pranë MFE, miratuar me Vendimin nr.234, datë 30.12.2021 të Kryetarit të KLSH-së, është bërë auditimi i zbatimit të rekomandimeve. Në auditimin e përputhshmërisë në zbatim të programit të auditimit nr.257/1 prot., datë 03.05.2023, i ndryshuar, është audituar zbatueshmëria e rekomandimeve, të cilat në auditimin e mëparshëm kanë rezultuar të pazbatuara, proces zbatimi dhe pjesërisht dhe që janë ri kërkuar për tu zbatuar.

Për auditimin e kësaj pikës 2, u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, si më poshtë vijon:

1.Raporti i auditimit të kryer nga KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH-ja, përcjellë në MFE me shkresë nr.1463/1 prot., datë 18.07.2022.

2.Plan-veprimi nga MFE për zbatimin e rekomandimeve.

3.Vendimet nr. 646, Datë 09.08.2019 dhe nr.884, datë 18.05.2022 të Autoritetit të Konkurrencës, për përmbajtjen e kontratës koncesionare, me qëllim parandalimin e kufizimit të konkurrencës, si dhe abuzimin me pozitën dominuese që mund të krijojë në treg shoqëria koncesionare, në zbatim të kontratës së koncesionit.

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me shkresën nr. 754/3, datë 05.07.2021, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 676 prot., datë 06.07.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër :				
		Rekomandime gjithsej	Nga rekomandimet janë:			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	4	1	-	1	2
2	Shpërblim demi	-				
3	Masa efekt adm. e fondeve publike	-				
4	Masa disiplinore	-				
	<b>Totali</b>	<b>4</b>	<b>1</b>		<b>1</b>	<b>2</b>

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**5.1 Rekomandimi:** MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë", të ngrejë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre në kontratën koncesionare nr.15326 prot., datë 21.08.2019.

*Brenda vitit 2022*

**Për MFE Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se nuk e pranon rekomandimin, pasi nuk ka mbivendosje të detyrave të ISHMT-s me kontratën koncesionare.

**Zbatimi: Rekomandimi 5.1 nuk është zbatuar.**

**6.1 Rekomandimi:** Me qëllim zbatimin e kontratës koncesionare, lidhur me monitorimin e saj, MFE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një manual të posaçëm për procedurat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit metrologjik, ku pjesë e tij të jenë edhe

procedura dhe metodologjia e monitorimit në terren, të shërbimit të verifikimit metrologjik, sipas një analizë risku.

#### ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se nuk e pranon rekomandimin, pasi kontrata e koncesionit i ka të parashikuara qartë mekanizmat për monitorimin e kontratës si NJZP dhe Task Force. Pjesë e kësaj Task Force mund të jenë ISHMT, DPM e DPT, si struktura në varësi të MFE të cilat janë të specializuara për kryerjen e monitorimit në terren të aktivitetit të shoqërisë koncesionare.

**Zbatimi: Rekomandimi 6.1 nuk është zbatuar.**

**6.2 Rekomandimi:** Gjithashtu, MFE të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e njësisë së monitorimit pranë MFE, të përfshihen specialistë metrologë të DPM-së/ISHMT-së, me qëllim rritjen e garancisë se po jepet shërbimi me cilësinë dhe kriteret e kërkuara, prej subjektit juridik privat.

#### ***Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022***

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se pranon rekomandimin dhe shpreh gatishmërinë për marrjen e masave për zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve monitoruese të kësaj kontrate duke përfshirë edhe përfaqësues të tjerë teknikë të fushës së metrologjisë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se me Urdhrin nr.117, datë 13.04.2022 në NJZP janë emëruar anëtar, të cilët janë specialist të fushës.

**Zbatimi: Rekomandimi 6.2 është zbatuar.**

**6.3 Rekomandimi:** Të rishikohen: neni 13.2.2 i kontratës koncesionare dhe të korrigjohet si vijon: “AK nëpërmjet NJZP ka detyrimin që në periudha kohore prej 24 muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit të monitorojë në vend objektin e koncesionit (...)”; - neni 13.3 të korrigjohet si vijon: “AK ka detyrimin të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme nëpërmjet shqyrtimit të raporteve që dorëzon Koncesionari (...)”

#### ***Brenda 6 mujorit të dytë të vitit***

**2022**

**Qëndrimi i audituesit të KLSH:** MFE/Drejtoria e Koncesioneve dhe PPV-ve sipas shkresës nr.13750/9, datë 11.03.2022, konfirmon se e ka pranuar pjesërisht rekomandimin, pasi rishikimi i neneve specifike të kontratës do të bëhet në bashkëpunim dhe do të vijë si rezultat i negociatave të të dyja palëve që kanë nënshkruar kontratën. Për sa më sipër është ngritur grupi i Punës sipas Urdhrit të Ministrit nr. 207 datë 16.11.2021, për negocimin e kësaj kontrate. Ky grup pune kryesohet në nivel Zëvendës ministri dhe ka në përbërjen e tij: Krye Inspektorin e ISHMT-së, DP e DPM si dhe institucionet përgjegjëse për fushën e metrologjisë i cili pas shqyrtimit, negocimit dhe vendim marrjes me përfaqësuesit e shoqërisë koncesionare lidhur me këtë rekomandim do të dalë me konkluzionet përkatëse. Nuk u paraqitën nga MFE konkluzione konkrete nga grupi i punës deri në korrik 2022.

**Zbatimi: Rekomandimi 6.3 është në proces zbatimi.**

## **II. Mbi rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës.**

II.1.Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e mendimit për përmbajtjen e draft-kontratës koncesionare. Autoriteti i konkurrencës ka marrë në shqyrtim draft-kontratën dhe ka marrë vendimin nr.646, datë 09.08.2019, si më poshtë vijon:

**Objekti:** Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”.



**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), (f), neni 26, dhe neni 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

**Konstatime:**

- Konstatohet nga vlerësimi ligjor i kësaj draft kontrate që pika 3 e nenit 14 për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja “N. C.” SHPK kufizon konkurrencën.
- Parashikimi i përcaktuar për 5% të totalit të instrumenteve do të sjellë kufizime të konkurrencës pasi përlllogaritja e tij është e paargumentuar dhe pa një metodologji të përcaktuar.
- Periudha tranzitore e papërcaktuar lë shkak për abuzim me pozitën dominuese që fiton ndërmarrja.
- Rritja e frekuencës së verifikimit të instrumenteve matës nuk duhet të bëhet për të gjithë subjektet e detyruar ose për zona ose për subjekte të detyruar për shkak se për veprime tregtare të njëjta me palët nuk mund t’i vendosë ata në gjendje të pafavorshme konkurrence.

**Rekomandime:**

1.Në nenin 14 të Draft Kontratës “Tarifa e Shërbimit, tarifa koncesionare dhe mënyra e pagesës” në rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit:

a. Të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet depozitimit të dokumentacioneve shoqërues, për të cilat kërkohet ndryshimi i tarifave, **për faktin se e drejta e dhënë në ofrimin e këtij shërbimi krijon një të drejtë ekskluzive.**

b. Ndryshimi i tarifave të shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të njoftohet paraprakisht për vlerësim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

c. Ndryshimet e tarifave të shërbimit duhet të jenë të argumentuara, të bazuara në një metodologji të përlllogaritjes së tyre, dhe të jenë tarifa të orientuara drejt kostos.

d. Detyrimin që si autoritet kontraktor të hartojë një metodologji për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme si dhe të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja “N. C.” SHPK.

2. Pika 3 e nenit 14 të draft kontratës së koncesionit, të rishikohet, të rishikohet, për sa më poshtë:

a. Përqindja e përcaktuar e totalit të instrumenteve matës të verifikuar që rezultojnë me probleme, duhet të përcaktohet në bazë të një metodologjie të miratuar nga autoriteti kontraktor;

b. Periudha tranzitore duhet të jetë e përcaktuar në terma konkretë, duke ju referuar një afati kohor të përcaktuar: muaj, vit apo vite;

c. Rritja e frekuencës së verifikimit të instrumenteve matës duhet të adresohet vetëm për ato “subjekte të detyruara” tek të cilat rezultojnë problematika dhe jo për të gjithë subjektet e detyruar;

d. Të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

II.2.Në vijim të sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr.863, datë 15.02.2022 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes N. C. SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

-Në pikën 11 të përmbajtjes së vendimit, Autoriteti i Konkurrencës, shprehet se “Referuar vlerësimit ligjor të draft kontratës dhe rekomandimeve të dhëna me Vendimin nr. 646/2019, rekomandime të cilat nuk reflektohen plotësisht në Kontratën e miratuar midis palëve, **vihet re se të drejtat që i jepen Koncesionarit nëpërmjet nenit 14 të kontratës i krijojnë atij mundësinë për të abuzuar me pozitën dominuese që ajo ka fituar**”.

-Në përfundim të procedurës hetimore, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë vendimin nr.884, datë 18.05.2022, për mbylljen e procedurës hetimore dhe në përfundim ka dhënë rekomandime për MFE.

**Objekti:** Mbylljen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes N. C. SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me detyrime për ndërmarrjen N. C. SHPK dhe rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Baza Ligjore:** Neni 8, 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 70, pika 2, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Konstatime:**

▪ Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 646/2019 i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rishikimin e pikës 3 të nenit 14 të draft kontratës koncesionare (sipas pikës II/2 të dispozitivit të VKK), **pasi ka konstatuar se kjo pikë për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja N. C. SHPK kufizon konkurrencën** (pika 23 e pjesës argumentuese të VKK nr. 646/2019). Në kontratën e miratuar ky rekomandim nuk është reflektuar.

**Rekomandime:**

a) Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare N. I. SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos.

b) Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare N. I. SHPK, të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës.

c) Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme, duke implementuar rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës ex-ante me vendimin nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, rezulton se **rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në vlerësimin ligjor që ka kryer, nuk janë zbatuar**, pavarësisht faktit se në dy vendimet, është cilësuar që përmbajtja e kontratës koncesionare, neni 14, **mund të krijojë hapësira për koncesionarin që të abuzojë me pozitën dominuese, si dhe të cenohet konkurrenca**. Theksojmë se në pikën 1 të nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “*Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive*”.

Theksojmë se me VKM Nr. 365, datë 20.06.2018 “*Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumentave matës, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurë konkurruese që i jepet shoqërisë*”, është vendosur dhënia me koncesion/PPP e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës, duke e vlerësuar edhe me 10 % të pikëve, shoqërinë “N. C.” shpk, me NIPT L.....C. Më pas është realizuar një procedurë prokurimi e hapur, në përfundim të së cilës është shpallur fitues shoqëria “N. C.” shpk. Para nënshkrimit të kontratës midis palëve, draft-kontrata i është dërguar për konsultim Autoritetit të Konkurrencës, i cili me Vendimin nr. 646, date 09.08.2019 ka vendosur: “T’i kërkojë shoqërisë “N. C.” shpk, si një subjekt e cila

fiton të drejta të veçanta nëpërmjet draft-kontratës së koncesionit, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**Sa sipër asnjë nga rekomandimet e cituara në Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës nr. 646/2019, nuk është marrë parasysh nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Autoritetit Kontraktor), duke lejuar hapësira për koncesionarin që të mund të abuzojë me pozitën dominuese, si dhe riskun e cenimit të konkurrencës.**

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion (grupi i hartimit të kontratës) me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e mendimit për përmbajtjen e draft-kontratës koncesionare. Autoriteti i konkurrencës ka marrë në shqyrtim draft-kontratën dhe ka marrë vendimin nr.646, datë 09.08.2019, duke konstatuar dhe rekomanduar ndryshime në nenin 14 të Draft Kontratës “Tarifa e Shërbimit, tarifa koncesionare dhe mënyra e pagesës”, duke përcaktuar se në rast të ndryshimit të tarifave të paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës, për faktin se e drejta e dhënë në ofrimin e këtij shërbimi krijon një të drejtë ekskluzive.

Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr.863, datë 15.02.2022 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj shoqërisë N. C. SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit.

-Në përfundim të procedurës hetimore, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë vendimin nr.884, datë 18.05.2022, për mbylljen e procedurës hetimore dhe në përfundim ka dhënë rekomandime për MFE:

a) Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare N. I. SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos;

b) Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare N. I. SHPK, të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës;

c) Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme, duke implementuar rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës ex-ante me vendimin nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, rezulton se rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në vlerësimin ligjor që ka kryer, nuk janë zbatuar, pavarësisht faktit se në dy vendimet, është cilësuar që përmbajtja e kontratës koncesionare, neni 14, mund të krijojë hapësira për koncesionarin që të abuzojë me pozitën dominuese, si dhe të cenohet konkurrenca.

Sa më sipër është në mos përputhje pikën 1 e nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “*Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive*”.

Mos zbatimi i rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës, dominuese krijon kushtet për abuzim nga ana e koncesionarit si pasojë e pozitës dominuese.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me email datë 27.06.2024 nga z. A. U., i cili shprehet se i qëndron observacioneve të bëra me shkresë nr. 19754/8, datë 29.01.2024, “Komente mbi gjetjet e evidentuara në Akt-Konstatimin nr. 1” nga znj. A. P. me email datë 21.06.2024, ku shprehet se

i qëndron observacioneve të bëra për akt konstatimet, si dhe z. G. V. me emailin e datës 19.06.2024 ku shprehet se i qëndron komenteve të bëra për akt konstatimet ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Komisioni i dhënies me koncesion lidhur me vendimin e Autoritetit të Konkurrencës për draft kontratën, ka vënë në dijeni AK, duke mos pasur tagër dhe mundësi për zbatimin e tyre.

**Qëndrimi:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se përgjegjësia juaj lidhet me fazën e parë, pra të hartimit të draft kontratës si dhe mbajtjes së procesverbalit nr.11, datë 16.08.2019 për përfundimin e draft-kontratës ku ndër të tjera, shpreheni se janë negociuar edhe sugjerimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokati i Shtetit, si dhe u konkludua në draftin bashkëlidhur procesverbalit, ndërkohë nga verifikimi i kryer, rezulton se rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës nuk kanë gjetur reflektim në kontratën koncesionare. Sqarojmë se ju nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi, për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, si dhe të rekomandimeve të dhëna në vendimin e dytë të Autoritetit të Konkurrencës.

Observacioni merret pjesërisht në konsideratë lidhur me përgjegjësinë e anëtarëve të komisionit.

**II.2.3. Auditim mbi masat e marra nga MFE, për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, lidhur me kryerjen e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe për ankesa të përcjella nga vetë koncesionari në drejtim MFE, sa i përket zbatimit të kontratës koncesionare.**

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit me objekt “Auditimin mbi masat e marra nga MFE, për ankesat e ardhura nga palë të treta ndaj koncesionarit, lidhur me kryerjen e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe për ankesa të përcjella nga vetë koncesionari në drejtim të MFE, sa i përket zbatimit të kontratës koncesionare”, u audituan ankesat e administruara në MFE nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K për subjektet e detyruara<sup>13</sup>.

Baza ligjore në të cilën është mbështetur pika e programit të sipërcituar:

-Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;

-Ligji nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”;

-Kontrata e koncesionit nr.15326 Prot., datë 21.08.2019 “Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”;

-Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e MFE.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MFE, sa i përket ankesave të administruara në MFE, u konstatua si më poshtë vijon:

**Viti 2022**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për vitin 2022 rezultojnë këto ankesa nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K:

- Shkresa nr. 06 datë 10.01.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE, nr. 289 datë 10.01.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën, në formë raportimi, mbi subjektet të cilat kanë tejkaluar afatet ligjore të parashikuara (neni 19/2 i ligjit 126/2020) për instrumentet matëse jo në përdorim, të mbyllura

---

<sup>13</sup> Stacionet e tregtimit të karburanteve dhe gazit të lëngshëm.

me dëshirë për vitin 2021 (duke i cilësuar si kundërvajtje administrative sipas parashikimeve të pikës 2.1.c të nenit 54 të ligjit 126/2020 ), duke kërkuar marrjen e masave për këtë situatë.

-MFE, me shkresën nr. 289/1 Prot., datë 21.02.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikimet përkatëse dhe marrjen e masave të nevojshme sipas rastit në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar që janë në tejkalim të afateve ligjore, si dhe të informojnë MFE, e cila si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo të jetë bërë kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>14</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z. E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Me shkresën nr.14/2 prot., datë 01.02.2022, ISHMT ka informuar MFE se në vijim të ankesave të ardhura nga Shoqëria Koncesionare që lidhen me vitin 2020-2021 dhe me fillim vitin 2022, ka kryer 336 inspektime të paplanifikuara, ku janë evidentuar disa mangësi. Gjithashtu ISHMT shprehet se një pjesë e konstatimeve të Shoqërisë Koncesionare, si mosparaqitja e administratorit, mungesë lëngu në depozitë, defekt në pajisje fiskale, mund të ezaurohen vetë nga N. I. Sh.P.K.

▪ Në vijim të sa më sipër, MFE me shkresën nr.231/4 prot., datë 21.02.2022, i ka kërkuar ISHMT kryerjen e verifikimeve përkatëse për ankesat e N. I. Sh.P.K. Gjithashtu ka kërkuar përcjelljen e informacionit nga ISHMT për masat e marra.

▪ Shkresa nr. 16 datë 03.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 2045 datë 03.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën e përsëritur nga subjektet e Kontratës së Koncesionit, që përfaqësojnë shkelje të përsëritura të legjislacionit, si dhe konstatimin për parregullsi teknike/evidentim i këputjes së shënjave metrologjike si dhe konstatim i moslidhjes së distributorit me pajisjen fiskale në disa subjekte, të cilat kanë pasojë në krijimin e evazionit fiskal.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për problematikën e konstatuar.

MFE, me shkresën nr. 2045/1 Prot., datë 21.02.2022, i drejtohet për ndjekje Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT, që nëpërmjet strukturave të saj kompetente, të kryejë të gjitha verifikimet përkatëse të pretendimeve dhe të informojë MFE në lidhje me gjetjet e konstatuara).

---

<sup>14</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative është përcjellë nga MFE pas 17 ditëve, ose 15 ditë me vonesë.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga DPT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të DPT, marrjen e masave përkatëse<sup>15</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 17 datë 03.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 2046 datë 03.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën e përsëritur nga subjektet e Kontratës së Koncesionit, që përfaqësojnë shkelje të përsëritura të legjislacionit, si dhe një numri subjektësh (17 subjekte bashkëlidhur shkresës) që nuk i është kryer ende inspektimi fillestar dhe periodik pavarësisht adresimit të përsëritur të problematikave të hasura pranë AK (citohen shkresa Nr. 86 Prot., datë 04.08.2021; Nr. 94 Prot., datë 02.09.2021; Nr. 102 Prot., datë 04.10.2021; Nr. 114 Prot., datë 04.11.2021; Nr. 121 Prot., datë 22.11.2021; Nr. 133 Prot., datë 09.12.2021; Nr. 141 Prot., datë 22.12.2021).

N. I. ka kërkuar marrjen e masave, për problematikën e konstatuar.

MFE, me shkresën nr. 2046/1 Prot., datë 24.02.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikimet përkatëse dhe marrjen e masave të nevojshme sipas rastit në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar që janë në tejkallim të afateve ligjore apo shkelje kuadrit ligjor, si dhe të informohet pas kryerjes së veprimeve verifikuese, e cila si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>16</sup>.

<sup>15</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

<sup>16</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z. E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 28 datë 28.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 3860 datë 28.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën të një numri të konsiderueshëm subjektësh që nuk i është kryer ende inspektimi fillestar dhe periodik pavarësisht adresimit të përsëritur të problematikave të hasura pranë AK, për të cilët N. I. ka kërkuar marrjen e masave sipas parashikimeve të Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”. Në vijim kërkohet një draft-raport me informacion për subjektet e përmendur në shkresë, në lidhje me masat e marra mbi shkeljet korresponduese. Bashkëlidhur shkresës për 7 nga 11 subjekte rezulton se janë raportuar edhe më parë për problematikën, pranë MFE-ISHMT, konkretisht:

Për subjektin L. Sh.P.K , shkresa nr. 130 Prot., datë 28.10.2020;

Për subjektin M. R. Sh.P.K, shkresa nr. 37 Prot., datë 02.04.2021;

Për subjektin A. P. Sh.P.K, shkresa nr. 94 Prot., datë 02.09.2021; nr. 37 Prot., datë 02.04.2021; nr. 16 Prot., datë 03.02.2022;

Për subjektin Xh. A. Sh.P.K, shkresa nr. 86 Prot., datë 04.08.2021; nr. 16 Prot., datë 03.02.2022;

Për subjektin F. G. Sh.P.K, shkresa nr. 37 Prot., datë 02.04.2021;

Për subjektin N. G. Sh.P.K, shkresa nr. 153 Prot., datë 21.12.2020;

Për subjektin B. Sh.P.K, shkresa nr. 133 Prot., datë 09.12.2021.

MFE, me shkresën nr. 3860/1 Prot., datë 10.05.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT dhe DPT. ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikime në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare në raportin e përcjellë ka evidentuar shkelje dhe sipas rastit të marrë masa sanksionuese që parashikon Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë”. DPT, që nëpërmjet strukturave të saj kompetente, të kryejë të gjitha verifikimet përkatëse në subjektet e raportuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë koncesionare, dhe të procedojë sipas rastit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT dhe DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT dhe DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative është përcjellë pas 2 muaj e 11 ditëve, ose 2 muaj e 9 ditë me vonesë. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton disa prej çështjeve të ngritura në kërkesën e palës), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>17</sup>.

<sup>17</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT dhe DPT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT dhe DPT, marrjen e masave përkatëse<sup>18</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 27 datë 28.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 3859 datë 28.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari ka ri-përcjellë raportimin mbi subjekte që u ka përfunduar afati i certifikimit dhe diktojnë nevojën për ri-adresim të problematikave e marrjen urgjente të masave në zbatim të kuadrit ligjor përkatës. Në vijim kërkohet një draft-raport me informacion për subjektet e përmendur në shkresë, në lidhje me masat e marra mbi shkeljet korresponduese. Bashkëlidhur shkresës, 10 subjekte rezultojnë të jenë raportuar edhe më parë për problematikën, pranë MFE-ISHMT, konkretisht: Për subjektin L. Sh.P.K , shkresa nr. 86 Prot., datë 04.08.2021 dhe shkresa 121 Prot., datë 22.11.2021;

Për subjektin S. H Sh.P.K, shkresa nr. 86 Prot., datë 04.08.202 dhe shkresa nr. 133 Prot., datë 09.12.2021;

Për subjektin M. G. Sh.P.K, shkresa nr. 102 Prot., datë 04.10.2021;

Për subjektin O. Sh.P.K, shkresa shkresa 121 Prot., datë 22.11.2021

Për subjektin B. M. Sh.P.K, shkresa 121 Prot., datë 22.11.2021;

Për subjektin A. Sh.P.K, shkresa nr. 121 Prot., datë 22.11.2021;

Për subjektin A. Sh.P.K, shkresa nr. 133 Prot., datë 09.12.2021;

Për subjektin B. Sh.P.K. shkresa nr. 133 Prot., datë 09.12.2021;

Për subjektin A. G. Sh.P.K. shkresa nr. 141 Prot., datë 21.12.2021;

Për subjektin I. M. Sh.P.K. shkresa nr. 141 Prot., datë 21.12.2021;

Për subjektin R. 14 Sh.P.K shkresa 141 Prot., datë 21.12.2021.

MFE, me shkresën nr. 3859/1 Prot., datë 10.05.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikime përkatëse dhe të marrë masat e nevojshme sipas rastit në të gjitha subjektet të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar që janë në shkelje të kuadrit rregullator brenda një afati sa më të shkurtër. Shkresat e cituara në shkresën e shoqërisë koncesionare rezultojnë pa përgjigje nga ana e ISHMT pranë MFE dhe N. I. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

---

<sup>18</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;



Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>19</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 58 datë 04.05.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 8052 datë 04.05.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, si Autoriteti Kontraktor.

Koncesionari bën prezent disa problematika dhe pengesa nga stacionet e tregtimit të karburantit, si:

-Një numër subjektsh nuk i është kryer inspektimi fillestar dhe periodik, pavarësisht adresimit të përsëritur të problematikave të hasur pranë AK.

-Një numër i caktuar subjektsh akoma nuk kanë kryer inspektimin periodik me pretendimin se do të bëjnë mbylljen e pikave.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pëzullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>20</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

<sup>19</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

<sup>20</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

“Bashkëndimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 29 datë 28.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 3861 datë 28.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari ka ripërcjellë raportimin mbi subjekte që janë konstatuar parregullsi teknike të këputjes së shenjave metrologjike si dhe mos-lidhjes së distributorit me pajisjet fiskale. Në vijim kërkohet një draft-raport me informacion për subjektet e përmendur në shkresë, në lidhje me masat e marra mbi shkeljet korresponduese. Bashkëlidhur shkresës, 14 subjekte rezultojnë të janë raportuar edhe më parë për problematikën, pranë MFE-ISHMT, konkretisht:

Për subjektet S. D. Sh.P.K, P. N. Sh.P.K dhe A. P. Sh.P.K - shkresa nr. 94 Prot., datë 02.09.2022;

Për subjektet J.P. Sh.P.K , V. N. Sh.P.K - shkresa nr. 102 Prot., datë 04.10.2022;

Për subjektet D. Gj. Sh.P.K , L. O. Sh.P.K dhe U. G. Sh.P.K- shkresa nr.114 Prot., datë 04.11.2022;

Për subjektet L. O. Sh.P.K, P. Sh.P.K, K. Sh.P.K dhe K. Sh.P.K - shkresa nr. 133 Prot., datë 09.12.2022;

Për subjektet F. Sh.P.K dhe Q. Sh. Sh.P.K - shkresa nr. 141 Prot., datë 21.12.2022.

MFE, me shkresën nr. 3861/1 Prot., datë 10.05.2022, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e nevojshme sipas rastit në të gjithë subjektet të cilat shoqëria koncesionare i ka raportuar në shkelje të kuadrit rregullator brenda një afati sa më të shkurtër. Shkresat e cituara në shkresën e shoqërisë koncesionare rezultojnë pa përgjigje nga ana e ISHMT pranë MFE dhe N. I. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkëndimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë edhe DPT, organi publik kompetent. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton disa nga çështjet e ngritura në kërkesën e palës), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>21</sup>.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>22</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

<sup>21</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>22</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 61 datë 18.05.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 9025 datë 18.05.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, si Autoriteti Kontraktor.

Koncesionari bën prezent disa problematika dhe pengesa që përfaqësojnë shkelje të përsëritura të kuadrit rregullator në fuqi, si:

-Një numër subjektsh nuk i është kryer inspektimi fillestar dhe periodik, pavarësisht adresimit të përsëritur të problematikave të hasura pranë AK.

-Një numër i caktuar subjektsh akoma nuk kanë kryer inspektimin periodik me pretendimin se do të bëjnë mbylljen e pikave.

-Probleme të lidhjes së dispenserit me pajisjen fiskale.

-Subjekti është debitor ndaj N. I. Sh.P.K për shërbime të ofruara më parë.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator.

MFE, me shkresën nr. 9025/1 Prot., datë 30.05.2022, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT dhe DPT. ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikime në të gjitha subjektet, për të cilat shoqëria koncesionare në raportin e përcjellë ka evidentuar shkelje dhe sipas rastit të marrë masa sanksionuese që parashikon Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë”. DPT, që nëpërmjet strukturave të saj kompetente, të kryejë të gjitha verifikimet përkatëse në subjektet e raportuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë koncesionare dhe të procedojë sipas rastit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT dhe DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT dhe DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative është përcjellë pas 11 ditëve, ose 9 ditë me vonesë. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>23</sup>.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT dhe DPT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT dhe DPT, marrjen e masave përkatëse<sup>24</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

<sup>23</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>24</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Me shkresën Nr. 9025/4 Prot., datë 04.07.2022 MFE përcjell për njohje shkresat e DPT dhe ISHMT, pranë shoqërisë koncesionare, mbi verifikimet përkatëse mbi shkeljet e pretenduara nga kjo e fundit (bashkëlidhur nuk ka kopje të shkresave). Vetëm kjo shkresë rezulton mbi përcjelljen verifikimeve përkatëse të bëra nga ISHMT dhe DPT.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për shkresat: Nr. 67 Prot., datë 09.06.2022 (prot. pranë MFE me nr. 11448 datë 09.06.2022); Nr. 71 Prot., datë 20.06.2022 (prot. pranë MFE me nr. 12047 datë 20.06.2022); Nr. 92 Prot., datë 27.07.2022 (prot. pranë MFE me nr. 14392 datë 27.07.2022); Nr. 101 Prot., datë 16.08.2022 (prot. pranë MFE me nr. 15392 datë 16.08.2022); Nr. 102 Prot., datë 19.08.2022 (prot. pranë MFE me nr. 15503 datë 19.08.2022; Nr. 142 Prot., datë 09.09.2022 (prot. pranë MFE me nr. 16665 datë 09.09.2022) si dhe Nr. 158 Prot., datë 13.11.2022 (prot. pranë MFE me nr. 15392 datë 13.11.2022) të Shoqërisë Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, si Autoriteti Kontraktor, ku bën prezent problematikën dhe pengesat nga subjektet e detyruara sipas kontratës së koncesionit dhe marrjen e masave në lidhje me to, **nuk rezulton përgjigje mbi masat e marra nga ISHMT apo përcjellje e shkresave për ndjekje dhe kërkesë e përsëritur për informacion nga MFE.**

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>25</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesave deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesat.

---

<sup>25</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III.

▪ Shkresa nr. 202 Prot., datë 21.11.2022 (prot. pranë MFE me nr. 21384 datë 21.11.2022), si dhe shkresa nr. 209 Prot., datë 19.12.2022 (prot. pranë MFE me nr. 23238 datë 19.12.2022) nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, si Autoriteti Kontraktor.

Koncesionari bën prezent një gamë problematikash dhe pengesash që përfaqësojnë shkelje të përsëritura të kuadrit rregullator në fuqi, si:

-Një numër subjektsh nuk i është kryer inspektimi fillestar dhe periodik, pavarësisht adresimit të përsëritur të problematikave të hasura.

-Një numër i caktuar subjektsh akoma nuk kanë kryer inspektimin periodik me pretendimin se do të bëjnë mbylljen e pikave.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator.

MFE, me shkresën nr. 23238/1 Prot., datë 28.12.2022, për dy shkresat e sipërcituara, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT dhe DPT. ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikime në të gjitha subjektet, për të cilat shoqëria koncesionare në raportin e përcjellë ka evidentuar shkelje dhe sipas rastit të marrë masa sanksionuese që parashikon Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë”. DPT, që nëpërmjet strukturave të saj kompetente, të kryejë të gjitha verifikimet përkatëse në subjektet e raportuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë koncesionare dhe të procedojë sipas rastit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT dhe DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT dhe DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative është përcjellë pas 1 muaj e 6 ditëve, ose 1 muaj e 4 ditë me vonesë. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>26</sup>.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE, nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT dhe DPT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT dhe DPT, marrjen e masave përkatëse<sup>27</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

<sup>26</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>27</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

“Bashkëndimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

## Viti 2021

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për vitin 2021 rezultojnë këto ankesa nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K:

▪ Shkresa nr. 37 datë 02.04.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 6097 datë 02.04.2021), drejtuar ISHMT, si dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara, është penguar nga subjektet, të grupuara në dy kategori:

- 47 subjekte kanë penguar verifikimin duke mos kryer pagesat e tarifave të shërbimeve të kryera dhe duke qenë kështu debitorë të shoqërisë “N. I.” Sh.P.K.

- 46 subjekte kanë penguar verifikimin nëpërmjet formave të tjera.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkëndimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. O. M., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>28</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkëndimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 59 datë 10.06.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 10384 datë 11.06.2021), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi instrumenteve matëse, është penguar nga 13 subjekte të listuara në shkresë, duke mos kryer pagesat e tarifave të shërbimeve të përcaktuara sipas Udhëzimit të përbashkët nr.2 datë 08.02.2013 të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave, konkretisht si më poshtë:

A. Sh.P.K debitor në vlerë 14,400 lekë

A. B. Sh.P.K debitor në vlerë 14,400 lekë

A. Sh.P.K debitor në vlerë 14,400 lekë

<sup>28</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

B. & A. Sh.P.K debitor në vlerë 18,000 lekë  
E. Sh.P.K debitor në vlerë 28,800 lekë  
G.J.S O. Sh.P.K debitor në vlerë 28,800 lekë  
G. A. Sh.P.K debitor në vlerë 7,200 lekë  
H. Sh.P.K debitor në vlerë 46,800 lekë  
K. K. Sh.P.K debitor në vlerë 3,600 lekë  
M. 2017 Sh.P.K debitor në vlerë 18,000 lekë  
Sh. K. Sh.P.K debitor në vlerë 21,600 lekë  
Sh. P. Sh.P.K debitor në vlerë 21,600 lekë  
S. Sh.P.K debitor në vlerë 32,400 lekë

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

-Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk ka përgatitur asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP, pasi arkëtimi i tarifës së shërbimit të verifikimit është detyrim i Shoqërisë Koncesionare dhe jo i AK. Në këtë rast Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve duhet të kishte propozuar NJZP kryerjen e verifikimit për situatën e mësipërme, konstatimin e problematikës dhe dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e saj. Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 58 datë 10.06.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 10383 datë 11.06.2021), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi i instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara, është penguar nga subjekte të listuar në shkresë, nga të cilat:

- 3 subjekte për prishje dhe heqje të shenjave metrologjike/mungesë kase fiskale;

- 26 subjekte kanë penguar/ndaluar kryerjen e verifikimit.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë organit publik kompetent. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>29</sup>.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë kthim-përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

<sup>29</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. O. M., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>30</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 86 datë 04.08.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 13867 datë 04.08.2021), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi i instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara është penguar nga subjekte të listuara në shkresë (deri në datën 31 korrik 2021), nga të cilat:

- 4 subjekte për prishje dhe heqje të shenjave metrologjike/mungesë kase fiskale;
- 10 subjekte kanë penguar/ndaluar kryerjen e verifikimit;
- 9 subjekte për problematika të tjera.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë organit publik kompetent. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>31</sup>.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë kthim-përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. O. M., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>32</sup>.

<sup>30</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

<sup>31</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>32</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;



-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z. E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 94 datë 02.09.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 15189 datë 02.09.2021), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi i instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara është penguar nga subjekte të listuar në shkresë (deri në datën 31 gusht 2021), nga të cilat:

- 6 subjekte për prishje dhe heqje të shenjave metrologjike/mungesë kase fiskale;
- 10 subjekte kanë penguar/ndaluar kryerjen e verifikimit;
- 9 subjekte për problematika të tjera.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë organit publik kompetent. Në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka kërkuar nisjen e procedurës administrative. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>33</sup>.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë kthim-përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE, nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>34</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

<sup>33</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>34</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

“Bashkëndimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

▪ Shkresa nr. 98 Prot., datë 29.09.2021 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 22.10.2021 datë 30.09.2021), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar mbi 366 subjekte që kanë tejkaluar afatet ligjore të parashikuara për instrumentet matës jo në përdorim (totali 2298), të mbyllura me dëshirë me kërkesë të subjektit.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për rastet e evidentuara bashkëlidhur shkresës.

MFE, me shkresën nr. 16565/1 Prot., datë 21.10.2021 i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të marrë masat e nevojshme për trajtimin e problematikave të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkëndimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE, nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>35</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkëndimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

-Për sa më sipër nuk vërtetohet trajtimi shterues i ankesës deri në kthim përgjigjen ndaj subjektit që ka bërë ankesën.

## **Viti 2020**

▪ Shkresa nr. 122 datë 09.10.2020 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE nr. 18896 datë 09.10.2020), drejtuar ISHMT dhe MFE. Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur 7 subjekte nuk kanë lidhur distributorin me kasën fiskale.

MFE me shkresën nr.18896/1 prot., datë 22.10.2020 i ka përcjellë për kompetencë ISHMT, kryerjen e inspektimeve. Në përfundim të informohet MFE për rezultatet e inspektimeve.

---

<sup>35</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë organit publik kompetent. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>36</sup>.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë kthim-përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. O. M., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>37</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

▪ Shkresa nr. 130 datë 28.10.2020 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 20344 datë 28.10.2020), drejtuar ISHMT dhe MFE.

Koncesionari bën prezent problematikën duke raportuar rastet kur verifikimi instrumenteve matëse, ligjërisht të kontrolluara është penguar nga subjekte të listuara në shkresë, apo probleme që lidhen me kasën fiskale, nga të cilat:

-4 subjekte për prishje dhe heqje të shenjave metrologjike/mungesë kase fiskale;

-4 subjekte kanë penguar/ndaluar kryerjen e verifikimit;

-1 subjekt për këputjen e vulave të bllokimit të vendosura Shoqëria Koncesionare N. I.

-6 subjekte për problematika të tjera.

N. I. ka kërkuar marrjen e masave për kontrollin/pezullimin/heqjen e licencës së aktivitetit të subjekteve në bazë të problematikës së konstatuar, krahas gjobës dhe masave të tjera që mund të rezultojnë të nevojshme sipas parashikimeve përkatëse në kuadrin rregullator.

MFE me shkresën nr.20344/1 prot., datë 18.11.2020 i ka përcjellë për kompetencë ISHMT, kryerjen e inspektimeve. Në përfundim të informohet MFE për rezultatet e inspektimeve.

-Konstatohet se kërkesa për nisjen e procedurës administrative nuk i është përcjellë organit publik kompetent. MFE në kushtet e mungesës së kompetencës lëndore dhe tokësore (me akt ligjor DPT është organi publik që trajton çështjet e ngritura në kërkesën e palës të cilat lidhen me element që mund të sjellin evazion fiskal), duhet ta përcillte kërkesën pa vonesë brenda 2 ditëve për trajtim në organin kompetent<sup>38</sup>.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë kthim-përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

<sup>36</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

<sup>37</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

<sup>38</sup> Pika 1 në nenin 24 në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”; Pika 3 në nenin 5 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”;

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. O. M., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse<sup>39</sup>.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Mbështetur në detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht:

“Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”.

“Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.

### **Ankesat- Subjektet për Shoqërinë Koncesionare N. I. Sh.P.K**

▪ Ankesa datë 04.10.2022, subjekti Er Petrol Sh.P.K, përcjellë në rrugë elektronike si dhe nëpërmjet platformës për bashkëqeverisje, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nëpërmjet së cilës shprehet shqetësimi për shërbimet e ofruara nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K. Ankesa e sipërcituar, me shkresë nr. 1927/1 datë 06.10.2022, i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoriteti kompetent.

Sipas mbishkrimit në kartelën shoqëruese të praktikës, ish Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, z. E. A. dhe Kryetari i NJZP znj. S. H. kanë marrë në dorëzim ankesën e mësipërme, e cila më pas ka dhenë dorëheqjen nga pozicioni.

Nga auditimi i dokumentacionit për çështjen e mësipërme, konstatohet se deri më datë 31.12.2022, nuk administrohet asnjë dokument, mbi informimin nga Kryetari i NJZP të grupit të NJZP për ankesën e subjektit E. dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesës.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

*-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, z. E. A..*

▪ Shkresa e datës (prot. nga MFE) nr. 7220 Prot., datë 19.04.2022 nga Shoqëria **M. N. Sh.P.K**, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet së cilës bën prezent ankesën në lidhje me deformimin e tregut dhe konkurrencës në fushën e fiskalizimit në treg nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, e cila pretendohet se i drejton subjektet drejt një kompanie të caktuar në fushën e fiskalizimit (lidhur me kërkesën e shoqërisë *2N Sh. P. Sh.P.K* pas hapjes së pikës së e të karburantit).

Me e-mail e datës 24.05.2022, znj. I. Z., Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të Kontratave Koncesionare, ka përcjellë për trajtim dhe kthim përgjigje mbi ankesën e shoqërisë **M. N. Sh.P.K**, brenda datës 26.05.2022.

Me e-mail e datës 27.05.2022, Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, për ankesën e Shoqërisë **M. N. Sh.P.K**, ka kthyer përgjigje se në dijenin e tyre, referuar informacioneve të publikuara në web-in e DPT, shoqëria në fjalë nuk ofron pajisje fiskale të certifikuar në përputhje me fiskalizimin, por ofron zgjidhje softwerike për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike. Gjithashtu, është shprehur se i ka bërë me dije shoqërisë *2N Sh. P. Sh.P.K*, që janë të gatshëm për të ofruar shërbimin, si dhe që pajisja fiskale duhet të jetë e certifikuar

<sup>39</sup> Pika 2 në nenin 15 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE, Kreu III;

në përputhje me fiskalizimin (i është kërkuar t'i vihet në dispozicion një dokument zyrtar që vërteton që subjekti që ka montuar pajisjen ka certifikimin përkatës nga institucionet shtetërore, në mënyrë që të vijojë me ofrimin e shërbimit). Më tej, kërkon të informohet nga MFE, si Autoritet Kontraktor dhe institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e funksionimit të administratës tatimore, mbi subjektet që kanë të drejtë të ofrojnë pajisjet fiskale dhe zgjidhjet softëerike të certifikuara në fushën e hidrokarbureve.

Me shkresë nr. 7220/1 prot., datë 04.07.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i është drejtuar për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (është bërë me dije ankesa e Shoqërisë M. N. Sh.P.K, si dhe përgjigja e Shoqërisë N. I. Sh.P.K), duke kërkuar vënien në dispozicion të listës së subjekteve të licencuar nga ana e DPT që ofrojnë pajisje fiskale të certifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

*Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nuk dokumentohet informimi i NJZP për ankesën e mësipërme, si dhe ankesa e Shoqërisë M. N. Sh.P.K nuk ka marrë përgjigje nga MFE, mbi problematikën e pretenduar nga ana e saj.*

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, z. E. A. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit të Kontratave Koncesionare, znj. I. Z..

**Shënim:** Grupi i auditimit, për kontratën e koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019, publikuar edhe online nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, ka hasur vështirësi jo vetëm për marrjen dhe shqyrtimin e dokumenteve, kjo kryesisht për shkak të keqadministrimit të praktikës nga të gjitha strukturat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, si dhe nëse janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet shkresore të prodhuara nga institucionet apo dorëzuara nga shoqëri përfituese, si dhe në mungesë të dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës.

-Gjatë periudhës 2022, Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.p.k., ka hasur problematika në zbatimin e shërbimit objekt i kontratës koncesionare. Shkresa nr. 06 datë 10.01.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE, nr. 289 datë 10.01.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën, në formë raportimi, mbi subjektet të cilat kanë tejkalluar afatet ligjore të parashikuara (neni 19/2 i ligjit 126/2020) për instrumentet matëse jo në përdorim, të mbyllura me dëshirë për vitin 2021 (duke i cilësuar si kundërvajtje administrative sipas parashikimeve të pikës 2.1.c të nenit 54 të ligjit 126/2020), duke kërkuar marrjen e masave për këtë situatë.

-MFE, me shkresën nr. 289/1 Prot., datë 21.02.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikimet përkatëse dhe marrjen e masave të nevojshme sipas rastit në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar që janë në tejkallim të afateve ligjore, si dhe të informojnë MFE, e cila si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT për këtë shkresë, apo të jetë bërë kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT, marrjen e masave përkatëse.

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqëruar, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP. Me shkresën nr.14/2 prot., datë 01.02.2022, ISHMT ka informuar MFE se në vijim të ankesave të ardhura nga Shoqëria Koncesionare që lidhen me vitin 2020-2021 dhe me fillim vitin 2022, ka kryer 336 inspektime të paplanifikuara, ku janë evidentuar disa mangësi.

Në vijim, MFE me shkresën nr.231/4 prot., datë 21.02.2022, i ka kërkuar ISHMT kryerjen e verifikimeve përkatëse për ankesat e N. I. Sh.P.K. Gjithashtu ka kërkuar përcjelljen e informacionit nga ISHMT për masat e marra. Shkresa nr. 16 datë 03.02.2022 nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K (prot. pranë MFE me nr. 2045 datë 03.02.2022), drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE. Koncesionari bën prezent problematikën e përsëritur nga subjektet e Kontratës së Koncesionit, që përfaqësojnë shkelje të përsëritura të legjislacionit, si dhe konstatimin për parregullsi teknike/evidentim i këputjes së shenjave metrologjike si dhe konstatim i mos-lidhjes së distributorit me pajisjen fiskale në disa subjekte, të cilat kanë pasojë në krijimin e evazionit fiskal.

Sa më sipër është në mos përputhje me detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE shprehimisht: “Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë”. “Bashkërendimi i punës me strukturat/personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave koncesionare ku AK është MFE”.

Mos bashkërendimi dhe koordinimi i strukturave të MFE rrit riskun për mos realizimin e objektivave të kontratës koncesionare.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve pranë MFE.*

-Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K me shkresa të ndryshme drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, i ka paraqitur problematika të një numri të konsiderueshëm subjektësh që nuk i është kryer ende inspektimi fillestar dhe periodik pavarësisht adresimit të përsëritur të problemeve të hasura pranë AK, për të cilët N. I. ka kërkuar marrjen e masave sipas parashikimeve të Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”. Në vijim është kërkuar një draft-raport me informacion për subjektet në shkelje, në lidhje me masat e marra mbi shkeljet korresponduese. Bashkëlidhur shkresës për 7 nga 11 subjekte rezulton se janë raportuar edhe më parë për problematikën, pranë MFE-ISHMT. MFE, me shkresën nr. 3860/1 Prot., datë 10.05.2023, i drejtohet për ndjekje dhe kompetencë ISHMT dhe DPT. ISHMT, që në tagrin e organit përgjegjës të kryejë verifikime në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare në raportin e përcjellë ka evidentuar shkelje dhe sipas rastit të marrë masa sanksionuese që parashikon Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë”. DPT, që nëpërmjet strukturave të saj kompetente, të kryejë të gjitha verifikimet përkatëse në subjektet e raportuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë koncesionare, dhe të procedojë sipas rastit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, MFE kërkon të informohet, pasi si AK duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me zbatueshmërinë e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT dhe DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT dhe DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE z. A. Gj., nuk administrohet asnjë dokument për zgjidhjen e situatës së mësipërme, i cili pavarësisht se ka qenë në dijeni të situatës, nuk ka kërkuar informacion mbi punën e bërë nga ISHMT dhe DPT, me qëllim mbikëqyrjen, si dhe në rast të mosveprimit të ISHMT dhe DPT, marrjen e masave përkatëse .

-Gjithashtu nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, nuk administrohet asnjë dokument shoqërues, si p.sh., MEMO, drejtuar NJZP për situatën e mësipërme, me qëllim kryerjen e monitorimit në bashkëpunim me NJZP.

Sa më sipër është në mos përputhje me detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE

shprehimisht: "Monitorimi i kontratave të koncesioneve në të cilat MFE është në rolin e AK në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të ngarkuara me këtë detyrë".

Mos bashkërendimi dhe koordinimi i strukturave të MFE rrit riskun për mos realizimin e objektivave të kontratës koncesionare.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me email datë 18.06.2024 nga znj. I. Z., "Komente mbi gjetjet e evindentuara në Projekt Raport, dhe nga z. E. A. me emailin datë 19.06.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

### **Pretendimi i subjektit:**

Referuar auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në bazë të programit të auditimit nr.257/1 prot, datë 03.05.2023, i ndryshuar dhe Projekt Raportit të përgatitur nga grupi i auditimit në muajin Prill 2024, i cili pasi është dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr.4650/2 prot., date 03.06.2024, është protokolluar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.19754/10 prot., datë 04.06.2024, Ju paraqes observacionet e mia si më poshtë vijon:

*Lidhur me qëndrimin tuaj ku shpreheni se: "Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur nga z. E. A., shprehem se nuk merret në konsideratë dhe qëndrojmë trajtimin të bërë në akt konstatimit nr.2. Konkretisht referuar kuadrit rregullator, shtojcës 4 të kontratës së koncesionit, ku Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve është pika e kontaktit ndërmjet AK dhe Koncesionarit dhe koordinon masat dhe strukturat përkatëse për ofrimin e zgjidhjes së kërkuar, pikës 3 të nenit 13 të masat ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", ka përcaktuar shprehimisht: 3. Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel i lartë hierarkik, për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njëjësive administrative dhe personelit brenda drejtorisë, duke vijuar me Rregulloren e brendshme të MFE në fuqi për periudhën, shkronja B. faqe 51, pikat 6 dhe 10 dhe dokumentacionit të administruar për trajtimin e ankesës përkatëse, arrihet në konstatimin se nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve nuk dokumentohet bashkërendimi me strukturat e tjera për zgjidhjen e situatës së mësipërme, e cila në thelb lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare, pra verifikimin metrologjik për instrumentet matës (te cilat qëndrojnë në stacionin e karburantit me mbishkrimin, instrument matës jo në përdorim, duke tejkaluar afatin ligjor, si dhe duke krijuar mundësinë për abuzim me tregtimin e karburantit nëpërmjet instrumentit matës jo të verifikuar nga Koncesionari). Ju shprehem se nga Drejtorja e Koncesioneve, shkresa është konceptuar brenda afatit ligjor. por në asnjë rast nuk e ilustroni, minimalit me një praktike konkrete: Grupi i auditimit e ka kufizuar veprimtarinë tuaj vetëm lidhur me NZP. pasi edhe sipas rregullores së brendshme, ju bashkërendoni veprimet me qëllim monitorimin zbatimit të kontratës koncesionare, vetëm me ato struktura të cilat kanë detyrë monitorimin e kontratës që në këtë rast është NJZP. Përcjellja tek Kryetari i NJZP të ankesave për trajtim. nuk: nënkupton zbatimin e kontratës së koncesionit. Për mos të përmendur raste ku ju nuk e keni adresuar ku duhet ankesën, si p, sh., (por jo vetëm këto raste) shkresat nr.29 prot, datë 28.02.2022, nr. 202 Prot., datë 21.1 1.2022, ku sipas informacionit të pasqyruar, ankesat duhet t'i ishin përcjellë edhe DPT, pra jo vetëm ISHMT. Qëndrimi i mësipërm vlen edhe për observacionet e tjera për konstatimet e së njëjtës natyrë. Observacioni merret pjesërisht në konsideratë"*

*Ju sqaroj si më poshtë: Nga ana ime si Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, janë kryer të gjitha veprimet procedurale në përputhje me ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet/PPP", i ndryshuar, detyrat e përcaktuara në shtojcën 4 të kontratës së koncesionit, " Për Shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matës së karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe sipas përshkrimit të punës ku ndër detyrat e tjera përcaktohet se Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve: "Menaxhon dhe koordinon procesin e raportimeve periodike të Autoritet*

*Kontraktues mbi monitorimin e ecurisë së zbatimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat sipas formatit të miratuar, nxit strukturat përgjegjëse monitoruese të kontratave të koncesioneve/partneritetit publik privat për monitorim periodik sipas parashikimeve kontraktore, ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Autoritet Kontraktues, përmes informacionit të përfituar nga këto struktura/njësi monitoruese të caktuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktues"; "Koordinon dhe ndjek me institucionet e tjera çdo çështje tjetër apo kërkesë që adresohet për ndjekje nga titullarët e ministrisë në kuadër të ecurisë së zbatimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat.*

*Pra, sipas përshkrimit të punës monitorimi i ecurisë së zbatimit të kontratave të koncesionit kryhet përmes informacionit të përfituar nga strukturat apo njësitë monitoruese të caktuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktues, që në këtë kontratë koncesioni është Njësia e Zbatimit të Projektit. Me marrjen në dorëzim të çdo praktike lidhur me këtë kontratë janë vënë në dijeni Kryetari i Njesisë së Zbatimit të Projektit për të vijuar më tej me trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesave përkatëse. Përveç Njesisë së Zbatimit të Projektit (strukturë e ngritur me urdhër Ministri), lidhur me shërbimin e ofruar nga koncesionari, institucion përgjegjës për inspektimin në terren sipas ligjit ar. 10433, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", datë 16/06/2011, është Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut.*

*Gjithashtu, në vijimësi në ushtrim të detyrave si Drejtor të Drejtorisë kam koordinuar punën me strukturat përgjegjëse në terren, duke adresuar çdo problematikë të raportuar nga Koncesionari tek institucionet përgjegjëse siç është Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilat kanë trajtuar problematikat përkatëse dhe kanë vënë në dijeni Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me çdo konstatim të hasur gjatë trajtimit të problematikave të raportuara nga ana e shoqërisë koncesionare N. I.. (Këto shkresa u janë vënë në dispozicion bashkëlidhur me observacionet e mëparshme).*

*Pra në çdo rast, sikundër ju kam përcjellë të gjitha shkresat e trajtuara në funksion të monitorimit të kontratës koncesioare, kërkesat e përcjella nga shoqëria koncesionare për trajtim të Autoriteti Kontraktues MFE, janë dërguar të gjitha te ISHMT dhe DPT, si institucione përgjegjëse të caktuara nga kuadri ligjor dhe kontrata e koncesionit, si institucione përgjegjëse për inspektimin në fushën e metrologjisë (ISHMT) dhe procedurat tatimore (DPT). Në çdo rast kemi MFE i kemi kërkuar këtyre institucioneve trajtimin e kërkesave të paraqitura nga shoqëria koncesionare brenda kompetencave të tyre, verifikimin në terren dhe mbajtjen e informuar të Autoritetit Kontraktues MFE në lidhje me trajtimin dhe konkluzionet përkatëse. Nga ana tjetër, këto institucione i janë përgjigjur Autoritetit Kontraktues MFE dhe shoqërisë koncesionare në lidhje me verifikimet në terren dhe masat e marra rast pas rasti. Për rrjedhojë, nga ana ime nuk është kufizuar puna vetëm me përcjelljen e praktikave por edhe me ndjekjen e tyre dhe përmbylljen e ciklit të komunikimit institucional mes palëve të përfshira për adresimin e problematikave të shfaqura nga puna në terren e shoqërisë koncesionare.*

*Sjellim në vëmendjen tuaj, se periudha për të cilën ju kemi parashtruar gjetjet e auditimit (2021- 2022) përkohë me vitin e parë dhe të dytë të zbatimit të kontratës koncesionare në terren, punë e cila ka patur domosdoshmëri ndërgjegjësimin e subjekteve të detyruara për respektimin e parashikimeve kontraktuale të koncesionit dhe bashkëpunimin me punonjësit e shoqërisë koncesionare për realizimin e shërbimit objekt kontrate.*

*Për sa më sipër, lutem që argumentet e sipërcituara për gjetjet tuaja të paraqitura edhe në observacionet e përgatitura në fazën e akt konstatimeve të merren në konsideratë plotësisht dhe këto gjetje të hiqet nga përmbajtja e Raportit të Auditimit.*

*Lidhur me qëndrimin tuaj: "Pas shqyrtimit të paraqitur nga z. E. A. dhe Znj. I. Z., shprehemi se merret në konsideratë pjesërisht (pra njohjen e NJZP me ankesën e subjektit M. N.) dhe për pjesën tjetër i qëndrojmë trajtimin të bërë në akt konstatimin nr.2. Draft- shkresa bashkëlidhur observacionit (e pa sigluar nga konceptuesi i saj dhe pranuesi) nuk tregon se ju si drejtori keni kryer veprimin tuaj, i cili nuk është finalizuar jo për shkakun tuaj. Për më tepër që subjekti M. N. mund t'i ishte kthyer përgjigje edhe nëpërmjet emailit zyrtar, duke vendosur në dijeni*



*Koncesionarin dhe subjektin 2N Sh. ka detyrimin ligjor që të përdorë instrumente matës të verifikuar, ashtu si edhe koncesionari ka detyrimin që të ofrojë shërbimin ndaj subjektit 2N Sh..."*

*Ju risqaroj se, subjekti ankues e ka marrë përgjigjen me shkresë zyrtare, duke qenë se edhe i është drejtuar subjekteve shtetërore me shkresë zyrtare, dhe nga ana ime si Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve në përputhje me përshkrimet e punës janë ndërmarrë të gjitha hapat për trajtimin e ankesës nga strukturat përgjegjëse dhe NJZP e kontratës, deri në draftimin e përgjigjes për subjektin ankues.*

*• Lidhur me gjetjen nr.19, nr. 21 dhe nr. 23 ku shpreheni se: "Ne dosje nuk administrohet informacioni i përgatitur nga NJZP, mbi bazën e raportimit 3-mujor, drejtuar përfaqësuesit të AK në këtë rast Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve. Gjithashtu, edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, pavarësisht faktit se është njohur me raportin 3-mujor të mësipërm, në zbatim të shtojcës 4, nuk ka raportuar tek AK për ecurinë e zhvillimit të projektit" Ju bej me dije se; Për çdo raportim të përcjellë nga ana e shoqërisë koncesionare është vënë në dijeni në mënyrë sistematike dhe me informacion të detajuar Titullari i Autoritetit Kontraktues dhe të gjithë zyrtarët përgjegjës në MFE në nivel hierarkie me Drejtorinë e Koncesioneve, me anë të memove periodike 3-mujore në të cilat përfshihen informacion për të gjitha kontratat e koncesionit e raportuara për 3-mujorin përkatës në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat " dhe Udhëzimit nr. 35, datë 12.12.2019 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për përcaktimin e rregullave dhe standardeve mbi raportimin dhe monitorimin e ecurisë Financiare dhe Jo-financiare të Kontratave Koncesionit/ Partneritetit Publik Privat nga Autoritetet Kontraktuese" , nga të gjitha Autoritetet Kontraktues të cilat kanë nënshkruar një kontratë koncesioni. (të cilat në rast vlerësimi mund t' Ju vihen në dispozicion). Për më tepër komunikimet shkresore që Autoriteti Kontraktues MFE ka mbajtur me shoqërinë koncesionare, institucionet përgjegjëse DPT dhe ISHMT, si dhe me çdo institucion tjetër është bërë me nënshkrimin dhe miratim të titullarit të Autoritetit Kontraktues të MFE, Zëvendësministrit përgjegjës për koncesionet/PPP dhe Sekretarit të Përgjithshëm në MFE.*

*Për sa më sipër, lutem edhe njëherë që argumentet e sipërcituara për gjetjet tuaja të paraqitura edhe në observacionet e përgatitura në fazën e akt konstatimeve të merren në konsideratë plotësisht dhe këto gjetje të hiqet nga përmbajtja e Raportit të Auditimit.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur nga z. E. A., shprehemi se merret pjesërisht në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimin të bërë në projekt raport. Konkretisht referuar kuadrin rregullator, shtojcës 4 të kontratës së koncesionit, ku Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve është pika e kontaktit ndërmjet AK dhe Koncesionarit, si dhe koordinon masat dhe strukturat përkatëse për ofrimin e zgjidhjes së kërkuar, pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", ku përcaktohet shprehimisht:

3. Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel më i lartë hierarkik, **për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj**, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njësisve administrative dhe personelit brenda drejtorisë, duke vijuar me Rregulloren e brendshme të MFE në fuqi për periudhën, shkronja B, faqe 51, pikat 6 dhe 10 dhe dokumentacionit të administruar për trajtimin e ankesës përkatëse, arrihet në konstatimin se nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve nuk dokumentohet bashkëndimi me strukturat e tjera për zgjidhjen e situatës së mësipërme, e cila në thelb lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare, pra verifikimin metrologjik për instrumentet matës (të cilat qëndrojnë në stacionin e karburantit me mbishkrimin, instrument matës jo në përdorim, duke tejkalluar afatin ligjor, si dhe duke krijuar mundësinë për abuzim me tregtimin e karburantit nëpërmjet instrumentit matës jo të verifikuar nga Koncesionari).

Ju shpreheni se nga Drejtoria e Koncesioneve, shkresa është konceptuar brenda afatit ligjor, por në asnjë rast nuk e ilustroni, minimalisht me një praktikë konkrete.

Grupi i auditimit e ka kufizuar veprimtarinë tuaj vetëm lidhur me NJZP, pasi edhe sipas rregullores së brendshme, ju bashkërendoni veprimet me qëllim monitorimin e zbatimit të kontratës koncesionare, vetëm me ato struktura të cilat kanë detyrë monitorimin e kontratës, që në këtë rast është NJZP.

Përcjellja tek Kryetari i NJZP të ankesave për trajtim, nuk nënkupton realizimin e të gjitha detyrave tuaja si Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, pasi në këtë rast ju nuk keni kryer asnjë veprim që tregon se keni bashkërenduar veprimtarinë me NJZP, apo jeni duke monitoruar zgjidhjen e ankesës së mësipërme, e cila automatikisht lidhet me zbatimin e kontratës së koncesionit. Për mos të përmendur raste ku ju nuk e keni adresuar ku duhet ankesën, si p.sh., (por jo vetëm këto raste) shkresat nr.29 prot., datë 28.02.2022, nr. 202 Prot., datë 21.11.2022, ku sipas informacionit të pasqyruar, ankesat duhet t'i ishin përcjellë edhe DPT, pra jo vetëm ISHMT.

Qëndrimi i mësipërm vlen edhe për observacionet e tjera për konstatimet e së njëjtës natyrë.

**Observacioni merret pjesërisht në konsideratë në lidhje me përgjegjësinë tuaj.**

-Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur nga z. E. A. dhe znj. I. Z., shprehemi se merret në konsideratë pjesërisht (pra njohjen e NJZP me ankesën e subjektit M. N.) dhe për pjesën tjetër i qëndrojmë trajtimit të bërë në akt konstatimin nr.2. Draft-shkresa bashkëlidhur observacionit (e pa sigluar nga konceptuesi i saj dhe pranuesi) nuk tregon se ju si drejtori keni kryer veprimin tuaj, i cili nuk është finalizuar jo për shkakun tuaj. Për më tepër që subjektit M. N. mund ti ishte kthyer përgjigje edhe nëpërmjet email-it zyrtar, duke vendosur në dijeni Koncesionarin dhe subjektin 2N Sh., si palë të lidhura dhe të interesuara, pasi subjekti 2N Sh. ka detyrimin ligjor që të përdorë instrumente matës të verifikuar, ashtu si edhe Koncesionari ka detyrimin që të ofrojë shërbimin e verifikimit ndaj subjektit 2N Sh.. Sqarojmë se në këtë rast, veç përgjegjësisë së Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve dhe Përgjegjësit të Sektorit të Koncesioneve, shtohet edhe përgjegjësia e Kryetarit të NJZP, znj. S. P., e cili ka qenë në dijeni të ankesës dhe nuk ka marrë masat e nevojshme për kthim përgjigjen ndaj subjektit M. N., por njëkohësisht edhe për të verifikuar nëse ndaj subjektit 2N Sh. është ofruar shërbimi i verifikimit, pavarësisht problemit të krijuar me pajisjen fiskale të instaluar.

#### **II.2.4. Auditim mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare.**

Në zbatim të pikës 4 u audituan çështjet e mëposhtme:

Kontrata e lidhur ndërmjet palëve.

Marrja e mendimeve nga institucionet e tjera për përmbajtjen e kontratës.

Përgatitja e projekt zbatimit dhe miratimi nga AK.

Zbatimi i projektit në kryerjen e investimit të kontraktuar.

Pagesa e tarifës koncesionare.

Kryerja e shërbimit të verifikimit.

Raportimet periodike të shoqërisë koncesionare.

Burimet njerëzore dhe trajnimi i tyre.

Kalibrimi i pajisjeve laboratorike.

**Nga auditimi konstatohet që:**

#### **I. Kontrata koncesionare.**

-Pas shpalljes së fituesit, njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit me nr.12609/1 prot., datë 01.07.2019, OE N. C. me shkresën nr.12609/7 prot., datë 23.07.2019 ka dorëzuar pranë AK sigurimin e kontratës në vlerën 7,000,000 lekë (10% të vlerës së investimit) për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së koncesionit.

-Me shkresën nr.12609/4 prot., 08.07.2019 OE N. C. ka shprehur interesin për lidhjen e kontratës, duke dorëzuar dokumentacionin e ofertës në procedurën konkurruese, dokumentin

bankar për pagesën e kryer ndaj Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) në vlerën 5,000 Euro.

-Me shkresën nr.12609/6 prot., datë 17.07.2019 ish Ministri i Financave dhe Ekonomisë znj. A. D., ka autorizuar ish Sekretarin e Përgjithshëm të MFE, z. A. K., për nënshkrimin e kontratës koncesionare.

-Komisioni i dhënies me koncesion ka mbajtur procesverbalin nr.10, datë 22.07.2019 për përfundimin e draft-kontratës dhe vendosjen në dispozicion të përfaqësuesve të shoqërisë N. C., për të shprehur dakordësinë në lidhje me përmbajtjen e draftit. Përfaqësuesit kanë bërë sugjerimet e tyre, të cilat pasi janë negociuar midis tyre dhe komisionit, janë reflektuar në draftin bashkëlidhur këtij procesverbali.

Në vijim draft-kontrata do të dërgohet për mendim pranë Avokatit të Shtetit dhe Autoritetit të Konkurrencës.

-Me shkresën nr.14167 prot., datë 25.07.2019 MFE i ka përcjellë Autoritetit të Konkurrencës, draft-kontratën për dhënien e mendimit.

-Në vijim, me shkresën nr.15009 prot., datë 13.08.2019, administrohet vendimi nr.646, datë 09.08.2019 i Autoriteti të Konkurrencës. (Përmbajtja e vendimit dhe rekomandimet e dhëna dhe marrja në konsideratë tyre, janë trajtuar në akt-verifikimin e mbajtur për auditimin e pikës 2 të programit të auditimit)

-Me shkresën nr.14167/1 prot., datë 25.07.2019 MFE i ka përcjellë Avokatit të Shtetit, draft-kontratën për dhënien e mendimit.

-Në vijim, me shkresën nr.14167/4 prot., datë 14.08.2019, administrohet mendimi i Avokatit të Shtetit.

-Komisioni i dhënies me koncesion ka mbajtur procesverbalin nr.11, datë 16.08.2019 për përfundimin e draft-kontratës dhe vendosjen në dispozicion të përfaqësuesve të shoqërisë N. C., për të shprehur dakordësinë në lidhje me përmbajtjen e draftit. Gjithashtu janë negociuar sugjerimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokati i Shtetit dhe u konkludua në draftin bashkëlidhur procesverbalit.

-Me shkresën nr.14167/6 prot., datë 21.08.2019 nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K janë dërguar dokumentet: Ekstrakti i Shoqërisë Koncesionare N. I., Akt-themelimi i shoqërisë më datë 15.07.2019 dhe Statuti i shoqërisë koncesionare.

Më datë 21.08.2019, nënshkruhet Kontrata Koncesionare nr. 15326 prot datë 21.08.2019 ndërmjet MFE, koncesionarit “N. C.” dhe shoqërisë koncesionare SPV “N. I.”.

Vlera e investimit është 70,000,000 lekë.

Disa nga detyrimet e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare në zbatim të kontratës së mësipërme janë si më poshtë vijon:

-Dizenjimi i projektit brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, pra brenda datës 17.11.2019 dhe miratimi i tij brenda 15-ditëve nga AK, nga data e paraqitjes së projektit;

-Kryerjen e investimit për realizimin e projektit brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, pra brenda datës 20.05.2020;

-Kryerja e shërbimit të verifikimit jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, pra brenda datës 20.05.2020;

-Mbledhja dhe administrimi i të ardhurave nga kryerja e shërbimit;

-Pagesa brenda çdo 6-mujori të tarifës koncesionare në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara në vitin paraardhës;

-Raportimi çdo 3-mujor, për kryerjen e investimit dhe më pas për realizimin e shërbimit të verifikimit, si dhe në fund të çdo viti dorëzimi i raportit për periudhën 12-mujore të aktivitetit.

-Shërbimi i verifikimit nga Shoqëria Koncesionare N. I., ka filluar më datë 31.03.2020.

### **Nga auditimi i përmbajtjes koncesionare, u konstatua se:**

**1.** Kontrata koncesionare në përmbajtjen e saj nuk reflekton plotësisht kërkesat e përcaktuara në DST, detyrim ligjor ky për t'u zbatuar nga Autoriteti Kontraktues. Konkretisht pika 14.2 e kontratës nuk është në përputhje me pikën 1.3.1 në specifikimet teknike të vendosura në DST, pasi në kontratë frekuenca e verifikimit përcaktohet jo më pak se dy herë në vit, ndërkohë në DST përcaktohet specifikisht dhe pa hapësira, verifikimi do të kryhet dy herë në vit, pra përjashton mundësinë për më tepër verifikime.

**2.** Gjithashtu edhe pika 20.2.7 e kontratës koncesionare nuk është në përputhje me përcaktimin në DST. Konkretisht në pikën 20.2.7 përcaktohet se AK brenda **një afati 12 muaj** nga nënshkrimi i kontratës do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore..., ndërkohë në DST, pika 1.3.3, paragrafi i fundit, përcaktohet se brenda **një afati minimal** nga nënshkrimi i kontratës, do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 27 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar.

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

**3.** Kontrata koncesionare e lidhur ndërmjet AK dhe Koncesionarit "N. C." dhe Shoqërisë Koncesionare "N. I.", bie në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 22 të nenit 3 të Ligjit nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar. Konkretisht kontrata e koncesionit është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm **apo** subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë.

-Shoqëria fituese e procedurës "N. C." shpk, me NIPT L.....C, ndërkohë që kontrata është nënshkruar ndërmjet MFE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe shoqërive "N. C." shpk dhe "N. I." shpk, në cilësinë e Kontraktorit, kur shoqëria "N. I." shpk nuk ka qenë operator ekonomik pjesëmarrës apo fitues i procedurës konkurruese.

-Pra sa më sipër ligji e ka përcaktuar lidhjen e kontratës me njërin prej subjekteve jo me të dy.

-Për më tepër edhe në përmbajtjen e kontratës, është cilësuar se palët pranojnë që në përputhje me ligjin Koncesionari pra N. C. ka themeluar Shoqërinë Koncesionare. Në këto kushte kuptohet qartë se AK ka qenë në dijeni të themelimit të Shoqërisë Koncesionare dhe në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të Ligjit nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, kontrata duhej lidhur me Shoqërinë Koncesionare N. I. Sh.P.K, duke krijuar të drejta dhe detyrime vetëm për SPV, jo edhe për Koncesionarin. Në këtë mënyrë sigurohet edhe evidentimi i qartë i përgjegjësisë së subjektit në realizimin e detyrimeve kontraktore apo edhe dakortësia e SPV me përmbajtjen koncesionare. Konkretisht për ta ilustruar në nenin 3, pika 3.1 "objekti i koncesionit", në kontratën koncesionare, përcaktohet se objekti i koncesionit është kryerja nga Koncesionari (N. C.) / Shoqëria Koncesionare (N. I.) të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në rast se objekti realizohet nga Koncesionari dhe jo nga SPV, atëherë jemi përballë mosrespektimit të pikës 3.2 "Realizimi i objektit të koncesionit do të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, shtojcat e saj, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Pra legjislacioni në fuqi përcakton se kontrata lidhet me OE fitues apo SPV, si dhe në rast se është krijuar SPV, atëherë lidhet vetëm me SPV, i cili është përgjegjës për realizimin e objektit të koncesionit.

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

Në procesverbalet e mbledhjes së komisionit, konkretisht në procesverbalin nr.10, datë 22.07.2019; dhe nr.11, datë 16.08.2019, nuk pasqyrohet plotësisht puna e kryer nga komisioni, pasi në procesverbalin nr.3, komisioni shprehet se bashkëlidhur procesverbalit është draft-kontrata e negociuar, por konstatohet se nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument që lidhet me përmbajtjen e draft-kontratës apo draft-kontrata e nënshkruar nga negociuesit.

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

**4.** Kontrata koncesionare, objekti i saj, nuk është në përputhje me detyrat e caktuara shoqërisë përcaktuar me VKM nr. 365, date 20.06.2018, pasi koncesionari kërkon të realizojë sipas kontratës shërbimet e verifikimit fillestar, pasardhës (verifikim periodik të detyrueshëm, verifikim jashtë radhe me kërkesë të subjektit, verifikim pas riparimit) dhe verifikim pa tarifë jashtë frekuencës të zakonshme, duke rritur intervalet e verifikimit të instrumenteve pa pasur referim ligjor apo rekomandime nga institucione të brendshme apo ndërkombëtare, duke pasur ndikim në rritjen e shpenzimeve të subjekteve të tregtimit të hidrokarbureve me pakicë, dhe duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të produktit, dhe për rrjedhojë te konsumatori fundor. Theksojmë këtu rekomandimet e International Organization of Legal Metrology (OIML) se “Të gjitha metrologjitë duhet të unifikojnë të njëjtën tarifë dhe afate për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, gjë e cila do të lehtësonte procedurat për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë”. Tarifat e aplikueshme kanë qenë të rregulluara me një akt nënligjor bazuar në metodologji ndërkohë që në kontratë, koncesionarit i jepet e drejta e vendosjes së tarifës mbi tarifën ligjore të përdorur nga DPM duke mos përcaktuar tavan tarifor, duke u përcaktuar edhe penalitete në vlerë 0.05% për vonesa në pagesë për çdo ditë vonesë në pagesë (tarifë mbi vlerën e shërbimit).

**5.** Sipas kontratës koncesionare, monitorimi i zbatimit të kontratës do të bëhet nga autoriteti kontraktues MFE, ndërkohë që monitorimi i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar është detyrë ligjore e DPM<sup>se</sup>. Po ashtu, intervalet e verifikimit të instrumenteve matës janë përcaktuar në akte ligjore të DPM, bazuar në rekomandimet europiane, si rrjedhojë shoqëria koncesionare nuk mund të përcaktojë intervale verifikimi të instrumenteve matës.

**6.** Sipas kontratës koncesionare kompania koncesionare mund të kryejë nën-kontraktime edhe pse këtë shërbim e ka të drejtë ekskluzive për ta kryer vetëm (Koncesionari).

Po ashtu, sipas kontratës koncesionare shoqëria koncesionare nëpërmjet saj do të realizojë shërbimin e verifikimit fillestar dhe verifikimit pas riparimit, kur i Pari është shërbim që referuar direktivave europiane kryhet nga prodhuesi i instrumentit matës, duke e markuar instrumentin me markimin CE, ndërsa shërbimi i dytë, verifikimi pas riparimit i referohet ligjit “Për metrologjinë”, ku DPM nuk mund të kryejë riparimin dhe verifikimin pas riparimit të instrumentit matës pasi është në kundërshtim me ligjin e konfliktit të interesit, për analogji në të njëjtin konflikt është apo mund të jetë edhe shoqëria koncesionare.

## **II. Mbi zbatimin e kontratës koncesionare.**

-Me shkresën nr.15943 prot., datë 06.09.2019, MFE i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, që brenda 5 ditëve të përcjellë databazën me verifikimet e kryera në 12 muajt e fundit nga data e nënshkrimit të kontratës.

-Me shkresën nr.15943/1 prot., datë 13.09.2019, DPM i ka kthyer përgjigje MFE. Në këtë shkresë Drejtori i Përgjithshëm i DPM, ka theksuar faktin se DPM është institucioni i vetëm që në zbatim të ligjit kryen verifikimin e instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Gjithashtu deri më tani nuk ka një akt ligjor që të ndryshojë/shfuqizojë ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, nëpërmjet të cilit t’i hiqet kompetenca DPM për kryerjen e shërbimit të mësipërm. Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, dokumentacioni i kërkuar administrohet pranë çdo subjekti privat.

-Me shkresën nr.15326/1 prot., datë 17.09.2019 MFE ka caktuar përfaqësuesin e AK, znj A.

K., ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.

-Me shkresën nr.15326/2 prot., datë 17.09.2019 MFE i është drejtuar ISHMT dhe ATRAKO, për caktimin e përfaqësuesit që do të jetë anëtar i Njësisë së Zbatimit të Projektit (NJZP).

-Me shkresën nr.15326/3 prot., datë 19.09.2019, administrohet kthim-përgjigje nga ISHMT, ku përfaqësuesi i këtij institucioni do të jetë J. Ll.

-Me shkresën nr.15326/4 prot., datë 25.09.2019, administrohet kthim-përgjigje nga ATRAKO, ku përfaqësuesi i këtij institucioni do të jetë A. A..

-Me shkresën nr.15943/2 prot., datë 04.10.2019, MFE i rikërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, që brenda 5 ditëve të përcjellë databazën me verifikimet e kryera në 12 muajt e fundit nga data e nënshkrimit të kontratës.

-Me urdhrin nr.358, datë 08.10.2019, ish Ministri i MFE, znj. A. D., ka urdhëruar ngritjen e Njësisë së Zbatimit të Projektit, me përbërje:

S. P. – Kryetar

S. D. – Anëtar

J. Ll. – Anëtar

A. A. – Anëtar

NJZP ngarkohet me monitorimin dhe mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të kontratës së koncesionit.

-Me urdhrin nr.145, datë 02.08.2021 të ish Ministrit të MFE, znj. A. D., është bërë ndryshimi i NJZP, si vijon: S. D. largohet si anëtar dhe vendoset P. C..

-Me urdhrin nr.117, datë 13.04.2022 të ish Ministrit të MFE, znj. D. I., është bërë ndryshimi i NJZP, si vijon:

S. P. – Kryetar

P. C. – Anëtar

V. J. – Anëtar

R. B. – Anëtar

E. B. - Anëtar

E. B. – Anëtar

A. A. - Anëtar

-Me urdhrin nr.225, datë 30.09.2022 të ish Ministrit të MFE, znj. D. I., është bërë ndryshimi i NJZP, si vijon:

S. P. largohet si Kryetar dhe vendoset S. H..

-Me shkresën nr.15326/6 prot., datë 09.10.2019, Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, i është drejtuar MFE, ku thekson mosrespektimin e detyrimit kontraktor për vendosjen brenda 45 ditëve të databazës me verifikimet e kryera nga DPM.

-Me shkresën nr.15943/3 prot., datë 16.10.2019, administrohet kthim-përgjigje nga DPM, për vendosjen në dispozicion në formatin elektronik (CD) bazën e të dhënave të verifikimit për vitin 2017 dhe 2018 të instrumenteve matës që përdoren në tregtimin me pakicë të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm.

-Me shkresën nr.15943/4 prot., datë 21.10.2019, MFE i ka përcjellë Shoqërisë Koncesionare N. I., databazën me verifikimet e kryera.

-Me shkresën nr.15943/5 prot., datë 05.11.2019, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, N. I., drejtuar MFE, ku theksohen mangësitë që ka databazë në formë dhe përmbajtje të informacionit, të cilat ndikojnë negativisht në përgatitjen e projekt-zbatimit për vendosjen në funksion të shërbimit.

-Me shkresën nr.20667 prot., datë 12.11.2019, administrohet projekti i dizenuar nga Shoqëria Koncesionare N. I., paraqitur në MFE për miratim.

-Me shkresën nr.15943/6 prot., datë 13.11.2019, MFE i rikërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, të përcjellë databazën me verifikimet e përditësuara përgjatë vitit 2019.

-Me shkresën nr.15943/7 prot., datë 15.11.2019, administrohet kthim-përgjigje nga DPM, ku kërkohet takim me palët e përfshira, për tu njohur me detyrimet që ka DPM në lidhje me koncesion, mënyrën e kalimit të shërbimit të verifikimit, pasi pika 9 në nenin 8 në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, ngarkon DPM për kryerjen e këtij shërbimi; Si do veprohet me asetet dhe investimet e kryera me fondet buxhetore dhe me projektet e huaja, ku përfshihen auto laboratorët që përdoren DPM; Si do të veprohet me personelin inxhinierik të trajnuar ndër vite.

-MEMO nr., s’ka, datë 21.11.2019, përgatitur nga NJZP ku i drejtohet ish Ministrit të MFE znj. A. D. për miratimin e projektit të zbatimit, përgatitur nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K.

-Me shkresën nr.21477/1 prot., datë 17.12.2019, MFE i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare, ku shpreh dakortësinë për projekt zbatimin.

-Me shkresën nr.15943/9 prot., datë 12.12.2019, Shoqëria Koncesionare, N. I., i është drejtuar MFE, ku ritheksohen mangësitë që ka databazë në formë dhe përmbajtje të informacionit.

-Me shkresën nr.15943/10 prot., datë 12.12.2019, administrohet kthim-përgjigje nga DPM, për vendosjen në dispozicion në formatin elektronik (CD) bazën e të dhënave të verifikimit për periudhën deri më datë 01.12.2019 të instrumenteve matës që përdoren në tregtimin me pakicë të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm.

-Me shkresën nr.15943/11 prot., datë 17.12.2019, MFE i ka përcjellë Shoqërisë Koncesionare N. I., databazën me verifikimet e kryera.

-Me shkresën nr.15943/12 prot., datë 24.12.2019, Shoqëria Koncesionare, N. I., i është drejtuar MFE, ku ritheksohen mangësitë që ka databazë në formë dhe përmbajtje të informacionit për verifikimet e kryera deri më datë 01.12.2019.

-Me shkresën nr.15326/10 prot., datë 24.12.2019, Shoqëria Koncesionare, N. I., i është drejtuar MFE, ku kërkon që MFE të njoftojë subjektet e detyruara, për kalimin e shërbimit nga shteti tek privati.

-Me shkresën nr.64 prot., datë 07.01.2020, Shoqëria Koncesionare, N. I., i është drejtuar MFE, ku njofton se është e gatshme që MFE të kryejë verifikimin e investimeve të realizuara.

-Me shkresën nr.64/1 prot., datë 10.01.2020, MFE i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare, N. I., ku shprehet se më datë 14.01.2020, NJZP do të kryejë verifikimin e realizimit të investimit.

-Në vijim Shoqëria Koncesionare me shkresën nr.14 prot., datë 17.01.2020 protokolluar në MFE me shkresën nr.992, datë 17.01.2020, ka dorëzuar raportin e investimeve të realizuara dhe dokumentacionin mbështetës.

-Nga NJZP me shkresën nr.1488 prot., datë 24.01.2020 është mbajtur raporti nr.2 mbi verifikimin e investimit të kryer nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K. Në mënyrë të përmbledhur në këtë raport pasqyrohet informacioni si më poshtë vijon:

-Gjatë zhvillimit të vizitës verifikuese tek ambientet e Shoqërisë Koncesionare, u parashtruan detajet për investimet e kryera, furnitorët, dokumentacioni mbështetës që vërteton kryerjen e investimit etj. Nga NJZP u kërkua informacion në lidhje me element të veçantë të kontratës së koncesionit si: Software dhe aksesin që do të ketë AK në këtë sistem; Mënyrën se si parashikohet të faturohet shërbimi i verifikimit; Gjithashtu u kërkua dokumentacioni mbështetës që vërteton investimet e kryera.

-Në përfundim të takimit, u bë vizita pranë një autolaboratori, ku u bë shpjegimi i pajisjeve të instaluar dhe mënyrës se si do të kryhet verifikimi pranë subjekteve të detyruara.

-Me shkresën nr.1488/1 prot., datë 11.03.2020, MFE i është drejtuar Shoqërisë Koncesionare, ku shprehet se AK ka konstatuar realizimin e vlerës së investimit të kontraktuar në përputhje me elementët e përcaktuar në planin e biznesit të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese. Për sa më sipër, nga ky moment ju njoftojmë se mund të vijoni me zbatimin e mëtejshëm të kontratës sipas parashikimeve të saj.

-Me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020, MFE i është drejtuar DPM, ku i kërkon ndërprerjen e shërbimit të verifikimit, pasi nga data 31.03.2020 ky shërbim do të ofrohet nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K.

-Në dosje administrohet shkresa nr.5774/1 prot., datë 26.03.2020, në përmbajtje të së cilës është

MEMO e Drejtorit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore pranë DPM, z. F. Ç., drejtuar z. P. R., Drejtor i Përgjithshëm i DPM-së, si dhe për dijeni znj. A. D., ish Ministër i MFE dhe z. A. K. ish Sekretar i Përgjithshëm i MFE. Në këtë MEMO, pasqyrohet informacioni se DPM nuk mund të procedojë me ndërprerjen e shërbimit të verifikimit vetëm me një shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE, pasi:

Pezullimi i këtij shërbimi është në kundërshtim me Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar;

Shkakton dëm të konsiderueshëm ekonomik në buxhetin e shtetit, nga mos vjelja e tarifave për këtë shërbim;

Largim nga puna të shumë punonjësve të ngarkuar deri më tani me kryerjen e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburanteve;

Nxjerr jashtë funksionit të gjithë bazën etalonuese të përdorur për këtë shërbim, në vlerën 64 milion lekë.

-Në vijim të shkresës së mësipërme, MFE me shkresën nr.5774/2 prot., datë 02.04.2020, i është drejtuar DPM, ku i kërkon të konfirmojë nëse përmbajtja e shkresës 5774/1 prot., datë 26.03.2020, është qëndrimi zyrtar i DPM, pasi në formën që është përcjellë nuk përbën një qëndrim të rregullt zyrtar, pasi përmban stemën e këtij institucioni, por jo firmën dhe vulën zyrtare të tij.

-Me shkresën nr.9065 prot., datë 21.05.2020, administrohet urdhri nr.126, datë 21.05.2020 i ish Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, znj. A. D.. Në urdhër përcaktohet kryerja e kontrollit ligjor dhe sigurimit të regjimit automatik të instrumenteve matëse shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm me shumicë dhe pakicë.

Hartimin dhe zbatimin e procedurës së kryerjes së këtij shërbimi nga shoqëria koncesionare N. I. Sh.P.K, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

-Me shkresën nr.10438 prot., datë 05.06.2020, MFE i është drejtuar ISHMT për caktimin e 3 përfaqësuesve të institucionit, të cilët do të jenë anëtar të task forcës, së parashikuar në kontratën e koncesionit.

-Me shkresën nr.10439 prot., datë 05.06.2020, MFE i është drejtuar DPT për caktimin e 2 përfaqësuesve të institucionit, të cilët do të jenë anëtar të task forcës, së parashikuar në kontratën e koncesionit.

-Me shkresën nr.7791 prot., datë 29.04.2021, ish Ministri i MFE znj. A. D. ka nxjerrë urdhrin nr.79, datë 29.04.2021, për ngritjen e grupit të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit. Grupi ka në përbërje:

I. Z. – Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

S. P. - Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

A. L. – Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

P. C. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

S. D. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

Grupi ngarkohet të ushrojë monitorim dhe verifikim në vend të objektit të koncesionit bazuar në dokumentacionin e Shoqërisë Koncesionare.

Brenda 15 ditëve nga përfundimi i monitorimit dhe verifikimit, të hartojë raportin përmbledhës.

-Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, është njoftuar për verifikimin me shkresën nr.7791/1 prot., datë 29.04.2021

-Nëpërmjet MEMO nr.7791 prot., datë 20.05.2021, grupi i punës i është drejtuar ish Ministrit të MFE znj. A. D., për rezultatet e verifikimit, bashkëlidhur raporti i punës së kryer.

-Nga sektori i financës pranë MFE është nxjerrë dokumenti nga sistemi financiar SIFQ, ku pasqyrohet pagesa e tarifës së koncesionit me arkëtimin nr.A0682/VP100003103763. më datë 24.06.2021, në vlerën 1,609,137 lekë, pra brenda 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara.



-Me shkresën nr.7248 prot., datë 19.04.2022, ish Ministri i MFE znj. D. I. ka nxjerrë urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, për ngritjen e grupit të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit. Grupi ka në përbërje:

I. Z. – Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

P. C. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

E. B. – Specialist pranë DPM

A. A. – Specialist pranë ATRAKO

R. B. – Përgjegjës sektori pranë ISHMT

Grupi ngarkohet të ushtrojë monitorim dhe verifikim në vend të objektit të koncesionit bazuar në dokumentacionin e Shoqërisë Koncesionare, për vitin 2021.

Brenda 30 ditëve nga përfundimi i monitorimit dhe verifikimit, të hartojë raportin përmbledhës.

-Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, është njoftuar për verifikimin me shkresën nr.7248/1 prot., datë 19.04.2022

-Në vijim të sa më sipër, administrohet shkresa nr.9333 prot., datë 23.05.2022, miratimi i programit të kontrollit, më datë 23.05.2022.

-Me shkresën nr.7248 prot., datë 31.05.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

PF të audituara për vitin 2020 dhe 2021;

Vlerën totale të investimeve për vitin 2021, shoqëruar me dokumentacionin vërtetues;

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe vendore;

Procedura për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm;

Raportin e vizitës mbikëqyrëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

Certifikatat e kalibrimit për pajisjet e karburantit dhe gazit, si etalon matës, termometër, flowmetër dhe manometër;

Policat e sigurimit të përgjegjësive civile të produktit;

Polica e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë;

Praktika me institucionet shtetërore për orarin e lëvizjes së autolaboratorëve të N. I.;

Raporti vjetor 2021;

Praktika me institucionet shtetërore (ISHMT dhe MFE) për problematikat e hasura në terren.

-Me shkresën nr.7248/3 prot., datë 12.07.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve shtesë të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

Raportet e inspektimit për instrumentet matës të deklaruara jo konform;

Procedurat për shërbimin e verifikimit;

PF për vitin 2021;

Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

-Me shkresën nr.7248/4 prot., datë 08.08.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve shtesë të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

PF të vitit 2020 dhe 2021 të konfirmuara nga QKB.

-Nga sektori i financës pranë MFE është nxjerrë dokumenti nga sistemi financiar SIFQ, ku pasqyrohet pagesa e tarifës së koncesionit me arkëtimin nr.A0367/VP100003729968 më datë 29.06.2022, në vlerën 2,405,255 lekë, pra brenda 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2021.

-Nga sektori i financës pranë MFE është nxjerrë dokumenti nga sistemi financiar SIFQ, ku pasqyrohet pagesa e tarifës së koncesionit me arkëtimin nr.A0362/P230828AISMOP1 më datë 28.08.2023, në vlerën 2,403,343 lekë, pra jashtë 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

## **Nga auditimi i dokumentacionit për projekt zbatimin konstatohet se:**

**7.**Projektzbatimi nuk jep informacion mbi tarifën e verifikimit jashtë rradhe, pra ku bazohet, kostimi i saj, pasi Udhëzimi nr.2, datë 08.02.2013 “Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të DPM”, i ndryshuar.

**8.**Projektzbatimi, sa i përket software që do të instalohet me qëllim raportimin dhe monitorimin në kohë reale të shërbimit të verifikimit, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit”. Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me software, përdoruesit dhe produktet që përfitohen prej tij në varësi të përdoruesit, pasqyrohet informacioni për raportet e gjeneruara, si vijon: “Përdoruesit të cilët do kenë të drejta të shikojnë raportet apo të gjenerojnë raporte sipas disa indikatorëve, do mundën ti shkarkojnë ato në një format lehtësisht të lexueshëm apo ti përdorin në raportet e tjera duke i shkarkuar në formën e imazhit. Sistemi do ti japë këtë mundësi përdoruesit që të zgjedhë formatin në të cilin do të shkarkoj raportin. Institucionet që do kenë akses në raportet dhe kontrollet e ndërmarrja do kenë mundësi ti marrin këto informacione për ti përdorur sipas nevojës me anë të grafikëve dhe tabelave të prodhuara nga sistemi”; Ndërkohë në projektzbatimin për përdoruesin “Institucioni shtetëror”, përcaktohet: “Ka mundësinë e aksesimit për të parë raportimet për rezultatet e verifikimeve të kryera në terren”.

Pra nuk përcaktohet aspak shkarkimi i raporteve të gjeneruara, apo për më tepër të përmbajtjes së këtyre raporteve, pra jo vetëm rezultatet e verifikimit në një subjekt, por edhe problematikat që kanë dalë nga verifikimet e kryera, koha mesatare për të realizuar rekomandimet që janë dhënë dhe masat që janë ndërmarrë.

**7.**Projektzbatimi sa i përket planit të burimeve njerëzore, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”. Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me burimet njerëzore, përcaktohet se procesi i rekrutimit do të zgjasë 2 muaj, ndërkohë në projektzbatimi nuk përcaktohet asnjë afat se sa do të zgjasë.

**8.**Projektzbatimi sa i përket burimeve njerëzore, nuk përcakton aspak planin e trajnimit hyrës, ndërkohë në dokumentin e ofertës teknike “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”, përcaktohet se si do të organizohet kursi hyrës i trajnimit teoriko-praktik.

**9.**Projektzbatimi nuk jep informacion për kalibrimin e pajisjeve matëse, frekuencën e kalibrimit, laboratorin ku do të kalibrohen etj.

**10.**Projektzbatimi sa i përket shpenzimeve kapitale, nuk është në përputhje me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Plani i Zbatimit të Projektit dhe Riinvestimit”. Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me shpenzimet kapitale, parashikohet investimi i detajuar si më poshtë vijon:

<b>Investimi sipas dokumentit të ofertës teknik</b>	<b>Vlera (Lekë)</b>	<b>Investimi sipas projekt zbatimit</b>	<b>Vlera (Lekë)</b>
Pajisjet testuese, sistemet portabël	26,877,637	Pajisjet testuese	37,361,18
Autolaborator	36,181,435	Autolaborator	15,994,200
Flowmetër (matësi i fluksit)	1,476,793	Nuk jepet informacion	
		Termometër dhe kronometër	1,220,000
Sistemi online	736,397	Sistemi online	14,030,000
Pajisje zyre	2,215,190	Pajisje zyre	4,520,100
Mjet transporti për administratën	2,21,190	Mjet transporti për administratën	1,830,000
<b>Total</b>	<b>70,000,000</b>		<b>74,955,458</b>

-Pra në projektzbatim ka një tjetër vlerë për investim. Për më tepër për pajisjen floëmetër nuk jepet informacion. Gjithashtu nuk ka një shpjegim për rritje të konsiderueshme të vlerës së investimit në sistemin online, si dhe në pajisje zyre.

-Vlera e investimit sipas projektzbatimit, nuk është në përputhje edhe me modelin financiar të dorëzuar nga OE gjatë procedurës konkurruese, ku përlllogaritjet për vlerën e IRR dhe NPV janë bërë për vlerën e investimit 70,000,000 lekë. Ndryshimi i vlerës së investimit, pra rritje të saj, përkthehet në rritje të kostove të subjektit, duke ndryshuar vlerën e NPV dhe IRR. Për më

tepër që ndryshimi i vlerës së investimit krijon detyrimin për shoqërinë koncesionare që të dorëzojë modelin financiar të përditësuar<sup>40</sup>.

-Gjithashtu në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese “Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit”, makinat që do të përdoren si autolaborator, janë tipi Volksäagen Transporter Van T6 KR 2.0 TDI, 75 Kw, ndërkohë në projektzbatim, makinat që do të përdoren si autolaborator janë tipi Ford Transit Custom.

-Referuar sa më sipër, projektzbatimi nuk është në përputhje të plotë me ofertën teknike, si dhe bazuar në kontratën koncesionare, neni 8, pika 8.1, NJZP nuk duhet të kishte shprehur miratimin e projektit të zbatimit, por t’ia rikthente Shoqërisë Koncesionare N. I., për korrigjim. *Sa më sipër mbanë përgjegjësi, NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

### **Nga auditimi i dokumentacionit për investimin e kryer konstatohet se:**

**9.**Në periudhën e auditimit, në dosje nuk administrohet raporti i investimeve të realizuara, përcjellë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, me shkresën nr.14 prot., datë 17.01.2020 protokolluar në MFE me shkresën nr.992, datë 17.01.2020.

**10.**NJZP përpara kryerjes së verifikimit të investimit të realizuar nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit<sup>41</sup>.

**11.**Nuk administrohet asnjë dokumentacion mbështetës që vërteton kryerjen e investimit, duke i’u referuar edhe mbishkrimin në raportin e verifikimit të mbajtur nga NJZP, shprehimisht: “Gjithashtu u kërkua dokumentacioni mbështetës që vërteton investimet e kryera”.

*Për sa më sipër janë paraqitur dokumente shtesë (fotokopje) me observacionet e sjella nga subjekti.*

**12.**Investimi i kryer, sipas informacionit të paraqitur në raportin nr.2, datë 24.01.2020 të mbajtur nga NJZP, për verifikimin e investimit të kryer, është në vlerën 79,305,455 lekë, pra jo sa vlera e përcaktuar në nenin 15 të kontratës koncesionare, në projektzbatimin, modelin financiar dhe planin e zbatimit dhe ri-investimit. Theksojmë se realizimi i investimit jo sipas përcaktimeve të mësipërme, sjellë moszbatimin e nenit 9, pika 9.1 në kontratën koncesionare, sa i përket garancisë në vlerën 7,000,000 lekë në masën 10 % të vlerës së investimit. Theksojmë se në nenin 15 është përcaktuar që vlera e investimit do të jetë 70,000,000 lekë, pra sipas shtojcës 3 “Modeli financiar”. Në vijim në nenin 15 përcaktohet se do të lejohen ndryshime ndërmjet zërave të investimit.

-Sa më sipër NJZP nuk duhet të kishte propozuar miratimin e investimit të kryer, por të rekomandonte kryerjen e tij sipas parashikimeve kontraktuale.

**13.**Ish Ministri i MFE, znj. A. D. është informuar nëpërmjet MEMO nr.992/1 prot., datë 11.02.2020, përgatitur nga z. D. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë MFE, nëpërmjet ish Drejtorit të Kabinetit, z. R. P., për mangësitë e evidentuara në lidhje me investimin e kryer. Në këtë MEMO pasqyrohet informacioni se investimi i realizuar nuk është në përputhje me vlerën e investimit të pasqyruar në dokumentet e procedurës konkurruese “Plani i zbatimit të projektit dhe ri-investimit” dhe “Modeli financiar”. Pavarësisht se ish Ministri është njohur me mangësitë, nuk ka kërkuar korrigjimin e tyre, por përkundrazi me shkresën nr.1488/1 prot., datë 11.03.2020 ka njoftuar Shoqërinë Koncesionare N. I. Sh.P.K, mbi miratimin e investimit.

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi, NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

<sup>40</sup> Neni 1 në kontratën koncesionare, termi “Modeli financiar”, shkronja “b”.

<sup>41</sup> Shkronja “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 në nenin 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Sa më sipër nuk vërtetohet përmbushja e nenit 18 të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP, me përbërje si më poshtë vijon:*

*S. P. – Kryetar i NJZP deri më datë 30.09.2022*

*S. D. – Anëtar i NJZP deri më datë 02.08.2021*

*J. Ll. – Anëtar i NJZP deri më datë 13.04.2022*

*A. A. – Anëtar i NJZP deri më datë 31.12.2022*

*P. C. - Anëtar i NJZP nga data 02.08.2021 deri më datë 31.12.2022*

**14.** Nuk administrohet polica e sigurimit të pronës, pajisjeve, si dhe polica e përgjegjësive civile dhe e produktit, për periudhën nga data **20.09.2022** dhe në vazhdim (për policën e përgjegjësive civile dhe të produktit) dhe nga data **13.12.2022** në vazhdim, për sigurimin e pronës.

Sa më sipër nuk vërtetohet përmbushja e nenit 18 të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP, me përbërje si më poshtë vijon:*

*S. P. – Kryetar i NJZP deri më datë 30.09.2022*

*A. A. – Anëtar i NJZP deri më datë 31.12.2022*

*P. C. - Anëtar i NJZP nga data 02.08.2021 deri më datë 31.12.2022*

*V. J. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*R. B. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*E. B. - Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*E. B. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*S. H. - Kryetar i NJZP 30.09.2022 deri më datë 31.12.2022*

**15.** Konstatohet se polica e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë me nr.COM0002008/2311, datë 13.12.2021, me objekt të siguruar “Zyra”, është lëshuar për pronën me adresë: “Rruga Nikolla Tupe, ndërtesa nr.3, kati i 1, Tiranë, ndërkohë adresa e ushtrimit të aktivitetit, është me vendndodhje “Bulevardi Deshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2”, Tiranë. Pra nuk përputhet objekti i siguruar me objektin në të cilin Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, ushtron aktivitet.

Sa më sipër nuk vërtetohet përmbushja e nenit 18 të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP, me përbërje si më poshtë vijon:*

*S. P. – Kryetar i NJZP deri më datë 30.09.2022*

*A. A. – Anëtar i NJZP deri më datë 31.12.2022*

*P. C. - Anëtar i NJZP nga data 02.08.2021 deri më datë 31.12.2022*

*V. J. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*R. B. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*E. B. - Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*E. B. – Anëtar i NJZP nga data 13.04.2022 deri më datë 31.12.2022*

*S. H. - Kryetar i NJZP 30.09.2022 deri më datë 31.12.2022*

-Ministria u ka dërguar të gjithë subjektet me pakicë të hidrokarbureve, shkresën me nr. 214/1 prot, date 31.01.2020 me lëndë: “Njoftim mbi kalimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës nëpërmjet verifikimit të instrumenteve matës shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm” shoqërisë N. I. shpk, ku i detyron të gjitha subjektet të pranojnë shërbimin e verifikimit të instrumenteve matës vetëm nga ky subjekt si e drejtë ekskluzive duke bërë mbivendosje detyrash me institucionin që vazhdonte të kryente shërbimin e verifikimit të instrumenteve matës në zbatim të ligjit “Për metrologjinë”.

**Nga auditimi i dokumentacionit për raportimet periodike (3-mujore dhe vjetore) të Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, në zbatim të nenit 19 të kontratës koncesionare, rezulton se:**

**Viti 2020**

**16.**Në dosjen e zbatimit të kontratës koncesionare, konstatohet se nuk administrohet raportimi periodik për 3 mujorin:

Prill-Qershor 2020

Korrik-Shtator 2020

Tetor-Dhjetor 2020

**17.**Me shkresën nr.808, datë 18.01.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin vjetor 2020 – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

**Viti 2021**

**18.**Me shkresën nr.8052, datë 06.05.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Janar-Mars 2021. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) – Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për:

- Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle;

- Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 31.03.2021 dhe të krijuar brenda 3-mujorit të raportuar;

- Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar;

- Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi;

- Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “instrument matës jo në përdorim” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit;

- Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë 3-mujorit të raportuar;

- Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar;

- Tarifat e aplikuara, pra 629 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 336 inspektime jashtë rradhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin;

- Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik;

- Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur difekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit;

- Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer.

**19.**Në dosje nuk administrohet informacioni i përgatitur nga NJZP, mbi bazën e raportimit 3-mujor, drejtuar përfaqësuesit të AK, në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve.

Gjithashtu edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, pavarësisht faktit se është njohur<sup>42</sup> me raportin 3 mujor të mësipërm, në zbatim të shtojcës 4, nuk ka raportuar tek AK për ecurinë e zhvillimit të projektit.

*Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

*Gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi z. E. A., ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.*

---

<sup>42</sup> Kartela e praktikës shoqëruese, ku materiali i ka kaluar për trajtim Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve.

**20.** Me shkresën nr.13070, datë 21.07.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Prill-Qershor 2021, si dhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2020. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor dhe PF 2020) - Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për:

-Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle.

-Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 30.06.2021 dhe të krijuar brenda 3-mujorit të raportuar.

-Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar.

-Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi.

-Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “instrument matës jo në përdorim” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit;

-Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë 3-mujorit të raportuar.

-Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar.

-Tarifat e aplikuara pra 607 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 363 inspektime jashtë rradhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërish të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin.

-Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik.

-Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur difekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit.

-Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer.

**21.** Në dosje nuk administrohet informacioni i përgatitur nga NJZP, mbi bazën e raportimit 3-mujor, drejtuar përfaqësuesit të AK, në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve.

Gjithashtu edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, pavarësisht faktit se është njohur<sup>43</sup> me raportin 3 mujor të mësipërm, në zbatim të shtojcës 4, nuk ka raportuar tek AK për ecurinë e zhvillimit të projektit.

*Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

*Gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi z. E. A., ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.*

**22.** Me shkresën nr.18040, datë 12.10.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Korrik-Shtator 2021. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) - Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për:

-Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle;

-Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 30.09.2021 dhe të krijuar brenda 3-mujorit të raportuar;

-Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar;

-Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi;

-Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “instrument matës jo në përdorim” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit;

---

<sup>43</sup> Kartela e praktikës shoqëruese, ku materiali i ka kaluar për trajtim Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve.

- Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë 3-mujorit të raportuar;
- Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar;
- Tarifat e aplikuara pra, 270 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 383 inspektime jashtë rradhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërish të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin;
- Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik;
- Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur difekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit;
- Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer.

**23.**Në dosje nuk administrohet informacioni i përgatitur nga NJZP, mbi bazën e raportimit 3-mujor, drejtuar përfaqësuesit të AK, në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve. Gjithashtu edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, pavarësisht faktit se është njohur<sup>44</sup> me raportin 3 mujor të mësipërm, në zbatim të shtojcës 4, nuk ka raportuar tek AK për ecurinë e zhvillimit të projektit.

*Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

*Gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi z. E. A., ish Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.*

**24.**Me shkresën nr.1521, datë 27.01.2022, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Tetor-Dhjetor 2021. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

**25.**Me shkresën nr.1522, datë 27.01.2022, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin vjetor 2021 – Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për:

- Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle;
- Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 31.12.2021 dhe të krijuar brenda vitit 2021;
- Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar;
- Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi;
- Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “instrument matës jo në përdorim” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit;
- Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime;
- Të ardhurat e realizuara përgjatë vitit 2021;
- Tarifat e aplikuara pra, 1878 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 1371 inspektime jashtë rradhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërish të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin;
- Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik;
- Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur difekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit;
- Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer.

<sup>44</sup> Kartela e praktikës shoqëruese, ku materiali i ka kaluar për trajtim Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve.

## **Viti 2022**

**26.** Me shkresën nr.6839, datë 12.04.2022, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Janar-Mars 2022. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

**27.** Me shkresën nr.19035, datë 17.10.2022, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Korrik-Shtator 2022. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

**28.** Me shkresën nr.433, datë 10.01.2023, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Tetor-Dhjetor 2022. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

**29.** Me shkresën nr.2110, datë 01.02.2023, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin vjetor 2022 – Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur.

### **Nga auditimi i dokumentacionit për monitorime të kryera nga AK lidhur me zbatimin e kontratës koncesionare, rezulton se:**

-Me shkresën nr.7791 prot., datë 29.04.2021, ish Ministri i MFE znj. A. D. ka nxjerrë urdhrin nr.79, datë 29.04.2021, për ngritjen e grupit të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit. Grupi ka në përbërje:

I. Z. – Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

S. P. - Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

A. L. – Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

P. C. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

S. D. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

Grupi ngarkohet të ushtrijë monitorim dhe verifikim në vend të objektit të koncesionit bazuar në dokumentacionin e Shoqërisë Koncesionare.

Brenda 15 ditëve nga përfundimi i monitorimit dhe verifikimit, të hartojë raportin përmbledhës.

-Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, është njoftuar për verifikimin me shkresën nr.7791/1 prot., datë 29.04.2021

-Nëpërmjet MEMO nr.7791 prot., datë 20.05.2021, grupi i punës i është drejtuar ish Ministrin të MFE znj. A. D., për rezultatet e verifikimit, bashkëlidhur raporti i punës së kryer. Gjithashtu në përfundim të monitorimit, grupi i punës ka lënë 10 rekomandime ndaj Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, të cilat kryesisht lidhen me zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se:**

**30.** Ish Ministri i MFE znj. A. D. ka vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13, pikat 13.2.1 dhe 13.2.2 të kontratës koncesionare. Konkretisht në referencat ligjore, përcaktohet se AK ngre NJZP, e cila do të monitorojë zbatimin e kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K. Në periudhën në të cilën është nxjerrë urdhri i ish Ministrin të MFE, ka funksionuar NJZP me përbërje si vijon:

S. P. – Kryetar

S. D. – Anëtar

J. Ll. – Anëtar

A. A. – Anëtar

-Sa më sipër NJZP duhet të kryente monitorimin dhe Ministri i MFE nuk duhet të kishte nxjerrë urdhrë për ngritjen e një grupi tjetër monitorimi.



**31.** Grupi i monitorimit përpara kryerjes së monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit<sup>45</sup>.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i monitorimit me përbërje I. Z., S. P., A. L., P. C. dhe S. D..*

**32.** Raporti i monitorimit nuk pasqyron informacion:

-Për tarifatat e aplikuara për verifikimin fillestar, periodik dhe jashtë rradhe. Tarifatat e aplikuara për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin;

-Për trajnimet e kryera të punonjësve, pra sa trajnime janë kryer, punonjësit e trajnuar;

-Policat e sigurimit të pronës dhe përgjegjësisë civile të produktit;

-Për rekrutimet, pra punonjësit e rekrutuar dhe formimi arsimor i tyre;

-Subjektet debitorë që nuk kanë likuiduar tarifën dhe vlera debitore;

-Përse Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;

-Në çfarë gjendje teknike janë pajisjet e punës, sa prej tyre janë përdorur dhe certifikatat e kalibrimit për secilën;

-Sa është numri i kontroleve për regjimin automatik;

-Pra nuk sigurohet zbatimi i plotë i urdhrit nr. 79, datë 29.04.2021 të ish Ministrit të MFE, znj. A. D., pasi në këtë urdhër është kërkuar kryerja e monitorimit dhe verifikimit për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, të cilat i kemi cituar më sipër.

-Gjithashtu nuk jepet informacion nëse subjekti ka hartuar procedurën për kontrollin e regjimit automatik në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 21.05.2020.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i monitorimit me përbërje I. Z., S. P., A. L., P. C. dhe S. D..*

**33.** Në vijim konstatohet se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka informuar AK për realizimin e rekomandimeve të dhëna. Edhe në raportimet periodike (3-mujore) të kryera me shkresën nr.13070, datë 21.07.2021 dhe shkresën nr.18040, datë 12.10.2021, nuk pasqyrohet asnjë informacion specifik që lidhet me zbatimin e rekomandimeve.

Pra sa më sipër Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K nuk ka respektuar nenin 19, pika 19.1 dhe nenin 31, pika 31.1 të kontratës koncesionare.

▪ Me shkresën nr.7248 prot., datë 19.04.2022, ish Ministri i MFE znj. D. I. ka nxjerrë urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, për ngritjen e grupit të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit. Grupi ka në përbërje:

I. Z. – Përgjegjës sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

P. C. - Specialist sektori pranë Drejtorisë së Koncesioneve

E. B. – Specialist pranë DPM

A. A. – Specialist pranë ATRAKO

R. B. – Përgjegjës sektori pranë ISHMT

Grupi ngarkohet të ushtrojë monitorim dhe verifikim në vend të objektit të koncesionit bazuar në dokumentacionin e Shoqërisë Koncesionare, për vitin 2021.

Brenda 30 ditëve nga përfundimi i monitorimit dhe verifikimit, të hartojë raportin përmbledhës.

-Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, është njoftuar për verifikimin me shkresën nr.7248/1 prot., datë 19.04.2022

---

<sup>45</sup> Shkronja “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 në nenin 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

-Në vijim të sa më sipër, administrohet shkresa nr.9333 prot., datë 23.05.2022, miratimi i programit të kontrollit, më datë 23.05.2022.

-Me shkresën nr.7248 prot., datë 31.05.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

PF të audituara për vitin 2020 dhe 2021;

Vlerën totale të investimeve për vitin 2021, shoqëruar me dokumentacionin vërtetues;

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe vendore;

Procedura për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm;

Raportin e vizitës mbikëqyrëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

Certifikatat e kalibrimit për pajisjet e karburantit dhe gazit, si etalon matës, termometër, flowmetër dhe manometër;

Policat e sigurimit të përgjegjësive civile të produktit;

Polica e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë;

Praktika me institucionet shtetërore për orarin e lëvizjes së autolaboratorëve të N. I.;

Raporti vjetor 2021;

Praktika me institucionet shtetërore (ISHMT dhe MFE) për problematikat e hasura në terren.

-Me shkresën nr.7248/3 prot., datë 12.07.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve shtesë të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

Raportet e inspektimit për instrumentat matës të deklaruara jo konform;

Procedurat për shërbimin e verifikimit;

PF për vitin 2021;

Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

-Me shkresën nr.7248/4 prot., datë 08.08.2022, administrohet kthim-përgjigje e Shoqërisë Koncesionare, ku i drejtohet MFE për përcjelljen e dokumenteve shtesë të kërkuara nga grupi i punës, si më poshtë vijon:

PF të vitit 2020 dhe 2021 të konfirmuara nga QKB.

### **Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se:**

**34.** Ish Ministri i MFE znj. D. I. ka vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13, pikat 13.2.1 dhe 13.2.2 të kontratës koncesionare. Konkretisht në referencat ligjore, përcaktohet se AK ngre NJZP, e cila do të monitorojë zbatimin e kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K. Në periudhën në të cilën është nxjerrë urdhri i ish Ministrit të MFE, ka funksionuar NJZP me përbërje si vijon:

S. P. – Kryetar

P. C. – Anëtar

V. J. – Anëtar

R. B. – Anëtar

E. B. - Anëtar

E. B. – Anëtar

A. A. - Anëtar

-Sa më sipër NJZP duhet të kryente monitorimin dhe Ministri i MFE nuk duhet të kishte nxjerrë urdhër për ngritjen e një grupi tjetër monitorimi.

**35.** Grupi i monitorimit përpara kryerjes së monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit<sup>46</sup>.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i monitorimit me përbërje I. Z., P. C., E. B.,*

---

<sup>46</sup> Shkronja “c” në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c” në pikën 2 në nenin 4, si dhe pika 1 në nenin 7 në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**36.**Raporti i monitorimit nuk pasqyron informacion:

-Për tarifatat e aplikuara për verifikimin fillestar, periodik dhe jashtë rradhe; Tarifatat e aplikuara për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin.

-Për trajnimet e kryera të punonjësve, pra sa trajnime janë kryer, punonjësit e trajnuar;

-Për rekrutimet, pra punonjësit e rekrutuar dhe formimi arsimor i tyre;

-Subjektet debitorë që nuk kanë likuiduar tarifën dhe vlera debitore;

-Përse Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;

-Në çfarë gjendje teknike janë pajisjet e punës, sa prej tyre janë përdorur dhe certifikatat e kalibrimit për secilën;

-Sa është numri i kontrolleve për regjimin automatik;

-Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i mëparshëm i monitorimit, rekomandime të cilat lidhen me detyrime kontraktuale.

-Pra nuk sigurohet zbatimi i plotë i urdhrit nr.129, datë 19.04.2022 të ish Ministrit të MFE, znj. D. I., pasi në këtë urdhër është kërkuar kryerja e monitorimit dhe verifikimit për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, të cilat i kemi cituar më sipër.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i monitorimit me përbërje I. Z., P. C., E. B., A. A. dhe R. B..*

Sipas raportit të monitorimit, rezulton se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K ka realizuar 96,210,200 lekë të ardhura nga ofrimi i shërbimit të verifikimit dhe ka kryer pagesën e tarifës koncesionare në vlerën 2,405,255 lekë.

**37.**Në vijim konstatohet se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka informuar AK për realizimin e rekomandimeve të dhëna. Edhe në raportimin periodik (3-mujor) të kryer me shkresën nr.18040, datë 12.10.2021, nuk pasqyrohet asnjë informacion specifik që lidhet me zbatimin e rekomandimeve.

Pra sa më sipër Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K nuk ka respektuar nenin 19, pika 19.1 dhe nenin 31, pika 31.1 të kontratës koncesionare.

**Mbi kalibrimin e instrumentit “Floëmetër”, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e zbatimit, rezulton se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, ka dorëzuar për instrumentin “Flowmetër” 7 certifikata kalibrimi për 7 instrumente, si vijon:**

-Certifikata nr.38-7, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-6, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-5, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-4, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-3, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-2, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

-Certifikata nr.38-1, datë 21.10.2021 lëshuar nga Laboratori “Denev” në Bullgari;

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm, **konstatohet se** certifikata e kalibrimit për instrumentin “Flowmetër/aparat për matjen e volumit të gazit”, e lëshuar nga Laboratori Denev, në Bullgari, nuk është i lëshuar nga një laborator i akredituar për ofrimin e shërbimit të kalibrimit në këtë fushë. Për mbështetjen e këtij konstatimi, grupi i auditimit:

-Bëri verifikimin në faqen e Organizatës Europiane të Akreditimit, ku rezultoi se për shtetin e Bullgarisë, nënshkrues i marrëveshjes EA-MLA (siç është kërkuar në DST) është edhe

Agjencia “BAS”, e cila ka akredituar laboratorin Denev<sup>47</sup> në Bullgari, për disa fusha (pasqyruar në tabelën nr.1 në vijim);

-Pra sipas informacionit të pasqyruar në tabelën nr.1, në asnjë nga fushat Laboratori Denev, nuk është i akredituar për kalibrimin e instrumentit/instrumenteve për matjen e volumit të gazit, që të ketë njësi matëse Litër/minut dhe të përfshijë intervalin e caktuar prurja maksimale = 50 Litra/minut dhe Prurja minimale 5 Litra/minut.

-Për më tepër metoda referuar nga Laboratori Denev në rrjeshtin 8 të tabelës, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 16, pikën 1, në Ligjin nr.126, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë”:

Neni 16 Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse

1. Kalibrimi kryhet në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë, si EURAMET-Organizata Rajonale e Metrologjisë për Europën<sup>48</sup>, OIML-Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore<sup>49</sup>, ILAC-Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Trupave të ndryshëm (testues, inspektues, kalibrues).<sup>50</sup>

Tabela nr.1 Fushat e akredituara të laboratorit Denev në Bullgari ku mund të ofrojë shërbimin e kalibrimit.

No-Nr	Measurement instrument- Instrumenti matës	Measured quantity, measurement unit-Njësia	Range of measurement- Intervali matjes	Measurement uncertainty- Pasiguria e matjes	Calibration method- Metoda e kalibrimit	Instrumenti i kërkuar për kalibrim “Aparat për matjen e volumit të gazit, LPG”
1	2	3	4	5	6	7
1	Instruments for volume measurements	Volume, m <sup>3</sup>			MK № K-01-15	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për tanket horizontal dhe vertikal, si dhe njësi matëse është metër kub, jo litër për minut, si ajo e kërkuar, në specifikimet teknike
	Horizontal and vertical tanks, stationary and mounted on movable platforms, ëith different geometric shapes		Up (sipër) to 10 m <sup>3</sup>	0,15%	Geometric and volumetric method- metodë gjeometrike dhe volumetrike	
			From (nga) 10 m <sup>3</sup>	0,1%	MK БДС ISO 7507-1	
			To (në) 50 m <sup>3</sup>	0,1%	Tape method- metoda shirit	
			From (nga) 50 m <sup>3</sup>		MK № K-01-15	
			To (në) 50 000 m <sup>3</sup>		Geometric method- metodë gjeometrike	
					MK БДС ISO 7507-1	

<sup>47</sup> <https://www.nab-bas.bg/en/registers/laboratory-for-calibration-at-denev-d-ltd-18-lk-10625.html>

<sup>48</sup> [https://www.euramet.org/index.php?eID=tx\\_securedownloads&p=446&u=0&g=0&t=1666301856&hash=8f3c5684cdfb5596ac61d467c807a1f608a9b584&file=Media/docs/Publications/calguides/I-CAL-GUI-023\\_Calibration\\_Guide\\_No.\\_23\\_web.pdf](https://www.euramet.org/index.php?eID=tx_securedownloads&p=446&u=0&g=0&t=1666301856&hash=8f3c5684cdfb5596ac61d467c807a1f608a9b584&file=Media/docs/Publications/calguides/I-CAL-GUI-023_Calibration_Guide_No._23_web.pdf)

<sup>49</sup> <https://oiml.nim.ac.cn/sites/default/files/media/document/2020-07/r117-1-e19.pdf>

<sup>50</sup> ILAC\_G18\_04\_2010.pdf-Materiali e specifikon se si duhet të përcaktohen fushat, instrumentat për të cilat është i akredituar laboratorit që ofron shërbimin e verifikimit.

					Tape method- metoda shirit	
	Volume instruments: pipettes, automatic pipettes, dosimeters, dispensers, test tubes,burettes, laboratory glassëare	Volume, l	From (nga) 0,1 ml	from 0,008 ml	MK № MO- 06	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për pipeta, pipeta automatike, dozator, shpërndarës, tuba, byreta, qelqe laboratorike, si dhe njësia matëse është në intervalin 0.1ml – 50ml, jo 5 L – 50 L, si ajo e kërkuar në specifikimet teknike
			To (në) 50 ml	to 0,016 ml	Ëeight method- Metoda e peshës	
	Flasks, cylinders, pycnometers		From (nga) 50 ml	from 0,016 ml		<u>Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, këtu bëhet fjalë për shishe, cilindra, piknometra[1]. dhe intervalin e matjes së kërkuar, për instrumentin në specifikimet teknike</u>
			To (në) 2 000 ml	to 0,13 ml		-
	Made of metal and non-metal		From (nga) 2 l To (në) 50 l	0,03 %		
			From (nga) 1 l To (në) 2500 l	0,04%	MK № K- 05-19	Nuk përputhet me llojin e instrumentit të kërkuar, si dhe intervalin e matjes së kërkuar për instrumentin në specifikimet teknike
					Volume method- metoda e volumit	
2	Thermometers	Temperature, °C	From (nga) negative (-) 30 °C	from 0,06 °C	MK № T-01	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar,

	liquid, digital, analogue		To (në) 300 °C	to 0,12 °C	Comparative method- metoda krahasuese	termometër likuid, dixhital, analog
3	Calipers, caliper depth gauges and caliper altimeters	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,030 mm	MK № Д-04	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
			To (në) 1 000 mm	to 0,032 mm	Direct method- metoda direkte	
	- Digital;		From (nga) 0,5 mm	from 0,033 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,034 mm		
	- Vernier					
4	Micrometers ëith flat measurement surface, Micrometer depth gauges	Length, mm			MK № Д-05	Instrumenta të tjerë nga ai i kërkuar, kalibra, matës thellësie
					Direct method- metoda direkte	
	- digital		From (nga) 0,5 mm	from 0,0058 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0070 mm		
	- mechanical		From (nga) 0,5 mm	from 0,0082 mm		
			To (në) 1 000 mm	to 0,0097 mm		
5	Scale marks measures of length: -tape measures	Length, mm	From (nga) 0 mm	from 0,15 mm	MK № Д-03	E njëjta si më sipër
	-tapes		To (në) 30 000 mm	to 0,50 mm	Comparative method- metoda krahasuese	
	-Measuring lines;		From (nga) 0 mm	0,15 mm		
			To (në) 3000 mm			
	-tape measures ëith tensioning ëeight and sinker		From (nga) 0 mm	0,06 mm	MK № Д-03-01	
			To (në) 310 mm		Comparative method- metoda krahasuese	
			From (nga) 310 mm	from 0,21 mm		
			To (në) 30 000 mm	to 0,60 mm		
6	Gauge blocks	Length, mm	From (nga) 0,5 mm	from 0,22 µm	MK № Д-06	E njëjta si më sipër

			To (në) 100 mm	to 0,36 µm	Comparative contact method- Metoda krahasuese e kontaktit	
7	Vacuum and Pressure measuring instruments	Pressure,	From (nga) negative (-) 0,9 bar	from 3.10 <sup>-3</sup> bar	MK № H-01	E njëjta si më sipër
		p, bar	To (në) 35 bar	to 6.10 <sup>-3</sup> bar	Comparative method- metoda krahasuese	
8	Floë meters for ëater and liquids other than ëater	Volume, m <sup>3</sup> , volumetric floë rate, m <sup>3</sup> /h	From (nga) 0,001 m <sup>3</sup> /h	0,05%	MK № Razhod-01	Matës të rrjedhës për ujë dhe lëngje të ndryshme nga uji, pra jo për instrumentin e kërkuar, si dhe njësia e matjes dhe intervali i matjes i ndryshëm nga ai i kërkuar në specifikimet teknike.
			To (në) 150 m <sup>3</sup> /h		Comparative method- metoda krahasuese	

Burimi: Faqja zyrtare e Agjencisë “BAS” të akreditimit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim të sa më sipër, po pasqyrojmë një model (foto ilustruese) të akreditimit të 2 laboratorëve në Shtetin e Hollandës dhe Suedisë për shërbimin e kalibrimit, nënshkruar të marrëveshjes EA-MLA, ku specifikohen qartë fushat e akredituara.

K028/M16/2020  
Vaatus/Requirement  
**03.06.2020**  
14.12.2022  
www.finas.fi

Liite 1 / Appendix 1  
SFS-EN ISO/IEC 17025:2017  
Päätöksen päiväys / Date of decision  
Päätöksen viimeinen voimassaolopäivä / Date of expiry  
Voimassaoleva pätevyysalue / Current scope of accreditation

Sivu / Page 1(5)

**AKKREDITOITU KALIBROINTILABORATORIO**  
ACCREDITED CALIBRATION LABORATORY



**FINAS**  
Finnish Accreditation Service  
K028 (EN ISO/IEC 17025)

**OY INDMEAS INDUSTRIAL MEASUREMENTS AB**

Tunnus Code	Laboratorio Laboratory	Osoite Address	www WWW
K028	Oy Indmeas Industrial Measurements Ab	Tietäjantie 14 02130 ESPOO  Tietäjantie 14 FI-02130 ESPOO FINLAND	<a href="http://www.indmeas.com">www.indmeas.com</a>  <a href="http://www.indmeas.com">www.indmeas.com</a>

PÄTEVYYSALUE SCOPE OF ACCREDITATION		
Menetelmä / kohde Method / object	Mittausalue Measurement range	Laajennettu mittausepävarmuus (k=2) Expanded Uncertainty (k=2)
<b>Virtaussuureet, Kaasun ja nesteen tilavuusvirta, kenttäkalibrointi</b> <i>Fluid quantities, Gas and liquid flow rate, Calibration on-site</i>		
Virtausmittarit, kulkuakamenetelmä <i>Flow meters, transit time method</i>	-paine $p_c$ = virtaavan aineen suhteellinen paine (Gauge) ympäristöviään ilmanpaineeseen nähdän -pressure $p_c$ = pressure of the fluid given as gage pressure to atmospheric pressure	
Turbulenttinen virtaus <i>Turbulent flow</i>		
ISO 2975/VII vesi, lämmönsiirtovesi <i>water, heat transfer water</i>	5 - 750 l/s ( $p_c$ = 0-20bar, 0,1-120°C)	0,5 %
	0,5 - 5000 l/s ( $p_c$ = 0-80bar, 0,1-200°C)	0,8 %
	0,5 - 5000 kg/s ( $p_c$ = 0-80bar, 0-200°C)	0,8 %
ISO 2975/VII syöttövesi (höyrykattila) <i>feed water (boiler)</i>	0,5 - 500 kg/s ( $p_c$ = 10-300 bar, 80-500°C)	1,0 %
ISO 2975/VII jätevesi <i>waste water</i>	5 - 5000 l/s ( $p_c$ = 0-10bar, 0,1-80°C)	0,8 %
ISO 2975/VII polttonesteet <i>liquid fuels</i>		
- nestekaasu, propaani, butaani, (nestefaasi) <i>LPG; propane and butane</i>	0,5 - 500 l/s ( $p_c$ = 1-40bar, -25-60°C)	0,8 %

	butaani, (nestefaasi) <i>LPG; propane and butane (liquid phase)</i>	( $p_c$ = 1-40bar, -25-60°C)	
	- kevyet polttoöljyt; diesel, benssiini, kerosiini yms, <i>light fuel oils; diesel, gasoline, kerosene etc.</i>	0,5 - 500 l/s ( $p_c$ = 0-40bar, -25-120°C)	0,8 %
	- raskaat polttoöljyt <i>heavy (heated) fuel oils</i>	0,5 - 250 l/s ( $p_c$ = 0-40bar, 50-200°C)	1,0 %
ISO 2975/VII	alkoholiperustaiset nesteet (mm. glykoli, etanoli) <i>alcohol based liquids (glycol, ethanol)</i>	0,5 - 1000 l/s ( $p_c$ = 0-60bar, -25-160°C)	0,8 %

FINAS kuuluu European co-operation for Accreditation (EA) monenkeskiseen tunnustamissopimukseen (EA MLA).  
 FINAS is a signatory of the European co-operation for Accreditation (EA) Multilateral Agreement for accreditation.

PÄTEVYYSALUE SCOPE OF ACCREDITATION		
Menetelmä / kohde Method / object	Mittausalue Measurement range	Laajennettu mittausepävarmuus (k=2) Expanded Uncertainty (k=2)
ISO 2975/VII kloorivesi <i>chlorine water</i>	0,5 - 250 l/s ( $p_c$ = 0-20bar, 0-160°C)	1,0 %
ISO 2975/VII lipeä <i>lye</i>	0,5 - 250 l/s ( $p_c$ = 0-20bar, 0-160°C)	1,0 %
BS 5852:2.4		0,5 %



BS 5857-2.4	lye ilma, kevyet kaasut <i>air, light gases</i>	( $p_c = 0-20\text{bar}$ , $0-160^\circ\text{C}$ )	
		0,005 - 1 m <sup>3</sup> /s ( $p_c = 0-1\text{bar}$ , $0-50^\circ\text{C}$ )	0,5 %
BS 5857-2.4 ISO 16911-1	savukaasut (märkä) <i>stack gases (wet)</i>	0,005 - 50 m <sup>3</sup> /s ( $p_c = 0-10\text{bar}$ , $-25-150^\circ\text{C}$ )	0,8 %
		0,005 - 500 m <sup>3</sup> /s ( $p_c = 0-60\text{bar}$ , $-25-300^\circ\text{C}$ )	1,0 %
BS 5857-2.4 ISO 12213-1 ISO 12213-2 ISO 12213-3	Maakaasu <i>Natural Gas</i>	0,5 - 20 m/s 20 - 50 m/s	0,8 % 0,8 % + (v-20)/50 % (v=nopeus, velocity [m/s])
		1 - 500 m <sup>3</sup> /s 1 - 500 Nm <sup>3</sup> /s 0-350°C, rh 0-98 %, none condensing	1,0 % 1,0 %
	- "Pipeline Quality", "Gasum"	0,005 - 150 Nm <sup>3</sup> /s 0,004 - 110 kg/s ( $p_c = 0-80\text{bar}$ , $-10-65^\circ\text{C}$ )	0,8 % 1,4 %
		- "Wider Range"	0,005 - 150 Nm <sup>3</sup> /s 0,004 - 110 kg/s ( $p_c = 0-80\text{bar}$ , $-48-77^\circ\text{C}$ )
BS 5857-2.4	höyryt, (kuiva kyllästynyt, tulistettu) <i>steam, (dry saturated, superheated)</i>	0,003 - 250 kg/s ( $p_c = 0,1-80\text{bar}$ , $100-350^\circ\text{C}$ )	1,0 %
Turbulentisessa tai tulppavirtauksessa <i>Turbulent flow or plug flow</i> ISO 2975/VII	paperimassa <i>pulp</i>	1 - 1000 l/s ( $p_c = 0,1-50\text{bar}$ , $0-100^\circ\text{C}$ ) (sakeus, consist. 0-10%)	1,0 %

FINAS kuuluu European co-operation for Accreditation (EA) monenkeskiseen tunnustamisopimukseen (EA MLA).  
FINAS is a signatory of the European co-operation for Accreditation (EA) Multilateral Agreement for accreditation.

PÄTEVYYSALUE SCOPE OF ACCREDITATION		
Menetelmä / kohde <i>Method / object</i>	Mittausalue <i>Measurement range</i>	Laajennettu mittausepävarmuus ( $k=2$ ) <i>Expanded Uncertainty (k=2)</i>
Nesteiden virtausmittarit, laimennusmenetelmä <i>Liquid flow meters, tracer dilution method</i>  ISO 9555-1, NF X10-350-2 NF ISO 9555-2		
ISO 2975/III	jätevedet (avokanava), joet <i>wastewater (open ch.), rivers</i>	5 - 50 000 l/s  1,5 %
ISO 2975/III	vedet, putkivirtaus <i>water, pipeflow</i>	1-5 000l/s 1-5 000 kg/s ( $p_c = 0-10\text{bar}$ , $0-50^\circ\text{C}$ )
	syöttövedet ym. korkea T, p, putkivirtaus <i>feedwater &amp; high T, p, pipeflow</i>	1-500 l/s 1 - 500 kg/s ( $p_c = 0-80\text{bar}$ , $0-200^\circ\text{C}$ )
<b>Kemialliset mittaukset, kaasupitoisuus, kenttäkalibrointi</b> <i>Chemical measurements, Gas concentration, Calibration on-site</i>		
Hiiidioksidimittarit, hiidioksidin pitoisuuden määrittäminen savukaasussa kattilan hiilitaseen avulla (homogeeniset kaasumaiset ja nestemäiset polttoaineet)	savukaasu <i>stack gas</i>	0 - 100 % ( $0-350^\circ\text{C}$ )  0,5 % (lask.-algoritmi, osalta) ( <i>calc.-algorithm, part</i> )

PÄTEVYYSALUE SCOPE OF ACCREDITATION		
Menetelmä / kohde <i>Method / object</i>	Mittausalue <i>Measurement range</i>	Laajennettu mittausepävarmuus (k=2) <i>Expanded Uncertainty (k=2)</i>
boiler (homogeneous gaseous and liquid fuels) SFS- EN 12952-15: 2003		
<p>CMC on kalibrointi- ja mittauskyky, joka on saavutettavissa asiakkaan laitteille normaaleissa olosuhteissa, ja se kuvataan esittämällä mittaussuure tai referenssimateriaali, kalibrointimenetelmä, kalibroitava laite/kohde, mittausalue sekä mittausepävarmuus. Huom. Termeillä CMC (Calibration and Measurement Capability) ja BMC (Best Measurement Capability) tarkoitetaan samaa asiaa.</p> <p><i>A CMC is a calibration and measurement capability available to customers under normal conditions, and it is expressed in terms of measurand or reference material; calibration method, type of instrument/object to be calibrated, measurement range and uncertainty of measurement. Note: The meanings of terms CMC (Calibration and Measurement Capability) and BMC (Best Measurement Capability) are identical.</i></p>		

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)					
Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017					
Registration number: <b>K 127</b>					
of <b>Bronkhorst High-Tech B.V.</b> <b>Bronkhorst Calibration Centre</b>					
This annex is valid from: <b>22-04-2020</b> to <b>01-06-2022</b>			Replaces annex dated: <b>24-04-2019</b>		
<b>Location(s) where activities are performed under accreditation</b>					
<b>Head Office</b>					
Nijverheidsstraat 1A 7261 AK Ruurlo Netherland					
<b>Location</b>		<b>Abbreviation/ location code</b>			
Nijverheidsstraat 1A 7261 AK Ruurlo Netherland		RU			
<b>HCS code</b>	<b>Measured quantity, Instrument, Measure</b>	<b>Range</b>	<b>CMC<sup>1</sup></b>	<b>Remarks</b>	<b>Location</b>
FG 1 0	FLOW OF GAS				RU
FG 1 1	Gas volume flow rate	0.16 ml/min – 108 ml/min	0.55% - 0.30%	Piston Prover	

		5.4 ml/min – 33 l/min	0.30% - 0.25%	Piston Prover	
		0.11 m <sup>3</sup> /h – 409 m <sup>3</sup> /h	0.35% – 0.25%	Rotary Meter	
FG 1 1	Gas mass flow rate	0.15 ml <sub>v</sub> /min – 100 ml <sub>v</sub> /min	0.55% - 0.30%	Piston Prover	
		5.0 ml <sub>v</sub> /min – 30 l <sub>v</sub> /min	0.30% – 0.25%	Piston Prover	

This annex has been approved by the Board of the Dutch Accreditation Council, on its behalf,

J.A.W.M. de Haas

<sup>1</sup> Calibration and Measurement Capability (CMC). Demonstrated measurement uncertainty, with coverage probability of 95%, in a given measurement point or measurement range. Measurement uncertainty, *U*, is calculated according to EA-402 "Evaluation of the Uncertainty of Measurement in Calibration".

Dutch Accreditation Council RvA

Page 1 of 3

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)  
 Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017  
 Registration number: **K 127**  
 of **Bronkhorst High-Tech B.V.**  
**Bronkhorst Calibration Centre**

This annex is valid from: **22-04-2020 to 01-06-2022**

Replaces annex dated: **24-04-2019**

HCS code	Measured quantity, Instrument, Measure	Range	CMC <sup>1</sup>	Remarks	Location
		0.1 m <sup>3</sup> /h – 380 m <sup>3</sup> /h	0.35% – 0.25%	Rotary Meter	
FL 1 0	FLOW OF LIQUIDS				RU
FL 1 1	Liquid mass flow rate	(1 – 2) g/h	0.65%	Balance	
		(2 – 10) g/h	0.35%	Balance	
		(0.01 – 30) kg/h	0.10%	Balance	
PV 0 0	PRESSURE AND VACUUM				RU
PV 1 1	Absolute gas pressure	(2.5 – 3500) kPa	5 · 10 <sup>-4</sup> p + 80 Pa	Pressure Calibrator	
		(0.1 – 41.5) MPa	5 · 10 <sup>-4</sup> p + 1.4 kPa	Pressure Calibrator	

		(0.1 – 41.5) MPa	$5 \cdot 10^{-4} p + 1.4 \text{ kPa}$	Pressure Calibrator
PV 1 2	Over atmospheric gas pressure	(-97.5 – 3400) kPa	$5 \cdot 10^{-4} p_e + 80 \text{ Pa}$	Pressure Calibrator
		(0 – 41.4) MPa	$5 \cdot 10^{-4} p_e + 1.4 \text{ kPa}$	Pressure Calibrator

**Remarks:**

The ambient temperature and humidity during calibration is:  $21 \text{ }^\circ\text{C} \pm 2 \text{ }^\circ\text{C}$  and  $50 \text{ \%rh} \pm 20 \text{ \%rh}$  resp.

**Calibration gases:**

For Piston prover: Compressed dry Air, Ar, N<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub>, H<sub>2</sub> or He, other gases on request  
 For Rotary meter: Compressed dry Air only

The flow units ml/min and l<sub>n</sub>/min refer to gases under normal (n) conditions of 273.15 K and 101325 Pa.

Fixed normal densities  $\rho_n$  [kg/m<sup>3</sup>] are used to convert from the flow unit [l<sub>n</sub>/min] to the mass flow unit [g/h], using the equation:

$$\Phi_n \left[ \frac{\text{g}}{\text{h}} \right] = \Phi_n \left[ \frac{\text{l}_n}{\text{min}} \right] \cdot \rho_n \left[ \frac{\text{kg}}{\text{m}^3} \right] \cdot 60$$

For example:

Annex to declaration of accreditation (scope of accreditation)

Normative document: EN ISO/IEC 17025:2017

Registration number: **K 127**

of **Bronkhorst High-Tech B.V.**  
**Bronkhorst Calibration Centre**

This annex is valid from: **22-04-2020** to **01-06-2022**

Replaces annex dated: **24-04-2019**

Gas	Normal density [kg/m <sup>3</sup> ]	Equivalent [g/h] to 1 [l <sub>n</sub> /min]:
Compressed dry air (AIR)	1.293	77.58
Argon (Ar)	1.784	107.0
Nitrogen (N <sub>2</sub> )	1.250	75.02
Carbon dioxide (CO <sub>2</sub> )	1.977	118.6
Hydrogen (H <sub>2</sub> )	0.08991	5.395
Helium (He)	0.1785	10.71

This way, any flow of any gas in [l<sub>n</sub>/min] can be converted into mass flow in [g/h].

-Gjithashtu nuk administrohen certifikatat e kalibrimit për:

-4 termometra. Duke i'u referuar projektzbatimit, Shoqëria Koncesionare ka vendosur blerjen e 11 termometrave, ndërkohë që administrohen certifikata kalibrimi për 7 termometra.

-4 sisteme matëse të karburantit. Duke i'u referuar projektzbatimit, Shoqëria Koncesionare ka vendosur blerjen e 11 sistemeve matëse, me qëllim që të ketë edhe sisteme rezervë në rast defekti, ndërkohë që administrohen certifikata kalibrimi për 6 sisteme.

**38.** Pra sa më sipër, subjekti është në kushtet e mos-përmbushjes së nenit 4, pika 4.2, shkronja “a”, nenit 8, pika 8.2.2, nenit 21, pika 21.2.1, shkronja “b” dhe pika 21.2.2, shkronja “u” në kontratën koncesionare.

-Situatë e mësipërme tregon se grupi i monitorimit ngritur me urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, por edhe NJZP nuk kanë kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm.

Sa më sipër mbajnë përgjegjës, I. Z., P. C., E. B., A. A., R. B., S. P., V. J., E. B..

## **Nga auditimi i dokumentacionit mbi pagesën e tarifës koncesionare dhe arkëtimin e tarifës së shërbimit të verifikimit, rezultoi se:**

Tarifat e shërbimit të verifikimit janë përcaktuar me Udhëzimin e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) dhe Ministrisë së Financave (MF), nr.2, datë 08.02.2013 “Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të DPM”, i ndryshuar. Në përfundim të shërbimit nga subjekti ofrues i shërbimit lëshohet fatura tatimore, të cilës i shtohet edhe vlera e TVSH.

Për kryerjen e pagesës së tarifës koncesionare, ndërmjet palëve është vendosur se brenda 6-mujorit të vitit kalendarik, do të paguhet tarifa për vitin paraardhës. Pra subjekti depoziton pranë MFE, pasqyrat financiare të audituara dhe në vijim nga MFE pritet fatura për arkëtim, vlera të cilës është 2.5% e të ardhurave operative pa TVSH. Shoqëria Koncesionare me marrjen e faturës, paraqitet në një nga bankat e nivelit të dytë dhe kryen pagesën. Pagesa e kryer konfirmohet edhe në sistemin e thesarit SIFQ.

Sa më sipër, në dosjen e zbatimit të kontratës, administrohen pasqyrat financiare për vitin 2020, 2021 dhe për vitin 2022, grupi i auditimit i ka marrë ato nëpërmjet shkarkimit nga ekstrakti i regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K., në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Gjithashtu nga sektori i financës pranë MFE është nxjerrë ekstrakti nga sistemi financiar SIFQ ku pasqyrohet pagesa e tarifës së koncesionit me dokumentin nr:

- A0682/VP100003103763, më datë 24.06.2021, në vlerën 1,609,137 lekë, pra brenda 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2020;
- A0367/VP100003729968 më datë 29.06.2022, në vlerën 2,405,255 lekë, pra brenda 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2021;
- A0362/P230828AISMOP1 më datë 28.08.2023, në vlerën 2,403,343 lekë, pra jashtë 6 mujorit dhe në masën 2.5% të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022;

Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyrës së performancës financiare, llogaria ekonomike “Të ardhura operative”, rezulton se Shoqëria Koncesionare N. I., për vitin 2020 ka realizuar të ardhura në vlerën 64,365,500 lekë, pra tarifa koncesionare për t’u paguar është 2.5% të 64,365,500 lekë = 1,609,137 lekë;

për vitin 2021 ka realizuar të ardhura në vlerën 96,210,200 lekë, pra tarifa koncesionare për t’u paguar është 2.5% të 96,210,200 lekë = 2,405,255 lekë;

për vitin 2022 ka realizuar të ardhura në vlerën 96,133,700 lekë, pra tarifa koncesionare për t’u paguar është 2.5% të 96,133,700 lekë = 2,403,343 lekë.

-Me qëllim vlerësimin nëse përputhen të dhënat mbi vlerën e të ardhurave të realizuara dhe të raportuara në PF, me të ardhurat që duhet të realizojë Shoqëria Koncesionare, duke pasur në konsideratë tarifat e miratuara, llojin e verifikimeve të kryera, si dhe **3 variantet** në varësi të numrit të pistoletave në një stacion karburanti, grupi i auditimit bëri përlllogaritjet për vitin 2021<sup>51</sup>, pra u testuan të dhënat ndërmjet dy dokumenteve, konkretisht:

### **Për verifikimin fillestar, tarifa është sa dyfishi i tarifës së verifikimit periodik, pra:**

Deri në 6 instrumente tarifa e verifikimit është 6,000 lekë pa TVSH, ose 12,000 lekë pa TVSH për verifikimin fillestar.

Nga 7 deri në 12 instrumente tarifa e verifikimit është 5,900 lekë pa TVSH, ose 11,800 lekë pa TVSH për verifikimin fillestar.

Mbi 12 instrumente tarifa e verifikimit është 5,500 lekë pa TVSH, ose 11,000 lekë pa TVSH për verifikimin fillestar.

### **Sa më sipër, sipas 3 varianteve kemi:**

1234 verifikime fillestare kaluese \* 12,000 lekë = 14,808,000 lekë

<sup>51</sup> Pasi vetwm pwr kwtw vit kemi tw dhwna mbi numrin dhe llojin e verifikimeve totale.

1234 verifikime fillestare kaluese \* 11,800 lekë = 14,561,200 lekë

1234 verifikime fillestare kaluese \* 11,000 lekë = 13,574,000 lekë

**Për verifikimin fillestar, kur instrumenti ngel, tarifa është sa ½ e tarifës së verifikimit periodik, pra:**

644 verifikime fillestare ngelëse \* 6,000 lekë = 3,864,000

644 verifikime fillestare ngelëse \* 5,900 lekë = 3,799,600

644 verifikime fillestare ngelëse \* 5,500 lekë = 3,542,000

**I. Pra për 3 variante, për verifikimet fillestare kemi:**

18,672,000 lekë

18,360,800 lekë

17,116,000 lekë

**Për verifikimin jashtë rradhe (verifikimi jashtë rradhe është pjesë e verifikimit pasardhës/periodik), tarifa është e njëjtë me atë të verifikimit periodik, pra:**

Deri në 6 instrumente tarifa e verifikimit është 6,000 lekë

Nga 7 deri në 12 instrumente tarifa e verifikimit është 5,900 lekë

Mbi 12 instrumente tarifa e verifikimit është 5,500 lekë

**Sa më sipër, sipas 3 varianteve kemi:**

1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 6,000 lekë = 7,428,000 lekë

1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 5,900 lekë = 7,304,200 lekë

1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 5,500 lekë = 6,809,000 lekë

**Për verifikimin jashtë rradhe, kur instrumenti ngel, tarifa është sa ½ e tarifës së verifikimit periodik, pra:**

133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 3,000 lekë = 399,000 lekë

133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 2,950 lekë = 392,350 lekë

133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 2,750 lekë = 365,750 lekë

**II.Pra për 3 variante, për verifikimet jashtë rradhe kemi:**

7,827,000 lekë

7,696,550 lekë

7,174,750 lekë

**Për verifikimin periodik, tarifa është:**

Deri në 6 instrumente tarifa e verifikimit është 6,000 lekë

Nga 7 deri në 12 instruente tarifa e verifikimit është 5,900 lekë

Mbi 12 instrumente tarifa e verifikimit është 5,500 lekë

**Sa më sipër, sipas 3 varianteve kemi:**

13044 verifikime periodike kaluese \* 6,000 lekë = 78,264,000 lekë

13044 verifikime periodike kaluese \* 5,900 lekë = 76,959,600 lekë

13044 verifikime periodike kaluese \* 5,500 lekë = 71,742,000 lekë

**Për verifikimin periodik, kur instrumenti ngel, tarifa është sa ½ e tarifës së verifikimit periodik, pra:**

5224 verifikime fillestare ngelëse \* 3,000 lekë = 15,672,000

5224 verifikime fillestare ngelëse \* 2,950 lekë = 15,410,800

5224 verifikime fillestare ngelëse \* 2,750 lekë = 14,366,000

**III.Pra për 3 variante, për verifikimet periodike kemi**

93,936,000 lekë
92,370,400 lekë
86,108,000 lekë

**IV. Për totalin, ku përfshihen të 3 llojet e verifikimeve (fillestar, jashtë rradhe, periodik), kemi:**

- 120,435,000 lekë, e cila është rrjedhojë e veprimeve si vijon [(1234 verifikime fillestare kaluese \* 12,000 lekë) + (644 verifikime fillestare ngelëse \* 6,000 lekë) + (1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 6,000 lekë) + (133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 3,000 lekë) + (13044 verifikime periodike kaluese \* 6,000) lekë + (5224 verifikime fillestare ngelëse \* 3,000 lekë)]
- 118,427,750 lekë, e cila është rrjedhojë e veprimeve si vijon [(1234 verifikime fillestare kaluese \* 11,800 lekë) + (644 verifikime fillestare ngelëse \* 5,900 lekë) + (1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 5,900 lekë) + (133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 2,950 lekë) + (13044 verifikime periodike kaluese \* 5,900 lekë) + (5224 verifikime fillestare ngelëse \* 2,950 lekë)]
- 110,399,350 lekë, e cila është rrjedhojë e veprimeve si vijon [(1234 verifikime fillestare kaluese \* 11,000 lekë) + (644 verifikime fillestare ngelëse \* 5,500 lekë) + (1238 verifikime jashtë rradhe kaluese \* 5,500 lekë) + (133 verifikime jashtë rradhe ngelëse \* 2,750 lekë) + (13044 verifikime periodike kaluese \* 5,500 lekë) + (5224 verifikime fillestare ngelëse \* 2,750 lekë)]

Sa më sipër në 3 variantet, në krahasim me të ardhurat e realizuara, krijohen diferencat si më poshtë:

120,435,000 lekë - 96,210,200 lekë = 24,224,800 lekë \* 2.5% = 605,620 lekë më pak

118,427,750 lekë - 96,210,200 lekë = 22,217,550 lekë \* 2.5% = 555,438 lekë më pak

110,399,350 lekë - 96,210,200 lekë = 14,189,150 lekë \* 2.5% = 354,728 lekë më pak

**39.** Pra edhe në rastin kur tarifet janë minimale<sup>52</sup>, pra sikur të gjithë stacionet e karburantit kanë më tepër se 12 pistoleta dhe tarifet që aplikohen janë:

-11,000 lekë (verifikime fillestare kaluese);

-5,500 lekë (verifikime fillestare ngelëse, verifikime jashtë rradhe kaluese dhe verifikime periodike);

-2,750 lekë (verifikime jashtë rradhe ngelëse dhe verifikime periodike ngelëse);

Krijohet diferencë në të ardhurat e realizuara, e cila sjellë impakt mbi tarifën koncesionare me 354,728 lekë më pak, TVSH në vlerën 2,837,830 lekë më pak dhe tatim mbi fitimin 1,785,944 lekë më pak.

-Situata e mësipërme tregon se nga grupi i monitorimit të ngritur me urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, nuk ka kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit financiar.

-Gjithashtu kjo situatë tregon se edhe NJZP nuk ka kryer monitorimin e dokumentacionit përkatës, me qëllim kryerjen e përllogaritjeve dhe vlerësimin e të ardhurave që duhet të kishte realizuar Shoqëria Koncesionare Sh.P.K, mbi të cilat përllogaritet tarifa koncesionare.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjës, I. Z., P. C., E. B., A. A., R. B., S. P., V. J., E. B..*

Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyra e pozicionit financiar, llogaria ekonomike të drejta të arkëtueshme, e cila përfaqëson subjektet që nuk kanë paguar tarifën e shërbimit të verifikimit/debitorët ndaj Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, rezulton se në fund të vitit:

2020 debitorët janë në vlerën 16,585,840 lekë;

2021 debitorët janë në vlerën 14,913,125 lekë;

<sup>52</sup> Nuk aplikohen tarifa mw poshtw se tarifet minimale.

2022 debitorët janë në vlerën 11,032,330 lekë;

Pavarsisht faktit se vlerat e mësipërme, bazuar në SKK janë njohur si të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, ato tregojnë se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka zbatuar nenin 14, pika 14.4 të kontratës koncesionare. Sipas referencës ligjore, Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K është përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave që vijnë nga kryerja e shërbimit të verifikimit. Çdo faturë e lëshuar për shërbimin e kryer përbën titull ekzekutiv.

Për ta ilustruar me raste konkrete, pasqyrojmë disa prej subjekteve, të cilët nuk kanë kryer pagesën e faturës përkatëse, si më poshtë vijon:

	Subjekti	Total
1	I. K.	14,400
2	B.	28,800
3	XH.G O.	28,800
4	K. O.	43,200
5	T. & F. sh.p.k	14,400
6	K. O.sh.p.k	57,600
7	L. O. sh.p.k	72,000
8	S. A.	75,360
9	A.	14,400
10	A. B.	10,800
11	A.	14,400
12	B. & A.	18,000
13	E. sh.p.k	28,800
14	GJ.S o. sh.p.k	28,800
15	G. A.	7,200
16	H. sh.p.k	46,800
17	K. K.	3,600
18	M. 2017	18,000
19	Sh. K.	21,600
20	Sh. P.	21,600
21	S.	32,400
22	2N-Sh. P.	7,200
23	A.S.R O.	43,200
24	A-F O.	43,200
25	A. B.	50,400
26	A. O.	50,400
27	A.	28,800
28	B. O.	50,400
29	C. O.	7,200
30	C. O.	39,600
31	D. O.	43,200
32	E.	28,800
33	E. S.	36,000
34	G,j,s O.	28,800
35	J.	50,400
36	K.-M.	43,200
37	K.	90,000
38	L. O.	43,200
39	L.	28,800
40	L.	18,000
41	M.	14,400
42	N. O.	43,200
43	O. B.	21,600
44	O. O.	39,600
45	P. O.	18,000
46	P. G. O.	36,000
47	R. G	21,600
48	Sh. 07	14,400
49	Sh.	32,400
50	S.	28,800
51	S. L	39,600
52	S.	43,200
53	S.	43,200
54	S. O.	54,000
55	T.O.	25,200



56	V. O.	50,400
57	V. & V.-G	71,520
58	Xh. O.	21,600
59	X. O.	3,600
60	Z.	43,200
		1,997,280

**40.** Sa më sipër konstatohet moszbatimi i kontratës në 60 raste. Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, në kushtet kur fatura që lëshon është titull ekzekutiv, duhet të kishte bërë kërkesë padi në gjykatë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nëpërmjet të cilit të ngarkoheshe shërbimi përmbartimor për ekzekutimin me forcë të detyrimeve. Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, pra moszbatimi i kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, po nga ky subjekt nuk është kryer shërbimi i verifikimit ndaj subjekteve të mësipërme, me pretendimin se nuk kanë paguar tarifën dhe në këto kushte nuk i ofrohet verifikimi<sup>53</sup>.

**41.** Nga subjektet e mësipërme u verifikuan 7 prej tyre, ku u konstatua se për 46 pistoleta nuk është respektuar afati i verifikimit fillestar, periodik, apo edhe pistoleta të cilat për një periudhë për më tepër se 1 vit (deri më 31.12.2022) nuk janë verifikuar. (Ku theksojmë se në këto verifikime, për pistoleta të ndryshme gaz, naftë dhe benzinë, kanë ngelur nga verifikimi i kryer. Pra për një periudhë rreth 1 vit, këto pistoleta kanë punuar jashtë kërkesave të metrologjisë ligjore, duke cenuar qëllimin e Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, mbrojtjen e konsumatorëve, pasi nuk është siguruar saktësia e rezultatit të matjes).

Pasqyruar në formë tabelare si më poshtë:

---

<sup>53</sup> Për ilustrim shkresa nr.6097 Prot., date 02.04.2021, ku Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, i është drejtuar MFE dhe ISHMT. Në këtë shkresë Shoqëria Koncesionare, shprehet se në këto subjekte është penguar kryerja e verifikimit nëpërmjet mospagesës së tarifës koncesionare.

A. Sh.P.K																
Verifikimi																
Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati	Periodik	Rezultati	Periodik	Rezultati	Periodik
17.04.20	Ngel me dëshirë															
17.04.20	Ngel me dëshirë															
17.04.20	Ngel me dëshirë															
17.04.20	Ngel me dëshirë															
1	17.04.20	Kalon			13.11.20	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit			14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
2	17.04.20	Kalon			13.11.20	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit			14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
1	15.05.20	Ngel me dëshirë			13.11.20	Ngel me dëshirë				14.5.21	Ngel me dëshirë	11.11.21	Ngel me dëshirë	11.5.22	Ngel me dëshirë	
1	15.05.20	Ngel me dëshirë			13.11.20	Ngel me dëshirë				14.5.21	Ngel me dëshirë	11.11.21	Ngel me dëshirë	11.5.22	Ngel me dëshirë	
2	15.05.20	Kalon			13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
2	15.05.20	Kalon			13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
A3	15.05.20	Kalon			13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
3	15.05.20	Kalon			13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	
1	15.05.20	Ngel me dëshirë			13.11.20	Ngel me dëshirë				14.5.21	Ngel me dëshirë	11.11.21	Ngel me dëshirë	11.5.22	Kalon	
2	15.05.20	Kalon			13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	

3	15.05.20	Kalon				13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
1	15.05.20	Ngel me dëshirë				13.11.20	Ngel me dëshirë				14.5.21	Ngel me dëshirë	11.11.21	Ngel me dëshirë	11.5.22	Ngel me dëshirë
2	15.05.20	Kalon				13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
3	15.05.20	Kalon				13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
1	17.04.20	Ngel me dëshirë														
2	17.04.20	Ngel me dëshirë														
3	17.04.20	Ngel me dëshirë														
1	17.04.20	Ngel me dëshirë														
2	17.04.20	Ngel me dëshirë														
3	17.04.20	Ngel me dëshirë														
	27.08.20	Kalon				19.02.21	Kalon				17.8.21	Kalon	15.2.22	Kalon	17.8.22	Kalon
	27.08.20	Ngel		04.09.20	Kalon	19.02.21	Kalon				17.8.21	Kalon	15.2.22	Kalon	17.8.22	Kalon
	27.08.20	Kalon				19.02.21	Kalon				17.8.21	Kalon	15.2.22	Kalon	17.8.22	Kalon
	27.08.20	Kalon				19.02.21	Kalon				17.8.21	Kalon	15.2.22	Kalon	17.8.22	Kalon
	19.07.22	Kalon				08.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								

	19.07.22	Kalon				08.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								
	19.07.22	Kalon				08.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								
	19.07.22	Kalon				08.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								
1-	22.12.22	Kalon														
1-	22.12.22	Kalon														
1-	22.12.22	Kalon														
1-	22.12.22	Kalon														
	17.04.20	Ngel me dëshirë														
	17.04.20	Ngel me dëshirë														
3	15.5.20	Kalon				13.11.20	Ngel me dëshirë				14.5.21	Ngel me dëshirë	11.11.21	Ngel me dëshirë	11.5.22	Ngel me dëshirë
4	18.5.20	Ngel		20.05.20	Kalon	13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon

4	18.5.20	Kalon				13.11.20	Ngel		13.11.20	Kalon	14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
4	15.5.20	Kalon				13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
4	15.5.20	Ngel		20.05.20	Kalon	13.11.20	Kalon				14.5.21	Kalon	11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon
4	17.04.20	Ngel me dëshirë														
22	17.04.20	Ngel me dëshirë														
	27.08.20	Ngel		04.09.20	Kalon	19.02.21	Kalon				17.08.21	Kalon	15.2.21	Kalon	17.8.22	Kalon
	27.08.20	Ngel		04.09.20	Kalon	19.02.21	Kalon				17.08.21	Kalon	15.2.21	Kalon	17.8.22	Kalon
	19.07.22	Kalon				8.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								
	19.07.22	Kalon				8.11.22	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit								
1-	22.12.22	Kalon														
1-	22.12.22	Kalon														

13.11.20	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 09.05.2019			14.5.21	Kalon				11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	8.11.22	Kalon
13.11.20	Ngel	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 09.05.2019 dhe 27.11.2019	13.11.20	Kalon	14.5.21	Kalon				11.11.21	Kalon	11.5.22	Kalon	8.11.22	Kalon

	Subjekti	A. B.						
<b>Pistoleta</b>		<b>Verifikimi</b>						
Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati
Naftë	51076/B3	19.10.20	Ngel	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 25.11.2019	19.10.20	Kalon	Nuk është kryer verifikim	
	51076/B2	19.10.20	Ngel me dëshirë					
	51076/A3	19.10.20	Ngel me dëshirë					
	51076/A2	19.10.20	Ngel me dëshirë					
	51076/A1	19.10.20	Ngel me dëshirë					

	<b>Subjekti</b>	<b>B. &amp; A.</b>						
<b>Pistoleta</b>		<b>Verifikimi</b>						
Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati
Naftë	275523-A1	10.06.20	Ngel	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 25.11.2019	02.07.20	Kalon	Nuk është kryer verifikim	
	275523-A2	10.06.20	Ngel me dëshirë					
	275523-B2	10.06.20	Ngel me dëshirë					
	275523-B1					02.07.20	Kalon	Nuk pasqyrohet arsye përse për këtë pistoletë, verifikimi është jashtë rradhe dhe jo periodik/fillestar. Nuk është kryer verifikim në vijm

	<b>Subjekti</b>	<b>Eurostation</b>						
<b>Pistoleta</b>		<b>Verifikimi</b>						
Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati
Naftë	3185-108554/C2	08.06.20	Kalon	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 28.06.2019			Nuk është kryer verifikim	
	3185-108554/C1	08.06.20	Kalon				Nuk është kryer verifikim	
	3185-108554/A1	08.06.20	Ngel me dëshirë					
	3185-108554/A2	08.06.20	Ngel me dëshirë					
Benzin	3185-108554/B2	08.06.20	Kalon				Nuk është kryer verifikim	
	3185-108554/B1	08.06.20	Kalon				Nuk është kryer verifikim	

	<b>Subjekti</b>	<b>G.J.S O.</b>
--	-----------------	-----------------

<b>Pistoleta</b>		<b>Verifikimi</b>						
Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati
Naftë	4306- 114442/B2	07.07.20	Kalon					Nuk është kryer verifikim
	4306- 114442/B1	07.07.20	Kalon					Nuk është kryer verifikim
	3185- 108554/A1	08.06.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 113685/B1	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 113685/B2	07.07.20	Ngel me dëshirë					
Benzin	4306- 114442/A1	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 114442/C1	07.07.20	Kalon					Nuk është kryer verifikim
	4306- 114442/A2	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 114442/C2	07.07.20	Kalon					Nuk është kryer verifikim
	4306- 113685/A1	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 113685/C1	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 113685/A2	07.07.20	Ngel me dëshirë					
	4306- 113685/C2	07.07.20	Ngel me dëshirë					

<b>Pistoleta</b>	<b>Subjekti</b>	<b>K. K.</b>						
		<b>Verifikimi</b>						



Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati
Naftë	8580/A1	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	8580/A2	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	8580/B1	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	8580/B2	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	A1228/A1	28.04.20	Ngel		05.05.20	Kalon				Nuk është kryer verifikim
	A1228/B1				05.05.20	Ngel	09.06.20	Kalon		Nuk është kryer verifikim
Benzin	8580/C1	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	8580/C2	28.04.20	Ngel me dëshirë							
	A1228/A2	05.05.20	Kalon							Nuk është kryer verifikim
	A1228/B2	05.05.20	Kalon							Nuk është kryer verifikim

	Subjekti	M.											
Pistolet a		Verifikimi											
Lloji	Kodi	Fillestar	Rezultati	Koment	Jashtë rradhe	Rezultati	Jashtë rradhe	Rezultati	Periodik	Rezultati	Periodi k	Rezultati	
Naftë	290854/B2	08.05.20	Ngel me dëshirë	Nuk është rrespektuar afati i verifikimit, sipas DPM për herë të fundit është verifikuar më datë 31.10.2019									
	290854/A2				10.06.2020	Kalon			10.12.20	Kalon		Nuk është kryer verifikim	
	8580/B1	28.04.20	Ngel me dëshirë										
	8580/B2	28.04.20	Ngel me dëshirë										

Benzin	290854/A3	08.05.20	Ngel	10.06.2020	Kalon			10.12.20	Kalon	Nuk është kryer verifikim	
	290854/A1	08.05.20	Ngel me dëshirë								
	290854/B1	08.05.20	Ngel me dëshirë								
	290854/B3	08.05.20	Ngel me dëshirë								

Gjithashtu, mangësi të konstatuara në respektimin e afatit të verifikimit metrologjik, janë konstatuar edhe 6 subjekte të tjera, si më poshtë vijon:

-P. O., Mat, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 04.11.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se deri më datë 31.12.2022, pranë këtij subjekti nuk është kryer asnjë verifikim.

-L. Dh., Mat, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 02.09.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se është verifikuar më datë 21.09.2020. Gjithashtu konstatohet se verifikimi i fundit pranë këtij subjekti është kryer më datë 02.03.2022 dhe pas kësaj date (pra pas 6 muajsh) nuk është kryer verifikim.

-A. P. P., Malësi e Madhe, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 13.09.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se është verifikuar më datë 18.11.2020 (Ku theksojmë se në këtë verifikim 2 pistoleta benzinë, 1 pistoletë gaz kanë ngelur nga verifikimi i kryer. Pra për një periudhe nga data 01.04.2020 deri më datë 18.11.2020, pra 7 muaj e 18 ditë, këto pistoleta kanë punuar jashtë kërkesave të metrologjisë ligjore, duke cenuar qëllimin e Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, mbrojtjen e konsumatorëve, pasi nuk është siguruar saktësia e rezultatit të matjes)

-A., Shkodër, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 06.08.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se është verifikuar më datë 30.04.2021.

-I. Sh.P.K, Shkodër, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 28.10.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se është verifikuar më datë 13.07.2020 (Ku theksojmë se në këtë verifikim 2 pistoleta naftë dhe benzinë, kanë ngelur nga verifikimi i kryer. Pra për një periudhe nga data 29.05.2020 deri më datë 13.07.2020, pra rreth 1 muaj 12 ditë, këto pistoleta kanë punuar jashtë kërkesave të metrologjisë ligjore, duke cenuar qëllimin e Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, mbrojtjen e konsumatorëve, pasi nuk është siguruar saktësia e rezultatit të matjes). Gjithashtu konstatohet se verifikimi jashtë rradhe pranë këtij subjekti, për pistoletat që kanë ngelur në verifikimin e mëparshëm, është kryer më datë 26.10.2020, pra jashtë afatit.

Konkretisht më datë 13.07.2020 pistoletat janë bllokuar si rrjedhojë e rezultatit jo konform.

Shtojmë 30 ditë (afati maksimal që instrumenti mund të qëndrojë në kushte të tilla) dhe më datë 14.08.2020, subjekti duhet të bëjë riparimin e pistoletave.

Shtojmë dhe 30 ditë (afati maksimal që instrumenti mund të qëndrojë i paverifikuar pas riparimit) dhe në datë 19.09.2020, është detyrimi që të kryhet verifikimi jashtë rradhe, ndërkohë në këtë subjekt, verifikimi është kryer rreth 1 muaj më vonë. Pra në rastin e mësipërm kemi marrë afatet maksimale, por riparimi mund të jetë bërë edhe më shpejtë në kohë.

-B. M., Shkodër, kryer verifikimi periodik për herë të fundit nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, më datë 12.04.2021, ndërkohë nga data 12.04.2021 deri më datë 31.12.2022, konstatohet se nuk është kryer asnjë verifikim.

-A. Sh.P.K, Bahçallek, Shkodër, verifikuar për herë të fundit nga DPM më datë 11.09.2019, ndërkohë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, konstatohet se është verifikuar më datë 20.08.2020. (Ku theksojmë se në këtë verifikim 2 pistoleta benzinë dhe 1 gaz, kanë ngelur nga verifikimi i kryer. Pra për një periudhe nga data 01.04.2020 deri më datë 20.08.2020, pra rreth 4 muaj 20 ditë, këto pistoleta kanë punuar jashtë kërkesave të metrologjisë ligjore, duke cenuar qëllimin e Ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, mbrojtjen e konsumatorëve, pasi nuk është siguruar saktësia e rezultatit të matjes). Gjithashtu konstatohet se verifikimi jashtë rradhe pranë këtij subjekti, për pistoletat që kanë ngelur në verifikimin e mëparshëm, është kryer më datë 26.10.2020, pra jashtë afatit.

16.Nuk administrohet deklarata e koncesionarit ku merr përsipër përpara AK se duke filluar nga data e hyrjes në fuqi dokumentet e projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre nga koncesionari nuk bie ndesh me asnjë ligj, kërkesë e përcaktuar në paragrafin ii, pika 12.1.4 neni 12 në kontratën koncesionare.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se nuk është respektuar periudha prej 12 muaj për të ndërmarrë angazhimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit të metrologjisë apo propozimin e ligjit të ri të metrologjisë, pasi ligji i ri i metrologjisë është miratuar më datë 15.10.2020, ndërkohë kontrata koncesionare është lidhur më datë 21.08.2019.

-Në vijim të situatës së mësipërme ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, z.A. K., me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020, i është drejtuar DPM për ndërprerjen e shërbimit të verifikimit metrologjik të karburanteve pasi ky shërbim do të ofrohet nga koncesionari. Në gjykimin e grupit të auditimit urdhërimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm, bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës (ligji për metrologjinë), i cili ngarkon DPM për kryerjen e këtij shërbimi. Pra sipas kësaj shkrese DPM urdhërohet të ndalohet të kryejë shërbimin të cilin e ka detyrim ligjor, vetëm me arsyen e ekzistencës së kontratës koncesionare. Ndërkohë në këtë rast në kontratën koncesionare është parashikuar që do të kryhen ndryshimet ligjore që të mundësojnë ofrimin e shërbimit nga koncesionari.

-Nëse do t'i referohemi të ardhurave që do të realizoheshin, në rastin sikur shërbimi do të kishte vazhduar nga DPM përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 (ligji është miratuar më datë 15.10.2020, publikuar në fletore zyrtare më datë 18.12.2020, hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit) do të kishim 64,365,500 lekë të ardhura të realizuara nga koncesionari sipas pasqyrave financiare të mbyllura për periudhën Prill-Dhjetor 2020 – (2.5% \* 64,365,500 lekë) = 62,756,362 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

-Në rastin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, i cili ka urdhëruar në mënyrë të paligjshme DPM, titullari i AK ish Ministri i Financave dhe Ekonomisë zj. A. D., si dhe z. P. R., Drejtor i Përgjithshëm i DPM, i cili nuk ka marrë masat që DPM të vazhdojë të kryejë detyrën ligjore.

18. Sipas kërkesave të DST (termat e referencës), të cilat operatori ekonomik ka marrë përsipër t'i plotësojë dhe t'i zbatojë, konkretisht në sistemet e informacionit, është përcaktuar zhvillimi i një platforme online për qëllime kontrolli/mbikëqyrje. Pasi të kryhet shërbimi, çdo e dhënë/proces/dokument duhet regjistruar në sistemin online, të cilat mund të ekstrahohen ose shkarkohen në formën e dokumenteve ose Dokumentet e tenderit për projektin “Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm” certifikatave. Gjithashtu sistemi do të jetë për qëllime statistikore raportimi.

Nga verifikimi i kryer në sistemin e ngritur nga N. I., konstatohet se nuk ofrohet mundësia për të aksesuar raportet e monitorimit peridoke të aktivitetit të koncesionarit; Nuk ngarkohen të gjitha dokumentet që lidhen me një proces verifikimi, konkretisht nëse instrumenti ka ngelur në testim, në inspektimin që kryhet jashtë radhe, nuk administrohet njoftimi i autoriparuesit drejtuar N. I., për të vlerësuar respektimin e afatit kohor prej 30 ditësh në kryerjen e verifikimit jashtë radhe; Nuk ofrohet mundësia për të monitoruar/mbikëqyrur se sa subjekte kanë aplikuar për verifikimin fillestar të instrumentit, për të bërë më pas kontrollin e respektimit të afatit nga data e aplikimit deri në datën e kryerjes së verifikimit; Në disa verifikime të kryera nga N. I., sipas raport verifikimit të lëshuar nga inspektorët, konstatohet se përdoret termi “Ngel me dëshirë”, ndërkohë që një përkufizim i tillë nuk parashikohet në legjislacionin në fuqi, përkundrazi parashikohet bllokimi i instrumentit ose lejimi i përdorimit të tij. Në rast se instrumenti nuk përdoret nga subjekti, atëherë në instrument vendoset shenjë dalluese me mbishkrimin jashtë përdorimit, si dhe brenda 30 ditëve, instrumenti duhet të hiqet nga vendi i ushtrimit të aktivitetit. Për më tepër që këto verifikime nuk dokumentohen plotësisht me foto (ndryshe në rastet e tjera, ku në sistem ngarkohen edhe foto) ku të verifikohet se instrumenti nuk është në përdorim.

**Shënim:** Grupi i auditimit, për kontratën e koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019, publikuar edhe online nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, ka hasur vështirësi jo vetëm për marrjen

dhe shqyrtimin e dokumenteve, kjo kryesisht për shkak të keqadministrimit të praktikës nga të gjitha strukturat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, si dhe nëse janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet shkresore të prodhuara nga institucionet apo dorëzuara nga shoqëri përfituese, si dhe në mungesë të dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës, duke ndikuar në rezultatin e auditimit, si dhe në dhënien e opinionëve të kufizuara lidhur me përputhshmërinë e zbatimit dhe monitorimin e saj nga strukturat përgjegjëse, e për rrjedhojë edhe zbatimin e saj.

-Kontrata koncesionare në përmbajtjen e saj nuk reflekton plotësisht kërkesat e përcaktuara në DST, detyrim ligjor ky për t'u zbatuar nga Autoriteti Kontraktues.

Gjithashtu edhe pika 20.2.7 e kontratës koncesionare nuk është në përputhje me përcaktimin në DST. Konkretisht në pikën 20.2.7 përcaktohet se AK brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore....., ndërkohë në DST, pika 1.3.3, paragrafi i fundit, përcaktohet se brenda një afati minimal nga nënshkrimi i kontratës, do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore.

Shoqëria fituese e procedurës "N. C." shpk, me NIPT L.....C, ndërkohë që kontrata është nënshkruar ndërmjet MFE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe shoqërive "N. C." shpk dhe "N. I." shpk, në cilësinë e Kontraktorit, kur shoqëria "N. I." shpk nuk ka qenë operator ekonomik pjesëmarrës apo fitues i procedurës konkurruese.

Kontrata koncesionare, objekti i saj, nuk është në përputhje me detyrat e caktuara shoqërisë përcaktuar me VKM nr. 365, date 20.06.2018, pasi koncesionari kërkon të realizojë sipas kontratës shërbimet e verifikimit fillestar, pasardhës (verifikim periodik të detyrueshëm, verifikim jashtë radhe me kërkesë të subjektit, verifikim pas riparimit) dhe verifikim pa tarifë jashtë frekuencës të zakonshme, duke rritur intervalet e verifikimit të instrumenteve pa pasur referim ligjor apo rekomandime nga institucione të brendshme apo ndërkombëtare, duke pasur ndikim në rritjen e shpenzimeve të subjekteve të tregtimit të hidrokarbureve me pakicë, dhe duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të produktit, dhe për rrjedhojë te konsumatori fundor.

Sipas kontratës koncesionare, monitorimi i zbatimit të kontratës do të bëhet nga autoriteti kontraktues MFE, ndërkohë që monitorimi i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar është detyrë ligjore e DPM<sup>së</sup>. Po ashtu, intervalet e verifikimit të instrumenteve matës janë përcaktuar në akte ligjore të DPM, bazuar në rekomandimet europiane, si rrjedhojë shoqëria koncesionare nuk mund të përcaktojë intervale verifikimi të instrumenteve matës.

Sipas kontratës koncesionare kompania koncesionare mund të kryejë nën-kontraktime edhe pse këtë shërbim e ka të drejtë ekskluzive për ta kryer vetëm (Koncesionari).

Po ashtu, sipas kontratës koncesionare, shoqëria koncesionare nëpërmjet saj do të realizojë shërbimin e verifikimit fillestar dhe verifikimit pas riparimit, kur i Pari është shërbim që referuar direktivave evropiane kryhet nga prodhuesi i instrumentit matës, duke e markuar instrumentin me markimin CE, ndërsa shërbimi i dytë, verifikimi pas riparimit i referohet ligjit "Për metrologjinë", ku DPM nuk mund të kryejë riparimin dhe verifikimin pas riparimit të instrumentit matës pasi është në kundërshtim me ligjin e konfliktit të interesit, për analogji në të njëjtin konflikt është apo mund të jetë edhe shoqëria koncesionare.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 26, pikën 3 të nenit 27 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar.

Mos përcaktimi i saktë i veprimtarisë që do kryhet rrit kostot e shërbimit te subjektet.

*Për këtë mbanë përgjegjësi komisioni i dhënies me koncesion me përbërje S. P., A. A., G. V., A. P. dhe A. U..*

-Projektzbatimi nuk jep informacion mbi tarifën e verifikimit jashtë radhe, pra ku bazohet, kostimi i saj, shpjegimet dhe argumentet.

Projektzbatimi, sa i përket softuerë që do të instalohet me qëllim raportimin dhe monitorimin në kohë reale të shërbimit të verifikimit, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit”. Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me softuerë, përdoruesit dhe produktet që përfitohen prej tij në varësi të përdoruesit, pasqyrohet informacioni për raportet e gjeneruara, si vijon.

Pra nuk përcaktohet aspak shkarkimi i raporteve të gjeneruara, apo për më tepër të përmbajtjes së këtyre raporteve, pra jo vetëm rezultatet e verifikimit në një subjekt, por edhe problematikat që kanë dalë nga verifikimet e kryera, koha mesatare për të realizuar rekomandimet që janë dhënë dhe masat që janë ndërmarrë.

Projektzbatimi sa i përket planit të burimeve njerëzore, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”.

Projektzbatimi sa i përket burimeve njerëzore, nuk përcakton aspak planin e trajnimit hyrës, ndërkohë në dokumentin e ofertës teknike “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”, përcaktohet se si do të organizohet kursi hyrës i trajnimit teoriko-praktik.

Projektzbatimi nuk jep informacion për kalibrimin e pajisjeve matëse, frekuencën e kalibrimit, laboratorin ku do të kalibrohen etj.

Projektzbatimi sa i përket shpenzimeve kapitale, nuk është në përputhje me dokumentet e ofertës teknike. Në projektzbatim ka një tjetër vlerë për investim. Për më tepër për pajisjen flowmetër nuk jepet informacion. Gjithashtu nuk ka një shpjegim për rritje të konsiderueshme të vlerës së investimit në sistemin online, si dhe në pajisje zyre.

Vlera e investimit sipas projektzbatimit, nuk është në përputhje edhe me modelin financiar të dorëzuar nga OE gjatë procedurës konkurruese, ku përlllogaritjet për vlerën e IRR dhe NPV janë bërë për vlerën e investimit 70,000,000 lekë. Ndryshimi i vlerës së investimit, pra rritje të saj, përkthehet në rritje të kostove të subjektit, duke ndryshuar vlerën e NPV dhe IRR. Për më tepër që ndryshimi i vlerës së investimit krijon detyrimin për shoqërinë koncesionare që të dorëzojë modelin financiar të përditësuar.

Gjithashtu në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese “Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit”, makinat që do të përdoren si autolaborator, janë tipi Volkswagen Transporter Van T6 KR 2.0 TDI, 75 Kw, ndërkohë në projektzbatim, makinat që do të përdoren si autolaborator janë tipi Ford Transit Custom.

Referuar sa më sipër, projektzbatimi nuk është në përputhje të plotë me ofertën teknike, si dhe bazuar në kontratën koncesionare, neni 8, pika 8.1, NJZP nuk duhet të kishte shprehur miratimin e projektit të zbatimit, por t’ia rikthente Shoqërisë Koncesionare N. I., për korigjim. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 08.02.2013 “Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të DPM”, i ndryshuar.

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi, NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

-Në dosje nuk administrohet raporti i investimeve të realizuara, përcjellë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, me shkresën nr.14 prot., datë 17.01.2020 protokolluar në MFE me shkresën nr.992, datë 17.01.2020.

NJZP përpara kryerjes së verifikimit të investimit të realizuar nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit

Nuk administrohet asnjë dokumentacion mbështetës që vërteton kryerjen e investimit, duke i’u referuar edhe mbishkrimin në raportin e verifikimit të mbajtur nga NJZP, shprehimisht: “Gjithashtu u kërkua dokumentacioni mbështetës që vërteton investimet e kryera”.

Investimi i kryer, sipas informacionit të paraqitur në raportin nr.2, datë 24.01.2020 të mbajtur nga NJZP, për verifikimin e investimit të kryer, është në vlerën 79,305,455 lekë, pra jo sa vlera e përcaktuar në nenin 15 të kontratës koncesionare, në projektzbatimin, modelin financiar dhe planin e zbatimit dhe ri-investimit. Theksojmë se realizimi i investimit jo sipas përcaktimeve

të mësipërme, sjellë moszbatimin e nenit 9, pika 9.1 në kontratën koncesionare, sa i përket garancisë në vlerën 7,000,000 lekë në masën 10 % të vlerës së investimit. Theksojmë se në nenin 15 është përcaktuar që vlera e investimit do të jetë 70,000,000 lekë, pra sipas shtojcës 3 “Modeli financiar”. Në vijim në nenin 15 përcaktohet se do të lejohen ndryshime ndërmjet zërave të investimit.

-Sa më sipër NJZP nuk duhet të kishte propozuar miratimin e investimit të kryer, por të rekomandonte kryerjen e tij sipas parashikimeve kontraktuale.

Sa më sipër është në mos përputhje me nenin 15 të kontratës koncesionare.

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi, NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar i NJZP, S. D., J. Ll. dhe A. A., Anëtar të NJZP.*

-Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se nuk është respektuar periudha prej 12 muaj për të ndërmarrë angazhimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit të metrologjisë apo propozimin e ligjit të ri të metrologjisë, pasi ligji i ri i metrologjisë është miratuar më datë 15.10.2020, ndërkohë kontrata koncesionare është lidhur më datë 21.08.2019.

-Në vijim të situatës së mësipërme ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, z. A. K., me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020, i është drejtuar DPM për ndërprerjen e shërbimit të verifikimit metrologjik të karburanteve pasi ky shërbim do të ofrohet nga koncesionari. Në gjykimin e grupit të auditimit urdhërimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm, bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës (ligji për metrologjinë), i cili ngarkon DPM për kryerjen e këtij shërbimi. Pra sipas kësaj shkrese DPM urdhërohet të ndalohet të kryejë shërbimin të cilin e ka detyrim ligjor, vetëm me arsyen e ekzistencës së kontratës koncesionare. Ndërkohë në këtë rast në kontratën koncesionare është parashikuar që do të kryhen ndryshimet ligjore që të mundësojnë ofrimin e shërbimit nga koncesionari.

-Nëse do t'i referohemi të ardhurave që do të realizoheshin, në rastin sikur shërbimi do të kishte vazhduar nga DPM përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 (ligji është miratuar më datë 15.10.2020, publikuar në fletore zyrtare më datë 18.12.2020, hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit) do të kishim 64,365,500 lekë të ardhura të realizuara nga koncesionari sipas pasqyrave financiare të mbyllura për periudhën Prill-Dhjetor 2020, minus  $(2.5\% * 64,365,500 \text{ lekë}) = 62,756,362 \text{ lekë}$ , të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Sa më sipër është në mos përputhje me Ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, neni 8, pika 9.

Vlera 62,756,362 lekë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

*-Në rastin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, i cili ka urdhëruar në mënyrë të paligjshme DPM, si dhe z. P. R., Drejtor i Përgjithshëm i DPM, i cili nuk ka marrë masat që DPM të vazhdojë të kryejë detyrën ligjore.*

-Në raportimet e kryera për periudhën 2021, u konstatua se mungonin:

-Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle;

-Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive të raportuar;

- Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar;

- Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi;

- Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “instrument matës jo në përdorim” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit;

- Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë periudhës së raportuar;

- Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar;

- Tarifata e aplikuara, për inspektimet fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 336 inspektime jashtë radhe me tarifën përkatëse. Tarifata e aplikuara për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin;
  - Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik;
  - Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur defekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit;
  - Data bazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer.
- Sa më sipër është në mos përputhje me Kontratën e koncesionit, nenet 13, 19, 21.

-Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyra e pozicionit financiar, llogaria ekonomike të drejta të arkëtueshme, e cila përfaqëson subjektet që nuk kanë paguar tarifën e shërbimit të verifikimit/debitorët ndaj Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, rezulton se në fund të vitit:

2020 debitorët janë në vlerën 16,585,840 lekë;

2021 debitorët janë në vlerën 14,913,125 lekë;

2022 debitorët janë në vlerën 11,032,330 lekë;

Pavarsisht faktit se vlerat e mësipërme, bazuar në SKK janë njohur si të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, ato tregojnë se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka zbatuar nenin 14, pika 14.4 të kontratës koncesionare. Sipas referencës ligjore, Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K është përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave që vijnë nga kryerja e shërbimit të verifikimit. Cdo faturë e lëshuar për shërbimin e kryer përbën titull ekzekutiv.

Në 60 raste është konstatuar moszbatimi i kontratës. Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, në kushtet kur fatura që lëshon është titull ekzekutiv, duhet të kishte bërë kërkesë padi në gjykatë, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, nëpërmjet të cilit të ngarkohej shërbimi përmbartimor për ekzekutimin me forcë të detyrimeve. Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, pra moszbatimi i kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, po nga ky subjekt nuk është kryer shërbimi i verifikimit ndaj subjekteve të mësipërme, me pretendimin se nuk kanë paguar tarifën dhe në këto kushte nuk i ofrohet verifikimi.

Sa më sipër është në mos përputhje me Ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, për mbrojtjen e konsumatorëve.

Mos verifikimi i pajisjeve matëse cenon mbrojtjen e konsumatorëve duke mos siguruar saktësinë e rezultatit të matjes.

-Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyrës së performancës financiare, llogaria ekonomike “Të ardhura operative”, rezulton se Shoqëria Koncesionare N. I., për vitin 2021 ka realizuar të ardhura në vlerën 96,210,200 lekë, pra tarifa koncesionare për t’u paguar është 2.5% të 96,210,200 lekë =2,405,255 lekë.

Me qëllim vlerësimit nëse përputhen të dhënat mbi vlerën e të ardhurave të realizuara dhe të raportuara në PF, me të ardhurat që duhet të realizojë Shoqëria Koncesionare, duke pasur në konsideratë tarifata e miratuara, llojin e verifikimeve të kryera, si dhe **3 variantet** në varësi të numrit të pistoletave në një stacion karburanti, grupi i auditimit bëri përlllogaritjet për vitin 2021, bazuar në të dhënat për verifikimet e kryera duke i përlllogaritur me tarifata minimale, për 1,234 verifikime fillestare kaluese, 644 verifikime fillestare ngelëse, 1,238 verifikime jashtë radhe kaluese, 133 verifikime jashtë radhe ngelëse, 13,044 verifikime periodike kaluese, ku vlera totale është 110,399,350 lek.

Në krahasim me të ardhurat e realizuara, krijohet diferenca 110,399,350 lek – 96,210,200 lek = 14,189,150 lek \* 2.5% = 354,728 lek më pak.

-Situata e mësipërme tregon se nga grupi i monitorimit të ngritur me urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, nuk ka kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit financiar.



-Gjithashtu kjo situatë tregon se edhe NJZP nuk ka kryer monitorimin e dokumentacionit përkatës, me qëllim kryerjen e përlllogaritjeve dhe vlerësimin e të ardhurave që duhet të kishte realizuar Shoqëria Koncesionare Sh.P.K, mbi të cilat përlllogaritet tarifa koncesionare. Vlera 354,728 lek përbën të ardhura të munguara.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjës, I. Z., P. C., E. B., A. A., R. B., S. P., V. J., E. B..*

-Sipas kërkesave të DST (termat e referencës), të cilat operatori ekonomik ka marrë përsipër t'i plotësojë dhe t'i zbatojë, konkretisht në sistemet e informacionit, është përcaktuar zhvillimi i një platforme online për qëllime kontrolli/mbikëqyrje. Pasi të kryhet shërbimi, çdo e dhënë/proces/dokument duhet regjistruar në sistemin online, të cilat mund të ekstrahohen ose shkarkohen në formën e dokumenteve ose certifikatave. Sistemi do tu japë akses klientëve, për të kontrolluar të dhënat e Shërbimit direkt nga interneti. Gjithashtu sistemi do të përdoret dhe për qëllime statistikore raportimi.

Nga verifikimi i kryer në sistemin e ngritur nga N. I., konstatohet se nuk ofrohet mundësia për të aksesuar raportet e monitorimit periodike të aktivitetit të koncesionarit; Nuk ngarkohen të gjitha dokumentet që lidhen me një proces verifikimi, konkretisht nëse instrumenti ka ngelur në testim, në inspektimin që kryhet jashtë radhe, nuk administrohet njoftimi i autoriparuesit drejtuar N. I., për të vlerësuar respektimin e afatit kohor prej 30 ditësh në kryerjen e verifikimit jashtë radhe; Nuk ofrohet mundësia për të monitoruar/mbikëqyrur se sa subjekte kanë aplikuar për verifikimin fillestar të instrumentit, për të bërë më pas kontrollin e respektimit të afatit nga data e aplikimit deri në datën e kryerjes së verifikimit; Në disa verifikime të kryera nga N. I., sipas raport verifikimit të lëshuar nga inspektorët, konstatohet se përdoret termi "Ngel me dëshirë", ndërkohë që një përkufizim i tillë nuk parashikohet në legjislacionin në fuqi, përkundrazi parashikohet bllokimi i instrumentit ose lejimi i përdorimit të tij. Në rast se instrumenti nuk përdoret nga subjekti, atëherë në instrument vendoset shenjë dalluese me mbishkrimin jashtë përdorimit, si dhe brenda 30 ditëve, instrumenti duhet të hiqet nga vendi i ushtrimit të aktivitetit. Për më tepër që këto verifikime nuk dokumentohen plotësisht me foto (ndryshe në rastet e tjera, ku në sistem ngarkohen edhe foto) ku të verifikohet se instrumenti nuk është në përdorim.

-Shoqëria Koncesionare nuk ka publikuar në faqen e saj web, emrat e pikave të karburantit të cilat nuk kanë kryer pagesën dhe nuk janë verifikuar, kanë hequr shiritin ose shenja të tjera dalluese, rezultojnë se kanë në përdorim instrumente matës me probleme metrologjike.

Sa më sipër është në mospërputhje me Kontratën e Koncesionit, shtojca 1, Dokumentet e tenderit për projektin "Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm", pika 1.3.4, sistemet e informacionit, pika 21.1.9.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJZP, znj. S. P., znj. P. C., znj. V. J., z. R. B., z. E. B., z. E. B. dhe znj. A. A..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 19754/8, datë 29.01.2024, "Komente mbi gjetjet e evidentuara në Akt-Konstatimin nr. 2" nga znj. I. Z., z. G. V., S. P., A. U., A. P., P. C., A. L., S. D., dhe J. Ll. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Referuar auditimit të ushtruar nga KLSH në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në bazë të programit të auditimit nr.25711 prot., datë 03.05.2023 i ndryshuar dhe konstatimeve të Grupit të Auditimit të vëna në dispozicion me anë të Akt Konstatimit nr.3 datë 19.01.2024 lidhur me këtë program auditimi, si fillim ju sqarojmë se:*

*Lidhur me shënimin e audituesve në fund të Akt konstatimit nr.3 citojmë: "Grupi i auditimit, për kontratën e koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019, publikuar edhe online nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka hasur vështirësi jo vetëm për marrjen dhe shqyrtimin e*

*dokumenteve, kjo kryesisht për shkak të keqadministrimit të praktikës nga të gjitha strukturat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, si dhe nëse janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet shkresore të prodhuara nga institucionet apo dorëzuara nga shoqëri përfutuese, si dhe në mungesë të dokumentacionit mbi zbatimin e kontratës, duke ndikuar në rezultatin e auditimit, si dhe në dhënien e opinioneve të kufizuara lidhur me përputhshmërinë e zbatimit dhe monitorimin e saj nga strukturat përgjegjëse, e për rrjedhojë edhe zbatimin saj", ju bëjmë me dije se nga ana e Ministrisë së Financave u është vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni i kërkuar lidhur me planin e auditimit, si me anë të postës elektronike ashtu edhe në formë shkresore zyrtare (bashkëlidhur email-et). Gjithashtu nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave u është ofruar asistencë lidhur me çdo paqartësi të hasur gjatë shqyrtimit të dokumentacionit.*

*Përveç sa më sipër, ju bëjmë më dije se në datën 19.01. 2024 datë në të cilën na keni vënë në dijeni se keni përfunduar auditimin dhe do të dorëzoni Akt konstatimet si dhe gjithë dokumentacionin e shqyrtuar, në përfundim të marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni kemi konstatuar mungesë dhe mangësi dokumentacioni. Gjithashtu argumentoj më së dosjet e dorëzuara grupit të auditit janë shoqëruar edhe me procesverbale përkatëse të cilat nuk janë firmosur nga grupi i auditimit. Gjithashtu grupi i auditimit në mënyrë të pajustificuar ka vijuar me dorëzimin e dokumentacionit edhe në datën 25.01.2024, një ditë përpara përmbushjes së afatit 7-ditor për përgatitjen e observacioneve nga personat përkatës. Edhe në këtë rast, dosjet janë dorëzuar pa procesverbal.*

*Në vijim, referuar konstatimeve të grupit të auditimit në përmbajtjen e këtij Akt Konstatimi po ju paraqesim observacionet tona si më poshtë vijon:*

*Auditimi i përmbajtjes së kontratës*

*Lidhur me konstatimin nr. 1 ku shpreheni se: "Kontrata koncesionare në përmbajtjen e saj nuk reflekton plotësisht kërkesat e përcaktuara në DST, detyrim ligjor ky për t'u zbatuar nga Autoriteti Kontraktues. Konkretisht pika 14.2 e kontratës nuk është në përputhje me pikën 1.3. 1 në specifikimet teknike të vendosura në DST, pasi në kontratë frekuenca e verifikimit përcaktohet jo më pak se dy herë në vit, ndërkohë në DST përcaktohet specifikisht dhe pa hapësira, verifikimi do të kryhet dy herë në vit, pra përjashton mundësinë për më tepër verifikime. " sqarojmë se: Në dokumentet e procedurës konkurruese seksioni 1.3 "Përshkrimi i projektit teknik" pika 1.3.3 "Verifikimi periodik jashtë rradhe" përcaktohet se: "Koncesionari do të kryejë verifikimin periodik dy herë në vit me ose pa lajmërim paraprak ndaj subjektit që do të verifikohet. Numri i verifikimeve periodike të detyrueshme për çdo vit kalendarik mund të ndryshojë me dakordësi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit. Gjithashtu Koncesionari ka të drejtë të kryejë verifikime shtesë të subjekteve, pa pagesë, bazuar mbi politikën e brendshme të Koncesionarit për menaxhimin e riskut dhe cilësisë ". Pra, vendosja në kontratë e frekuencës së shërbimit jo më pak se dy herë në vit reflekton plotësisht kërkesat e DST, duke i lënë diskrecion Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues që në varësi të situatës dhe në dakordësi midis palëve, të përcaktojnë një frekuencë shërbimi më të madhe se dy herë në vit në rast se do të jetë e nevojshme.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë.

**Konkretisht në DST kemi:**

1.Koncesionari do të kryejë verifikimin periodik dy herë në vit me ose pa lajmërim paraprak ndaj subjektit që do të verifikohet.

2.Numri i verifikimeve periodike të detyrueshme për çdo vit kalendarik mund të ndryshojë me dakordësi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

Ndërkohë në kontratë (pika 14.2 dhe 14.3 në nenin 14) kemi:

1.Frekuenca e verifikimit do të jetë jo më pak se dy herë në vit.

2.Pas fillimit të kryerjes së shërbimit, palët mund të bien dakord për rritjen frekuencës së verifikimit të rregullt.

-Pra qartë pika 1 ndryshon në të dy dokumentet.

*Lidhur me konstatimin nr.2 ku shpreheni se: "Gjithashtu edhe pika 20.2.7 e kontratës koncesionare nuk është në përputhje me përcaktimin në DST. Konkretisht në pikën 20.2. 7 përcaktohet se AK brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore....., ndërkohë në DST, pika 1. 3.3, paragrafi i fundit, përcaktohet se brenda një afati minimal nga nënshkrimi i kontratës, do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 27 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat ", i ndryshuar. "sqarojmë se: Në pikën 3 të nenit 27 në Ligjin nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar që keni referuar është përcaktuar se: "Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës. " Ndërkohë në Shtojcën 16 të DST të procedurës konkurruese "Kushtet e veçanta të kontratës" neni 7.2 pika (vi) përcaktohet se: "Autoriteti Kontraktues angazhohet, brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i Kontratës, se do të propozojë të gjitha ndryshimet e nevojshme për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës dhe do të marrë iniciativën për miratimin e të gjitha ligjeve, akteve nënligjore dhe/ose rregulloreve që te lejoje Koncesionarin te kryeje shërbimin objekt te Kontratës përfshirë këtu veprimtarinë e inspeklimit metrologjik sipas legjislacionit te zbatueshëm shqiptar mbi metrologjinë, përfshirë por pa i kufizuar të drejtën e Koncesionarit për të bllokuar subjektet në shkelje. "*

*Në këtë kuptim, konstatimi juaj nuk qëndron pasi përcaktimi i nenit në kontratë është i njëjtë me atë të DST. Për më tepër, në dokumentet e tenderit është parashikuar se: "Dispozitat e parashikuara në Kushtet e Përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës janë subjekt i ndryshimeve, nëse është e nevojshme, gjatë fazës së negociimit të kontratës me ofertuesin e përzgjedhur fitues ", që do të thotë që nuk është e detyrueshme që këto parashikime të reflektohen njësoj në kontratën e nënshkruar, pasi janë objekt negociimi mes palëve.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se merret në konsideratë. Gjithësesi ju nuk duhet të kishit mbajtur dy qëndrime për të njëjtën çështje në përmbajtje të një dokumenti, pasi për këtë çështje në DST jeni shprehur në dy mënyra.

*Lidhur me konstatimin nr. 3 ku shpreheni se: "Kontrata koncesionare e lidhur ndërmjet AK dhe Koncesionarit "N. C." dhe Shoqërisë Koncesionare "N. I.", bie në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 22 të nenit 3 të Ligjit nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat ", i ndryshuar. Konkretisht kontrata e koncesionit është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë. Shoqëria fituese e procedurës "N. C." shpk, me NIPT L.....C, ndërkohë që kontrata është nënshkruar ndërmjet MFE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe shoqërive "N. C. " shpk dhe "N. I." shpk, në cilësinë e Kontraktorit, kur shoqëria "N. I. " shpk nuk ka qenë operator ekonomik pjesëmarrës apo fitues i procedurës konkurruese. Pra sa më sipër ligji e ka përcaktuar lidhjen e kontratës me njërin prej subjekteve jo me të dy. - Për më tepër edhe në përmbajtjen e kontratës, është cilësuar se palët pranojnë që në përputhje me ligjin Koncesionari pra N. C. ka themeluar Shoqërinë Koncesionare. Në këto kushte kuptohet qartë se AK ka qenë në dijeni të themelimit të Shoqërisë Koncesionare dhe në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të Ligjit nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, kontrata duhej lidhur me Shoqërinë Koncesionare N. I. Sh.P.K, duke krijuar të drejta dhe detyrime vetëm për SPV, jo edhe për Koncesionarin. Në këtë mënyrë*

sigurohet edhe evidentimi i qartë i përgjegjësisë së subjektit në realizimin e detyrimeve kontraktare apo edhe dakortësia e SPV me përmbajtjen koncesionare. Konkretisht për ta ilustruar në nenin 3, pika 3. 1 "objekti i koncesionit", në kontratën koncesionare, përcaktohet se objekti i koncesionit është kryerja nga Koncesionari (N. C.), Shoqëria Koncesionare (N. I.) të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës në të gjithë territorin e RSH Në rast se objekti realizohet nga Koncesionari dhe jo nga SPV, atëherë jemi përballë mosrespektimit të pikës 3.2 "Realizimi i objektit të koncesionit do të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, shtojcat e saj, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Pra legjislacioni në fuqi përcakton se kontrata lidhet me OE fitues apo SPV, si dhe në rast se është krijuar SPV, atëherë lidhet vetëm me SPV, i cili është përgjegjës për realizimin e objektit të koncesionit. "ju bëjmë më dijë se: Ligji nr. 1 25/20 13 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar në pikën 5 të nenit 26 ka përcaktuar se: "Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit Kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi. " ndërsa pika 6 e nenit 26 te po këtij ligji ka përcaktuar se: "Kur ofertuesi i përzgjedhur si më i suksesshmi, në përputhje me dokumentet e tenderit, me vendimin për dhënien e kontratës fituese dhe me ofertën e zgjedhur, është i detyruar të krijojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit "Shoqëri koncesionare" dhe me objekt "Objektin e kontratës së koncesionit", autoriteti kontraktues nënshkruan kontratën me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë. " Në rastin e kësaj procedure nuk ka ndonjë parashikim në DST për detyrimin e ofertuesit të zgjedhur fitues për krijimin e SPV dhe lidhjen e kontratës me personin e autorizuar të SPV. Në këto kushte mendojmë se përfshirja e SPV nuk sjell ndonjë pasojë negative por thjesht konfirmon se edhe SPV ka dakordësuar në lidhje me detyrimet e veta në këtë kontratë. Kjo reflektohet edhe në parashikimet e kontratës së koncesionit ku në nenin 4.1 të kontratës përcaktohet shprehimisht se: "Palët pranojnë që në përputhje me ligjin koncesionari ka krijuar Shoqërinë koncesionare për të realizuar këtë kontratë. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kësaj kontrate ", duke e definuar që si koncesionari dhe shoqëria koncesionare janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të kontratës.

Lidhur me konstatimin se "në procesverbalet e mbledhjes së komisionit, konkretisht në procesverbalin nr. 10, datë 22.07.2019 dhe nr. 11, datë 16.08.2019, nuk pasqyrohet plotësisht puna e kryer nga komisioni, pasi në procesverbalin nr. 3, (referuar gabim nga audituesit) komisioni shprehet se bashkëlidhur procesverbalit është draft-kontrata e negociuar, por konstatohet se nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument që lidhet me përmbajtjen e draft-kontratës apo draft-kontrata e nënshkruar nga negociuarit ", ju sjellim në vëmendje se në pikën 6 të nenit 18 të ligjit nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, parashikohet se "6. Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit ". Referuar këtij përcaktimi ligjor, komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatëse ku konkretisht procesverbali nr.10 është mbajtur ne date 22.7.2019 pas hartimit te draftit te pare te kontratës i cili është dërguar për mendim me shkresën nr. 14167/1 datë 25.07.2019 Avokaturës së Shtetit dhe me shkresën nr. 14167 datë 25.07.2019 Autoritetit te Konkurrencës. Procesverbali nr.11, datë 16.08.2019 ka pasqyruar punën e komisionit për hartimin e draftit përfundimtar pas negociimit dhe reflektimit te komenteve te institucioneve te sipërcituara. Të dy procesverbalet së bashku me draftet e kontratave bashkëlidhur janë bërë pjesë e dosjes së procedurës së administruar në protokollin e MFE. Për sa më sipër konstatimi juaj nuk qëndron dhe duhet të hiqet.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Thjesht ju sjellim në vëmendje si do të kontrollohen dokumentet financiare (por jo vetëm, por edhe burimet njerëzore, pasi N. C. burimet njerëzore të saj mund ti angazhojë edhe në shërbime të tjera, e cila mund të sjellë performancë të dobët në realizimin

e shërbimit objekt koncesioni) të koncesionarit nga NJZP, ndërkohë që në pasqyrat financiare të N. C. nuk identifikohen të ardhurat nga shërbimi i verifikimit metrologjik, por pasqyrohen të ardhurat në total. Jo më kot është parashikuar krijimi i SPV, subjekt që krijohet vetëm për realizimin e këtij koncesioni, me seli, burime njerëzore, burime financiare, dokumente tekniko-financiare më vetë, duke mundur edhe kontrollin e saktë dhe të plotë të koncesionarit.

Në lidhje me Pikën 3.1 (Procesverbalet).

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Ju shprehemi se draft-kontrata ka qenë bashkëlidhur procesverbalit, ndërkohë që grupi i auditimit është shprehur se nuk administrohet asnjë dokument bashkëlidhur. Për më tepër që ju edhe në observacion nuk keni dorëzuar draft-kontratën e nënshkruar nga grupi negociues.

*Lidhur me konstatimin nr. 4 ku shpreheni se: "Kontrata koncesionare, objekti i saj, nuk është në përputhje me detyrat e caktuara shoqërisë përcaktuar me VKM nr. 365, date 20. 06.2018, pasi koncesionari kërkon të realizojë sipas kontratës shërbimet e verifikimit fillestar, pasardhës (verifikim periodik të detyrueshëm, verifikim jashtë radhe me kërkesë të subjektit, verifikim pas riparimit) dhe verifikim pa tarifë jashtë frekuencës të zakonshme, duke rritur intervalet e verifikimit të instrumenteve pa pasur referim ligjor apo rekomandime nga institucione të brendshme apo ndërkombëtare, duke pasur ndikim në rritjen e shpenzimeve të subjekteve të tregtimit të hidrokarbureve me pakicë, dhe duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të produktit, dhe për rrjedhojë te konsumatori fundor. Theksojmë këtu rekomandimet e International Organization of Legal Metrology (OIML) se "Të gjitha metrologjitë duhet të unifikojnë të njëjtën tarifë dhe afate për verifikimin e instrumenteve matës ligjorisht të kontrolluar, gjë e cila do të lehtësonte procedurat për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë ". Tarifat e aplikueshme kanë qenë të rregulluara me një akt nënligjor bazuar në metodologji ndërkohë që në kontratë, koncesionarit i lind e drejta e vendosjes së tarifës mbi tarifën ligjore të përdorur nga DPM duke mos përcaktuar tavan tarifor, duke u përcaktuar edhe penalitete në vlerë 0. 05% për vonesa në pagesë për çdo ditë vonesë në pagesë (tarifë mbi vlerën e shërbimit)." sqarojmë se: Në nenin 14 të kontratës së koncesionit është parashikuar qartë se tarifat për këtë shërbim do të jenë sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë dhe Ministrisë të Financave nr.2, datë 08.02.2013 dhe nuk ka asnjë penaltet për vonesat si dhe asnjë parashikim në lidhje me përcaktimin e nivelit të çmimeve. Penaliteti prej 0.05 % është për koncesionarin në rast se vonon të paguajë tarifën koncesionare kundrejt AK sipas përcaktimeve në kontratë. Në pikën 1 të VKM nr.365 datë 20.06.2018 është përcaktuar se dhënia me koncesion/PPP e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe të gazit të lëngshëm, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues. Kjo VKM nuk ka për qëllim përcaktimin e detyrave të koncesionarit por përcaktimin e shërbimit të kontrollit ligjor nëpërmjet verifikimit të instrumenteve matës të karburantit dhe gazit të lëngshëm si fushe që do të jepet me koncesion si dhe afatin e dhënies së shërbimit. Në nenin 6 të kontratës së koncesionit Kontrolli Metrologjik ligjor të Verifikimit të Instrumenteve Shpërndarëse të Karburantit dhe Gazit të Lëngshëm është specifikuar në mënyrë të detajuar se: "6. 1 Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm do të kryhet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate dhe Shtojcën 1 dhe do të përfshijë: a) Verifikimin fillestar b) Verifikim pasardhës që përfshin: 1. Verifikim periodik të detyrueshëm të një instrumenti matës. 2. Verifikim jashtë radhe me kërkesë të Subjektit të Detyruar. 3. Verifikim pas riparimit. c) Verifikim pa tarifë jashtë frekuencës së zakonshme. " Ky parashikim vjen në përputhje me pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr 9875/2008 "Për Metrologjinë" ku përcaktohet se: "Verifikimi i instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara mund të jetë fillestar, periodik, i kryer në intervale specifike dhe jashtë*

radhe dhe parashikimet e Rregullores të miratuar me anë të Urdhrit nr. 1 95, datë 09.03.2009. "Për Verifikimin Fillestar dhe Pasardhës të Instrumenteve matëse ligjërish të Kontrolluara " të Ministrisë të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës ku parashikohet se: " Verifikimi fillestar përbën ekzaminimin e një instrumenti matës të ri apo të riparuar dhe konfirmimi i përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar ose me kërkesat e Rregullores së Këshillit të Ministrave «Për karakteristikat teknike dhe metrologjike të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar» miratuar me VK.M Nr. J351, date 03.10.2008 (këtë e tutje vetëm Rregullore e Këshillit të Ministrave) lidhur me instrumentin matës në fjalë; dhe Verifikim pasardhës është çdo verifikim i instrumenteve matës që kryet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose person juridik i autorizuar, pas verifikimit të mëparshëm dhe që përfshin: - verifikimin periodik të detyrueshëm – verifikimin jashtë radhe me kërkesë - verifikimin pas riparimit. "

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë.

Lidhur me konstatimin nr.5 ku shpreheni se: "Sipas kontratës koncesionare, monitorimi i zbatimit të kontratës do të bëhet nga autoriteti kontraktues MFE, ndërkohë që monitorimi i instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar është detyrë ligjore e DPM. Po ashtu, intervalet e verifikimit të instrumenteve matës janë përcaktuar në akte ligjore të DPM, bazuar në rekomandimet europiane, si rrjedhojë shoqëria koncesionare nuk mund të përcaktojë intervale verifikimi të instrumenteve matës. " argumentojmë se: Lidhja e kontratës koncesionare është vendosur në VKM nr.365 datë 20.06.2018 "Për Dhënie me Koncesion të Shërbimit të Kontrollit Ligjor të Instrumenteve Matëse, Nëpërmjet Verifikimit të Instrumenteve Shpërndarëse të Karburantit dhe Gazit të Lëngshëm dhe Miratimit të Bonusit në Procedurën Konkurruese që i jepet Shoqërisë". Po ashtu në këtë VKM është përcaktuar Autoriteti Kontraktues Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe është në tagrin e saj përcaktimi se kush do të jetë struktura/institucioni që do të ndjekë monitorimin e zbatimit të kontratës.

Gjithashtu lidhur me intervalet e verifikimit ju bëjmë me dije se këto intervale janë të përcaktuara në Rregulloren e miratuar me anë të Urdhrit nr. 1 95, datë 09.03.2009. "Për Verifikimin Fillestar dhe Pasardhës të Instrumenteve matëse ligjërish të Kontrolluara " të Ministrisë të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Në nenin 3 të kontratës "Objekti i koncesionit " pika 3.2 përcaktohet se "Realizimi i objektit të koncesionit do të realizohet në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë, shtojcat e saj si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi " si dhe në nenin 14.2 të kontratës përcaktohet se "Frekuenca e Verifikimit të rregullt të instrumenteve matës do të jetë jo më pak se dy herë në vit për çdo subjekt." Në këtë kuptim, kontrata reflekton të njëjtat parashikime për intervalet e verifikimit si Rregullorja e miratuar me Urdhrit nr. 195 datë 09.03.2009, e cila parashikon një interval verifikimi për këto instrumente 1 herë në 6 muaj.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit, ku nuk janë paraqitur argumente ose dokumente shtesë, sqarojmë se nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me konstatimin nr.6 ku shpreheni se: "Sipas kontratës koncesionare kompania koncesionare mund të kryejë nënkontraktime edhe pse këtë shërbim e ka të drejtë ekskluzive për ta kryer vetëm (Koncesionari). Po ashtu, sipas kontratës koncesionare shoqëria koncesionare nëpërmjet saj do të realizojë shërbimin e verifikimit fillestar dhe verifikimit pas riparimit, kur i Pari është shërbim që referuar direktivave europiane kryhet nga prodhuesi i instrumentit matës, duke e markuar instrumentin me markimin CE, ndërsa shërbimi i dytë, verifikimi pas riparimit i referohet ligjit "Për metrologjinë ", ku DPM nuk mund të kryejë riparimin dhe verifikimin pas riparimit të instrumentit matës pasi është në kundërshtim me ligjin e konfliktit të interesit, për analogji në të njëjtin konflikt është apo mund të jetë edhe shoqëria koncesionare. "ju bëjmë me dije se: Për sa i takon paragrafit të parë të konstatimit nr.6 sqarojmë se e drejta për të nënkontraktuar është parashikuar në germën a) të pikës 1, të nenit 34 të ligjit nr. 125 /2013"Për Koncesionet dhe PPP" i ndryshuar, ku është parashikuar se:

"Autoriteti Kontraktues mund: a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rrisin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit; ", dhe rrjedhimisht është e qartë që në zbatim të këtij përcaktimi ligjor, koncesionari ka të drejtën të nënkontrakttojë mbi 30 % të punimeve. Ne lidhje me paragrafin e dyte të këtij konstatimi theksojmë se nga shqyrtimi i bazës ligjore ne fuqi ne RSH nuk kemi konstatuar ndonjë konflikt të mundshëm interesi pasi sipas detyrave të përcaktuara në nenin 6 të kontratës, shoqëria koncesionare nuk ka detyrimin të kryejë riparime por ka vetëm një qellim në objektin e veprimtarisë, i cili lidhet vetëm me shërbimin e Kontrollit Ligjor të Instrumenteve Matëse, nëpërmjet Verifikimit të Instrumenteve Shpërndarëse të Karburantit dhe Gazit të Lëngshëm. Lidhur me Verifikimin Fillestar sqarojmë se është i përcaktuar Ligjin 9875 datë 1 4.02.2008 "Për metrologjinë", si edhe Urdhrin nr 1 95, datë 09.03.2009 "Për Verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matës ligjorisht të kontrolluar", në zbatim të tij.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit, ku nuk janë paraqitur argumente ose dokumente shtesë, sqarojmë se nuk merret në konsideratë.

Auditimi i dokumentacionit lidhet me projektzbatimin.

Lidhur me konstatimin nr.7 ku shpreheni se: "Projektzbatimi nuk jep informacion mbi tarifën e verifikimit jashtë rradhe, pra ku bazohet, kostimi i saj, pasi Udhëzimi nr.2, datë 08.02.2013 "Për tarifën dhe pagesat e shërbimeve të DPM", i ndryshuar. " ju bëjmë me dije se: Sipas përkufizimeve në kontratë verifikim jashtë radhe është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit, përkufizim i cili është i njëjtë me atë të ligjit nr.9875 datë 1 4. 02.2008 "Për metrologjinë". Gjithashtu nëni 14 pika 1 e kontratës së koncesionit parashikon se: "Tarifat e Shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do të jenë sipas sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave nr. 2 datë 08.02.2013. Në këtë Udhëzim janë të përcaktuara të gjitha tarifët për të gjitha llojet e verifikimeve të instrumenteve matës të cilat zbatohen nga shoqëria koncesionare për të gjitha llojet e verifikimit që kryhen. Gjithashtu, referuar pikës 9 të këtij Udhëzimi përkatësisht në fjalinë e dytë të kësaj pike "kur gjatë verifikimit instrumenti matës nuk i përgjigjet kërkesave teknike dhe metrologjike, ai bllokohet për mos përdorim dhe nga subjekti paguhet gjysma e pagesës së përcaktuar sipas pasqyrave nr.3 dhe nr.3.1 që i bashkëlidhen si edhe shpenzimet përkatëse të transportit për rastet që parashikohen në këtë udhëzim (nën pika 10.1 )" . Pra është e përcaktuar pagesa e tarifës në rastet kur gjatë verifikimit instrumenti matës nuk i përgjigjet kërkesave teknike dhe metrologjike, pasi ai bllokohet dhe subjekti paguan gjysmën e tarifës që paguhet në kushte normale. Në këto kushte nuk ka qenë e nevojshme përcaktimi i kostimit në projekt zbatim për verifikimet jashtë rradhe për sa kohë që aktet ligjore dhe nënligjore e kanë përcaktuar tarifën e tij..

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Për kronologjinë ngjarjesh dhe veprimesh:

- 1.Në studimin fizibilitetit, subjekti ka përcaktuar se verifikimi jashtë rradhe do të kryhet me tarifën e zakonshme duke i shtuar asaj edhe 20%.
- 2.Mbi bazën e këtij përcaktimi është bërë edhe parashikimi i të ardhurave nga ky shërbim, pjesë e të ardhurave totale të subjektit.
- 3.Mbi bazën e këtij përcaktimi është përgatitur dhe dorëzuar modeli financiar (të ardhurat nga shërbimi përbëhen nga verifikimi fillestar, periodik dhe ai jashtë rradhe, ku ky i fundit është parashikuar tarifën e zakonshme pra 6,000 lekë + 20% shtesë) gjatë zhvillimit të procedurës konkurruese (pra tenderit) dokument i cili është pjesë integrale e kontratës.

Në udhëzimin që përcakton tarifën e shërbimeve metrologjike, në asnjë rast nuk parashikohet se tarifa e verifikimit jashtë rradhe është 6,000 lekë + 20% shtesë. Përcaktimi (pra kur ndërpritet

verifikimi....) që ju pasqyroni nuk ka të bëjë me verifikimin jashtë rradhe. Ai përfshinë cdo lloj verifikimi, pra edhe atë periodik. Konkretisht në një datë të caktuar duhet të kryhet verifikimi periodik i detyrueshëm dhe Inspektorët e koncesionarit paraqiten në subjekt dhe fillojnë procedurën e verifikimit, por gjatë zhvillimit të procedurës të verifikimit periodik, instrumenti nuk funksionon si duhet. Në këtë rast aplikohet 1/2 e tarifës së zakonshme. Kjo mund të ndodhi edhe në verifikimin jashtë rradhe që ndodh pas riparimit, por kur ky verifikim ndërpritet gjatë zhvillimit të procedurës. Grupi i auditimit shprehet për verifikimin jashtë rradhe kur ai përfundon në kushte normale dhe arrihet qëllimi, duke iu referuar përcaktimit të bërë nga koncesionari në dokumentet e dorëzuara pranë MFE.

*Lidhur me konstatimin nr.8 ku shpreheni se: "Projektzbatimi, sa i përket software që do të instalohet me qëllim raportimin dhe monitorimin në kohë reale të shërbimit të verifikimit, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin "Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i informacionit ". Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me software, përdoruesit dhe produktet që përfitohen prej tij në varësi të përdoruesit, pasqyrohet informacioni për raportet e gjeneruara, si vijon: "Përdoruesit të cilët do kenë të drejta të shikojnë raportet apo të gjenerojnë raporte sipas disa indikatorëve, do munden ti shkarkojnë ato në një format lehtësisht të lexueshëm apo ti përdorin në raportet e tjera duke i shkarkuar në formën e imazhit. Sistemi do ti japë këtë mundësi përdoruesit që të zgjedhë formatin në të cilin do të shkarkoj raportin. Institucionet që do kenë akses në raportet dhe kontrollet e ndërmarra, do kenë mundësi ti marrin këto informacione për ti përdorur sipas nevojës me anë të grafikëve dhe tabelave të prodhuara nga sistemi". Ndërkohë në projektzbatimin për përdoruesin "Institucioni shtetëror", përcaktohet: "Ka mundësinë e aksesimit për të parë raportimet për rezultatet e verifikimeve të kryera në terren". Pra nuk përcaktohet aspak shkarkimi i raporteve të gjeneruara, apo për më tepër të përmbajtjes së këtyre raporteve, pra jo vetëm rezultatet e verifikimit në një subjekt, por edhe problematikat që kanë dalë nga verifikimet e kryera, koha mesatare për të realizuar rekomandimet që janë dhënë dhe masat që janë ndërmarrë. " sqarojmë se: Në dokumentin pjesë e ofertës teknike "Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit" tek pika 4 përshkrimi i programit kompjuterik tek seksioni Aksesimi i sistemit elektronik online përcaktohet si vijon: "Sistemi elektronik online do të ketë mundësi të aksesohet nga të gjitha palët pjesë e këtij procesi si stafi përkatës menaxherial, inspektorët në terren. ndërkohë që dhe institucionet përkatës shtetëror dhe klientët (subjektet që do të verifikohen) do ti mundësohet një akses "read only" për marrjen e raportimeve të ndryshme ... -Institucioni përkatës shtetëror ka mundësinë e aksesimit të sistemit elektronik online për të parë raportimet për rezultatet e verifikimeve të kryera në terren. Institucionit shtetëror nuk i mundësohet e drejta për editim të dhënash që do të thotë për modifikim, shtim apo fshirje të dhënash. Personat që do të kenë akses nga institucionet do të jenë të autorizuar nga koncesionari dhe do të duhet të kalojnë një proces trajnimi për sistemin. " I njëjti parashikim është përcaktuar edhe në faqen 17 të dokumentit të Projekt Zbatimit të dorëzuar nga shoqëria koncesionare me shkresën nr. 20667 datë 12.11.2019.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Grupi i auditimit i referohet shprehimisht:

- Kërkesave në DST që lidhen me kriteret teknike dhe në veçanti instalimin e software, kriter i cili ka edhe pikët maksimale;
- Parashikimit të vetë subjektit në dokumentin e dorëzuar si pjesë e ofertës teknike, me qëllim përmbushjen e kriterit teknik, zgjidhje dhe propozim i cili është vlerësuar me pikët maksimale pra 35 pikë;
- Kontratës koncesionare, pika 8.1, neni 8, ku përcaktohet qartë se projekt zbatimi nuk duhet të jetë në kundërshtim thelbësor me projektin e paraqitur nga subjekti gjatë ofertës teknike, për të cilin e ritheksojmë se ka marrë pikët maksimale.



Lidhur me konstatimin nr. 7 se: "Projektzbatimi sa i përket planit të burimeve njerëzore, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin "Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve ". Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me burimet njerëzore, përcaktohet se procesi i rekrutimit do të zgjasë 2 muaj, ndërkohë në projektzbatim nuk përcaktohet asnjë afat se sa do të zgjasë." Sqarojmë se neni 8.1 i kontratës së koncesionit parashikon se: "Faza e Projektit: Koncesionari duhet të realizojë dizejnimin e plotë të Projektit brenda 90 ditëve nga Data e Hyrjes ne Fuqi. Palët bien dakord qe Autoriteti Kontraktues do te shqyrtoje dhe miratoje brenda 15 ditësh kalendarike projektin e paraqitur nga Koncesionari, nëse ky Projekt nuk është në kundërshtim thelbësor me projektin e paraqitur nga Koncesionari në ofertën teknike." Një nga dokumentet e dorëzuara gjatë procedurës konkurruese është "Plani i zbatimit të projektit dhe ri investimit" dhe nga krahasimi i përmbajtjes së këtij dokumenti me Projekt zbatimin rezulton se lidhur me rekrutimin e stafit të dy dokumentet kanë përmbajtje të njëjtë. Gjithashtu në përmbajtjen e këtij dokumenti në faqen 15 tek seksioni "Monitorimi i planit të zbatimit" ndër të tjera përcaktohet se: "Rekrutimi si procesi më i rëndësishëm pritet që të zgjasë katër muaj. Ky aktivitet do të kërkojë më shumë kohë pasi do të lihet hapësirë për kohën e shpalljes, si dhe më pas për pjesët e tjera të procesit (testimi, intervistimi dhe marrja në punë)", gjë e cila pasqyrohet edhe në grafikun e planit kohor për fillimin e shërbimit në faqen 14 të këtij dokumenti. Edhe në përmbajtjen e grafikut të planit kohor për fillimin e shërbimit të Projektzbatimit faqja 33, afati kohor për rekrutimin e stafit është i njëjtë (katër muaj).

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë pasi nuk janë paraqitur shpjegime ose argumente shtesë nga sa shtjelluar në Akt-Konstatim.

Lidhur me konstatimin nr.8 ku shpreheni se: "Projektzbatimi sa i përket burimeve njerëzore, nuk përcakton aspak planin e trajnimit hyrës, ndërkohë në dokumentin e ofertës teknike "Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve", përcaktohet se si do të organizohet kursi hyrës i trajnimit teoriko-praktik sqarojmë se: Në përkufizimet e kontratës së koncesionit përcaktohet se "Plani i zbatimit të projektit është plani i Projektit i cili përmban përshkrimin e hollësishëm të punimeve dhe afatet e shërbimeve që do të kryhen nga Koncesionari për të realizuar dhe zbatuar Projektin". Nisur nga përkufizimi i mësipërm dhe përcaktimi i neni 8.1 të kontratës së koncesionit mospërcaktimi në projektzbatim i planit të trajnimit hyrës nuk përbën ndryshim thelbësor që të çojë në mosmiratimin e projekt zbatimit.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Grupi i auditimit i referohet shprehimisht dokumentit Plani i burimeve njerëzore dhe rekrutimit, dokument në të cilin përcaktohen politikat e burimeve njerëzore. Nuk i referohet projektit të zbatimit dhe riinvestimit, për të evidentuar një mangësi që lidhet me burimet njerëzore.

Lidhur me konstatimin nr.9 ku shpreheni se: "Projektzbatimi nuk jep informacion për kalibrimin e pajisjeve matëse, frekuencën e kalibrimit, laboratorin ku do të kalibrohen etj. " sqarojmë se në Projekt zbatim në faqen 12 shoqëria koncesionare është shprehur se të gjitha sistemet që do të përdoren nga N. I. do të kalibrohen sipas detyrimeve të kontratës së koncesionit dhe praktikave më të mira të sektorit. Gjithashtu referuar DST të procedurës konkurruese kjo është një kërkesë që nuk ka qenë e parashikuar në to dhe si rrjedhojë nuk ka qenë e detyrueshme për tu paraqitur as në ofertën konkurruese. Lidhur me frekuencën e kalibrimit sqarojmë se ajo është përcaktuar në nenin 26 të kontratës ku parashikohet se: "Autoriteti Kontraktues ka te drejte të zgjidhë kontratën: ... 26. 1.2 Në rast të moskryerjes në mënyrë të përsëritur të kalibrimit te paktën çdo 24 muaj kalendarikë te pajisjeve matëse përkatëse ne pronësi te Koncesionarit, Shoqërisë Koncesionare për kryerjen e verifikimit dhe ne rast mos përmbushjes se detyrimit ne lidhje me kalibrimin brenda një periudhe 12 mujore

*pas afatit te sipërcituar. Palët bien dakord qe kalibrimi është i nevojshëm për te ruajtur standardet e saktësisë ne matje."*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë. Pasqyrimi i informacionit se në cilët laborator do të kalibrohen pajisjet, ka rëndësi pasi është një nga elementët kryesor që siguron gjurmueshmërinë në matje. Subjekti mund të kryejë kalibrimin në laboratorë kalibrues të akredituar nga organe akredituese nënshkruese të marrëveshjes MLA-EA ose laboratorë kalibrues që kanë të regjistruara aftësitë matëse e kalibruese në databasë të BIPM. Përcaktimi i saj në projektzbatim, krijon mundësinë edhe për kontrollin e këtij elementi në vijimësi të zbatimit të kontratës së koncesionit.

*Lidhur me konstatimin nr.10 ku shpreheni se: "Projektzbatimi sa i përket shpenzimeve kapitale, nuk është në përputhje me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin "Plani i Zbatimit te Projektit dhe Ri-investimit". Konkretisht ne dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjate procedurës konkurruese, lidhur me shpenzimet kapitale, parashikohet investimi i detajuar. Pra ne projektzbatim ka një tjetër vlerë për investim. Për më tepër për pajisjen flowmetër nuk jepet informacion. Gjithashtu nuk ka një shpjegim për rritje të konsiderueshme të vlerës së investimit në sistemin online, si dhe në pajisje zyre. Vlera e investimit sipas projektzbatimit, nuk është në përputhje edhe me modelin financiar të dorëzuar nga OE gjatë procedurës konkurruese, ku përllogaritjet për vlerën e IRR dhe NPV janë bere për vlerën e investimit 70,000,000 lekë. Ndryshimi i vlerës së investimit, pra rritje te saj, përkthehet në rritje te kostove të subjektit, duke ndryshuar vlerën e NPV dhe IRR. Për me tepër që ndryshimi i vlerës së investimit krijon detyrimin për shoqërinë koncesionare që të dorëzojë modelin financiar të përditësuar. Gjithashtu në dokumentin e ofertës teknike te dorëzuar gjatë procedurës konkurruese "Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit ", makinat që do të përdoren si autolaboratar, janë tipi Volksäagen Transporter Van Tw KR 2.0 TD!, 75 Kw, ndërkohë në projektzbatim, makinat që do të përdoren si autolaborator janë tipi Ford Transit Custom. Referuar sa më sipër, projektzbatimi nuk është në përputhje të plotë me ofertën teknike, si dhe bazuar në kontratën koncesionare, neni 8, pika 8.1, NJZP nuk duhet të kishte shprehur miratimin e projektit të zbatimit, por t'ia rikthente Shoqërisë Koncesionare N. I., për korrigjim." Sqarojmë se: Kontrata e koncesionit në nenin 8. 1 të saj parashikon se: "Faza e Projektit: Koncesionari duhet të realizojë dizenjimin e plotë të Projektit brenda 90 ditëve nga Data e Hyrjes ne Fuqi. Palet bien dakord qe Autoriteti Kontraktues do te shqyrtoje dhe miratoje brenda 15 ditësh kalendarike projektin e paraqitur nga Koncesionari, nëse ky Projekt nuk është në kundërshtim thelbësor me projektin e paraqitur nga Koncesionari në ofertën teknike." Gjithashtu, neni 15 i kontratës së koncesionit parashikon se: "Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 70,000,000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, sipas Shtojcës 3, duke i lejuar Koncesionarit ndryshimet përkatëse në raport me zërat e paraqitur në projektin e investimit ". Në këtë kuptim, ndryshimi midis zërave të projekt zbatimit është i lejuar përsa kohë që i përmbahet elementëve të paraqitur në ofertën teknike. Pra, vlera prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, përcakton kufirin minimal të investimit që duhet të realizohet nga shoqëria koncesionare dhe nuk është një vlerë fikse për shkak të kompleksitetit të investimit për realizimin e shërbimit ku të gjitha pajisjet matëse/pajisjet ndihmëse/ si edhe certifikatat e kalibrimit në laboratorë të akredituar jashtë vendit, transporti i tyre, etj, nuk janë në vlera të fiksuara të cilat nuk ndryshojnë nga oferta teknike në projektin e zbatimit. Gjithashtu lidhur me konstatimin se nuk jepet informacion për zërin Floëmetër sqarojmë se investimi për këtë zë është përfshirë në zërin pajisje testuese, ku në faqen 32 të tij tek seksioni "Plani Financiar" tek zëri pajisje testuese specifikohet (nafta dhe GLN), ku pajisjet testuese GLN përbëjnë pikërisht zërin Flowmetër. Për sa i përket rritjes së vlerës në sistemin online në projektzbatim në faqen 15 "Kryerja e investimit për software" përcaktohet se: "Një nga zërat më të rëndësishëm të investimit qe do të kryhet është dhe software për Shoqërinë. Siç është diskutuar dhe ne analizën e riskut, për shkak të rëndësisë së madhe të software në realizimin e Shërbimit, N. I. ka vendosur që të angazhojë dy*

shoqëri të ndryshme për të realizuar secila software me kërkesat dhe karakteristikat e nevojshme. Përzgjedhja e shoqërive që po ndërtojnë software është bazuar në disa kritere kryesore, ku përfshihen përvoja në realizimin e projekteve, si dhe raporti kosto-përfitim ("value for money"), si dhe në faqen 32 të këtij dokumenti "Plani financiar" përshkruhet se: "Tabela e mësipërme është një parashikim, që bazohet mbi ofertat e marra si dhe kontratat e rena dakord. Sidoqoftë, duke qe se procesi i blerjeve është në vazhdim atëherë mund të ketë dhe ndryshime në zëra të caktuar, gjithmonë duke respektuar detyrimin për vlerën e investimit për tu kryer." Referuar sa më sipër vlera e investimeve e paraqitur në tabelën e investimeve në ofertën ofertën teknike ka qënë një parashikim nga ana e Koncesionarit në atë kohë, bazuar në çmimet e tregut të kohës kur është bërë procedura (viti 2018). Pra diferenca e shkaktuar vjen si rezultat i ndryshimit të çmimeve të tregut për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e shërbimit. Lidhur me konstatimin se ndryshimi i vlerës së investimit krijon detyrimin për shoqërinë koncesionare që të dorëzojë modelin financiar të përditësuar, pasi rritja e investimit përkthehet në ndryshim të IRR dhe NPV të paraqitur në procedurën konkurruese, sjellim në vëmendje se: Në kontratën e koncesionit tek përkufizimet parashikohet se: "Model Financiar" është: a) Modeli Financiar i paraqitur në ofertën e Koncesionarit; dhe b) pas kësaj date, modeli i përditësuar në përputhje me këtë Kontratë. " si dhe në nenin 15 parashikohet: "Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 70,000,000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, sipas Shtojcës 3, duke i lejuar Koncesionarit ndryshimet përkatëse në raport me zërat e paraqitur në projektin e investimit. " Referuar sa më sipër, në asnjë nen tjetër të kontratës nuk përcaktohet se nëse vlera e investimit është më e lartë koncesionari duhet të dorëzojë model financiar të përditësuar. Lidhur me ndryshimin e IRR kontrata ka vetëm një parashikim konkretisht në nenin 14.7 ku parashikohet se: "Nëse në çdo kohë, pas Datës Efektive Koncesionari/Shoqëria Koncesionare pëson një pakësim në të ardhurat për njëdhjetë të rënies së numrit të verifikimeve të inspektimeve, që nuk lidhet me ndryshime ligjore, që shkakton një zvogëlim të IRR së parashikuar në Modelin Financiar me më shumë se 2%. atëherë Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa, ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qënë nëse nuk do të kishte ndodhur ky pakësim në numrin e verifikimeve si treguar në këtë paragraf " Duke qënë se në momentin e realizimit të investimeve jemi para faktit që akoma nuk janë plotësuar të gjitha kushtet për fillimin e datës efektive të kontratës, nuk jemi as në kushtet e zbatimit të këtij neni mbi bazën e të cilit koncesionari mund të sillte ndonjë njoftim për ndryshim. Lidhur me konstatimin se automjetet që do të përdoren si autolaboratorë në Projekt zbatim janë të ndryshme nga ato të dorëzuara në ofertën teknike, sjellim në vëmendje se në Dokumentin "Pajisjet, Logj i stika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit" të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese përcaktohet se shoqëria do të blejë "7 automjete me karakteristika të ngjashme të automjetit tip Volksäagen Transporter Van T6 KR 2.0 TD1 75 kW, Modeli high roof, me qëllim që për çdo rast, të jetë e mundur që në secilin automjet të mund të instalohen 2 (dy) pajisje testuese/sisteme matës për verifikimin e shpërndarësve, përkatësisht 1 (një) për karburantet dhe 1 (një) për GLN". Për më tepër në nenin 8.3 të kontratës parashikohet se: "Gjatë kohëzgjatjes, Shoqëria Koncesionare bie dakord të kryejë Shërbimin duke përdorur pajisjet e përmendura në Shtojcën 2, ose pajisje ekuivalente (këto pajisje së bashku me të gjitha zëvendësueset dhe përfshirë punimet civile dhe sistemet e lidhura me to, referohen bashkërisht si "pajisjet ") sipas termave dhe kushteve të kësaj Kontrate. " Në vijim të këtij përcaktimi projekt zbatim parashikon se: "N. I. parashikon të blejë rreth 7 furgona që do të shërbejnë për mbajtjen e sistemeve matëse dhe për kryerjen e Shërbimit. Përzgjedhja e tipit të furgonit është bazuar mbi këto kritere kryesore: a) përmasat e furgonit janë të tilla që lejojnë futjen e dy sistemeve matëse (si ai për karburant dhe ai për GLN), si dhe të kenë mundësi për të mbajtur 2 deri në 3 persona;" Për sa më sipër, blerja nga ana e shoqërisë koncesionare si autolaborator të automjeteve Ford Transit Custom nuk është në kundërshtim me parashikimet e kontratës për

*sa kohë që këto automjete plotësojnë kriteret teknike për mbajtjen e dy sistemeve matëse (për karburant dhe për GLN). Referuar argumenteve më sipër konstatimet tuaja nuk qëndrojnë.*

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se merret në konsideratë pjesërisht.

1. Kontrata përcakton vlerën totale të investimit dhe nuk shpjegohet se ku bazoheni ju që vlera totale është vlera minimale.

2. Kontrata përcakton ndryshimin ndërmjet zërave, pra ulet çmimi i mjeteve dhe rritet çmimi i pajisjeve, por gjithmonë duke ruajtur vlerën totale të investimit.

3. Padyshim që koncesionari mund të investojë më tepër, por këtu jemi në projekt zbatim të cilin duhet ta pasqyrojë pa ndryshim thelbësor në krahasim me dokumentet e dorëzuara gjatë ofertës. Diferenca prej 4,955,458 lekë (vlera e investimit në dokumentet e ofertës me vlerën e investimit në projekt zbatim) është ndryshim thelbësor. Për më tepër që edhe garancia e kontratës është 7,000,000 lekë / 10% të vlerës së investimit, ndërkohë me investimin sipas projekt zbatimit duhet të ishte ndryshe.

4. Nuk është gabim që të investojë në sistemin software, por grupi i auditimit është shprehur se ka një rritje të konsiderueshme, ku minimalisht për transparencë duhet të ishte dhënë një argument nga koncesionari, megjithatë ky observacion si dhe ai për flowmetër, merret në konsideratë.

5. Deri në momentin që kontrata parashikon modelin financiar të përditësuar, atëherë ndryshimi i vlerës së investimit, elementi kyç në modelin financiar, qarkullimin e parasë, vlerën aktuale neto, normën e kthimit nga investimi, kërkon edhe ndryshimin e modelit financiar, pra përditësimin e tij.

6. Lidhur me automjetet, sqarojmë se nuk është e drejtë që subjekti gjatë zhvillimit të procedurës të pasqyrojë se do të investojë në mjete të një marke të caktuar dhe pasi është shpallur fitues të investojë në të tjera mjete (ky ndryshim duhet të ishte evidentuar nga NJZP), ku zgjedhja e një mjeti nuk bëhet vetëm për hapësirën e mjaftueshme për sistemin matës, por edhe për parametra të tjerë (rezistenca, siguria, shpejtësia, konsumi i karburantit, kosto mirëmbajtje), ku jo pa qëllim vlerat e tyre ndryshojnë, element që tregon edhe ndryshimin në cilësi. Automjetet nuk janë pajisje, për të justifikuar argumentin tuaj mbështetur në pikën 8.3.

*Auditimi i dokumentacionit mbi investimin e kryer.*

*Lidhur me konstatimin nr.9 ku shpreheni se: "Në dosje nuk administrohet raporti i investimeve të realizuara, përcjellë nga shoqëria koncesionare N. I. shpk, me shkresën nr. 14., datë 17.01.2020 protokolluar në MFE me shkresën nr.992, datë 17.01.2020. " sqarojmë se ky raport së bashku me shkresën përcjellëse ka qenë pjesë e dokumenteve që ju janë vënë në dispozicion nga MFE gjatë procesit të auditimit. Megjithatë meqenëse shpreheni se nuk e keni administruar po jua vëmë në dispozicion edhe njëherë.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Lidhur me konstatimin nr.10 ku shpreheni se: "NJZP përpara kryerjes së verifikimit të investimit të realizuar nga shoqëria koncesionare N. I. shpk, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës të konfliktit të interesit " sqarojmë se bazuar në ligjin nr.9367 datë 07.04.2005, ku në nenin 7 pika 1 parashikohet se "Çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetë deklaram paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi " dhe duke qenë se asnjë nga anëtarët e NJZP nuk ka bërë të ditur ekzistencën e interesave të tij privatë lidhur me ushtrimin e funksioneve si anëtar i NJZP, apo të jetë në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e kësaj detyre nuk është vlerësuar i nevojshëm nënshkrimi i kësaj deklarate.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Në lidhje me konstatimin nr.11, ku pohohet se "Nuk administrohet asnjë dokumentacion mbështetës që vërteton investimet e kryera, duke i 'u referuar edhe mbishkrimit në raportin e verifikimit të mbajtur nga NJZP, shprehimisht: 'Gjithashtu u kërkua dokumentacioni mbështetës që vërteton investimet e kryera '", sqarohet se ky dokumentacion administrohet nga NJZP dhe protokollin i MFE-së. Ky dokumentacion është përcjellë nga shoqëria koncesionare me anë të shkresës nr.14 prot., datë 17.01.2020, protokolluar në MFE me nr.992, datë 17.01.2020 së bashku me raportin e investimeve të realizuara. NJZP ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e dërguar, të cilin e gjeni bashkëlidhur, informacioni i cili është dorëzuar grupit të auditit që në fillim të procesit të auditimit. (Bashkëlidhur dokumentet shoqëruese).*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Në lidhje me konstatimin nr.12 ku pohohet se "Investimi i kryer, sipas informacionit të paraqitur në raportin nr.2, datë 24.01.2020 të mbajtur nga NJZP, për verifikimin e investimit të kryer, është në vlerën 79, 305,455 lekë, pra jo sa vlera e përcaktuar në nenin 15 të kontratës koncesionare, në projekt zbatimin, modelin financiar dhe planin e zbatimit dhe ri-investimit. Theksojmë se realizimi i investimit jo sipas përcaktimeve të mësipërme, sjellë moszbatimin e nenit 9, pika 9.1 në kontratën koncesionare, sa i përket garancisë në vlerën 7,000,000 lekë në masën 10 % të vlerës së investimit. Theksojmë se në nenin 15 është përcaktuar që v/era e investimit do të jetë 70,000,000 lekë, pra sipas shtojcës 3 "Modeli financiar ". Në vijim në nenin 15 përcaktohet se do të lejohen ndryshime ndërmjet zërave të investimit. Sa më sipër NJZP nuk duhet të kishte propozuar miratimin e investimit të kryer, por të rekomandonte kryerjen e tij sipas parashikimeve kontraktuale "sqarojmë si më poshtë: Në nenin 15.1 të Kontratës së Koncesionit përcaktohet se "Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 70,000,000 (shtatëdhjetë milion Lekë) sipas Shtojcën 3, duke i lejuar Koncesionarit ndryshimet përkatëse në raport me zërat e paraqitur në projektin e investimit ". Në interpretim të kësaj dispozite është përcaktuar vlera e investimit prej 70,000,000 (shtatëdhjetë milion Lekë), por kjo dispozitë nuk ndalon Shoqërinë Koncesionare ta tejkalojë këtë vlerë, përse kohë që janë realizuar investimet sipas planit të investimeve dhe ofertës teknike të paraqitur. Ndërkohë në Nenin 9 të Kontratës së Koncesionit parashikohet se: "Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose të sigurojë në një shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 7,000,000 (shtatë milion) lekë, që përbën 10 % të vlerës totale të investimit për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. " Pra në këtë kuptim, ky është një detyrim për koncesionarin që ka një vlerë të përcaktuar dhe që është pënbushur nga koncesionari para nënshkrimit të kontratës.*

*Përse i përket konstatimit tuaj ku shpreheni se: Ish Ministri i MFE, znj. A. D. është informuar nëpërmjet MEMO nr. 99211 prot., datë 11. 02.2020, përgatitur nga z. D. D., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Apelitit Tatimor pranë MFE, nëpërmjet ish Drejtorit të Kabinetit, z. R. P., për mangësitë e evidentuara në lidhje me investimin e kryer. Në këtë MEMO pasqyrohet informacioni se investimi i realizuar nuk është në përputhje me vlerën e investimit të pasqyruar në dokumentet e procedurës konkurruese "Plani i zbatimit të projektit dhe ri-investimit " dhe "Modeli financiar". Pavarësisht se ish Ministri është njohur me mangësitë, nuk ka kërkuar korrigjimin e tyre, por përkundrazi me shkresën nr. 1488/1 prot., datë 11.03.2020 ka njoftuar Shoqërinë Koncesionare N. I. Sh.P.K, mbi miratimin e investimit", sqarojmë se: NJZP është njohur më këtë Memo dhe i ka argumentuar titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me anë të Memos nr.992 prot., datë 18.02.2020 se këto konstatime nuk qëndrojnë duke i paraqitur edhe argumentet përkatëse referuar Neneve përkatëse të Kontratës së*

*Koncesionit. (Bashkëlidhur gjeni Mernon dhe Raportin e NJZP dërguar Ministrin të MFE-së lidhur me këtë konstatim).*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë, të cilin e kemi të mbështetur në detyrimet kontraktuale. Në një auditim përputhshmërie vlerësohet nëse veprimi i materializuar në dokument është në përputhje me kriteret ligjore, në këtë rast kontrata.

*Në lidhje me konstatimin tuaj nr.13, ku shpreheni se: "Nuk administrohet polica e sigurimit të pronës, pajisjeve, si dhe polica e përgjegjësisë civile dhe e produktit, për periudhën nga lidhja e kontratës deri në datë 20. 09.2021 (për policën e përgjegjësisë civile dhe të produktit) dhe deri më datë 13. 12.2021 për pronën. Sa më sipër nuk vërtetohet përmbushja e nenit 18 të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K. " Sqarojmë se në zbatim të Nenit 18 të Kontratës së Koncesionit "Sigurimet e Nevojshme", është administruar dhe u është vënë në dispozicion polica e sigurimit pronës, pajisjeve, si dhe polica e përgjegjësisë civile dhe e produktit, për periudhën nga lidhja e kontratës deri në datë 20.09.2021 (për policën e përgjegjësisë civile dhe të produktit) dhe deri më datë 13.12.2021 për pronën, të cilat po jua ridërgojmë bashkëlidhur. (Bashkëlidhur dokumenti).*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Në lidhje me konstatimin tuaj nr.14 ku shpreheni se: Nuk administrohet polica e sigurimit të pronës, pajisjeve, si dhe polica e përgjegjësisë civile dhe e produktit, për periudhën nga data 20.09.2022 dhe në vazhdim (për policën e përgjegjësisë civile dhe të produktit) dhe nga data 13.12.2022 në vazhdim, për sigurimin e pronës. Sa më sipër nuk vërtetohet përmbushja e nenit 18 të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K. Sqarojmë se në zbatim të Nenit 18 të Kontratës së Koncesionit "Sigurimet e Nevojshme", është administruar dhe u është vënë në dispozicion polica e sigurimit të pronës, pajisjeve, si dhe polica e përgjegjësisë civile dhe e produktit, për periudhën nga data 20.09.2022 dhe në vazhdim (për policën e përgjegjësisë civile dhe të produktit) dhe nga data 13.12.2022 në vazhdim, për sigurimin e pronës, të cilat po jua ridërgojmë bashkëlidhur. (Bashkëlidhur dokumenti)*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Në lidhje me konstatimin tuaj nr.15 ku shpreheni se: "Polica e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë me nr. COM000200812311, datë 13. 12.2021, me objekt të siguruar "Zyra", është lëshuar për pronën me adresë: "Rruga Nikolla Tupe, ndërtesa nr. 3, kati i 1, Tiranë, ndërkohë adresa e ushtrimit të aktivitetit, është me vendndodhje "Bulevardi Deshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2 ", Tiranë. Pra nuk përputhet objekti i siguruar me objektin në të cilin Shoqëria Koncesionare N. I. Sh. P.K, ushtron aktivitet." Polica e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë me nr.COM0002008/231, datë 13.12.2021, është lëshuar me objekt të siguruar "Inventar" dhe jo "Zyra", duke qenë se këto të fundit nuk janë në pronësi të Shoqërisë Koncesionare, pasi në të dy selitë e saj ku kjo e fundit ka ushtruar aktivitetin përmes kontratave respektive të qiramarrjes. Objektet e siguruara të quajtura në policë ' inventar' i përkasin Auto-laboratorëve në pronësi të Shoqërisë Koncesionare, pajisje të tjera portabël të përdorur nga kjo shoqëri për veprimtarinë e saj si dhe laptop e kompiutera, etj . Ky 'inventar' pavarësisht adresës ku ushtrohet aktiviteti mbetet i pandryshuar siç edhe mund të konstatohet nga Shuma e Sigurimit (Vlera e Marrjes në Sigurim) e cila vazhdon të mbetet 47.000.000 Lekë. Në lidhje me konstatimin tuaj ku shpreheni se: "Ministria u ka dërguar të gjithë subjekteve me pakicë të hidrokarbureve, shkresën me nr. 21411 prot, date 31.01.2020 me lëndë: "Njoftim mbi kalimin e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës nëpërmjet verifikimit të instrumenteve matës shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm " shoqërisë N. I. shpk, ku i detyron të gjitha subjektet të pranojnë shërbimin e verifikimit të instrumenteve matës vetëm*

nga ky subjekt si e drejtë ekskluzive duke bërë mbivendosje detyrash me institucionin që vazhdon të kryente shërbimin e verifikimit të instrumente matës në zbatim të ligjit "Për metrologjinë", ju bëjmë me dije se: Në zbatim 7.3 të kontratës së koncesionit Autoriteti Kontraktues ka detyrim kontraktual të njoftojë të gjithë Subjektet e Detyruara për kalimin e këtij shërbimi te Shoqëria Koncesionare. "...Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktues duhet të njoftojë të gjithë Subjektet e Detyruara për kalimin e këtij shërbimi të shoqëria Koncesionare...". Gjithashtu në Nenin 20.2 të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues merr përsipër përbushjen e detyrimeve të mëposhtme: "20.2.1. Të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet që të përbushë brenda afateve të arsyeshme dhe pa vonesa veprimet e përcaktuara në këtë kontratë, si dhe Neni 20.2.2 Të garantojë vazhdimësinë e kontratës së koncesionit pavarësisht nga ndryshimet e objektivave apo të legjislacionit në Shqipëri në lidhje me sektorin ku vepron Koncesionari. Që në momentin e lidhjes së kontratës datë 21.08.2019, Koncesionari përmes nenit 3.3 ka të drejtën e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e objektit të Kontratës së Koncesionit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës koncesionare. Në asnjë rast, Autoriteti Kontraktues apo çdo institucion shtetëror të çfarëdo niveli, apo tjetër organizatë me funksione publike të deleguara nuk do të lidhë kontratë apo të licencojë, autorizojë, apo të kryejë çfarëdo veprimi që do të kalonte një pjesë apo të gjithë shërbimin ndonjë pale tjetër, ose të ndërmarrë ndonjë veprim duke përfshirë përfundimin e kontratës që mund të ndikojë negativisht në këtë të drejtë të dhënë Koncesionarit të kësaj kontrate.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr. 16 ku shpreheni se: "Nga auditimi i dokumentacionit për raportimet periodike (3-mujore dhe vjetore) te Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, në zbatim të nenit 19 të kontratës koncesionare, rezulton se për vitin 2020 në dosjen e zbatimit të kontratës koncesionare, nuk administrohet raportimi periodik për 3 mujorin (Prill-Qershor 2020; Korrik-Shtator 2020; Tetor-Dhjetor 2020)", ju bëjmë me dije se ky konstatim nuk qëndron. Raportimet 3-mujore dhe vjetore të Shoqërisë Koncesionare administrohen nga Drejtoria e Koncesioneve dhe ky dokumentacion i është vënë në dispozicion që në fillim të procesit grupit të auditimit, megjithatë po ju ridërgohet përsëri. (Bashkëlidhur dokumenti)

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr.17 ku shpreheni se "Me shkresën nr.808, datë 18.01. 2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin vjetor 2020. Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur", ju bëjmë me dije se ky konstatim nuk qëndron. Raportimi vjetor 2020 i përcjellë nga Shoqëria Koncesionare administrohet nga Drejtoria e Koncesioneve dhe ky dokumentacion i është vënë në dispozicion që në fillim të procesit grupit të auditimit; megjithatë po ju ridërgohet përsëri. (Bashkëlidhur dokumenti)

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr.18 ku shpreheni se: "Me shkresën nr.8052, datë 06.05.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Janar-Mars 2021. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor). Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për: Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle; (ligji 126, neni 21) •Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 31.03.2021 dhe të krijuar brenda 3-mujorit të raportuar; •Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar; •Numrin e

subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi; •Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin "instrument matës jo në përdorim" kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit; •Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë 3-mujorit të raportuar; •Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar; •Tarifat e aplikuar, pra 629 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 336 inspektime jashtë rradhe me tarifën përkatëse. •Tarifat e aplikuar për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin; •Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik; •Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur defekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit; •Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer. " Ju sqarojmë se në nenin 19 përcaktohet se: "Koncesionari/Shoqëria Koncesionare është i detyruar që çdo 3(tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoriteti Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e verifikimeve, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues. Në fund të çdo viti Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të dorëzojë një raport për periudhën 12 mujore të aktivitetit të tij. " Duke qenë se kontrata nuk përcakton një format eksplisit raportimi, shoqëria koncesionare përveç raportimeve periodike 3 mujore apo vjetore, paraqet në mënyrë të vazhdueshme korrespondencat sipas natyrës së problematikave tek Autoriteti Kontraktues. Kështu ka ndodhur edhe në lidhje me numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin "instrument matës jo në përdorim" kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit, për të cilat shoqëria koncesionare ka raportuar me anë të shkresës nr. 16565 prot., datë 30.09.2021. (Shkresa bashkëlidhur) Në lidhje me tarifat e aplikuar për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, në rastin kur e kalojnë apo jo testin, sqarojmë se këto tarifa janë të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 08.02.2013 të Ministrit të Ekonomisë, Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe janë standarde dhe të aplikueshme për çdo verifikim. Lidhur me konstatimin se në raport mungon numri i kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle; (ligji 1 26, neni 21 ), ju sqarojmë se bazuar në nenin 22 pika 1 të ligjit 1 2612020 "Për metrologjinë" ku përcaktohet se: "... Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik ", shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit dhe parashikimit të mësipërm ligjor me ofrimin e shërbimeve të saj realizon edhe sigurimin e regjimit automatik.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Elementët e cituar nga grupi i auditimit lidhen tërësisht me zbatimin e kontratës koncesionare, të cilat nëse pasqyrohen plotësisht ofrojnë një panoramë të plotë të aktivitetit të koncesionarit. Nuk ka nevojë të përcaktohet një format eksplisit për raportimin, pasi kuptohet qartë, çfarë detyrimesh kontraktore ka subjekti, pra për realizimin e objektit të koncesionit, ku një pjesë e detyrimeve gjenden në kontratë dhe një pjesë në shtojcat e kontratës, si pjesë integrale e kontratës.

Për regjimin automatik nuk jemi shprehur përse e kryen koncesionari, por në raportimin periodik, të jap informacion të detajuar për këtë detyrë, si dhe për çdo detyrë në zbatim të kontratës koncesionare.

Argumenti i mësipërm vlen edhe për observacionet e bëra për pikat 20, 22 dhe 25.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr. 19 ku shpreheni se: "Në dosje nuk administrohet informacioni i përgatitur nga NJZP, mbi bazën e raportimit 3- mujor, drejtuar përfaqësuesit të AK, në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë së Koncesioneve. Gjithashtu edhe nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, pavarësisht faktit se është njohur me raportin 3 mujor të mësipërm, në zbatim



të shtojcës 4, nuk la raportuar tek AK për ecurinë e zhvillimit të projektit. "ju sqarojmë se Njësia e Zbatimit të Projektit është një strukturë e ngritur nga Ministri i MFE për mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të kontratës së Koncesionit dhe informimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me ecurinë e zbatimit të saj dhe për këtë arsye të gjitha informacionet e përgatitura nga NJZP mbi raportet 3-mujore të monitorimit i janë përcjellë titullarit të AK. Gjithashtu duke qenë se dokumentacioni lidhur me ecurinë e kësaj kontrate administrohej edhe në Drejtorinë e Koncesioneve, informacioni lidhur me raportimet periodike të kësaj kontrate i janë përcjellë nga Drejtoria e Koncesioneve titullarit të AK me anë të memo-ve të raportimeve periodike 3-mujore të përgatitura në zbatim të nenit 10 të ligjit 125/20 13 "Për koncesionet/PPP " i ndryshuar.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Nuk ka asnjë pengesë ligjore që të përgatiten raporte informuese për Ministrin e MFE dhe shumë mirë që bëhen, por si fillim raportimi duhet bërë pranë pikës së kontaktit, që përfaqëson AK në këtë marrëdhënie kontraktore.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr. 20 në të cilin shpreheni se: "Me shkresën nr. 13070, datë 21.07.2021, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh. P.K, për aktivitetin 3 mujor, Prill-Qershor 2021, si dhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2020. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor dire PF 2020) - Nga auditimi i raportit të mësipërm konstatohet se ai nuk pasqyron informacion për: •Numrin e kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle; •Numrin e subjekteve debitore, si dhe vlerën e debisë së krijuar, progresive deri në datë 30.06.2021 të krijuar brenda 3-mujorit të raportuar; •Numrin e trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar; •Numrin e subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë aplikimi; •Numrin dhe listën e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin "instrument matës jo në përdorim " kanë kaluar afatin 30- ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit; •Numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë 3-mujorit të raportuar; •Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar; •Tarifat e aplikuara pra 607 inspektime fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 363 inspektime jashtë radhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin; •Listën e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik; •Gjëndjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur defekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit; •Databazën e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer." Ju sqarojmë se në nenin 19 përcaktohet se: "Koncesionari/Shoqëria Koncesionare është i detyruar që çdo 3(tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoriteti Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e verifikimeve, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues. Në fund të çdo viti Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të dorëzojë një raport për periudhën 12 mujore të aktivitetit të tij. "Duke qenë se kontrata nuk përcakton një format eksplisit raportimi, shoqëria koncesionare përveç raportimeve periodike 3 mujore apo vjetore, paraqet në mënyrë të vazhdueshme korrespondencat sipas natyrës së problematikave tek Autoriteti Kontraktues. Ndërkohë, në lidhje me tarifat e aplikuara për verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, në rastin kur e kalojnë apo jo testin, këto tarifa janë ato të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 08.02.2013 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave. Lidhur me konstatimin se në raport mungon numri i kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle; (ligji 126, neni 21), ju sqarojmë se bazuar në nenin 22 pika 1 të ligjit 126/2020 "Për metrologjinë" ku përcaktohet se: "...Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë

*kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik ", shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit dhe parashikimit të mësipërm ligjor me ofrimin e shërbimeve të saj realizon edhe sigurimin e regjimit automatik. Kjo nënkupton që të dhënat lidhur me numrin e regjimit automatik dhe subjektet ku është kryer ky shërbim janë apriori të njëjta me numrin e verifikimeve, duke qenë se verifikimi dhe regjimi janë një shërbim i cili jepet njëherazi.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Elementët e cituar nga grupi i auditimit lidhen tërësisht me zbatimin e kontratës koncesionare, të cilat nëse pasqyrohen plotësisht ofrojnë një panoramë të plotë të aktivitetit të koncesionarit. Nuk ka nevojë të përcaktohet një format eksplicit për raportimin, pasi kuptohet qartë, çfarë detyrimesh kontraktore ka subjekti, pra për realizimin e objektit të koncesionit, ku një pjesë e detyrimeve gjenden në kontratë dhe një pjesë në shtojcat e kontratës, si pjesë integrale e kontratës.

Për regjimin automatik nuk jemi shprehur përse e kryen koncesionari, por në raportimin periodik, të jap informacion të detajuar për këtë detyrë, si dhe për çdo detyrë në zbatim të kontratës koncesionare.

*Lidhur me konstatimin nr.21, 23, vlen i njëjti argument i dhënë për konstatimin nr. 19. - Lidhur me konstatimin nr. 22, 25 ku shpreheni lidhur me mungesën e informacionit në raportin 3-mujor periodik të dërguar nga shoqëria koncesionare vlen i njëjti argument i përgatitur për konstatimin nr. 20. - Lidhur me konstatimin nr.24 ku shpreheni se: "Me shkresën nr. 52, datë 27.01.2022, administrohet raportimi i Shoqërisë Koncesionare N. I. Sh.P.K, për aktivitetin 3 mujor, Tetor-Dhjetor 2021. Në këtë shkresë pasqyrohet informacioni (Bashkëlidhur raporti tremujor) - Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk ka raport bashkëlidhur. "ju sqarojmë se ky raport është dorëzuar nga shoqëria koncesionare bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, dhe mbi bazën e tij NJZP ka përgatitur informacionin për titullarin e AK, të cilat po jua vendosim në dispozicion bashkëlidhur.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Nuk ka asnjë pengesë ligjore që të përgatiten raporte informuese për Ministrin e MFE dhe shumë mirë që bëhen, por si fillim raportimi duhet bërë pranë pikës së kontaktit, që përfaqëson AK në këtë marrëdhënie kontraktore.

*Nga auditimi i dokumentacionit për monitorime të kryera nga AK lidhur me zbatimin e kontratës koncesionare, rezulton se: Në lidhje me konstatimin tuaj nr.30, ku shpreheni se: "Ish Ministri i MFE-se znj. A. D. ka vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13, pikat 13.2.1 dhe 13.2.2 të kontratës koncesionare. Konkretisht në referencat ligjore, përcaktohet se AK ngre NJZP, e cila do të monitorojë zbatimin e kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh. P.K. Në periudhën në të cilën është nxjerrë urdhri i ish Ministrit të MFE, ka funksionuar NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar, S. D., J. Ll., A. A., Anëtar. Sa më sipër NJZP duhet të kryente monitorimin dhe Ministri i MFE nuk duhet të kishte nxjerrë urdhër për ngritjen e një grupi tjetër monitorimi. " ju bëjmë me dije se: Kontrata e Koncesionit në nenin 20.1.1 përcakton të drejtën e Autoritetit Kontraktues për monitorimin, inspektimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e çdo faze të zbatimit të kontratës, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare. Kjo nënkupton që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ngrëjë në çdo kohë grupe monitorimi të kontratës së koncesionit, përveç NJZP-së.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Personat e autorizuar janë përcaktuar që në krye të herës, pra NJZP, jo pa qëllim është një nen që përcakton monitorimin dhe kush e kryen monitorimin.

Në lidhje me konstatimin nr.31 ku shpreheni se: "Grupi i monitorimit përpara kryerjes së monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit " ju bëjmë me dije që deklaratat e ekzistencës ose jo të konfliktit të interesit janë nënshkruar nga anëtarët e grupit, por këto deklarata nuk kanë qenë në listën e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i auditimit. Megjithatë një kopje të këtyre deklaratave do i gjeni bashkëlidhur. (Bashkëlidhur deklaratat). **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

-Në lidhje me konstatimin nr.32, ku shpreheni se: "Raporti i monitorimit nuk pasqyron informacionin: Për tarifën e aplikuarë për verifikimin fillestar, periodik dhe jashtë rradhe. Tarifën e aplikuarë për instrumentet matës ligjërish të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin; •Për trajnimet e kryera të punonjësve, pra sa trajnime janë kryer, punonjësit e trajnuar; •Policat e sigurimit të pronës dhe përgjegjësisë civile të produktit; Për rekrutimet, pra punonjësit e rekrutuar dhe formimi arsimor i tyre; •Subjektet debitorë që nuk kanë likuiduar tarifën vlera debitorë; •Përse Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit; •Në çfarë gjendje teknike janë pajisjet e punës, sa prej tyre janë përdorur dhe certifikatat e kalibrimit për secilën; • Sa është numri i kontroleve për regjimin automatik; •Pra nuk sigurohet zbatimi plotë i Urdhrit nr. 79, datë 29.04.2021 të ish Ministrisë të MFE, znj. A. D., pasi në këtë urdhër është kërkuar kryerja e monitorimit dhe verifikimit për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, të cilat i keni cituar më sipër •Gjithashtu nuk jepet informacion nëse subjekti ka hartuar procedurën për kontrollin e regjimit automatik në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 21.05.2020 " sqarojmë se: Në lidhje me tarifën e aplikuarë për verifikimin e instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar, në rastin kur e kalojnë apo jo testin, këto tarifa janë ato të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 08.02.2013 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave, tarifa këto të aplikueshme edhe nga shoqëria koncesionare në bazë të parashikimeve të kontratës së koncesionit, konkretisht nenit 14. 1 të saj . Në lidhje me trajnimet, rekrutimin e stafit dhe formimin arsimor të tyre, shprehem se në raportin nr.779 l.prot., datë 20.05.2021 të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.79 datë 29.04 2022, në faqen 7 të tij tek seksioni "Problematika të hasura gjatë zbatimit të kontratës" paragrafi 2, grupi i punës është shprehur se: "...Faza e dytë ka qenë e lidhur me kryerjen e aktiviteteve të nevojshme për fillimin e Shërbimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar: a) kryerjen e investimit për blerjen e pajisjeve; b) realizimin e investimit për softëware; c) rekrutimin e stafit; ç) trajnimin e stafit; d) vendosjen në punë të pajisjeve, funksionimin e sistemit software, dhe përgatitjet e tjera të nevojshme për fillimin e Shërbimit. Edhe në këto aspekte, si kundër është provuar dhe demonstruar nga raportet periodike tre mujore dhe vjetore, të përcjella pranë MFE nga N. I., kjo e fundit ka patar zhvillime të rëndësishme dhe sistematike të realizimit të projektit, duke paraprirë edhe afatet e përcaktuara nga Kontrata e Koncesionit për realizimin e fazave të projektit. Aktualisht shoqëria koncesionare "N. I. " sh.p. k ka blerë, kalibruar dhe vendosur në funksionim të gjithë pajisjet e propozuara në ofertën e saj dhe Projektin e parashtruar pranë MFE në Nëntor 2019, dhe të miratuar nga kjo e fundit në Janar 2020, duke mundur në këtë mënyrë fillimin e shërbimit në datë 31.03.2020. Fillimi i vitit 2020 ka përkuar edhe me përfundimin e procesit të rekrutimit dhe trajnimit hyrës dhe praktik të inspektorëve të N. I., dhe vijimësia e vitit 2020, në këtë drejtim, ka qenë e shoqëruar edhe nga intervale të tjera trajnimit të inspektorëve, në varësi të standardeve që zbaton shoqëria koncesionare "N. I. " sh.p.k në realizimin e Shërbimit të Koncesionit. " Gjithashtu, në pikën 8 të rekomandimeve grupi i punës në zbatim të nenit 21 .2.2 pika (j) ka rekomanduar shoqërisë koncesionare për realizimin e trajnimeve të vazhdueshme për të gjithë personelin e shoqërisë koncesionare i cili është punësuar apo angazhuar në shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Në lidhje me policat e sigurimit, sqarojmë

që shoqëria koncesionare ka plotësuar detyrimet e saj kontraktuale lidhur me këtë nen. Grupi i monitorimit i ka disponuar këto dokumentacione dhe i ka vënë bashkëlidhur raportit të monitorimit të hartuar nga ana e tyre për dijeni të Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu lidhur me policën e sigurimit të pronës dhe përgjegjësisë civile të produktit sqarojmë se grupi i punës në rekomandimin nr. 7 të raportit të përgatitur, në zbatim të nenin 21 .2.2 pi ka (h) ka kërkuar nga ana e shoqërisë koncesionare marrjen e të gjitha masave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për garantimin dhe respektimin e parashikimeve ligjore mbi punësimin, sigurinë, disiplinën teknike, kushtet e sigurimit në punë, higjienën dhe mbrojtjen nga zjarri, trajnimin e personelit në mënyrë që të parandalojë çdo dëm apo aksident në punë ashtu si dhe të shmangë dëme ndaj mjedisit, pronës publike dhe private. Lidhur me debitorët dhe vlerat e debisë së tyre sqarojmë se shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit me anë të korrespondencave të vazhdueshme të mbajtura me AK ka përcjellë listën e debitorëve të subjekteve të detyruara. Sa i përket faktit se përse N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimitin e urdhrit të ekzekutimit, kjo është një marrëdhënie që përcaktohet mes palëve shoqërisë koncesionare dhe subjekteve. Pra është në tagrin e shoqërisë koncesionare rregullimi i marrëdhënieve dhe mënyra e vjeljes së debisë nga subjektet e detyruara. Në lidhje me verifikimin nga grupi i punës të hartimit të procedurës për kontrollin e regjimit automatik në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 21.05.2020, sjellim në vëmendje se Urdhri i Ministrit të MFE nr. 79 datë 29.04.2021 ka patur si objekt kontrollin dhe monitorimin në vend lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës së koncesionit, në të cilën nuk ka parashikime në lidhje me procedurën e regjimit automatik. Ndërsa lidhur me konstatimin se në raport mungon numri i kontroleve për regjimin automatik, ju sqarojmë se bazuar në nenin 22 pika 1 të ligjit 126/2020 "Për metrologjinë" ku përcaktohet se: "... Verifikimi i instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik. ", shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit dhe parashikimit të mësipërm ligjor me ofrimin e shërbimeve të saj realizon edhe sigurimin e regjimit automatik. Kjo nënkupton që të dhënat lidhur me numrin e regjimit automatik dhe subjektet ku është kryer ky shërbim janë apriori të njëjta me numrin e verifikimeve, duke qenë se verifikimi dhe regjimi janë një shërbim i cili jepet njëherazi.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Ndalemi vetëm tek një nga pikat, konkretisht përse Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimitit të urdhrit të ekzekutimit, ku ju shpreheni se është marrëdhënie ndërmjet koncesionarit dhe subjektit. Në vijim të argumentit tuaj, theksojmë se koncesionari, nuk ka ofruar shërbim tek ato subjekte të cilat nuk kanë paguar tarifën, pra automatikisht kemi të bëjmë me moszbatim kontrate, për më tepër që këto subjekte megjithëse nuk kanë paguar, si dhe koncesionari megjithëse nuk ka kryer verifikimin, përsëri subjektet kanë vazhduar aktivitet, duke shitur karburant me instrument matës të pa verifikuar. Pra mungesa e marrjes së veprimeve nga koncesionari, automatikisht cenon zbatimin e kontratës, çka është objekt monitorimi nga NJZP dhe korrigjimi në rast se nuk është kryer si duhet.

Në lidhje me konstatimin tuaj nr.33 ku shpreheni se: "Në vijim konstatohet se Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, nuk ka informuar AK për realizimin e rekomandimeve të dhëna. Edhe në raportimet periodike (3-mujore) të kryera me shkresën nr. 13070, datë 21.07.2021 dhe shkresën nr. 18040, datë 12.10.2021, nuk pasqyrohet asnjë informacion specifik që lidhet me zbatimin e rekomandimeve. Pra sa më sipër Shoqëria Koncesionare N. I. sh.p. k nuk ka respektuar nenin 19, pika 19.1 dhe nenin 31, pika 31. 1 të kontratës Koncesionare. " sqarojmë se: Neni 19, pika 19.1 i cili lidhet me Raportimin, është respektuar nga shoqëria koncesionare pasi kanë përcjellë raportet periodike sipas frekuencës së përcaktuar në Kontratën e

*Koncesionit, (3- mujore dhe vjetore). Ndërkohë për zbatimin e nenit 31, pika 31.1, sqarojmë se grupi i punës në përmbushje të detyrave të caktuara në Urdhrin nr. 79 datë 29.04.2021, pasi ka përgatitur raportin për monitorimin dhe kontrollin në vend të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit, së bashku me rekomandimet e sugjeruara për tju përcjellë shoqërisë koncesionare, ia ka përcjellë këtë dokumentacion me anë të memos nr.7791 datë 20.05.2021 Ministrin të MFE. Duke qenë se kjo praktikë nuk ka dalë e miratuar ose me shënime nga ministri nuk është vijuar me dërgimin e këtyre rekomandimeve tek shoqëria koncesionare. (Bashkëlidhur një kopje të MEMO-s) Në lidhje me konstatimin nr.34, ku shpreheni se: "Ish Ministri i MFE znj. D. I. ka vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13, pikat 13.2. 1 dhe 13.2.2 të kontratës koncesionare. Konkretisht në referencat ligjore, përcaktohet se AK ngre NJZP, e cila do të monitorojë zbatimin e kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. sh.p.k. Në periudhën në të cilën është nxjerrë Urdhri i ish Ministrin të MFE, ka funksionuar NJZP me përbërje si vijon: S. P., Kryetar; P. C., Anëtar; V. J., Anëtar; R. B., Anëtar; E. B., Anëtar; E. B., Anëtar; A. A., Anëtar. Sa më sipër NJZP duhet të kryente monitorimin dhe Ministri i MFE nuk duhet të kishte nxjerrë urdhër për ngritjen e një grupi tjetër monitorimi. " Kontrata e Koncesionit në nenin 20.1.1 përcakton të drejtën e Autoritetit Kontraktues për monitorimin, inspektimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e çdo faze të zbatimit të kontratës, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, me qëllim verifikimin e përmbushjes së detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare. Kjo nënkupton që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ngrejë në çdo kohë grupe monitorimi të kontratës së koncesionit, përveç NJZP-së.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Në asnjë nen të kontratës apo edhe në urdhrin e ngritjes së grupit të monitorimit nuk përcaktohet se ju duhet të prisni miratimin e titullarit të AK në memon që ju drejtoni, për të përgatitur shkresën përcjellëse të raportit të monitorimit, me qëllim përcjelljen e tij pranë koncesionarit. Shtojca 4 përcakton pikën e kontaktit ndërmjet AK dhe koncesionarit dhe raporti i monitorimit i përcillet koncesionarit nëpërmjet email-it zyrtar. Pra sipas argumentit tuaj, puna e monitorimit nuk ka patur asnjë vlerë të shtuar, pasi koncesionari nuk është njohur me raportin e monitorimit, sepse titullari i AK, nuk ka bërë shënim në memo, që të përgatitet shkresa përcjellëse.

*Në lidhje me konstatimin nr.35, ku shpreheni se: "Grupi i monitorimit përpara kryerjes së monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare nga Shoqëria Koncesionare N. I. ShP.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës ose/jo të konfliktit të interesit ", ju bëjmë me dije që deklaratat e ekzistencës ose/ jo të konfliktit të interesit janë nënshkruar nga anëtarët e grupit, por këto deklarata nuk kanë qenë në listën e dokumentacionit të kërkuar nga grupi i auditimit. Megjithatë një kopje të këtyre deklaratave do i gjeni bashkë lidhur. (Bashkëlidhur deklaratat).*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Në lidhje me konstatimin nr.36 ku shpreheni se: "Raporti i monitorimit nuk pasqyron informacion: •Për tarifën e aplikuar për verifikimin fillestar, periodik dhe jashtë radhe; Tarifën e aplikuar për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin. •Për trajnimet e kryera të punonjësve, pra sa trajnime janë kryer, punonjësit e trajnuar; •Për rekrutimet, pra punonjësit e rekrutuar dhe formimi arsimor i tyre; •Subjektet debitorë që nuk kanë likuiduar tarifën dhe vlera debitorë; •Përse Shoqëria Koncesionare N. I. shpk nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit; •Në çfarë gjendje teknike janë pajisjet e punës, sa prej tyre janë përdorur dhe certifikatat e kalibrimit për secilën; •Sa është numri i kontrolleve për regjimin automatik; •Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i mëparshëm i monitorimit, rekomandime të cilat lidhen me detyrime kontraktuale. Pra nuk sigurohet zbatimi i plotë i urdhrit nr. 129, datë 19.04.2022 të ish Ministrin të MFE, znj. D. I., pasi në këtë urdhër është kërkuar kryerja e monitorimit dhe verifikimit për përmbushjen e*

detyrimeve kontraktuale, të cilat i kemi cituar më sipër. ", ju sqarojmë si më poshtë: Në lidhje me tarifën e aplikuar për verifikimin e instrumenteve matës ligjrisht të kontrolluar, në rastin kur e kalojnë apo jo testin, këto tarifa janë ato të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët nr.2, datë 08.02.2013 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave, tarifa këto të aplikueshme edhe nga shoqëria koncesionare në bazë të parashikimeve të kontratës së koncesionit, konkretisht nenit 14. 1 të saj . Në lidhje me trajnimet, rekrutimin e stafit dhe formimin arsimor të tyre, shprehemi se në raportin e përcjellë titullarit të AK me memon nr. 7248/5 prot., të përgatitur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 129 datë 19.04.2022, në faqen 7 të tij tek seksioni "Problematika të hasura gjatë zbatimit të kontratës" paragrafi 2, grupi i punës është shprehur se: "... Faza e dytë ka qenë e lidhur me kryerjen e aktiviteteve të nevojshme për fillimin e Shërbimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar: a) kryerjen e investimit për blerjen e pajisjeve; b) realizimin e investimit për software; c) rekrutimin e stafit; ç) trajnimin e stafit; d) vendosjen në punë të pajisjeve, funksionimin e sistemit software, dhe përgatitjet e tjera të nevojshme përfitimin e Shërbimit. Edhe në këto aspekte, sikundër është provuar dhe demonstruar nga raportet periodike tre mujore dhe vjetore, të përcjella pranë MFE nga N. I., kjo e fundit ka patur zhvillime të rëndësishme dhe sistematike të realizimit të projektit, duke paraprirë edhe afatet e përcaktuara nga Kontrata e Koncesionit për realizimin e fazave të projektit. Aktualisht shoqëria koncesionare "N. I. " sh.p.k ka blerë, kalibruar dhe vendosur në funksionim të gjithë pajisjet e propozuara në ofertën e saj dhe Projektin e parashtruar pranë MFE në Nëntor 2019, dhe të miratuar nga kjo e fundit në Janar 2020, duke mundësuar në këtë mënyrë fillimin e shërbimit në datë 31.03.2020. Fillimi i vitit 2020 ka përkuar edhe me përfundimin e procesit të rekrutimit dhe trajnimit hyrës dhe praktik të inspektorëve të N. I., dhe vijimësia e vitit 2020, në këtë drejtim, ka qenë e shoqëruar edhe nga intervale të tjera trajnimi të inspektorëve, në varësi të standardeve që zbaton shoqëria koncesionare "N. I., sh.p.k në realizimin e Shërbimit të Koncesionit. " Gjithashtu, në pikën 8 të rekomandimeve grupi i punës në zbatim të nenit 21.2.2 pika 0) i ka rekomanduar shoqërisë koncesionare për realizimin e trajnimeve të vazhdueshme për të gjithë personelin e shoqërisë koncesionare i cili është punësuar apo angazhuar në shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Në lidhje me policat e sigurimit, sqarojmë që shoqëria koncesionare ka plotësuar detyrimet e saj kontraktuale lidhur me këtë nen. Grupi i monitorimit i ka disponuar këto dokumentacione dhe i ka vënë bashkëlidhur raportit të monitorimit të hartuar nga ana e tyre për dijeni të Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu lidhur me policën e sigurimit të pronës dhe përgjegjësisë civile të produktit sqarojmë se grupi i punës në rekomandimin nr. 7 të raportit të përgatitur, në zbatim të nenit 21.2.2 pika (h) ka kërkuar nga ana e shoqërisë koncesionare marrjen e të gjitha masave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për garantimin dhe respektimin e parashikimeve ligjore mbi punësimin, sigurinë, disiplinën teknike, kushtet e sigurimit në punë, higjienën dhe mbrojtjen nga zjarri, trajnimin e personelit në mënyrë që të parandalojë çdo dëm apo aksident në punë ashtu si dhe të shmangë dëme ndaj mjedisit, pronës publike dhe private. Lidhur me debitorët dhe vlerat e debisë së tyre sqarojmë se shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit me anë të korrespondencave të vazhdueshme të mbajtura me AK ka përcjellë listën e debitorëve të subjekteve të detyruara. Sa i përket faktit se përse N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, kjo është një marrëdhënie që përcaktohet mes palëve shoqërisë koncesionare dhe subjekteve. Pra është në tagrin e shoqërisë koncesionare rregullimi i marrëdhënieve dhe mënyra e vjeljes së debisë nga subjektet e detyruara. Në lidhje me verifikimin nga grupi i punës të hartimit të procedurës për kontrollin e regjimit automatik në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 21.05.2020, sjellim në vëmendje se Urdhri i Ministrisë të MFE nr. 129 datë 19.04.2022 ka patur si objekt kontrollin dhe monitorimin në vend lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës së koncesionit, në të cilën nuk ka parashikime në lidhje me procedurën e regjimit automatik. Ndërsa lidhur me konstatimin se në raport mungon numri i kontrolleve për regjimin automatik, ju sqarojmë se

bazuar në nenin 22 pika 1 të ligjit 126/2020 "Për metrologjinë" ku përcaktohet se: "... Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontraktuara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik. ", shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit dhe parashikimit të mësipërm ligjor me ofrimin e shërbimeve të saj realizon edhe sigurimin e regjimit automatik. Kjo nënkupton që të dhënat lidhur me numrin e regjimit automatik dhe subjektet ku është kryer ky shërbim janë apriori të njëjta me numrin e verifikimeve, duke qenë se verifikimi dhe regjimi janë një shërbim i cili jepet njëherazi.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Ndalemi vetëm tek një nga pikat, konkretisht përse Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, ku ju shpreheni se është marrëdhënie ndërmjet koncesionarit dhe subjektit. Në vijim të argumentit tuaj, theksojmë se koncesionari, nuk ka ofruar shërbim tek ato subjekte të cilat nuk kanë paguar tarifën, pra automatikisht kemi të bëjmë me moszbatim kontrate, për më tepër që këto subjekte megjithëse nuk kanë paguar, si dhe koncesionari megjithëse nuk ka kryer verifikimin, përsëri subjektet kanë vazhduar aktivitet, duke shitur karburant me instrument matës të pa verifikuar. Pra mungesa e marrjes së veprimeve nga koncesionari, automatikisht cenon zbatimin e kontratës, çka është objekt monitorimi nga NJZP dhe korrigjimi në rast se nuk është kryer si duhet.

Në lidhje me konstatimin nr.37, ku shpreheni se "Në vijim konstatohet se Shoqëria Koncesionare N. I. shpk, nuk ka informuar AK për realizimin e rekomandimeve të dhëna. Edhe në raportimin periodik (3-mujor) të kryer me shkresën nr. 18040, datë 12.10.2021, nuk pasqyrohet asnjë informacion specifik që lidhet me zbatimin e rekomandimeve. Pra sa më sipër Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K nuk ka respektuar nenin 19, pika 19. 1 dhe nenin 31, pika 31. 1 të kontratës koncesionare ", ju sqarojmë se: Neni 19, pika 19.1 i cili lidhet me Raportimin, është respektuar nga shoqëria koncesionare pasi kanë përcjellë raportet periodike sipas frekuencës së përcaktuar në Kontratën e Koncesionit, (3- mujore dhe vjetore). Ndërkohë për zbatimin e nenit 31, pika 31. 1, sqarojmë se grupi i punës në përmbushje të detyrave të caktuara në Urdhrin nr. 126 datë 19.04.2022, pasi ka përgatitur raportin për monitorimin dhe kontrollin në vend të monitorimit të zbatimit të kontratës së koncesionit, së bashku me rekomandimet e sugjeruara për tju përcjellë shoqërisë koncesionare, ia ka përcjellë këtë dokumentacion me anë të memos nr. 7248/5 Ministrin të MFE. Duke qenë se kjo praktikë nuk ka dalë e miratuar ose me shënime nga ministri nuk është vijuar me dërgimin e këtyre rekomandimeve tek shoqëria koncesionare. Në lidhje me konstatimin tuaj ku shpreheni se: Në lidhje me kalibrimin e instrumentit Flowmetër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e zbatimit, rezulton që shoqëria koncesionare N. I. shpk ka dorëzuar për instrumentin Flowmetër 7 certifikata kalibrimi për 7 instrumente. Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se certifikata e kalibrimit për instrumentin Flowmeter/aparat për matjen e volumit të gazit ', e lëshuar nga Laboratori Denev në Bullgari, nuk është lëshuar nga një laborator i akredituar për ofrimin e shërbimit të kalibrimit në këtë fushë ", sqarojmë se: Fusha e emërtuar në Tabelën nr. 1 të Agjencisë Bullgare BAS në numrin 8 "Flowmeters for water and liquids other than water", përfshin pikërisht edhe kategorinë e karburanteve dhe Liquid Petroleum Gas (LPG). Për të sqaruar më tej këtë kategorizim bëjmë me dije se edhe në Direktivën MID 34/2016 e transpozuar me VKM 770/2016 "Për miratimin e rregullit teknik "Për instrumentet matëse", për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërish të kontrolluara", dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, në kreun VII emërtesa në rastin konkret e GLN-së, është gaz i lëngëzuar, pra siç edhe është e njohur GLN shpërndahet nëpërmjet instrumenteve matës që shpërndajnë lëngje

të ndryshëm nga uji. GLN është një lëng i ndryshëm nga uji (gaz i lëngëzuar nën një presion të caktuar dhe temperaturë). Gjithashtu, intervali i matjes nga 0,001 m<sup>3</sup>/h – 1.50 m<sup>3</sup>/h është përfshirës për kapacitetet e flowmetër 5 L/min - 50 L/min. Njësitë e vëllimit në të dyja rastet shprehin të njëjtën prurje të lëngut, si edhe janë të njohura për tu përdorur. Siç edhe konstatohet nga të dhënat e Certifikatës së Kalibrimit në faqen e BAS, Denev është i akredituar për Flowmetër të prurjeve të larta ndaj dhe në këto raste është e justifikuar që përdoret njësia metër kub/orë. Në rastin konkret nëse e konvertojmë në litër/m in Lab Denev është i akredituar për Flowmetër që ka një kapacitet nga 0,017 l/min-2500 l/min. Intervali i kërkuar për Flowmeter të shoqërisë koncesionare N. I. sh.p.k në kufijtë nga 5 l/min-50l/min është brenda kufijve të akreditimit të prurjes së laboratorit Denev. Sqarojmë se Certifikatat e Akreditimit të lëshuara nga Laboratori Denev në Bullgari për kategorinë e pajisjeve Flowmetër që përdoren nga shoqëria koncesionare N. I. sh.p.k janë të njohura si të vlefshme, duke njohur akreditimet e laboratorit Denev në këtë kategori të kalibrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ku shoqëria koncesionare N. I. sh.p.k është e akredituar. Në lidhje me konstatimin tuaj që "...nuk administrohen certifikatat e kalibrimit për: -4 termometra. Duke i'u referuar projektzbatimit, Shoqëria Koncesionare ka vendosur blerjen e 11 termometrave, ndërkohë që administrohen certifikata kalibrimi për 7 termometra. 4 sisteme matëse të karburantit. Duke i'u referuar projektzbatimit, Shoqëria Koncesionare ka vendosur blerjen e 11 sistemeve matëse, me qëllim që të ketë edhe sisteme rezervë në rast difekti, ndërkohë që administrohen certifikata kalibrimi për 6 sisteme. "sqarojmë se: Shoqëria Koncesionare N. I. shpk ka realizuar projektin sipas propozimit teknik të paraqitur në ofertë dhe projektzbatim, e ka realizuar investimet për blerjet e 11 sistemeve matëse (etalonë) për verifikimin metrologjik të shpërndarësve të naftës dhe benzines, si edhe 7 sisteme matëse për kontrollin e shpërndarësve të GLN-së Flowmetër. Koncesionari ka realizuar blerjen e 7 Autolaboratorëve të cilët kanë të instaluar sistemet matëse për karburantet, si edhe GLN-në. Çdo autolaborator është i pajisur gjithashtu me pajisjet ndihmëse të parashikuara në projekt zbatim: termometra dhe kronometra të kalibruar sipas legjislacionit në fuqi. (bashkëlidhur certifikatat e kalibrimit për sistemet matëse dhe termometrat). Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matës të karburanteve kryhet nga Shoqëria Koncesionare N. I. në zbatim të rekomandimeve të OIML dhe Direktivat EU, për të cilat është akredituar nga OPA me Certifikatën e Akreditimit TI 038, Trupë Inspektuese sipas standardeve dhe rregullave teknike ku rendisim: - VKM nr.770/20 16 "Për miratimin e rregullit teknik "Për instrumentet matëse" dhe për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse, ligjërish të kontrolluara", dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" - OIML R- 1 1 7- 1: 2007; "Sistemi matës dinamik për lëngje të ndryshme nga uji" ; - OIML R-1 1 7-2: 2014 "Sistemi matës dinamik për lëngje të ndryshme nga uji" ; - OIML R-1 1 7- 3: 20 14 "Sistemi matës dinamik për lëngje të ndryshme nga uji"; - OIML R-120: 2010; "Standarde prove të testimit të Sistemit matës për lëngje të ndryshme nga uji"; - OIML R- 1 19:1996 "Matës standard i volumeve për testimin e sistemit matës të ndryshëm nga uji"; - Direktiva Europiane MID 201 4/32/EU, Aneksi MI-005, (adoptuar me VKM Nr.770, /20 16). Sqarojmë se praktikat më të mira të industrisë së aplikuara nga Koncesionari garantojnë nga OPA, institucion i specializuar për kontrollin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, institucion që ka akredituar Shoqërinë Koncesionare për Verifikimin e instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar shpërndarës të karburanteve dhe GLN-së. (bashkëlidhur certifikata e Akreditimit të N. I. ose link <https://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/N.-INSPEKT-TI-038.pdf>) Në lidhje me konstatimin tuaj nr.38, ku shpreheni se: "Për sa më sipër, subjekti është në kushtet e mospërputhjes së nenit 4, pika 4.2, shkronja "a ", nenit 8, pika 8.2.2, nenit 21,pika 21.2. 1, shkronja "b " dhe piko 21.2.2, shkronja "u " në kontratën koncesionare. Situatë e mësipërme tregon se grupi i monitorimit ngritur me urdhrin nr. 129, datë 19. 04.2022, por edhe NJZP nuk kanë kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm ", ju bëjmë me dije se bazuar në argumentet më sipër ky konstatim nuk qëndron.



**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Në asnjë nen të kontratës apo edhe në urdhrin e ngritjes së grupit të monitorimit nuk përcaktohet se ju duhet të prisni miratimin e titullarit të AK në memon që ju drejtoni, për të përgatitur shkresën përcjellëse të raportit të monitorimit, me qëllim përcjelljen e tij pranë koncesionarit. Shtojca 4 përcakton pikën e kontaktit ndërmjet AK dhe koncesionarit dhe raporti i monitorimit i përcillet koncesionarit nëpërmjet email-it zyrtar. Pra sipas argumentit tuaj, puna e monitorimit nuk ka patur asnjë vlerë të shtuar, pasi koncesionari nuk është njohur me raportin e monitorimit, sepse titullari i AK, nuk ka bërë shënim në memo, që të përgatitet shkresa përcjellëse.

*-Nga auditimi i dokumentacionit mbi pagesën e tarifës koncesionare dhe arkëtimin e tarifës së shërbimit të verifikimit rezulton se: Në lidhje me konstatimin tuaj nr.39, "...se krijohet diferencë në të ardhurat e realizuara, e cila sjell impakt mbi tarifën koncesionare. ..." dhe se "...grupi i monitorimit ngritur me urdhrin nr. 129, datë 19.04.2022, nuk ka kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit financiar. ..." dhe "Kjo situatë tregon se edhe NJZP nuk ka kryer monitorimin e dokumentacionit përkatës me qëllim kryerjen e përlllogaritjeve dhe vlerësimin e të ardhurave që duhet të kishte realizuar shoqëria koncesionare sh.p.k mbi të cilat përlllogaritet tarifa koncesionare", sqarojmë se nuk është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues për të verifikuar llogaritjet financiare. Për sa kohë pasqyrat financiare sillen të audituara nga shoqëria koncesionare, dhe nga ana tjetër merret nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, konfirmimi për këto pasqyra financiare, Autoriteti Kontraktues bën vlerësimin e tarifës koncesionare mbi vlerën e të ardhurave vjetore të paraqitura në pasqyrat financiare. Për më tepër, përlllogaritjet e bëra më sipër nuk qëndrojnë për arsyet si më poshtë : Referuar nenit 1 7, pika 4 e ligjit nr. 1 26 "Për Metrologjinë", instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara që nuk janë objekt i markimit CE, ashtu si përbërësit e tyre, pajisjet shtesë dhe pajisjet ndihmëse, i nënshtrohen kontrollit metrologjik, që kryhet nëpërmjet miratimit të tipit, verifikimit fillestar, verifikimit pasardhës dhe verifikimit jashtë radhe, kur lind nevoja, të instrumenteve matëse. Më tej vazhdon neni 4 "Përrjashtimisht nga pika 3 e këtij neni, instrumentet matëse objekt i markimit të CE, markimit suplementar të shoqëruar me dy numrat e fundit të vitit të prodhimit, numri identifikues i trupës notifikuese, që është përfshirë në vlerësimin e konformitetit, nuk i nënshtrohen miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar, por vetëm verifikimeve pasardhëse dhe verifikimeve jashtë radhe kur lind nevoja. Thënë me thjesht për të gjitha instrumentet matës objekt i markimit CE nuk bëhet verifikim fillestar. Pjesa më e madhe e instrumenteve të reja të futura në treg janë objekt i markimit CE, si rezultat nuk kemi të bëjmë me verifikim fillestar që tarifohet me dyfishin e tarifës, por në këto raste verifikimet trajtohen si verifikime periodike.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë. Detyra e NJPZ është të kryejë përlllogaritjet duke u nisur nga të dhënat e raportuara nga koncesionari, duke i krahasuar me raportimet financiare të tij, por duke u bazuar në përcaktimet e kontratës koncesionare.

*-Në lidhje me konstatimin tuaj nr.40, ku shpreheni se: "...konstatohet moszbatimi i kontratës ne 60 raste. Shoqëria koncesionare N. I. sh.p.k, në kushtet kur fatura që lëshon është titull ekzekutiv, duhet të kishte bërë kërkesë padi në gjykatë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nëpërmjet të cilit të ngarkohej shërbimi përmbartimor për ekzekutimin me forcë të detyrimeve. Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, pra moszbatimi i kontratës nga Shoqëria Koncesionare N. I. shpk, po nga ky subjekt nuk është kryer shërbimi i verifikimit ndaj subjekteve të mësipërme, me pretendimin se nuk kanë paguar tarifën dhe në këto kushte nuk i ofrohet verifikimi ", sqarojmë se: Lidhur me debitorët dhe vlerat e debisë së tyre sqarojmë se shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës së koncesionit me anë të korrespondencave të vazhdueshme të mbajtura me AK ka përcjellë listën e debitorëve të subjekteve të detyruara. Sa i përket faktit se përse N. I. Sh.P.k nuk ka ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tarifës, pra kërkimin në gjykatë të lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, kjo është një marrëdhënie që përcaktohet mes palëve*

shoqërisë koncesionare dhe subjekteve. Pra është në tagrin e shoqërisë koncesionare rregullimi i marrëdhënieve dhe mënyra e vjeljes së debisë nga subjektet e detyruara. Në lidhje me konstatimin tuaj nr.41 ku shpreheni se "Nga subjektet e mësipërme u verifikuan 7 prej tyre, ku u konstatua se për 46 pistoleta nuk është respektuar afati i verifikimit fillestar, periodik apo edhe pistoleta të cilat për një periudhë për më tepër se 1 vit (deri më 31.12.2022) nuk janë verifikuar. (Ku theksojmë se në këto verifikime, për pistoleta të ndryshme gaz, naftë dhe benzinë, kanë ngelur nga verifikimi i kryer. Pra për një periudhë rreth 1 vit, këto pistoleta kanë punuar jashtë kërkesave të metrologjisë ligjore, duke cenuar qëllimin e ligjit nr. 126/2020 "Për Metrologjinë ", neni 1 shkronja 'f' mbrojtjen e konsumatorëve, pasi nuk është siguruar saktësia e rezultatit të matjes.", sqarojmë si më poshtë: Në momentin e marrjes së shërbimit nga ana e shoqërisë koncesionare, bazuar në raportimet periodike të tyre është theksuar në vazhdimësi se janë hasur në problematika të ndryshme të natyrës: refuzim nga subjektet për kryerjen e shërbimit, mungesa e administratorit në pikë që të mundësojë kryerjen e shërbimit, mungesa e lëngut etj. Nga ana tjetër ka raste kur shërbimi kërkohet edhe jashtë radhe sipas problematikës që paraqet subjekti. Kjo ka sjellë herë pas here ndryshim në afatet e verifikimit. Po ashtu në konstatimin nr.41, ku shpreheni se "Gjithashtu, mangësi të konstatuara në respektimin e afatit të verifikimit metrologjik, janë konstatuar edhe 6 subjekte të tjera " sqarojmë si më poshtë: Sikurse u sqarua edhe më sipër për konstatimin 40, gjatë kalimit të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburanteve nga DPM tek shoqëria koncesionare, në bazë të raportimeve periodike të tyre në MFE apo edhe në ISHMT është theksuar në vazhdimësi se janë hasur në problematika nga më të ndryshmet që kanë ndikuar në afatet e verifikimit të subjekteve. Në raportimet e përcjella nga shoqëria koncesionare në fillimin e shërbimit ka deklaruar që nga ana e subjekteve të detyruara ka patur refuzime të vazhdueshme për të mos kryer inspektimin edhe për shkak të ndryshimit në ofrimin e shërbimit nga DPM tek shoqëria koncesionare. Po ashtu në periudhën kur ky shërbim kaloi tek shoqëria koncesionare, përkoi edhe me mbylljen totale të vendit për shkak të Pandemisë Covid- 19, fenomen i cili ka ndikuar në vonesat në inspektimin sipas afateve të inspektimit. Në lidhje me konstatimin tuaj nr. 16 ku shpreheni se: "Nuk administrohet deklarata e koncesionarit ku merr përsipër përpara AK se duke filluar nga data e hyrjes në fuqi dokumentet e projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre nga koncesionari nuk bie ndesh me asnjë Ligj, kërkesë e përcaktuar në paragrafin ii, pika 12.1.4, neni 12 në kontratën koncesionare ", ju sqarojmë se: Referuar nenit 12.1.4 (ii) ku përcaktohet se "Koncesionari më tej garanton, deklaron dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktues se, duke filluar nga Data e hyrjes në Fuqi: (ii) Dokumentet e projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre nga Koncesionari nuk bie ndesh me: Asnjë ligj, Aktin e themelimit, ose dokumente të tjera të brendshme të Koncesionarit; ose Detyrimet e Koncesionarit", në mënyrë direkte Koncesionari duke firmosur Kontratën e Koncesionit, ka deklaruar dhe pranuar pohimin e mësipërm. Prandaj në këtë rast ky parashikim konsiderohet i përmbushur nga koncesionari. - Në lidhje me konstatimin tuaj se "Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se, nuk është respektuar periudha prej 12 muaj për të ndërmarrë angazhimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit të metrologjisë apo propozimin e ligjit të ri të metrologjisë, pasi ligji i ri i metrologjisë është miratuar më datë 15.10.2020, ndërkohë kontrata koncesionare është lidhur më datë 21.08.2019. Në vijim të situatës së mësipërme ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, z.A. K., me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020, i është drejtuar DPM për ndërprerjen e shërbimit të verifikimit metrologjik të karburanteve pasi ky shërbim do të ofrohet nga koncesionari. Në gjykimin e grupit të auditimit urdhërimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës (ligji për metrologjinë), i cili ngarkon DPM për kryerjen e këtij shërbimi. Pra sipas kësaj shkrese DPM urdhërohet të ndalohet të kryejë shërbimin të cilin e ka detyrimin ligjor, vetëm me arsyen e ekzistencës së kontratës koncesionare. Ndërkohë në këtë rast në kontratën koncesionare është parashikuar që do të kryhen ndryshimet ligjore që të mundësojnë ofrimin e shërbimit nga koncesionari. Nëse do t'i referohemi të ardhurave që do të realizoheshin, në rastin sikur shërbimi do të kishte vazhduar nga DPM përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 (ligji është

miratuar më datë 15.10.2020, publikuar në fletore zyrtare më datë 18.12.2020, hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit) do të kishin 64,365,500 lekë të ardhura të realizuara nga koncesionari sipas pasqyrave financiare të mbyllura për periudhën Prill-Dhjetor 2020  $\{2.5\% * 64, 365, 500 \text{ lekë}\} = 62,756,362 \text{ lekë}$ , të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Në rastin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi ish Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së, i cili ka urdhëruar në mënyrë të paligjshme DPM, titullari i AK ish Ministri i Financave dhe Ekonomisë zj.A. D., si dhe z. P. R., Drejtor i Përgjithshëm i DPM, i cili nuk ka marrë masat që DPM të vazhdojë të kryejë detyrën ligjore. " Sqarojmë se: Me anë të Urdhrit nr.267 datë 15.10.2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ngritur grupin e punës për rishikimin e draft ligjit "Për metrologjinë", në të cilin ka patur përfaqësues nga MFE, DPM dhe ISHMT. Gjithashtu, ju sqarojmë se ndryshimet në aktet ligjore bëhen duke respektuar një procedurë të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Detyra e institucionit propozues të ndryshimeve ligjore është deri në fazën e përcjelljes së projekt-ligjit për mendim apo hallkat e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Përsa i përket vonesës në miratimin e një akti sqarojmë se kjo nuk varet vetëm nga institucioni propozues por edhe nga instancat/Institucionet e tjera nëpër të cilat shqyrtohet ky dokument. Pra theksojmë se fillimi i ofrimit të shërbimit nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me miratimin e ndryshimeve ligjore pasi në nenin 20.2.7 të kontratës është parashikuar shprehimisht: "20.2.7 Autoriteti Kontraktues angazhohet, brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i Kontratës, se do të propozojë të gjitha ndryshimet e nevojshme për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës dhe do të marrë iniciativën për miratimin e të gjitha ligjeve, akteve nënligjore dhe/ose rregulloreve që të lejojnë Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare të kryejë shërbimin objekt të Kontratës përfshirë këtu veprimtarinë e verifikimit metrologjik sipas legjislacionit të zbatueshëm shqiptar mbi metrologjinë, përfshirë por pa u kufizuar të drejtën e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për të evidentuar, raportuar, pezulluar dhe/ose bllokuar subjektet në shkelje. " Në këto kushte fillimi i ofrimit të shërbimit ka qenë i përcaktuar në parashikimet e tjera të kontratës së koncesionit dhe nuk lidhet me miratimin e ndryshimeve ligjore edhe pse MFE e ka përmbushur detyrimin e saj për marrjen e iniciativës për propozimin dhe miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore. Po ashtu në lidhje me konstatimin se 'urdhërimi i bërë nga ish Sekretari i Përgjithshëm bie në kundërshtim të hapur me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës (ligji për metrologjinë), i cili ngarkon DPM për kryerjen e këtij shërbimi', argumentojmë se në zbatim të ligjit nr. 125/2013 Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Vendimin nr.365 datë 20.06.2018 "Për Dhënien me Koncesion te Shërbimit të Kontrollit Ligjor të Instrumenteve Matëse, Nëpërmjet Verifikimit të Instrumenteve Shpërndarëse të Karburantit dhe Gazit të Lëngshëm dhe Miratimin e Bonusit në Procedurën Konkurruese që i Jepet Shoqërisë". Në zbatim të këtij vendimi MFE në cilësinë e AK ka ndjekur të gjitha hapat procedurat për zbatimin e VKM nr.365/2018, ku në përfundim të të gjithë procesit është lidhur kontrata e koncesionit nr. 15 326 datë 21.08.2019 midis MFE në rolin e AK dhe Koncesionarit "N. C. shpk" dhe Shoqërisë koncesionare "N. I. shpk". Në këtë kontratë janë parashikuar të drejta dhe detyrime për secilën prej palëve ku ndër të tjera parashikohet: Neni 3.3 i kontratës përcakton se "Koncesionari ka të drejtën e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e objektit të Kontratës së Koncesionit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës koncesionare. Në asnjë rast, Autoriteti Kontraktues apo çdo institucion shtetëror të çfarëdo niveli, apo tjetër organizatë me funksione publike të deleguara nuk do të lidhë kontratë apo të licencojë, autorizojë, apo të kryejë çfarëdo veprimi që do të kalonte një pjesë apo të gjithë shërbimin ndonjë pale tjetër, ose të ndërmarrë ndonjë veprim duke përfshirë përfundimin e kontratës që mund të ndikojë negativisht në këtë të drejtë të dhënë Koncesionarit të kësaj kontrate. " Neni 13.1 pika 9 dhe 10 përcaktojnë se:"13.1.9 Autoriteti Kontraktues gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate do të sigurojë mos cenimin nga palë të treta të aktivitetit të Shoqërisë Koncesionare si dhe do të ndërmarrë të gjitha masat për të zgjidhur problemet që palë të treta do të kenë dhe/ose pretendojnë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate. 13. 1.1 0 Autoriteti Kontraktues do t'i garantojë Shoqërisë Koncesionare, vetë apo kur është rasti në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse,

gëzimin e qetë dhe aksesin në Pikat gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate. " Neni 20.2 pika 1 përcakton se: "Autoriteti Kontraktues merr përsipër përbushjen e detyrimeve të mëposhtme: 20. 2.1 Të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet që të përbushë brenda afateve të arsyeshme dhe pa vonesa veprimet e përcaktuara në këtë Kontratë. " Po ashtu sipas nenit nr. 17.1 të kontratës së koncesionit përcaktohet se nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari për investimet e kryera, Autoriteti Kontraktues brenda 15 ditëve duhet të bëjë verifikimin e investimeve. Më tej në nenin 17.2, përcaktohet se Autoriteti Kontraktues duhet të konkludojë me një raport përfundimtar për kryerjen e investimeve brenda 15 ditëve kalendarike. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk merr pjesë në këtë verifikim, atëherë Koncesionari do të fillojë ofrimin e Shërbimit 15 ditë kalendarike pas dorëzimit të raportit pranë Autoritetit Kontraktues. (Neni 17.3). Bazuar në këto përcaktime ligjore shkresa dërguar DPM për ndërprerjen e shërbimit, ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të një detyrimi kontraktual të parashikuar në kontratën e koncesionit, kontratë e cila është nënshkruar ndërmjet palëve respektive në zbatim të VKM nr. 365 datë 20.06.2018.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë në akt-konstatim. DPM nuk e detyron kontrata e koncesionit që të ndërpresë kryerjen e detyrimit ligjor, verifikimin metrologjik, pasi mbi të gjitha nuk është as palë në këtë kontratë. Në Kodin Civil përcaktohet qartë se kontrata ka efekt mbi të tretët kur është përcaktuar me ligj.

*Në lidhje me konstatimin e fundit nr.18, sqarojmë se referuar projekt zbatimit të miratuar dhe dokumenteve të ofertës teknike konkretisht "Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit, tek pika 4, për përdoruesin "Institucioni përkatës shtetëror" përcaktohet si vijon: "Sistemi elektronik online do të ketë mundësi të aksesohet nga të gjitha palët pjesë e këtij procesi si stafi përkatës menaxherial, inspektorët në terren, ndërkohë që dhe institucionet përkatës shtetëror dhe klientët (subjektet që do të verifikohen) do ti mundësohet një akses "read only " për marrjen e raportimeve të ndryshme ...-Institucioni përkatës shtetëror ka mundësinë e aksesimit të sistemit elektronik online për të parë raportimet për rezultatet e verifikimeve të kryera në terren. Institucionit shtetëror nuk i mundësohet e drejta për editim të dhënash që do të thotë për modifikim, shtim apo fshirje të dhënash. Personat që do të kenë akses nga institucionet do të jenë të autorizuar nga koncesionari dhe do të duhet të kalojnë një proces trajnimi për sistemin. " I njëjti parashikim është përcaktuar edhe në faqen 17 të dokumentit të Projekt Zbatimit të dorëzuar nga shoqëria koncesionare me shkresën nr. 20667 datë 12.11.2019." Kjo nënkupton që Autoriteti Kontraktor ka akses në sistemin online, ku sheh të dhëna të përmbledhura me numrin e inspektimeve të kryera, tipin e tyre dhe faturimet. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor mund të shikojë Raportet e Inspektimit për çdo subjekt të kontrolluar, por nuk mund ti shkarkojë, sipas parashikimeve në projektzbatim dhe në dokumentet e ofertës teknike. (screenshot i faqes së sistemit si më poshtë):*

*Referuar argumenteve të dhëna më sipër në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit kërkojmë nga ana juaj marrjen në konsideratë të observacioneve të përgatitura dhe ndryshimin/ heqjen e konstatimeve tuaja.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë në akt-konstatim. I jemi referuar kritereve teknike të dokumenteve të tenderit, detyrim për tu plotësuar nga subjekti jo vetëm gjatë procedurës konkurruese, por edhe gjatë zbatimit të kontratës (neni 21, pika 21.2.1, shkronja "b"), për më tepër që subjekti gjatë procedurës konkurruese ka plotësuar edhe shtojcën 5 ku deklaroi se plotëson të gjitha kriteret teknike të kërkuara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 257/10, datë 25.01.2024, "Komente mbi gjetjet e evidentuara në pikën 4, mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare" nga znj. V. J. dhe z. R. B., nga ISHMP, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

### **Pretendimi i subjektit:**

*Ne lidhje me Akt Konstatimin nr.3 "Mbi auditin e ushtruar në MFE në bazë të Programit të Auditimit të përputhshmërisë nr.257/1 prot, datë 03.05.2023 i ndryshuar, mbajtur në datë 19.01.2024" , nga përfaqësuesit e ISHMT-së gjeni si më poshtë kontestimet në lidhje me disa nga gjetjet e këtij dokumenti:*

*II Mbi zbatimin e kontratës koncesionare*

*a) R. B. dhe V. J., janë caktuar anëtarë të NJZP me Urdhrin nr.117, datë 13.04.2022, si plotësim i detyrave të lëna nga KLSH në kontrollin e ushtruar në DPM "Për pjesëmarrjen në komision të specialisteve teknike për procedurat e verifikimit të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara (shpërndarësit e hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm)", pra për veprime teknike të koncesionarit në praktikë.*

*Me Urdhrin 129, datë 19.04.2022, R. B. është caktuar nga ISHMT si anëtar i Grupit D) te Punës per Monitorimin e Koncesionit, i cili si specialist i fushës, ka kryer monitorimin ne terren të veprimeve të koncesionarit, përsa i përket procedurës së verifikimit/inspektimit nga inspektorët e N. I..*

*Gjetja e pikës 35*

*Ju sqarojmë se R. B. dhe V. J. kanë firmosur deklaratën e konfliktit te interesit në një nga mbledhjet e kryera nga NJZP, të cilat ndodhen në dokumentet në ruajtje nga MFE, si institucioni që mbikëqyr koncesionin.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me observacionin sa më sipër merret në konsideratë, me rezervë pasi dokumentet sa më sipër duhet të ishin pjesë e dosjes.

*Gjetja nr.36 pikat 2,3, 6 fq17 dhe gjetja nr.37, fq 18.*

*N. (koncesionari) kur ka fituar te drejtën e koncesionit ka paraqitur një ofertë teknike sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga dokumentet e tenderit. Një nga këto kërkesa të tenderit është dhe akreditimi i subjektit nga autoritetet akredituese shqiptare, që në këtë rast është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA). Në zbatim të kriterëve N. është akredituar nga DPA si Trup Inspektuese referuar Standardit 17020 "Për trupat inspektuese".*

*DPA sipas standardit kryen vizitë inspektuese çdo vit pranë trupës inspektuese N. dhe po sipas standardit është DPA që kontrollon trajnimet e kryera të punonjësve, formimin arsimor të tyre, gjendjen teknike të laboratorëve, si dhe certifikatat e kalibrimit të tyre. Raporti përfundimtar i vizitës mbikëqyrëse të DPA konsiderohet shterues për problematikat e ngritura në pikën 36 të raportit.*

*Gjetja 36 pika 7 fq 17*

*Përsa i përket pyetjes në gjetjen me nr. 36 "Sa është numri i kontrolleve për regjimin automatik? "ju bëjmë me dije se në Ligjin 126/2020 "Për metrologjinë", Neni 22, pika 1 shprehet "Verifikimi i instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik", pra çdo verifikim/inspektim i kryer nga N. nënkupton (ka brenda procedurës) kontrollin e regjimit automatik. Në përfundim numri i verifikimeve është i barabartë me numrin e kontrolleve të regjimit automatik.*

*Gjetja 36 pika 1 , Gjetja nr.38 dhe Kreu IV*

*Në përgjigje të gjetjes nr. 36, fq 17: Për tarifën e aplikuarë për verifikimin fillestar, periodik dhe jashtë radhe; tarifën e aplikuarë për instrumentet matës ligjërish të kontrolluara që gjatë inspektimit nuk e kalojnë testin, gjetjes nr. 38, fq.27 :Nga auditimi i dokumentacionit mbi pagesën e tarifës koncesionare dhe arkëtimin e tarifës së shërbimit të verifikimit, dhe Kreu IV: Për totalin ku përfshihen të 3 llojet e verifikimit ", fq.29, ju sqarojmë si më poshtë:*

*Në Ligjin nr. 126/2020 "-Për metrologjinë", Neni 17, pika 4 shprehet ""Instrumentet matës objekt i markimit CE, markimit suplementar metrologjik nuk i nënshtrohen miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar, por vetëm verifikimit pasardhës dhe verifikimit jashtë radhe kur lind nevoja". Të gjithë instrumentet e përdorur në këtë fushë janë pjesë e markimit CE si dhe*

markimit metrologjik sipas Ligjit 10489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore". i ndryshuar, për këtë arsye ato janë të përjashtuara nga miratimi i tipit dhe verifikimit fillestar.

Referuar Ligjit 126/2020 "Për metrologjinë", në Neni 22, pika 1 shprehet "Verifikimi i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm bëhet jo më pak se 2 herë në vit", që tregon se periodiciteti ndërmjet 2 verifikimeve është 6 muaj, prandaj dhe certifikata e verifikim/inspektimit që lëshon N. për konformitetin e instrumentit ka afat 6 mujor.

Sipas Udhëzimit nr 2, date 08.02.2013 " Për tarifën dhe pagesat e shërbimeve të DPM". në pikën 9 jepet shpjegimi i tarifave për rastet që nuk kalojnë testin e verifikimit (ngelin). Kur instrumenti matës ligjërisht i kontrolluar nuk kalon verifikimin konsiderohet jo në konformitet dhe në këto raste shërbimi tarifohet me gjysmën e çmimit të verifikimit. Të gjitha verifikim/inspektimet e kryera nga N. në kuptim të Ligjit nr.126 "Për metrologjinë" janë periodike, pasardhëse, jashtë radhe me kërkesë, të cilat kanë tarifën 6000 lekë për 1(një) instrument. Instrumentet kanë qenë në punë kur shërbimi kaloi nga DPM te N. dhe N. vazhdoi kryerjen e verifikimit periodik pavarësisht të ndonjë tejkalimi afati verifikimi. Kryerja për herë të parë nga N. i këtij shërbimi konsiderohet verifikim periodik ose pasardhës. Edhe për rastet kur kryhet verifikimi pas riparimit të instrumentit, ky verifikim konsiderohet verifikim periodik sepse në atë moment llogaritet fillimi i kohës së periodicitetit. Në përfundim të arsyetimeve dhe fakteve të mësipërme përlllogaritjet tuaja të shprehura në fq.28,29 dhe 30, duke përdorur tarifën 12,000 lekë për verifikim fillestar dhe 6000 lekë tarifë për ngeljet në verifikimin fillestar nuk qëndrojnë.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë në akt-konstatim. Së pari nuk kemi shprehur asnjë konstatim për përmbajtjen e pasqyrave financiare. Së dyti përlllogaritjet janë bërë bazuar informacionit të raportuar. Pra përlllogaritjet për verifikimet fillestare, janë bërë bazuar në terminologjinë e përdorur nga vetë koncesionari, kur raporton numrin e verifikimeve fillestare. Pra në raportimin vjetor 2021, koncesionari është shprehur se ka kryer 1234 verifikime fillestare kaluese. Në këto kushte referuar terminologjisë së përdorur nga vetë koncesionari, si dhe terminologjisë që përdoret në udhëzimin për tarifën e shërbimeve metrologjike, atëherë ska arsye që të nënkuptohet/supozohet se vitet e fundit, pjesa më e madhe e instrumenteve matës janë me markimin CE dhe nuk i nënshtrohen verifikimit fillestar. Në këtë rast koncesionari në raportimet e tij nuk duhet të përdorë këtë terminologji.

Në lidhje me kalibrimin e instrumenteve, pas shqyrtimit të observacionit të paraqitur sqarojmë se nuk merret në konsideratë dhe i qëndrojmë trajtimit të bërë në akt-konstatim. Instrumenti që mund të kalibrohet nga laboratorit i akredituar, duhet të përcaktohet qartë dhe jo në terma të përgjithshëm, pasi lëngje ka disa. Për më tepër që edhe në rekomandimet/guidat e OIML (OIML TC 3/SC 5; OIML D 37 etj.) përcaktohet se qartë se duhet specifikuar instrumenti.

#### IV. KONKLuzioni I Përgjithshëm

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Financave "Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimit të bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë", për periudhën 09.12.2016 deri më datë 31.12.2022, lidhur me përputhshmërinë, rezultuan mangësi kryesisht në procedurën e dhënies me koncesion dhe zbatimin e kontratës koncesionare, si shkelje e kuadrit rregullator të fushës (koncesioneve) për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, pasi është bërë nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, i cili nuk e përfshin dhënien me koncesion në një nga fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës. Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi, ku janë investuar

63,975,994 lekë. U konstatuan mangësi në hartimin e kontratës së koncesionit duke mos pasqyruar kushtet e DST. Gjithashtu u konstatuan mangësi në zbatimin e kontratës nga koncesionari si dhe nga institucionet që mbështesin parregullsitë e konstatuara.

## V. REKOMANDIME

### A. MASAT ORGANIZATIVE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së procedurës së dhënies me koncesion u konstatua se studimi i fizibilitetit dorëzuar nga koncesionari përmban të dhëna të pasakta në përlllogaritjen e të ardhurave vjetore, të cilat automatikisht ndikojnë në vlerën e NPV (vlera aktuale neto), tregues i cili shërben për marrjen e vendimit për kryerjen e investimit ose/jo. Studimi i fizibilitetit përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion, përmban të dhëna jo të sakta, si dhe të pakonfirmuara nga burime zyrtare. Komisioni, për ta bërë fizibël projektin e koncesionit, i ka shtuar si të ardhura vjetore koncesionarit, të ardhurat nga TVSH që do të sigurohen nga ofrimi i shërbimit nga koncesionari, si dhe është sjellë situata në kushte jo të barabarta me krahasuesin e sektorit publik, pra ofrimin e shërbimit nga DPM, ku kësaj të fundit nuk i kanë njohur aspak të ardhura për buxhetin e shtetit, përkundrazi i kanë shtuar si kosto TVSH që nuk ka mbledhur DPM, ndërkohë që DPM nuk është institucioni përgjegjës për mbledhjen e TVSH. Komisioni i dhënies me koncesion nuk përmban specialist të fushës, detyrim ky ligjor për tu përmbushur.

Nga analiza financiare e kryer nga grupi i auditimit, përlllogaritja e NPV dhe IRR (norma e kthimit të investimit) bazuar në të dhënat e studimit të fizibilitetit të koncesionarit dhe të dhënave faktike nga DPM, rezulton se ofrimi i shërbimit nga sektori publik në krahasim me privat, është më fizibël nga ana financiare, pasi norma e NPV dhe IRR janë më të larta në krahasim me normat e privatit. Vetëm ky rezultat për komisionin e dhënies me koncesion duhet të kishte përbërë shkak për rishikimin e vendimit për koncesionin e shërbimit të verifikimit metrologjik. Sa më sipër janë në kundërshtim me VKM nr. 575, datë 10.7.2013, “*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat*”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, neni 7, 8. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që në procedurat e dhënies me koncesion, analiza ekonomike dhe financiare si pjesë e studimit të fizibilitetit, të kryhet me përgjegjshmëri e profesionalizëm duke shprehur një vlerësim të investimit në total, kostove operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe çdo të ardhur që pritet të krijohet, në të gjithë kohëzgjatjen e projektit.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në shqyrtimin e dokumenteve standarde të tenderit u konstatuan parregullsitë:

-Në pikën 4.2 të dokumenteve të tenderit, AK në kriteret e përzgjedhjes së fituesit, ka përcaktuar 80 pikë, për kriteret teknike dhe 10 pikë, për ofertën ekonomike për investimin fillestar si dhe 10 pikë tarifën koncesionare. Në procesverbalin nr. 6, datë 24.08.2018 komisioni nuk ka argumentuar arsyet e dhënies së pjesës më të madhe të pikëve kriterëve teknike.

-Në lidhje me aktivitetin ekonomik pozitiv, AK nuk i ka kërkuar të certifikuar pasqyrat financiare.

-AK nuk ka argumentuar kërkesën për eksperiencë brenda 3 viteve të fundit në fushën e inspektimit dhe matjes, kur shërbimi që kërkohet është verifikimi i instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm duke konfirmuar nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike. Pra instrumenti do ti nënshtrohet matjes për të verifikuar saktësinë e tij. Në këto kushte është e mjaftueshme eksperiencia në fushën e matjes. Në gjykimin e grupit të auditimit, kërkesa për eksperiencë në fushën e inspektimit, kufizon konkurrencën.

-Kërkesa nga OE për dokumentimin e përvojave të mëparshme duke kërkuar kontratën dhe faturat tatimore krijon vështirësi në pjesëmarrjen në procedurë.

Në procesverbalin e hartimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetet teknike, nuk pasqyrohet argumenti teknik se si ndikon në përmbushjen e kapacitetit teknik, disponimi i certifikatës së akreditimit ISO/IEC 17020:2012 “*Kritere të përgjithshme për funksionimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektime*” (në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarëseve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit), vetëm në fushën e inspektimit nëpërmjet verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si dhe jo edhe në një fushë tjetër pra energji elektrike, uji i pijshëm, mjekësi etj. Vendosija e këtij kriteri kufizon konkurrencën.

-Në përmbajtjen e DST, specifikimet teknike, pika 2.2, lidhur me sistemet e informacionit që do të ofrohen nga OE gjatë zbatimit të projektit, konstatohet se nuk janë në përputhje të plotë me propozimin e bërë në studimin e fizibilitetit. Konkretisht në studimin e fizibilitetit propozohet që të ndërtohet baza e të dhënave, duke qenë e aftë të këmbejë, ndërveprojë dhe të verifikojë të dhënat me bazat e tjera shtetërore të të dhënave. Pra krijimin e një baze të dhënash me numrin e karburanteve, emrin tregtar, vendndodhjen, selinë kryesore dhe degët, etj., si dhe përditësimin e këtij informacioni. Ndërtimi i bazës së të dhënave nuk është përcaktuar në DST. -Gjithashtu në DST nuk jepet informacion mbi numrin e distributorëve që janë në Shqipëri, me qëllim dhënien e ndihmës ndaj OE për përgatitjen e analizës financiare.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 22 në Ligjin nr. 125/2013, “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*”, i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 24 në VKM nr.575 datë 10.07.2013 “*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat*”, i ndryshuar; Pikën 3, shkronjën “a” të pikës 4 në nenin 28, nenin 30, pikën 2 të nenit 31, pikën 2 të nenit 61 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që komisionet e ngritura për procedurat e dhënieve me koncesion, të kenë aftësitë profesionale përkatëse si dhe të mbikëqyrin që në procedurat e hartimit të dokumenteve të tenderit kriteret e kërkuara të jenë të argumentuara dhe të justifikuara për të ulur riskun e kufizimit të pjesëmarrjes të operatorëve ekonomikë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e tenderimit ka marrë pjesë një Operator Ekonomik, përkatësisht OE “N. C.” Sh.P.K me ofertën ekonomike në vlerën 70,000,000 lekë, vlera e investimit që do të kryejë subjekti. Në këtë procedurë u konstatuar parregullsitë:

-Komisioni i dhënies me koncesion nuk ka në përbërje të tij ekspert të fushës, në kundërshtim me përcaktimet e bëra pikën 2 të nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013, “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*”, i ndryshuar.

-Në procesverbalin e mbajtur për kualifikimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe në raportin përmbledhës, nuk pasqyrohet asnjë informacion mbi dorëzimin ose/jo të dokumentacionit të kërkuar në përmbushje të kriterëve teknike, shtojca 10, një plan të detajuar në lidhje me kapacitetin logjistik të shoqërisë dhe një plan të përgjithshëm mbi disponueshmërinë e pajisjeve, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e të gjitha pajisjeve, mjeteve dhe programeve kompjuterike gjatë periudhës së Koncesionit.

-Raporti i vlerësimit nuk përmban informacionin sipas përcaktimit të bërë nenin 68 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Sa më sipër nuk është në përputhje me pikën 2, të nenit 18 në Ligjin nr. 125/2013, “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*”, i ndryshuar, dhe nenin 68 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**3.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që komisionet e ngritura për procedurat e dhënies me koncesion, të kenë aftësitë profesionale përkatëse si dhe të mbikëqyrin që në procedurat e hartimit të dokumenteve të tender, raportet e vlerësimit të kenë formatet dhe informacionet përkatëse.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Raporti përmbledhës i përgatitur nga komisioni i dhënies me koncesion është bërë pas hartimit të studimit të fizibilitetit, ndërkohë që ky dokument hartohet përpara përgatitjes së studimit të fizibilitetit. Ky raport është i rëndësishëm për vendim marrjen e AK për vazhdimësinë e projektit.

Në raportin përmbledhës drejtuar titullarit të AK, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK. Në mendimin e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik, nëpërmjet MEMO-s nr. s'ka, datë 27.08.2018, nuk pasqyrohet mendimi i drejtorisë së mësipërme për impaktin që mund të ketë dhënia me koncesion në drejtim të deficitit buxhetor dhe detyrimeve kontingjente eventuale.

Nuk administrohet miratimi i projektit për dhënien me koncesion, nga titullari i AK. Konkretisht në MEMO-n, nr. s'ka, datë 03.09.2018, përgatitur nga ish Sekretari i Përgjithshëm, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ku kërkohet miratimi i projektit për vazhdimin e procedurave, pra shpalljen e njoftimit të kontratës në APP, mungojnë elementë që i japin fuqi ligjore dokumentit, konkretisht mungon vula e institucionit dhe si i tillë nuk vërteton miratimin nga titullari i AK. Sa më sipër nuk është në përputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 9 dhe neni 15, pika 3 dhe nenet 13, 14 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që dokumentet e hartuara nga punonjësit, si raporte, vlerësime, studime, të ndjekin pjesët e kontrollit dhe miratimeve përkatëse duke i pajisur me fuqi ligjore, si dhe plotësimin e kushteve që kërkojnë elementët e gjurmës së auditimit.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk plotëson shkronjën “a” të pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në DST. Konkretisht në shkronjën “a” të pikës 2.2 kërkohet: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të Pasqyrave Financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet – Nga verifikimi i pasqyrave financiare, në vitin 2016 subjekti “N. C.” shpk ka dalë me humbje. Nëse do ti referohemi edhe shpjegimit të AK drejtuar KPP me shkresën nr.17871/2 prot., datë 09.10.2018, rezulton se qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qenë shprehimisht: Sipas këtij parashikimi (pra aktivitet pozitiv të qëndrueshëm) ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do të kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave financiare.

Gjithashtu edhe KPP në trajtimin e ankesës së subjektit “P. T. SA”, shprehet se dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite, është një parakusht që tregon rrezikun potencial të mos përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike.

-Në kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, kërkohet që operatori ekonomik duhet të përmbushte kriterin e “Certifikatës së Akreditimit”, lëshuar nga DPA. Në datën e nënshkrimit të kontratës, shoqëria “N. I.” shpk nuk ka qenë e akredituar sipas kriterit parësor të kërkuar nga MFE. Kjo shoqëri është pajisur me certifikatë akreditimi më datë 10.01.2020 (pesë muaj pas

nënshkrimit të kontratës). OE “N. C.” Sh.P.K nuk duhet të ishte kualifikuar për fazën e vlerësimit të kriterëve teknike. Sa më sipër është në kundërshtim me shkronjën “a” të pikës 2.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që komisionet e ngritura për procedurat e dhënieve me koncesion, të kenë aftësitë profesionale përkatëse si dhe të mbikëqyrin procedurat e vlerësimit për të pasur zgjedhje efektive dhe eficiente.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e mendimit për përmbajtjen e draft-kontratës koncesionare. Autoriteti i konkurrencës ka marrë në shqyrtim draft-kontratën dhe ka marrë vendimin nr.646, datë 09.08.2019, duke konstatuar dhe rekomanduar ndryshime në nenin 14 të Draft Kontratës “Tarifa e Shërbimit, tarifa koncesionare dhe mënyra e pagesës”, duke përcaktuar se në rast të ndryshimit të tarifave të paraparakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës, për faktin se e drejta e dhënë në ofrimin e këtij shërbimi krijon një të drejtë ekskluzive.

Autoriteti i Konkurrencës me vendimin nr.863, datë 15.02.2022 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj shoqërisë “N. C.” SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit.

-Në përfundim të procedurës hetimore, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë vendimin nr.884, datë 18.05.2022, për mbylljen e procedurës hetimore dhe në përfundim ka dhënë rekomandime për MFE:

a) Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos.

b) Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” SHPK, të merret paraparakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës.

c) Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme, duke implementuar rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës ex-ante me vendimin nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).

Rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në vlerësimin ligjor që ka kryer, nuk janë zbatuar, pavarësisht faktit se në dy vendimet, është cilësuar që përmbajtja e kontratës koncesionare, neni 14, mund të krijojë hapësira për koncesionarin që të abuzojë me pozitën dominuese, si dhe të cenohet konkurrenca. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 1 të nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit duhet të marrin masa për Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos. Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” SHPK, të merret paraparakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës. Miratimin e një metodologjie për vendosjen e përqindjes për instrumentet matës të verifikuara që rezultojnë me probleme.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, në periudhën 2022-2023, me shkresa të ndryshme drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE, ka paraqitur problematika të një numri të konsiderueshëm subjektsh të cilave nuk i është kryer ende inspektimi fillestar dhe periodik. Gjithashtu janë paraqitur konstatime për parregullsi teknike/evidentime të këputjes së shenjave metrologjike si dhe konstatime të mos lidhjes së distributorit me pajisjen fiskale në disa subjekte, të cilat kanë pasur pasoja në krijimin e evazionit fiskal.

MFE, me shkresën nr. 3860/1 Prot., datë 10.05.2023, i ka kërkuar për ndjekje dhe marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e situatës ISHMT dhe DPT.

ISHMT në tagrin e organit përgjegjës duhet të kryente verifikimet në të gjitha subjektet për të cilat shoqëria koncesionare ka evidentuar shkelje dhe sipas rastit të merrte masa sanksionuese siç parashikon Ligji nr.126/2020 “Për metrologjinë”. DPT nëpërmjet strukturave të saj kompetente, duhet të kryente të gjitha verifikimet përkatëse në subjektet e raportuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë koncesionare, dhe të procedonte sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. MFE ka kërkuar informacion mbi masat përkatëse të mara nga këto institucione në cilësinë e AK, për ndjekjen e kontratës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton përgjigje nga ISHMT dhe DPT për këtë shkresë, apo kërkesë e përsëritur nga MFE mbi bashkërendimin e punës me ISHMT dhe DPT për ndjekjen e situatës së mësipërme, që lidhet me zbatimin e kontratës koncesionare.

Sa më sipër është në kundërshtim me detyrat e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, shtojcën 4 të kontratës koncesionare, si dhe Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e MFE. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 68-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që ISHMT dhe DPT në zbatim të kompetencave si organe përgjegjës, të kryejnë verifikime për problematikën që evidentohen nga koncesionari, për të siguruar veprimtarinë normale të objektit të kontratës si dhe për të parandaluar rastet e krijimit të evazionit fiskal.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Kontrata koncesionare në përmbajtjen e saj nuk reflekton plotësisht kërkesat e përcaktuara në DST, detyrim ligjor ky për t’u zbatuar nga Autoriteti Kontraktues. Konkretisht pika 14.2 e kontratës nuk është në përputhje me pikën 1.3.1 në specifikimet teknike të vendosura në DST, pasi në kontratë frekuenca e verifikimit përcaktohet jo më pak se dy herë në vit, ndërkohë në DST përcaktohet specifikisht dhe pa hapësira, verifikimi do të kryhet dy herë në vit, pra përjashton mundësinë për më tepër verifikime.

Gjithashtu edhe pika 20.2.7 e kontratës koncesionare nuk është në përputhje me përcaktimin në DST. Konkretisht në pikën 20.2.7 përcaktohet se AK brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore, ndërkohë në DST, pika 1.3.3, paragrafi i fundit, përcaktohet se brenda një afati minimal nga nënshkrimi i kontratës, do të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore.

Kontrata është nënshkruar ndërmjet MFE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe shoqërive “N. C.” shpk dhe “N. I.” shpk, në cilësinë e Kontraktorit, kur shoqëria “N. I.” shpk nuk ka qenë operator ekonomik pjesëmarrës apo fitues i procedurës konkurruese.

Kontrata koncesionare, objekti i saj, nuk është në përputhje me detyrat e caktuara shoqërisë përcaktuar me VKM nr. 365, date 20.06.2018, pasi koncesionari kërkon të realizojë sipas kontratës shërbimet e verifikimit fillestar, pasardhës (verifikim periodik të detyrueshëm, verifikim jashtë radhe me kërkesë të subjektit, verifikim pas riparimit) dhe verifikim pa tarifë jashtë frekuencës të zakonshme, duke rritur intervalet e verifikimit të instrumenteve pa pasur referim ligjor apo rekomandime nga institucione të brendshme apo ndërkombëtare, duke pasur ndikim në rritjen e shpenzimeve të subjekteve të tregtimit të hidrokarbureve me pakicë, dhe

duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e çmimit të produktit, dhe për rrjedhojë te konsumatori fundor.

Sipas kontratës koncensionare, monitorimi i zbatimit të kontratës do të bëhet nga autoriteti kontraktues MFE, ndërkohë që monitorimi i instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar është detyrë ligjore e DPM<sup>së</sup>. Po ashtu, intervalet e verifikimit të instrumenteve matës janë përcaktuar në akte ligjore të DPM, bazuar në rekomandimet europiane, si rrjedhojë shoqëria koncensionare nuk mund të përcaktojë intervale verifikimi të instrumenteve matës.

Sipas kontratës koncensionare kompania koncensionare mund të kryejë nën-kontraktime edhe pse këtë shërbim e ka të drejtë ekskluzive për ta kryer vetëm (Konçesionari).

Po ashtu, sipas kontratës koncensionare, shoqëria koncensionare nëpërmjet saj do të realizojë shërbimin e verifikimit fillestar dhe verifikimit pas riparimit, kur verifikimi i parë është shërbim që referuar direktivave evropiane kryhet nga prodhuesi i instrumentit matës, duke e markuar instrumentin me markimin CE, ndërsa shërbimi i dytë, verifikimi pas riparimit i referohet ligjit “Për metrologjinë”, ku DPM nuk mund të kryejë riparimin dhe verifikimin pas riparimit të instrumentit matës pasi është në kundërshtim me ligjin e konfliktit të interesit, për analogji në të njëjtin konflikt është apo mund të jetë edhe shoqëria koncensionare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që në të ardhmen në lidhjen e kontratave koncensionare, kushtet kontraktore mes palëve të reflektojnë përcaktimet e bëra në dokumentet e tenderit si dhe kuadrin ligjor rregullues.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në shqyrtimin e dokumenteve të Projektzbatimit u konstatuan parregullsitë:

-Mungesa e informacionit mbi tarifën e verifikimit jashtë radhe, pra ku bazohet, struktura e kostos, shpjegimet dhe argumentet.

Projektzbatimi, në lidhje me software-in që do të instalohet me qëllim raportimin dhe monitorimin në kohë reale të shërbimit të verifikimit, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit”. Konkretisht në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, lidhur me software-in, përdoruesit dhe produktet që përfitohen prej tij në varësi të përdoruesit, nuk përcaktojnë shkarkimin e raporteve të gjeneruara, përmbajtjen e këtyre raporteve, rezultatet e verifikimit në një subjekt, si dhe problematikat që kanë dalë nga verifikimet e kryera, kohën mesatare për të realizuar rekomandimet që janë dhënë dhe masat që janë ndërmarrë.

Projektzbatimi sa i përket planit të burimeve njerëzore, nuk është në përputhje të plotë me dokumentet e ofertës teknike, konkretisht me dokumentin “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”, si dhe nuk përcakton planin e trajnimit hyrës, ndërkohë në dokumentin e ofertës teknike “Plani i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve”, përcaktohet se si do të organizohet kursi hyrës i trajnimit teoriko-praktik.

Në Projektzbatim mungon informacioni për kalibrimin e pajisjeve matëse, frekuencën e kalibrimit, laboratorin ku do të kalibrohen etj.

Projektzbatimi sa i përket shpenzimeve kapitale, nuk është në përputhje me dokumentet e ofertës teknike pasi në projektzbatim ka një tjetër vlerë për investim. Për më tepër për pajisjen flowmetër nuk jepet informacion. Gjithashtu nuk ka një shpjegim për rritje të konsiderueshme të vlerës së investimit në sistemin online, si dhe në pajisje zyre. Vlera e investimit sipas projektzbatimit, nuk është në përputhje me modelin financiar të dorëzuar nga OE gjatë procedurës konkurruese, ku përlllogaritjet për vlerën e IRR dhe NPV janë bërë për vlerën e investimit 70,000,000 lekë. Ndryshimi i vlerës së investimit, pra rritje të saj, përkthehet në rritje të kostove të subjektit, duke ndryshuar vlerën e NPV dhe IRR. Për më tepër që ndryshimi i

vlerës së investimit krijon detyrimin për shoqërinë koncesionare që të dorëzojë modelin financiar të përditësuar.

Gjithashtu në dokumentin e ofertës teknike të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese “*Pajisjet, Logjistika, Eksperienca dhe Sistemi i Informacionit*”, makinat që do të përdoren si autolaborator, janë tipi Volkswagen Transporter Van T6 KR 2.0 TDI, 75 Kw, ndërkohë në projektzbatim, makinat që do të përdoren si autolaborator janë tipi Ford Transit Custom.

Referuar sa më sipër, projektzbatimi nuk është në përputhje të plotë me ofertën teknike, si dhe bazuar në kontratën koncesionare, neni 8, pika 8.1, NJZP nuk duhet të kishte shprehur miratimin e projektit të zbatimit, por t’ia rikthente Shoqërisë Koncesionare “N. I.”, për korrigjim.

Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 08.02.2013 “*Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të DPM*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që në të ardhmen vlerësimi e miratimi i Projekteve të Zbatimit në kontrata koncesionare/PPP të kryhet me përgjegjshmëri e profesionalizëm.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në dosjen e procedurës së zbatimit nuk administrohet raporti i investimeve të realizuara, përcjellë nga Shoqëria Koncesionare N. I. Sh.P.K, me shkresën nr.14 prot., datë 17.01.2020 protokolluar në MFE me shkresën nr.992, datë 17.01.2020.

NJZP përpara kryerjes së verifikimit të investimit të realizuar nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, nuk ka nënshkruar deklaratën e ekzistencës/jo të konfliktit të interesit.

Nuk administrohet asnjë dokumentacion mbështetës që vërteton kryerjen e investimit, duke i’u referuar edhe mbishkrimit në raportin e verifikimit të mbajtur nga NJZP, shprehimisht: “*Gjithashtu u kërkua dokumentacioni mbështetës që vërteton investimet e kryera*”.

Investimi i kryer, sipas informacionit të paraqitur në raportin nr.2, datë 24.01.2020 të mbajtur nga NJZP, për verifikimin e investimit të kryer, është në vlerën 79,305,455 lekë, pra jo sa vlera e përcaktuar në nenin 15 të kontratës koncesionare, në projektzbatimin, modelin financiar dhe planin e zbatimit dhe ri-investimit. Theksojmë se realizimi i investimit jo sipas përcaktimeve të mësipërme, sjellë moszbatimin e nenit 9, pika 9.1 në kontratën koncesionare, sa i përket garancisë në vlerën 7,000,000 lekë në masën 10 % të vlerës së investimit. Theksojmë se në nenin 15 është përcaktuar që vlera e investimit do të jetë 70,000,000 lekë, pra sipas shtojcës 3 “*Modeli financiar*”.

-Sa më sipër NJZP nuk duhet të kishte propozuar miratimin e investimit të kryer, por të rekomandonte kryerjen e tij sipas parashikimeve kontraktuale. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 15 të kontratës koncesionare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa Njësia e Zbatimit të Projektit në detyrat e monitorimit të kontratës koncesionare, të plotësojë raportet e verifikimit me dokumente mbështetëse që vërtetojnë investimet e shpenzimet e kryera.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në raportimet e kryera nga koncesionari për periudhën 2021, u konstatua se mungonin:

-Numri i kontrolleve për regjimin automatik, subjektet të cilat janë kontrolluar, dhe çfarë ka rezultuar nga këto kontrolle. -Numri i subjekteve debitore, vlera progresive e debisë së krijuar dhe e raportuar. - Numri i trajnimeve të kryera, temat e trajnimit dhe punonjësit e trajnuar; - Numri i subjekteve që kanë aplikuar për verifikimin fillestar, listën me subjekte dhe datë

aplikimi. -Numri dhe lista e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “*instrument matës jo në përdorim*” kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit. - Numri i punonjësve në strukturë, formimin profesional, si dhe nëse ka pasur rekrutime të reja apo largime përgjatë periudhës së raportuar; - Të ardhurat e realizuara përgjatë 3-mujorit të raportuar. - Tarifat e aplikuara, për inspektimet fillestare të kryera me tarifën përkatëse, 336 inspektime jashtë radhe me tarifën përkatëse. Tarifat e aplikuara për instrumentet matës ligjërish të kontrolluar që gjatë inspektimit/verifikimit nuk e kalojnë testin. - Lista e subjekteve të cilët kanë ngelur në inspektimin fillestar apo periodik. - Gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës, nëse ka pasur defekte të cilat kanë penguar realizimin e shërbimit. - Data baza e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimi i fundit i kryer. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenet 13,19,21 të kontratës së koncesionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që koncesionari në raportet e tij periodike të paraqesë me besueshmëri kontrollat e ndryshme të zhvilluara, subjektet e kontrolluar, tarifin e aplikuara me rezultatet përkatëse. Një element i rëndësishëm i raportimit është data baza e përditësuar me subjektet, numrin e pistoletave për subjekt, verifikimet e fundit të kryera, numri dhe lista e subjekteve në të cilët pistoletat e mbyllura me dëshirë, pra të identifikuar me mbishkrimin “*instrument matës jo në përdorim*” që kanë kaluar afatin 30-ditor të qëndrimit në vendin e përdorimit. Koncesionari duhet të paraqesë numrin e punonjësve në strukturë, formimin profesional, trajnimet e kryera, temat dhe punonjësit e trajnuar, gjendjen teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës si dhe problematikat që kanë penguar në realizimin e shërbimit.

*Në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyra e pozicionit financiar, llogaria ekonomike të drejta të arkëtueshme, e cila përfaqëson subjektet që nuk kanë paguar tarifën e shërbimit të verifikimit/debitorët ndaj Shoqërisë Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, rezulton se në fund të vitit 2020 debitorët janë në vlerën 16,585,840 lekë, vitit 2021 debitorët janë në vlerën 14,913,125 lekë dhe vitit 2022 debitorët janë në vlerën 11,032,330 lekë.

Pavarësisht faktit se vlerat e mësipërme, bazuar në SKK janë njohur si të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, ato tregojnë se Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, nuk ka zbatuar nenin 14, pika 14.4 të kontratës koncesionare. Sipas referencës ligjore, Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K është përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave që vijnë nga kryerja e shërbimit të verifikimit. Çdo faturë e lëshuar për shërbimin e kryer përbën titull ekzekutiv.

Në 60 raste është konstatuar moszbatimi i kontratës. Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, në kushtet kur fatura që lëshon është titull ekzekutiv, duhet të kishte bërë kërkesë padi në gjykatë, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, nëpërmjet të cilit të ngarkohej shërbimi përmbartimor për ekzekutimin me forcë të detyrimeve. Si rrjedhojë e situatës së mësipërme, pra moszbatimi i kontratës nga Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, po nga ky subjekt nuk është kryer shërbimi i verifikimit ndaj subjekteve të mësipërme, me pretendimin se nuk kanë paguar tarifën dhe në këto kushte nuk i ofrohet verifikimi. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, neni 1 shkronja “f”, për mbrojtjen e konsumatorëve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të marrin masa që Koncesionari të ndjekë me përparësi procedurat e faturimit dhe likuidimit nga subjektet, për të realizuar objektivin e kontratës, dhënien e sigurisë për instrumentet e shpërndarjes së karburantit dhe gazit të lëngshëm për konsumatorët.

*Në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i pasqyrave financiare, konkretisht pasqyrës së performancës financiare, llogaria ekonomike “*Të ardhura operative*”, rezulton se shoqëria Koncesionare “N. I.” SHPK, për vitin 2021 ka realizuar të ardhura në vlerën 96,210,200 lekë, pra tarifa koncesionare për t’u paguar është 2.5% të 96,210,200 lekë = 2,405,255 lekë.

Me qëllim vlerësimin nëse përputhen të dhënat mbi vlerën e të ardhurave të realizuara dhe të raportuara në PF, me të ardhurat që duhet të realizojë Shoqëria Koncesionare, duke pasur në konsideratë tarifat e miratuara, llojin e verifikimeve të kryera, si dhe 3 variantet në varësi të numrit të pistoletave në një stacion karburanti, grupi i auditimit bëri përlllogaritjet për vitin 2021, bazuar në të dhënat për verifikimet e kryera duke i përlllogaritur me tarifat minimale, për 1,234 verifikime fillestare kaluese, 644 verifikime fillestare ngelëse, 1,238 verifikime jashtë radhe kaluese, 133 verifikime jashtë radhe ngelëse, 13,044 verifikime periodike kaluese, ku vlera totale është 110,399,350 lek.

Në krahasim me të ardhurat e realizuara, krijohet diferenca 110,399,350 lek – 96,210,200 lek = 14,189,150 lek \* 2.5% = 354,728 lek më pak.

-Situata e mësipërme tregon se grupi i monitorimit të ngritur me urdhrin nr.129, datë 19.04.2022, nuk ka kryer verifikimin e plotë të dokumentacionit financiar.

-Gjithashtu kjo situatë tregon se edhe NJZP nuk ka kryer monitorimin e dokumentacionit përkatës, me qëllim kryerjen e përlllogaritjeve dhe vlerësimin e të ardhurave që duhet të kishte realizuar Shoqëria Koncesionare Sh.P.K, mbi të cilat përlllogaritet tarifa koncesionare. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrin masa që Njësia e Zbatimit të Projektit të raportojë për monitorimin e kontroleve të kryera nga Koncesionari me qëllim kryerjen e përlllogaritjeve dhe vlerësimin e të ardhurave që duhet të kishte realizuar Shoqëria Koncesionare “N. I.” Sh.P.K, mbi të cilat përlllogaritet tarifa koncesionare.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Sipas kërkesave të DST (termat e referencës), të cilat operatori ekonomik ka marrë përsipër t’i plotësojë dhe t’i zbatojë, konkretisht në sistemet e informacionit, është përcaktuar zhvillimi i një platforme online për qëllime kontrolli/mbikëqyrje. Pasi të kryhet shërbimi, çdo e dhënë/proces/dokument duhet regjistruar në sistemin online, të cilat mund të ekstrahohen ose shkarkohen në formën e dokumenteve ose certifikatave. Sistemi do tu japë mundësi klientëve, për të kontrolluar të dhënat e Shërbimit direkt nga interneti. Gjithashtu sistemi do të përdoret dhe për qëllime statistikore raportimi.

Nga verifikimi i kryer në sistemin e ngritur nga “N. I.” SH.P.K, konstatohet se nuk ofrohet mundësia për të aksesuar raportet e monitorimit periodike të aktivitetit të koncesionarit; Nuk ngarkohen të gjitha dokumentet që lidhen me një proces verifikimi, konkretisht nëse instrumenti ka ngelur në testim, në inspektimin që kryhet jashtë radhe, nuk administrohet njoftimi i auto-riparuesit drejtuar “N. I.” SH.P.K., për të vlerësuar respektimin e afatit kohor prej 30 ditësh në kryerjen e verifikimit jashtë radhe; Nuk ofrohet mundësia për të monitoruar/mbikëqyrur se sa subjekte kanë aplikuar për verifikimin fillestar të instrumentit, për të bërë më pas kontrollin e respektimit të afatit nga data e aplikimit deri në datën e kryerjes së verifikimit; Në disa verifikime të kryera nga “N. I.” SH.P.K., sipas raport verifikimit të lëshuar nga inspektorët, konstatohet se përdoret termi “*Ngel me dëshirë*”, ndërkohë që një përkufizim i tillë nuk parashikohet në legjislacionin në fuqi, përkundrazi parashikohet bllokimi i instrumentit ose lejimi i përdorimit të tij. Në rast se instrumenti nuk përdoret nga subjekti, atëherë në instrument vendoset shenjë dalluese me mbishkrimin jashtë përdorimit, si dhe brenda 30 ditëve, instrumenti duhet të hiqet nga vendi i ushtrimit të aktivitetit. Për më tepër që këto verifikime nuk dokumentohen plotësisht me foto (ndryshe në rastet e tjera, ku në sistem ngarkohen edhe foto) ku të verifikohet se instrumenti nuk është në përdorim.

-Shoqëria Koncesionare nuk ka publikuar në faqen e saj web, emrat e pikave të karburantit të cilat nuk kanë kryer pagesën dhe nuk janë verifikuar, kanë hequr shiritin ose shenja të tjera dalluese, rezultojnë se kanë në përdorim instrumente matës me probleme metrologjike.

Sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën e Koncesionit, shtojca 1, Dokumentet e tenderit për projektin “*Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm*”, pika 1.3.4, sistemet e informacionit, si dhe pika 21.1.9.

Mos pasja e të dhënave të veprimtarisë së Koncesionarit në sistemin online, ul transparencën dhe rrit riskun për veprime abuzive të ndërsjella dhe vështirëson vlerësimin e performancës. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandimi:** Njësia Zbatuese e Projektit të kërkojë nga shoqëria koncesionare zbatimin e kushteve kontraktore në lidhje me sistemet e informacionit që janë sistemi online dhe publikimi në faqen web i subjekteve me pajisje jo konform standardeve të kërkuara. Sistemet e informacionit janë pjesë thelbësore në monitorimin e kontratës, transparencën e veprimeve të kryera nga koncesionari si dhe sigurinë që nuk ka abuzime me pozitën dominuese që mund të krijohet në zbatimin e kontratës së koncesionit.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE TË ARDHURAT E MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Procedura e dhënies me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, nga MZHETS, është në kundërshtim me kuadrin rregullator të koncesioneve. Forma e zgjedhur është nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, të subjektit “A. N. C.” Sh.P.K, me argumentin se: “*Aktiviteti që kryhet aktualisht nga DPM, nuk bazohet në teknologji të përparuar, në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës dhe kjo shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer*”, duke pasur bashkëlidhur propozimit, studimin e fizibilitetit. Objekti i kërkuar në propozim nuk përfshihet në fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës së koncesioneve.

Projekt-vendimi dhe relacioni shoqëruar i tij, përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim, është në kundërshtim me kërkesat e kuadrit rregullator të koncesioneve, kryesisht në përmbajtjen e projekt-akteve që propozohen për miratim. Relacioni shoqëruar përmban të dhëna jo të sakta, sa i përket mungesës së efekteve në buxhet të këtij projekt vendimi, pasi DPM nga shërbimi i verifikimit të pistoletave të karburantit realizon 76,193,121 lekë, të cilat kalojnë për llogari të buxhetit të shtetit dhe me dhënien me koncesion këto të ardhura janë të munguara për Buxhetin e Shtetit.

- Mendimet e dhëna nga Ministritë e Linjës, kryesisht mendimet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, bien në kundërshtim me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës, konkretisht në VKM që përcakton fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive të mësipërme.

MZHETS duhet të ishte shprehur kundër dhënies me koncesion, pasi e ka detyrë (VKM për përgjegjësinë shtetërore) që të vlerësojë nëse një projekt-akt është në përputhje me politikat e qeverisë. Në këtë rast ky projekt-akt bie në kundërshtim me politikat e qeverisë, pasi në strategjinë për mbrojtjen e konsumatorit 2015-2020 (dokument politik i qeverisë, cilësuar në krye të herës në përmbajtje të strategjisë) miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015, në planin e veprimit nuk është përcaktuar si objektiv dhënia e shërbimit të verifikimit metrologjik të pistoletave të karburanteve nëpërmjet koncesionit/formë tjetër ligjore. Në procedurën e ndjekur nuk është marrë mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nuk është marrë



mendimi i Ministrisë së Mjedisit, ku sipas raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, megjithëse në vlera të ulëta, projekti mund të ketë ndikim në mjedis. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar me Ligjin nr. 88/2014 dhe Ligjin Nr.77/2015, në fuqi për periudhën kur janë kryer veprimet e MZHETTS, neni 3, pika 10, neni 4, pika 1.

-Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e auto-laboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Konkretisht për kryerjen e këtij shërbimi, janë investuar 63,975,994 lekë në blerjen e 9 auto-laboratorëve si dhe pajisjet e nevojshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si dhe Ministrinë përkatëse të analizojnë vlerën 63,975,994 lekë si përdorim pa efikasitet të fondeve të Buxhetit e Shtetit, si dhe të marrin masa që në të ardhmen, vendim marrja për dhënien e koncesioneve të jetë në përputhje me politikën dhe strategjitë e aprovuara, brenda kuadrit rregullator dhe e bazuar në vlerësime objektive të identifikimit të mungesës së shërbimeve dhe nevojave për investime.

*Menjëherë e në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se nuk është respektuar periudha prej 12 muaj për të ndërmarrë angazhimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit të metrologjisë apo propozimin e ligjit të ri të metrologjisë, pasi ligji i ri i metrologjisë është miratuar më datë 15.10.2020, ndërkohë kontrata koncesionare është lidhur më datë 21.08.2019.

-Në vijim të situatës së mësipërme MFE, me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020, i është drejtuar DPM për ndërprerjen e shërbimit të verifikimit metrologjik të karburanteve pasi ky shërbim do të ofrohet nga koncesionari, kur përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës (ligji për metrologjinë), ngarkonin DPM për kryerjen e këtij shërbimi. Pra sipas kësaj shkrese DPM urdhërohet të ndalohet të kryejë shërbimin të cilin e ka detyrim ligjor, vetëm me arsyen e ekzistencës së kontratës koncesionare. Ndërkohë në këtë rast në kontratën koncesionare është parashikuar që do të kryhen ndryshimet ligjore që të mundësojnë ofrimin e shërbimit nga koncesionari.

-Nëse do t'i referohemi të ardhurave që do të realizoheshin, në rastin sikur shërbimi do të kishte vazhduar nga DPM përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 (ligji është miratuar më datë 15.10.2020, publikuar në fletore zyrtare më datë 18.12.2020, hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit) do të kishim 64,365,500 lekë të ardhura të realizuara nga koncesionari sipas pasqyrave financiare të mbyllura për periudhën Prill-Dhjetor 2020, minus  $(2.5\% * 64,365,500 \text{ lekë}) = 62,756,362 \text{ lekë}$ , të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, neni 8, pika 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 105-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Ministri, të analizojnë vlerën 62,756,362 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit si dhe të marrin masa që në të ardhmen procesi i dhënies me koncesion i shërbimeve, të shoqërohet dhe me ndryshimet ligjore përkatëse.

*Në vijimësi*

## C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për

përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, si dhe për arsye të ndarjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i rekomandohet Titullarëve të Ministrive përkatëse, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit:

Të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë disiplinore për drejtuesit e institucioneve të audituara, si dhe këto të fundit për punonjësit e varësisë sipas përgjegjësisë individuale dhe funksioneve zyrtare që mbajnë, si dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**